

GËZIM MEKULI

**FJALIMET
QË PËRGJAKËN
BALLKANIN**

Analizë retorike e fjalimeve të Millosheviqit

Botues: Kristë Shtufi

Lektor: Salih Mehmeti

Realizimi: Albert Zuka

Ilustrimi i ballinës: Bujar Sylejmani

Shtypi: Printing Press – Prishtinë

ALPHABET J&H

Blvd. Bill Clinton p. n.

(Objekti nën shkallët e hyrjes së Katedrales së Prishtinës)

10000 Prishtinë, Kosovë.

E-mail: alphajorahera@gmail.com

Tel.: +383(0)44/988-412

© by autori, 2022

Të gjitha të drejtat e rezervuara, edhe ato të riprodhimit
fotomekanik brenda dhe jashtë kufijve të Republikës së
Kosovës.

ISBN 978-9951-826-08-2

Printed in Kosova

Falënderime

Ky libër nuk do të dilte në dritë pa inkurajimin, dashamirësinë dhe këshillat mirëdashëse të njerëzve të mirë. Ua di për nder dhe u jam mirënjohës nga e bardha e zemrës të gjithë atyre që ishin pranë meje duke më mbështetur dhe frymëzuar gjatë mbarështimit të këtij libri.

Por, hisen më të madhe të falënderimit, besoj, e meritojnë Edita dhe Noka për durimin dhe mirëkuptimin e pafundmë. E, parasëgjithash, ky libër i kushtohet dy prindërve të mi fisnik; është një tribut përkujtimor për Mamin tim të dashur që vdiq nga pasojat e fjalimeve që përgjakën Ballkanin.

PËRMBAJTJA

HYRJE	9
1.0. RETORIKA.....	14
1.1. Mediat dhe retorika	15
1.2. Orientimi në pamje dhe zë	16
1.3. Elementet retorike për të ndikuar në publik	16
a. Mbi Ethosin	17
b. Mbi Pathosin.....	18
c. Mbi Logosin.....	21
1.4. Vlerësimi retorik	22
2.0. TEORIA DHE METODA	23
2.1. Ndikimi ndaj publikut dhe situata retorike: kairos	25
2.2. Teori e perspektiva vështrimi.....	27
2.3. Kushtet retorike	30
2.4. Analiza e përbërjes në togfjalësha	32
2.5. Termetat kyç.....	33
2.6. Krijimi i publikut nga retorika.....	35
2.7. Të kuptuarit e publikut retorik: rasti i Quebecut.....	36
2.8. Duke shpikur një identitet	38
2.9. Një botë metaforash.....	39
3.0. HISTORIKU	41
3.1. Ballkani gjatë Periudhës Osmane dhe Kongresi i Berlinit (1878)	41
3.2. Kosova si baza e kryengritjeve shqiptare	42
3.3. Lufta e Dytë Botërore	43
3.4. Shpërthimi në Kosovë	44
3.5. Kontradiktat etnike	46
3.6. Shfaqja e nacionalizmit serb (1987-1989)	47
3.7. “Askush nuk do t’ju rrahë kurrë!”	48
3.8. Gjurmëve të Çubrilloviqit	49
3.9. Media ose “një mbajtëse mikrofoni”	51
4.0. FJALIMET	54

5.0. FJALIMI NË GAZIMESTAN DHE PRAPAVIJA E TIJ (1989)	57
5.1. Situata retorike në Gazimestan	57
5.2. Përmbajtja e fjalimit	61
5.3. Pranuesit e fjalimit dhe pasojat	63
6.0 ANALIZA E GAZIMESTANIT	66
6.1. Analiza e fjalëve simbol	66
6.2. Fjalët kyçe	69
6.3. Kosova, mit dhe identitet	71
6.4. “Vetëm Uniteti do të shpëtojë Serbinë”	73
6.5. Tradhtitë e vjetra, tradhtitë e reja	75
6.6. Ambivalenca e “unitetit”	77
6.7. Heroizmi për të sotmen	78
6.8. Një kod i vjetër lufte	80
6.9. Ndërtimi i publikut të dyzuar	81
6.10. Demonizimi i “tjetrit”	84
6.11. Shkrirja e mitit dhe historisë	88
6.12. Roli i liderit të kombit	90
6.13. “Mesjeta e gjallë”	93
6.14. “Kryqi dhe gjysmëhëna”	96
6.15. Katër “S”-të	98
6.16. “Zemra” e Serbisë	99
6.17. “Populli qiellor” gati për luftë	101
7.0. FJALIMI NË BEOGRAD (1999)	103
7.1. Prapavija	103
7.2. Situata retorike	103
7.3. Përmbajtja e fjalimit	105
7.4. Pasojat e fjalimit	106
7.5. Analiza e fjalimit në Beograd	107
7.6. Duke ruajtur homogjenitetin	108
7.7. Luftë për veten, luftë për botën	109
7.8. Qytetarë dhe “qytetarë”	111
7.9. Përsëri Kosova	113
7.10. Daullet e luftës ende rrahin	114
7.11. Viktimizimi	115
7.12. Ndërtimi i publikut	117
7.13. Pikëpamja për botën dhe sajimi i publikut	119
7.14. “Populli ishte ushtri dhe ushtria ishte popull”	120
7.15. Paradoksi i luftëtarit dhe viktimës	121
7.16. Të “tjerët”	123
7.17. Kulti i vdekjes	125

8.0. FJALIMI NË BEOGRAD, 2000	127
8.1. Prapavija	127
8.2. Situata retorike	128
8.3. Përmbajtja e fjalimit	130
8.4. Pasojat e fjalimit	131
8.5. Analiza e fjalimit në Beograd (2000).....	132
8.6. Analiza e grupimit të fjalëve.....	134
8.7. Boshti i së keqes	135
8.8. Një identitet as andej, as këndeje	138
8.9. Diskursi “antikolonialist”	141
8.10. Sajimi i publikut.....	145
8.11. Frikë e paranojë	147
8.12. Pikëpamja mbi botën dhe ndërtimi i publikut	149
8.13. Përsëri Kosova.....	151
9.0. PËRMBLEDHJE	154
9.1. Vizione serbocentrike	155
9.2. Kosova, një ide mitike	157
9.3. “Nderi i humbur”	159
9.4. Retorika politike përçan	161
9.5. Për fund.....	162
TRE FJALIMET	164
Shtojca 1: Kremtimi i 600-vjetorit të Betejës së Kosovës në Gazimestan (1989).....	164
Shtojca 2: Fjalimi presidencial i Millosheviqit në Beograd (1999)	169
Shtojca 3: Fjalimi presidencial i Millosheviqit në Beograd (2000)	172
10.0. BIBLIOGRAFIA	178

HYRJE

Si e përdorin politikanët gjuhën për të bindur publikun? Cilët njerëz kanë aftësi magjike për të bindur të tjerët që të bëhet edhe e papërfytyrueshmja: të vriten fëmijë të palindur në barkun e nënës? Cila fuqi bindëse mistike mund të ngre një popull në këmbë për të djegur e për të dhunuar një popull tjetër? Ndoshta nuk është fare fuqi mistike, nuk është as fuqi mbinatyrore, por veçse një *teknikë njerëzore* ose edhe *aftësi*. Një aftësi që ne duhet ta njohim, ta zbulojmë dhe të mësojmë më shumë rreth saj. Jo për të vrarë njëri-tjetrin, por për të parandaluar këtë. Ne duhet të mësojmë se si ta zbulojmë, por edhe ta kundërshtojmë fuqinë e bindjes kur kjo përdoret për qëllime djallëzore. Dhe ne vetë duhet të mësohemi ta përdorim atë për qëllime të mira. Retorika, rrjedhimisht, mund të mësohet si për të mirë, ashtu edhe për të keq.

Se retorika mund të mësohet, kjo është thënë edhe nga Aristoteli në librin e tij mbi retorikën (*Ρητορική*) qysh në vitin 330 para erës sonë. Gjatë gjithë jetës, ne lavdërojmë dhe kritikojmë. Ne mbrojmë veten tonë dhe akuzojmë të tjerët. Shpesh këto gjëra ne i bëjmë pa menduar si do t'i bëjmë. Por në secilin diskutim, ne vlerësojmë se çka do të ishte më bindëse. Cili argument mund të jetë më i mirë e më efikas? Si të bëhet renditja e fjalëve, cila fjalë apo paraqitje do të jetë më e arsyeshme për ata që na dëgjojnë ose na lexojnë? Cili është argumentimi bindës dhe kur është momenti i duhur të luajmë me ndjenja?

Së këndejmi, sipas Aristotelit, është e mundur që të gjendet një metodë për të bindur. Thënë troç: retorika mund të kuptohet e të mësohet. E bash për këtë retorika jep përgjigje.

Retorika, pra, synon të bëjë diçka me ty, me mua e me publikun. Ai që flet, pra fjalimmbajtësi, dëshiron të arrijë *diçka* të caktuar tek publiku. Ne mendojmë se retorika është njëdrejtimëshe: fjalimmbajtësi flet, publiku dëgjon. Por sinjalet shkojnë në *dy drejtime*. Publiku, në këtë rast pranuesit, është i gjallë dhe ndikohet, e, rrjedhimisht, edhe do të reagojë si për të mirë, ashtu edhe për të keq.

Retorika sot është imponuar me një vend qendror në përditshmërinë tonë. Ajo më nuk është e kufizuar vetëm në të shkruarit e fjalimeve. Këtu është me vend të nënvizohet se veçoritë

retorike gjenden në të gjitha llojet e komunikimeve moderne. Kjo do të thotë se retorikën e gjejmë jo vetëm në politikë, në kulturë, në sport e në ekonomi. Ajo përdoret mes shokësh, mes gruas e burrit, prindit e fëmijës, pra ajo është pjesë e mjedisit familjar. Në fushën e reklamës, fjala vjen, këto veçori retorike i hasim çdo ditë.

Retorika lindi e qendëruar me qëllimin që fjalët tona të jenë sa më bindëse, dhe asisoj që folësi të duket sa më “argumentues” kundrejt publikut. Paçka se publiku nuk ka mundësi të kundërshtojë ndikimin e fuqishëm të retorikës, megjithatë është e pritshme që ai në njëfarë mënyre të jetë në gjendje të kundërshtojë, të debattojë dhe të thotë mendimin e vet rreth një veprimi apo vendimmarrje të caktuar qoftë ajo politike, ekonomike apo kulturore. Kundërshtimi ndaj ndikimit të retorikës do të zhvillohet me qëllim që fjalët dhe diskutimet e mëpastajme të formësojnë një proces demokratik; proces ky që në prapaktim do të çonte deri tek një qëllim dhe një vendim i mirë për shoqërinë.

Mirëpo, fjala mund të përçajë. Fjala mund të urrejë. Fjala mund të ngushëllojë. Fjala mund të tregojë dashuri, të ndërtojë ura, e të bëhet sakaq dhunë. E, po kështu, fjala mund të shkaktojë edhe gjakderdhje, luftë, varfëri e mjerim. Le të kujtojmë për një çast artin e frikshëm të fjalimeve të Hitlerit e të Goebelsit. Çdo gjë fillon nga fjala, nga komunikimi e nga fjalimi.

Duhet theksuar se çdo fjalim varet nga rrethanat në të cilën mbahet ai, por po kaq varet edhe nga publiku të cilit i kushtohet vetë fjalimi. Mund të thuhet se që të tria bashkë: *fjalimbajtësi, tema e fjalimit* dhe *publiku* përbëjnë themelin e fjalimit. Sipas Aristotelit, në retorikë ekzistojnë tri gjendje të ndryshme, dhe, si rrjedhojë, edhe tri fjalime të ndryshme, ose zhanre të ndryshme fjalimesh, ku secili nga këta ka funksionin e vet të veçantë.¹

- *Fjalimi deliberativ*, i quajtur ndryshe edhe fjalim këshillues dhe politik. Ky fjalim duhet të këshillojë nëse diçka duhet të bëhet ose nuk duhet të bëhet në të ardhmen.
- *Fjalimi forenzik*, i quajtur alternativisht edhe fjalim gjyqësor. Ky lloj fjalimi ndërlihet shpesh me sallën e gjyqit. Nëpërmjet tij synohet të gjykohet ajo që është e vërtetë dhe e pavërtetë, e drejtë apo e gabuar, në lidhje me ngjarjet që kanë ndodhur në të shkuarën. Si në fjalimin deliberativ (këshillues), ashtu edhe në atë forenzik (gjyqësor), publiku ka për detyrë vetëm të gjykojë ngjarjet.

1 Andersen, 2007: 28.

- *Fjalimi epideiktik*, i njohur edhe si fjalim demonstrativ, strumbullohet rreth publikut, i cili është spektator aktiv. Detyra e tij këtu është të lavdërojë, të kritikojë ose të fajësojë njerëzit, ndodhitë dhe rrethanat e të sotmes. Fjalimet, në këtë rast, i drejtohen një populli të mbledhur për ngjarje të veçanta, të tilla sikurse dasmat, funeralet ose ritualet.²

Në këtë mënyrë, fjalimet epideiktike funksionojnë si përbashkuese, mu ashtu sikurse ishin edhe tri fjalimet e Millosheviqit, për të cilat do të bëhet fjalë më poshtë.

Karakteristikë kryesore në fjalimet politike të ish-presidentit serb, Slobodan Millosheviq, të mbajtura në prani të publikut të gjerë, është një retorikë me pikëpamje nacional-shoviniste serbe.

Është konstatuar tashmë se këto fjalime demonstrative janë të përshkuara nga një retorikë patetike. Qëllimi i përzgjedhjes së kësaj retorike shoviniste flaku tej retorikën formaliste të gjeratëhershme në Serbi, duke pasur për synim përgatitjen morale të popullit serb për luftëra të reja e të përgjakshme në Ballkan dhe krijimin e Serbisë së Madhe.

Një prej tipareve thelbësore të kësaj retorike politike nacional-shoviniste ishte përdorimi me mjeshtëri i të ashtuquajturave “fakte historike” dhe kodit fetar ortodoks, por pa teologji e priftërinj, duke pasur si mbështesë mitologjinë kombëtariste serbe. Fjalimi retorik ngacmoi dhe tendosi fort ndjenjat shoviniste, dhe kjo zhvilloi te Millosheviq *artin e të folurit*, duke krijuar raporte të reja mes tij dhe masës së gjerë të publikut serb. Pikërisht këtu, te kjo oratori e Millosheviqit, zë fill rishfaqja e shovinizmit serb. T’i pëlqesh një publiku të tillë do të thotë të heqësh dorë nga arsyetimet e shumta teknike, nga grumbullimi i fakteve e statistikave, dhe të mjaftohesh duke paraqitur parimet dhe idetë e përgjithshme me një stil të lëmuar e të përsëritur, i cili nuk e përjashton emfazën.

Në këtë zbërthim, analiza orvatet të nxjerrë në pah se si Millosheviq me anë të retorikës arriti ta prekte popullin e vet në “telat” e shpirtit kolektiv, duke siguruar masa të tëra që e dëgjonin me vëmendje. Dhe për këtë hulumtim do të bazohemi kryesisht në tri nga fjalimet e tij kryesore.

Qysh në fillim duhet të nënvizohet se, përmes ndihmës së retorikës³ së Millosheviqit, do të bëhet analiza e qëllimit të fjalimeve të atilla,

2 Kjeldsen, 2003: 34.

3 Retorikë-a nga greq. e vjetër *ρήτωρ* (*rhetor*) = orator. Kështu quhej në kohët e mëdha ajo degë e veçantë e oratorisë, pra e artit për të folur; në ditët tona fjala *retorikë* përdoret si një përcaktim kritik për një vepër ose fjalë, që në dukje është e stolisur, por që në të vërtetë ka përmbajtje të dobët.

për të dalë pastaj në përfundimin se cilët kanë qenë togfjalëshat⁴ e përzgjedhur prej diktatorit serb dhe çfarë qëllimi kanë pasur këto adresime publike. Gjithashtu, përmes retorikës, ne mund të kuptojmë edhe mënyrën se si Millosheviqi arriti të bindte masën e madhe të popullit serb për të ndërmarrë ato luftëra të njëpasnjëshme në ish-Federatën Jugosllave.

Gjithnjë përmes shqyrtimit të situatave të asokohshme politike, ne mund të kuptojmë më mirë e më qartë retorikën e Millosheviqit.

Sidoqoftë për një kuptueshmëri më depërtuese të qëllimeve politike dhe shoviniste të asaj retorike, pashmangshëm është e nevojshme të flitet edhe për aspekte të ndryshme sociale të ish-Jugosllavisë në periudhën ngjarjeshumë të harkut kohor mes viteve 1980-2000.

Po në këtë frymë, për të qëmtuar më mirë historikun e luftës Kosovë-Serbi, është i nevojshëm edhe trajtimi i rrethanave politike të Luftës së Dytë Botërore, pa lënë mënjanë përfundimet që dalin nga lufta e fundit në Kosovë (1997-1999), gjithnjë në korrelacion me realitetet e nduarnduarta si dhe pozicionin dhe rolin e mediave.

E gjithë kjo tangjentë bëhet në funksion të përvijimit të një panorame sa më të plotë e më të gjerë, duke dritësuar psenë e asaj se si arriti retorika e Millosheviqit të ndikonte popullin serb – një retorikë, e cila pati rol aq të fuqishëm ndikues jo vetëm në hapësirën publike serbe, por dhe në atë shqiptare e më gjerë.

Që lexuesit t'i mundësohet një orientim sa më i drejtë për retorikën politike e propagandistike të Millosheviqit mbi shpërthimin e luftërave të viteve '90 të shekullit të kaluar, do të trajtohet shkurtimisht edhe shoqëria "jugosllave" para sipërfaqjes së Millosheviqit në skenën politike të Serbisë dhe, tevona, edhe në atë të Jugosllavisë. I brendashkruar me këtë shtjellim, është parë e arsyeshme edhe një analizë e paanshme e përmbajtjes kulturore dhe historike të fjalimeve retorike të tij.

Kur jemi te kjo, libri në shtjellën e vet shkoqit gjashtë fusha të ndryshme, të cilat i konsiderojmë të një rëndësie të veçantë: historia, ekonomia, politika, demografia (shpërndarja geografike, përbërja dhe shtimi i popullsisë shqiptare në ish-Jugosllavi), arsimi si dhe mendësia e popullit serb.

⁴ Togfjalësh-i; dy a më shumë fjalë kuptimplota, të cilat kanë lidhje të ngushtë e kuptimore me njëra-tjetrën që marrin pjesë në ndërtimin e fjalisë.

Po kështu një vend i është ndarë edhe *kushteve retorike*⁵ (oratorisë), të cilat mbizotëronin në kohën, hapësirën dhe mjedisin kur janë mbajtur ato fjalime oratorike. Natyrisht që, në një rast si ky, bëhet e nevojshme edhe analiza e mjeteve si dhe mënyrave bindëse dhe jobindëse (kushtet retorike)⁶ të transmetimit të fjalimeve nga ana e Millosheviqit.

Sipas Kjeldsenit, kushtet retorike janë pjesë e rrethanave dhe kushteve gjatë të cilave fjalimet oratorike marrin tipare më të theksuara për drejtime të caktuara.

Si shqiptar i Kosovës, unë jam i vetëdijshtëm që jam pjesë e konfliktit, por në këtë analizë i kam vënë vetes një detyrë kërkimore-shkencore dhe do përpiqem paanshëm të zbuloj botëkuptimin e Millosheviqit në fjalimet e tij. Pra, përmes analizës së fjalive dhe togfjalëshave të përdorur në fjalime, ky libër përpiqet të sjellë botëkuptimin (tërësinë e pikëpamjeve) e shprehur në fjalimet e tij. Këtu do të paraqitet dhe do të dëshmohet se ndërtimi i fjalive, i togfjalëshave dhe përzgjedhja e fjalëve prej tij, me të cilat ai përshkruan heronjtë e ngjarjet, nuk janë të rastësishme dhe as të pafajshme.

Dhe së fundmi, por jo më pak e rëndësishme, në këtë analizë do të bëhet fjalë edhe për përbërjen dhe përmbajtjen e retorikës (oratorisë, gojëtarisë), pa lënë anash as përshkrimin e shprehjeve historike, kulturore dhe nacionale që janë përdorur në këto fjalime prej Millosheviqit.

Përmbajtja e retorikës konstituive mund të ndikojë dhe të ketë kontroll të madh mbi një komb të caktuar, në mënyrën se si fjalimi retorik e përpunon publikun përkatës. Për më tepër, kjo është e rëndësishme edhe për ngjarjet e sotme politike, sepse disa nga fjalimet retorike politike sot janë bërë një kërcënim aktiv kundër demokracisë dhe vlerave liberale.

Për ta saktësuar këtë, analiza merr përsipër jo vetëm të përshkruajë dhe shqyrtojë shprehjet, pohimet apo mohimet, argumentet dhe vendet ku janë mbajtur fjalimet, por edhe të shqyrtojë mitet, religjionin (besimin fetar), simbolet dhe ikonat (figurat historike).

Përmes analizës së retorikës politike të përdorur nga Millosheviqi për ndryshimin e identitetit politik të dëgjuesve të tij, arrijmë të zbulojmë dhe të kuptojmë se çfarë lloj ndjekësish ka pasur për qëllim të krijonte me adresimet politike në formë fjalimesh. Sepse, tekembramja, përbërja e publikut ka rëndësi të madhe për retorikën politike.

5 Kjeldsen 2004: 84.

6 Kjeldsen 2004: 85.

1.0. RETORIKA

Derisa retorika është një gjë, keqpërdorimi i saj është diçka tjetër. Retorika i kushton rëndësi të veçantë mënyrës së komunikimit. Disiplina, e cila merret me studimin e saj, sugjeron që retorika gjithmonë duhet të përdoret në rast të ndonjë ndodhie të veçantë, në një kohë të caktuar, për një publik të zgjedhur dhe, padyshim, për një qëllim të caktuar. Fundamentalisht, ajo është e orientuar kah mënyra pragmatike. Në rrafshin asociativ, fjala “retorikë” në ligjërimin publik që zhvillohet brenda gjuhës shqipe shëmbëllen kuptimisht si “gjuhë e trëndafilave, por pa përmbajtje të thellë” apo edhe si “gjuhë e zbrazët”. Retorika (oratoria) është një disiplinë simotër e dialektikës.⁷ Përmbajtja e retorikës përcaktohet nga momenti historik si dhe rrethanat e kushtet ekonomike, shoqërore, politike e ushtarake të një kuadri të caktuar kohor. Megjithëkëtë, përmbajtja e saj është e ndërruar edhe nga aftësitë e gojëtarisë së autorit folës, të folurit bukur e rrjedhshëm. E parë në këtë dritë, retorika është një lloj komunikimi i efektshëm dhe asnjansës, atëherë kur ligjërimi i saj është i pasur në fjalor dhe shprehet qartë e rrjedhshëm, në përshtatje me publikun.

Gjuha është *mjeti themelor* dhe më i rëndësishëm që na shërben për të mbrojtur e shprehur mendimin dhe për t’u kuptuar, marrë vesh e ndërmjetësuar me ata me të cilët komunikojmë. Tërësia e këtyre mendimeve të shprehura përmes gjuhës përbën retorikën.

Nëse ne arrijmë ta bindim dikë se pikëpamjet tona rreth një aksh teme apo një problemi janë të sakta e të drejta, kjo parakupton se ne, falë ndihmës së gjuhës, kemi ndikuar pak a shumë në botën e këtij personi apo të të gjithë publikut. Tok me këtë pason edhe pohimi se e vërteta nuk është absolute dhe e qëndrueshme; ajo është *relative* (e kushtëzuar edhe nga diçka tjetër), sidomos kur në ekuacion është *dikush* apo *diçka* tjetër që mbron mendimet tona. Pra, përmes gjuhës e fjalëve që përzgjidhen gjatë ligjëritimit oratorik pasqyrohet dhe merr formë një realitet tjetër, i pavarur nga bota fizike, por gjithnjë në varësi nga fjalët dhe gjuha.

Sigurisht se në çfarëdo ballafaqimi rreth asaj se cili është kuptimi më i drejtë i rrethanave të gjendjes konkrete, do të ekzistojë një gjendje

7 Aristoteli 1983: 23.

“krize”. Grupe të ndryshme interesash, pushtete dhe individë janë e do të jenë nxehtësisht të interesuar për të nxjerrë në pah idetë dhe porositë e tyre duke shfrytëzuar mediat.

Zaten, përmasa e arritjes së këtij qëllimi mund të ketë rëndësi vendimtare për zhvillimin e një shoqërie. Diskutimet e ndryshme rreth një çështje, historie apo ndodhie të caktuar kanë pasojë në atë sesi ne i përjetojmë dhe i interpretojmë gjërat që ndodhin në mjedisin rrotull nesh. Prandaj, është fare i përligjur pohimi i dikujt që do të thoshte, duke ndjekur një rezonim të tillë, se ai që e ka nën kontroll mënyrën se si prezantohet një konflikt, e ka gjithashtu në dorë edhe atë sesi përplasja kuptohet nga publiku. Në një shoqëri bashkëkohore, retorika përfton një rëndësi të veçantë, por kjo nuk e eklipson mundësinë që *arti i bindjes* edhe mund të keqpërdoret.

1.1. Mediat dhe retorika

Shoqëria jonë mediatike është shndërruar tashmë në një peizazh të ri retorik. Kështu mund të numërohen një vistër dallimesh që janë të përdallueshme për format aktuale të komunikimit. Ne komunikojmë nëpërmjet mediash të shumta. Kjo nënkupton se ne komunikojmë, përveç gjuhës, edhe me anë të fotografive, simboleve, shenjave dhe muzikës. Në mjaft raste ndodh që të gjitha këto forma të shprehjes retorike kapërthuren mes vete.

Në terma të retorikës tradicionale, komunikimi nuk zhvillohet gjithnjë me qëllime të caktuara. Pra, nuk ekzistojnë gjithmonë aso situata në të cilat *dërguesi* është i interesuar nevojisht për të ndikuar tek *tjetri*. Ne vërsulemi nga shumë informacione. Ky vërshim informacionesh përbëhet nga një gjerdan elementesh të shumta e të llojndryshme, siç është fotografia, simboli, shenja, muzika dhe teksti.

Që të jemi objektiv, le t'i lëmë anash dyshimet: secili medium, qoftë letër, fjalim, zë, fotografi apo internet, e ndikon porosinë sipas *mënyrës së vet*.

Pra, është e qartë se zhvillimi i shoqërisë mediatike ka ndikim të ndjeshëm mbi retorikën. Së këndejmi, kjo është arsyeja pse në ditët tona shfaqet një laramani strategjish retorike, varësisht se cili mjet komunikimi përdorët nga folësit për të tejçuar mendimin, fjalën apo lajmin.

Fjalëmbajtësit intimizojnë mundësisht çdo gjë. Retorika shpesh orientohet në *patos*: në rast se fjalimi ka përballë një publik të madh, aty adresuesi e ka mundësinë të flasë me zë të fuqishëm. Është një miriadë mundësish: fjalimmbajtësi e ka në tagër ta përshtatë fjalimin, ashtu sikundër që mund të përdorë edhe elemente teatrale që e

hovizojnë dhe e shtyjnë më përpara e më me sukses porosinë e fjalës.

Por në radio ngjet krejt e kundërta. Aty fjalimmbajtësi futet “brenda” dhomës së publikut, prandaj kjo dikton logjikën që adresimi i tillë të bëhet me zë të ulët, të këndshëm dhe të butë. E gjithë kjo në shërbim të krijimit të një mjedisi sa më intim, sa më romantik e sa më “prindëror” kundrejt publikut.

Në rrethana të njëjta – dhe me të njëjtin fjalim – një adresim i emetuar në televizion kërkon një strategji retorike krejtësisht tjetërfare. Në televizion, fjalimmbajtësi ka rolin kryesor. Kamera është e përqendruar mbi të; rrjedhimthi mimika, gjestet dhe lëvizja e muskujve të fytyrës është në plan të parë dhe nën “mikroskopin” e kamerës. Në këtë mënyrë, fjalimi merr nuancime fort personale e intimizohet, kurse folësi etablohet si dërguesi dhe autori i vetëm i komunikimit.

1.2. Orientimi në pamje dhe zë

Në universin tonë retorik e mediatik, fotografitë janë ato që kanë peshën më të madhe. E kjo vlen jo vetëm për televizionin, por edhe për gazetatat, revistat javore dhe internetin. Dhe kështu paraqitja e bukur dhe e mirë bëhet e pashmangshme. Fjala vjen, grimasat e rënda të John McCainit, gjatë fushatës presidenciale në vitin 2008, pushtuan botën për njëzet e katër orë rresht. Shumica e analistëve vlerësonin se ky qe një gabim i pafalshëm nga ana e tij. Sikundër u bë e qartë edhe më sipër, është fort me rëndësi që paraqitja të bashkëshoqërohet doradorës me një zë të këndshëm “radiofonik” – nëse synimi është për t’i dhënë një të shtyrë përpara porosisë së menduar nëpërmjet radios.

Është me vend të vihen në spikamë si shembull fjalimet e famshme të Winston Churchillit nga Lufta e Dytë Botërore. Ato e përligjën namin e të qenit të famshme mu për shkak se ishin së tejmi ndikuese për ngritjen e moralit të njerëzve në përpjekjen e madhe kundër nazizmit gjerman. Prandaj, mund të thuhet se fotografitë më të mira sajohen në radio, por fjalimmbajtësi së pari duhet t’i krijojë ato në kokën e vet.

1.3. Elementet retorike për të ndikuar në publik

Aristoteli i konsideronte fjalimmbajtësin, fjalimin dhe publikun si resurse retorike. Që të gjitha marrë së bashku, në mënyrën e tyre, kontribuojnë në bindjen e tjetrit. Kështu, me mjaft saktësi këto do të emëroheshin më së miri si *mjete për të bindur ose mjete bindëse*.

Në greqishten e vjetër, fjala që përdorej ishte *pistis* (πίστις), kurse në shqip barasvlera e saj kuptimore është “bindje” ose “besim”. Gjithnjë sipas teorisë retorike, njerëzit kanë në dorë tre faktorë për të bindur e ndikuar publikun. Duke folur me kategorizimet e bëra nga Aristoteli, ata janë me sa vijon: *Ethos*, *Pathos* dhe *Logos*.

Në antikitet, retorikanët e kohës e konsideronin retorikën si komunikim pragmatik. Preokupimi i tyre i vazhdueshëm ishte vramendja mbi atë se çfarë duhet të bënin fjalimet. Pra, cilat janë ato funksione që duhet t’i kryejnë fjalët dhe cilat qëllime duhet t’i jetësojnë?

Në çdo rrethanë, qëllimi kryesor i komunikimit retorik është për të bindur. E për të arritur këtë qëllim, fjalimmbajtësi duhet të plotësojë tri kritere:

Pikësëpari, ai duhet të na mësojë, pra të informojë e të argumentojë (*docere*).

Pikësëdyti, ai duhet të na kënaqë, duke mbajtur gjallë vëmendshmërinë, të argëtojë e të magjepsë (*delectare*).

Dhe, pikësëtreiti, ai duhet të na lëvizë, duke apeluar në ndjenjat tona, ashtu sikurse edhe të ndikojë tek publiku për të vepruar (*movere*).

Rrjedhimisht, nisur nga këto tri konsiderata, çdo fjalim i mirë duhet të informojë, të argëtojë, të magjepsë e të lëvizë publikun (*docere, delectare, movere*). Në artin retorik, disa i kushtojnë më shumë rëndësi anës etike (*Ethos*); disa ngacmojnë dhe luajnë me ndjenjat e publikut (*Pathos*), e të tjerë orvaten të argumentojnë me arsye e me logjikë (*Logos*). Kësisoj na bëhet akoma më e qartë se njeriu është kokë (*logos*), bark (*pathos*) dhe zemër (*ethos*). Prandaj është e këshillueshme, dhe njëkohësisht e leverdishme, që të apelojmë tek njeriu si anatomi/biologji.

a. Mbi Ethosin

Me *Etos* referohet karakteri, e ngandonjëherë edhe personaliteti i fjalimmbajtësit. Ai merret me atë se si besueshmëria dhe fuqia bindëse e autorit krijohet tek lexuesi. Kjo mund të ndodhë përmes tekstit ose njohurive që qëndrojnë jashtë tekstit. Së këndejmi, *Etosi* është mjeti më i rëndësishëm retorik për bindje, ku vetë folësi funksionon si argument. Folësi duhet të ketë besueshmëri. Nëse publiku nuk i beson folësit, ai nuk i pranon as argumentet e tij. Pra, etika e folësit synon, më e pakta, të ngjallë tri gjëra në publik: besim e simpati te publiku, argëtim e kënaqësi.

Nëse ne e dimë që një profesor ka shkruar një tekst, atëherë kjo na shtyn që t’i besojmë më shumë këtij teksti, sesa ky shkruer po të ishte një student apo një gazetar partiak.

Dërguesi, pra, është *një pjesë* e porosisë. Jo shumë njerëz e dinë se Vidkun Quislingu (norvegjezi, i cili pati admirim dhe bashkëpunoi me nazistët) shkroi një vepër filozofike, e cila u bë e mundur të lexohet vetëm në kohët e fundit. Por vetëm një numër i vogël nga ne do ta vlerësonte seriozisht këtë vepër. Kjo sepse menjëherë aktivizohet vlerësimi i *etosit*, pra karakteri i tij.

Do të ishte interesante sikur dikush të bënte vlerësimin e veprës së tij, por duke mos ditur gjë paraprakisht për jetën e autorit shkruar. Të parat publikime të Albert Einsteinit, edhe në kohën kur ai po shpaloste teorinë e relativitetit, nuk u morën fort seriozisht nga publiku. Njerëzit nuk kishin besim se një person, i cili punonte në një zyrë të rëndomtë, kishte fuqinë profesionale për të shkruar artikuj të atillë shkencorë. Publiku mund të krijojë përshtypje për shkrimtarin/fjalimmbajtësin edhe përmes mënyrës se si ai shkruan e flet. *Etosi* është i rëndësishëm në komunikimin retorik. Sepse kjo çon tek cilësia, besueshmëria dhe autoriteti i personit apo institucionit që shkruan.

Nuk është vetëm besueshmëria e fjalimmbajtësit/shkruesit ajo që është vendimtare, nëse ne do të besojmë në atë se çfarë ai ka shkruar. Edhe bindja dhe besueshmëria duhet të ndërtohen përmes argumentimit. Prandaj, folësi duhet të përfjethet nga publiku si një person me moral të shëndoshë, i zgjuar dhe me aftësi të mbrehtë gjykyese dhe që e do më të mirën për publikun e vet. Në retorikë, kjo gjë njihet me fjalën *delectare*.

b. Mbi Pathosin

Me një përkthim të zakonshëm të fjalës lashtogreke *pathos* (πάθος), jashtë fushës së retorikës, siç janë për shembull tragjeditë klasike greke, do të përfitohej fjala “vuajtje”. Por ajo e ka të brendashkruar edhe një rreze më të gjerë konotacioni si “vrull” ose “pasion”.

Nëse *pathosit* ia vëmë shenjat e barazimit kuptimor me fjalën “ndjenjë”, atëherë duhet të kemi parasysh se këtu bëhet fjalë për ndjenja të forta. *“Ndjenjat janë diçka që ndikojnë njerëzit asisoj që këta ndryshojnë apo ndërrojnë mendimin e vet; që janë shoqëruese të shqetësimit ose kënaqësisë, ashtu sikurse zemërimi, dhembshuria, frika dhe çdo gjë që është e kundërta e tyre”*, shkruante Aristoteli.

Fjalimmbajtësi duhet të shkaktojë *pathos* në publik si një hallkë që çon deri te bindja. Kjo e fundit ndodh në sajë të ndihmës së publikut, atëherë kur fjalimi ia del mbanë të ngacmojë emocione tek ai. Përdorimi i emocioneve e ka të domosdoshme fillimisht njohjen e tyre. Shi për këtë, Aristoteli shkruante se *“zemërimi ndodh në lidhje me veten. Zemërimi është gjithmonë i drejtuar tek një person, përderisa urrejtja kundër të*

*gjitha klasave dhe llojeve. Zemërimi mund të kalojë pas një kohe, urrejtja jo. Zemërimi është një dëshirë për të shtuar dhembje, urrejtja është dëshirë për të shkaktuar dëme*⁸ *“Të gjithë ata që janë të sëmurë, të varfër, të prekur nga lufta, të dashuruar, të etur, ose, përgjithësisht, kanë nevoja që nuk mund t’i përmbushin, e kanë fare të lehtë të katandisen në zemërim, veçanërisht ndaj atyre që e shohin gjendjen e tyre si hijçgjë”.*

Veçori e një fjalimmbajtësi vërtet të mirë vlerësohet të jetë kur ai arrin të luajë me ndjenjat e publikut ashtu që ai e bën atë të qajë e të qeshë sipas nevojës. Por, mungesa e *pathosit* mund të dobësojë besueshmërinë e oratorit. Thuhet se Klaudi⁹ mëtonte se një njeri kishte dashur ta vrasë. Por ai fliste aq dobët e përhumbshëm sa Ciceroni e cilësoi këtë si një shenjë se e gjithë akuza nuk ishte gjë tjetër veçse shpifje nga ana e Klaudit.

Ai gjatë mbrojtjes së vet pyet: *“Ku është padrejtësia e thellë? Ku është zemërimi yt? Ne nuk pamë shenja të tmerrit, ti nuk e rrahe as gjoksën, as kokën e askëmbët me duar! Nuk kishe madje as edhe pak ngërç në këmbë! Ti as nuk na nxehe gjakun, ne mezi i mbanim sytë hapur gjatë fjalimit tënd”*.¹⁰ Në këtë mënyrë dikush mund të (keq)përdorë përmbajtjen ose qetësinë e fjalëmbajtësit, *“ose, me fjalë të tjera, gabimin e tij”*¹¹, siç do të shprehej Ciceroni.

Kësisoj lind edhe pyetja nëse fjalëmbajtësi duhet të angazhohet vetë, dhe nëse ndjenjat (emocionet) duhet të jenë të vërteta. Për këtë çështje, Cicero thoshte se *“një dëgjues kurrë nuk do ta lejojë veten që të përndizet nëse fjalimi nuk arrin tek veshi i tij përderisa ai është ende i zjarrtë”*.¹²

Thënë figurshëm, dikush duhet të digjet për të nderur një zjarr. Ata që mbajnë fjalimin duhet *“të jenë në gjendje të bëhen të zemëruar, të ndjejnë vuajtje, e të shpërthejnë në vaj”*.¹³

Ciceroni, i cili veç e kishte mjeshtëruar bashkëvuajtjen, thoshte për veten e tij se nuk ishte dhuntia prej gojëtari që e bënte aq të madh në këtë fushë, por ndjenjat e tij të vërteta të bashkëvuajtjes. Ai kaplohej e përndizej nga, siç e përshkruante, një *“fuqi e madhe e brendshme, sa që unë nuk e zotëroj veten time”*.

8 Aristoteli; 1983:31.

9 Bëhet fjalë për për Marcus Claudius Marcellus, politikan e senator në periudhën e fundit republikane të Romës.

10 Cicero: 278.

11 Po aty.

12 Po aty.

13 De oratore, 192.

Kur është fjala për *pathosin*, është me vend të rikujtohen fjalët e Kuintil¹⁴, sipas të cilit “*shpesh kur mbaja fjalime, jam prekur aq shumë saqë jo vetëm filloja të qaja, por edhe zbehesha posi një kufomë dhe tregoja krejt shenjat e një vuajtje të vërtetë*”.

Në çdo rast, fjalimmbajtësi duhet të jetë i aftë të kontrollojë si ndjenjat, ashtu edhe zjarrin, që i ndezë gjatë ligjërimit retorik. Ndonëse emocionet janë veçse mjet bindje në duart e retorikës, ky element retorik nuk duhet keqkuptuar e as keqinterpretuar: *pathosi* e përjashton elementin irracional brenda nesh dhe, vetëkuptueshëm, i kundërvihet ndjekjes impulsive individuale.

Është kërkesë e domosdoshme, pra, që fjala të shpaloset asisoj që të jetë sa më e besueshme për publikun. Dhe kjo, ç’është e vërteta, përben arsyen kryesore pse oratori apelon tek populli/publiku. Rrjedhimisht, shkruesi dhe fjalimmbajtësi kanë si qëllim që publikut t’ia japin një *kahje* në një drejtim të caktuar. E për të arritur këtë gjë, fjalëmbajtësi, midis të tjerash, duhet të përqendrohet edhe tek ndjenjat, vlerat dhe pikëpamjet e caktuara të publikut.

Të ushtrosh ndikim dhe, njëkohësisht, të përkapësh vëmendjen e publikut është një punë retorike me peshë të madhe. Edhe lajkatimi që i shërbehet marrësit nëpërmjet të kuptuarit, qoftë ky lexues apo dëgjues, është njënjëshëm veprim retorik. Ne ndjehemi më të mençur kur kuptojmë atë që lexojmë, sesa kur nuk kuptojmë atë që sapo lexuam. Zaten, një ndër armët më të forta e ndikuese të retorikës është përdorimi i mbiemrave dhe përshkrimi i një çështje me ndajfolje e mbiemra, të tillë si: “*natyrisht*”, “*i qartë*”, “*interesant*”, “*me rëndësi*”, “*i domosdoshëm*”, “*vendimtare*”, “*vërtetuese*”, “*sqaruese*” e të tjera si këto.

Një formë lajkatimi është mënyra se si oratori apelon tek publiku i tij. Cili është dërguesi i fjalëve apo tekstit: *unë* apo *ne*? A është afruar apo përjashtuar publiku nga gjuha/teksti? A i shtrohet atij ndonjë pyetje përmes fjalimit? Të apelosh tek publiku është një *efekt retorik*. Efekti i *pathosit* mund të jetë përforcues, atëherë kur thirrja duhet të ndikojë në ndjenjat dhe qëndrimet e lexuesit. Është e qartë se shprehja e porosisë duhet të përshtatet me përmbajtjen e vet, sepse ndikimi është një nga detyrat parësore të retorikës. Nëse ia dalim mbanë të ngacmojmë ndjenjat e dhura të publikut, në një rast të tillë do të shtoheshin gjasat edhe për ta bindur atë. Pra, *pathosi* përdoret kur fjalëmbajtësi përpiket të lëvizë, të zgjojë ose të angazhojë publikun e tij. Kjo strategji quhet *move*.

14 Fjala është për oratorin dhe edukatorin e njohur romak, Marcus Fabius Quintilianus që jetoi në shekullin e parë të erës sonë.

c. Mbi Logosin

Logosi ka të bëjë me bindjen e publikut duke përdorur argumentim objektiv dhe racional. Kësisoj, dërguesi apelon në arsyen e publikut dhe në intelektin e tij, por jo në ndjenja.

Logosi i mëshon të gjitha llojeve të fakteve, statistikave dhe fjalimeve, pra gjërave që mund të maten, peshohen dhe vërtetohen. Gjithashtu, një apel i fortë i *logosit* mund të arrihet duke përdorur një gjuhë asnjëse, të baraspeshuar dhe objektive, ashtu sikurse edhe një argument të qartë e faktik.

Apelet e *logosit* karakterizohen shpesh nga shprehje që theksojnë kontekstin logjik të tekstit, me anë të lidhëzave kryesisht: “*pasi*”, “*sepse*”, “*për këtë arsye*”, “*domethënë*”, “*për shkak të...*” e kështu me radhë. Duke e ndërmendur gjithë këtë, *logosi* megjithatë kërkon përdorim të kujdesshëm e me mjeshtri; kjo sepse dobësia kryesore e apeleve të tilla është se fjalimi ose teksti në publik mund të duket i mërzitshëm dhe i rëndë, veçanërisht nëse kufizohet sall në fakte dhe statistika.

Ka të ngjarë që më e rëndësishmja e një fjalimi apo teksti të jetë *qëllimi*. Pikësëpari, duhet të shihet se si janë shpalosur pikëpamjet kryesore në të. A është kjo një hipotezë të cilën e thotë dikush në publik? A është vallë ky një përfundim që ka edhe argumentin si dëshmi? Këto pyetje mbarështrohen, sepse për publikun hipoteza është ajo e cila e angazhon, ndërkohë një përfundim do të shpërfaqte një çështje të vlerësuar fillim e mbarim, dhe, në një rast të tillë, do ta pasivizonte publikun. Përveç argumentimit, fjalimmbajtësi mund ta mbështesë fjalën e vet edhe përmes shembujsh. Por, në të njëjtën kohë, është me rëndësi të dihet se këta janë vetëm një dorë shembujsh që, duke qenë të tillë, përshkruajnë vetëm një pjesë të vogël të një tërësie larg më të madhe. Shembujt, në fakt, mund të kenë një lloj efekti simbolik për porosinë në një fjalim. Retorika i përdor si mjete për të ndikuar, por që në fund të fundit duhet të mbesin vetëm shembuj e që nuk e zëvendësojnë dot argumentin.

Sidoqoftë, retorika është mbiquajtur “arti për të bindur”, dhe bindja, siç u vu në dukje më lart, është e lidhur ngushtësisht me argumentimin. Retorika ndikohet shumë nga fuqia e argumentit. Më i lehtë është ndikimi nga një shkrim objektiv i një akademiku, sesa nga shkrimi subjektiv i ndonjë gazetari që është në shërbim të një partie politike apo ndoca grupi interesash ekonomike. *Logosi*, si forma e tretë e apelit, shquhet nga folësi, i cili përdor argumentet për të bindur dhe synon të mësojë, të ndriçojë apo edhe të informojë publikun. Kjo strategji retorike quhet *docere*.

1.4. Vlerësimi retorik

Që të tri elementet që u zunë ngoje, *Ethosi*, *Pathosi* dhe *Logosi*, reagojnë dhe ndikojnë njëkohshëm në njëra-tjetrën. Pra, publiku e gjykon tekstin/fjalimin edhe në bazë të asaj se si këto elemente funksionojnë së bashku, dhe në mënyrën se si ato ndikohen reciprokisht. Thënë shkurtazi, bindja është gërshetim i të tria formave të apelit. Rrjedhimisht, teksti/fjalimi, ndër tjerash, duhet të vlerësohet në tri drejtime:

1. **Ethos** – ndikimi përmes autoritetit:

Si ndikon etosi përmes faktit që ne dimë shumë (ose pak) për jetën, veprimtarinë, të bëmat, karakterin dhe statusin e fjalimmbajtësit?

2. **Pathos** – ndikimi përmes ndjenjave/emocioneve dhe qëndrimeve:

Çfarë apeli qëndron në fjalim/tekst, dhe cilat apele i përdor oratori për të ndikuar publikun?

3. **Logos** – ndikimi përmes arsyes/logjikës:

Çfarë fuqie bindëse qëndron në shpërfaqjen e argumentimit në fjalim/tekst?

Detyrimisht, retorika kërkon vazhdimisht një publik, pra kërkon popullin në pozicion marrës. Shprehjet retorike mund të ndikojnë apo edhe të ndryshojnë mendimet, vendimet dhe veprimet e njerëzve. Kjo ngase një publik retorik mund të jetë vetëm ai lloj publiku, i cili “pranon” dhe është në gjendje të ndikohet e të ndryshohet nga ligjërimi publik, dhe, përveç kësaj, “pranon” që të jetë bartës i ndryshimeve në shoqëri, ashtu siç e dëshiron vet falëmbajtësi publik.

2.0. TEORIA DHE METODA

Kur bëhet fjalë për rregullat dhe parimet e retorikës, ka një sërë teorish që ndihmojnë në përmirësimin e të kuptuarit të fjalimeve ose shkrimeve. Këto teori përdoren për të mirëkuptuar tërësinë e elementeve përbërëse të diçkaje që lidhet ngushtë me këtë çështje; tutje mu këto elemente plotësojnë njëra-tjetrën në funksion të asaj se çfarë duhet të jetë më me peshë brenda një fjalimi.

Thënë qysh në krye të herës, ky hulumtim nuk përqendrohet vetëm në teoritë që strumbullohen sall në një problematikë. Janë bash këto teori që orientojnë vëmendjen e publikut në anë të ndryshme të problematikës së shqyrtuar nga oratori. Në këtë mënyrë, ato hapin një fushë më të gjerë veprimi për të kuptuar realitetin konkret, apo thënë ndryshe për të zbuluar botëkuptimin, i cili qëndron në zemër të analizës së mbarështuar në këtë libër.

Që të tri teoritë e përzgjedhura janë të ndryshme në fushën e *retorikës*, si në rregullat ashtu edhe në parimet e saj. Kjo është arsyeja që këto janë zgjedhur si bazë e zbatimit të këtyre rregullave dhe parimeve të saj.

Ekzistojnë shumë përkufizime mbi kryepytjen se *çka është retorika*, por ajo ka të bëjë para së gjithash dhe kryesisht me të ndryshuarit e realitetit nëpërmjet gjuhës. Dhe kurdo që përmes përdorimit të gjuhës, komunikimit apo shkrimit bëhet e mundur që një situatë (gjendje) të ndryshohet tërësisht apo pjesërisht, kjo përbën një rast klasik të një *situatë retorike*.¹⁵

Si platformë kryesore për të dritësuar dhe sqaruar botëkuptimin e Millosheviqit është teoria e Burkes me analizën që u bën togfjalëshave, ashtu sikurse edhe teoria e autorëve McGee dhe Charland mbi përpunimin e publikut. Në këtë shtjellim nuk lihet anash as teoria e Bitzerit mbi përshkrimin e situatës (gjendjes, rrethanave) retorike. Gjithnjë në funksion të vërtetimit faktik të analizës, janë përdorur tejet tej edhe teoritë mbi ndikimin e publikut, të trajtuara prej Chaim Perelmanit dhe Luice Olbrechts-Tytecas.

Pikësëpari, është e rëndësishë së dorës së parë që të qartësohet se cilit publik i janë dedikuar këto tri fjalime retorike nga Millosheviqi.

15 Kjeldsen 2004: 32.

Pikësëdyti, me këtë harxh shtjellimi, duhen qartësuar edhe rrethanat politike dhe sociale në Serbi gjatë periudhës kohore 1980-2000, e që janë të një rëndësie të madhe.

Pra, kjo është analizë empirike (dhe kritike) e fjalimeve të Millosheviqit. Qëllimi i saj rrah të zbulojë botëkuptimin e Millosheviqit, kuptimin e realitetit prej tij, ashtu sikurse edhe të zbardhë rrethanat se si është përpunuar publiku në saje të fjalimeve të mbajtura prej tij. Vetëm kështu do të qartësohet se çfarë efekti patën këto fjalime në hapësirën e gjerë publike.

Dhe për këtë, qysh në fillim, do të bëjmë përcaktimin metodologjik të shprehjeve (togfjalëshave) kryesore në këto fjalime, dhe, më pas, do të përqendrohemi në fjalorin e tij që është i lidhur dhe referencuar në mitet, ideologjinë agresive dhe thëniet që janë të pleksura me historinë, kulturën dhe politikën.

Fjalimet e Millosheviqit janë interesante për disafish arsye. E para, përmes përdorimit të gjuhës së përdorur prej tij mund të vihen në pah vlerat themelore dhe orientimet e tij në politikë. E dyta, përmes analizës së retorikës së tij mund të qartësohet se si Millosheviqi e manipuloi gjuhën në përputhje me rrethanat konkrete sociale dhe politike, varësisht nga synimi i tij për të arritur sa më shpejt përfitime të caktuara politike.

Duke e ndjekur fillin studimor, pyetja e natyrshme që lind është pse retorika e Millosheviqit ka një formë specifike? Në po këtë frymë, ne mund të diskutojmë se deri në ç'masë retorika e tij politike pranohej *a priori* (pa argumentim) nga ana e publikut kur po ngjanin luftërat në ish-Jugosllavi.

Ballkani është një *gjeografi historike*¹⁶ parëndomësisht e ndërlikuar, aty ku ç'është e vërteta gjendja politike ende vijon të jetë e paqëndrueshme. Ndaj duhet të theksohet se, pa marrë parasysh sesi paraqitet situata politike apo ajo sociale në Ballkan, gjithmonë do të dalë dikush e do të mëtojë se shpalimi është i njëanshëm.

Për shembull, vetëm përdorimi i shpeshtë prej Millosheviqit në serbisht i fjalës "*Косово / Kosovo*" (shqip – Kosovë, Kosova) gjakonte të krijonte një përgjithësim shumë të madh historik që të ishte i pranueshëm edhe nga brezi i kohës së tij, e edhe nga ata të mëpastajmë serbë. Pra, sipas këtij përdorimi, bëhej përpjekje të krijohej bindja se gjoja me emrin *Kosovë* është mishëruar aspirata dhe hovi i pandërprerë i shpirtit kombëtar serb për të ecur përpara; përdorimi i shpeshtë prej tij

16 Gjeografia historike shërben për të mësuar gjendjen e tanishme në lidhje me të kaluarën, përmes së cilës veprat e lashta gjeografike marrin karakter historik.

i emrit *Kosovë* bëhej vetëm e vetëm që ai popull të krijonte një dashuri të pafund për Millosheviqin, por në të njëjtën kohë edhe të krijohej bindja se gjoja Kosova ka lidhje me truallin amtar e me kombin serb.

2.1. Ndikimi ndaj publikut dhe situata retorike: kairos

Në teorinë retorike moderne është farkëtuar termi “situatë retorike” për situatat kur sajohet, përdoret dhe, para së gjithash, ka nevojë për ndërhyrje retorike. Një situatë retorike është një e asisojtë që ka plot cene, ku rolin e shpëtimtarit e ka fjala. Megjithëkëtë, fjalimi që mbahet në një situatë të këtillë e formëson njëkohësisht edhe vetë situatën. Parësisht, fjalimi është reagim e më pas ai shkallëzohet në veprim (aksion). Për një fjalim mund të thuhet se është retorik veç atëherë kur ai është një përgjigje – dhe një përgjigje e përshtatshme! – për një situatë retorike. Dhe ashtu sikundër që jo të gjitha fjalimet janë retorike, jo të gjitha situatat janë retorike.

Së këndejmi, një pjesë e rëndësishme e situatës retorike (pra e përmbytjes së gojëtarisë në përputhje me rrethanat ku dhe kur mbahet fjalimi) është e varur edhe nga përbërja e publikut.

Marrëdhëniet në mes të tekstit dhe situatës përbëjnë një ndër pikat më të rëndësishme të hulumtimeve brenda truallit të retorikës bashkëkohore. Në këtë drejtim, rol të madh ka veçoria e përbërjes së publikut, të cilit me shumë kujdes i drejtohet dhe servohet fjalimi.

Lloyd F. Bitzer, në artikullin e tij “*Situata retorike*”¹⁷ të botuar në vitin 1968, pohon se publiku ka rol qendror në përmbytjen e mjeshtërisë retorike (pra gjithnjë brenda kontekstit të situatës retorike).

Në këtë artikull, Bitzer rropatet të sqarojë çfarë e shquan atë që quhet *situatë retorike* dhe se çka e përdallon një situatë të tillë nga llojet e situatave të tjera. Pikënisje për diskutimin e Bitzerit bëhet një përkufizim për shprehjen *shprehje retorike*.

Një shprehje retorike, sipas Bitzerit, është një shprehje gjuhësore, e cila ka për qëllim që të sjellë veprime ose ndryshime në botë. Pra, ne prodhojmë shprehje që si cak kanë ndryshimin e modelit të të menduarit tek pranuesi. Kjo bëhet me qëllim që *pranuesi* (publiku) të mendojë e veprojë në një mënyrë të caktuar, e që paskëtaj ky publik të kontribuojë në ndryshimin e botës. Një fjalim politik është një shembull i mirë.

Politikani prodhon shprehje që kanë si qëllim që publiku ta pranojë atë si një përfaqësues të denjë e të mirë të kauzës së tyre. Pra, një

17 Bitzer: 1968. “The Rhetorical Situation”.

situatë retorike mund të përkufizohet si një situatë ku është e mundur të tejçohen ndryshime në botë përmes shprehjeve gjuhësore – ku si mjet kryesor është fjalimi.

Tutje sipas Bitzerit, është *situata retorike* ajo që paracakton atë se çfarë do të flitet e çfarë do të thuhet në publik. Pra, është *dikush* në këso rrethana që kërkon që *dikush* të reagojë, të marrë fjalën dhe të përpiket ta ndryshojë situatën. Dhe në çastin kur një situatë mund të ndryshohet pjesërisht apo plotësisht përmes komunikimit (fjalës dhe tekstit), atëherë kjo plotëson të gjithë parametrat për një *situatë retorike*.

Ligjërimi retorik, gjithnjë sipas Bitzerit, është krejtësisht pragmatik, që domethënë se niset nga aftësia për të zgjedhur çastin e duhur për t'u shprehur. Pra, për të qenë i suksesshëm në bindjen e dikujt, nuk është e mjaftueshme vetëm aftësia për të thënë diçka, por edhe përkajpa e momentumit (çastit) të duhur, që në greqishten e vjetër quhej *kairos* (καίρος).

Kjo nënkupton që fjalimet retorike shkaktojnë ndryshime duke ndikuar në mendimet, në vendimet dhe veprimet e personave, të cilët mund të japin ndihmesë në realizimin e ndryshimit.¹⁸ Porë nga një kënd i tillë, fjalimet retorike më përmbajtje të stisur, pavarësisht brendisë së dobët shkencore, çdo herë kërkojnë një masë të madhe njerëzish.¹⁹ Prandaj pranohet *a priori* se nuk mund të ketë dot një situatë retorike nëse nuk ka paraprakisht një publik.

Autorët Chaim Perelman dhe Luice Olbrechts-Tyteca e shohin publikun si një sagesë të krijuar me një përmbajtje dhe me një qëllim të caktuar nga vetë fjalimi retorik. Për krijimin e atij lloj publiku, përmbajtja e argumenteve në një fjalim retorik ka për qëllim nxitjen ose rritjen e besueshmërisë ndaj oratorit. Sipas dyshes studiuese, publiku nuk është diçka konkrete dhe e materializuar, por vetëm një sagesë e fjalimmbajtësit (pra, e oratorit).²⁰ Sipas tyre, secili fjalimmbajtës ndikon sadopak në mënyrë të vetëdijshme në publikun dhe për publikun. Pra, oratori kërkon t'u mbushë mendjen, t'i bindë ata që e dëgjojnë, për atë që ai i ka vënë qëllim vetes.

Për të analizuar krijimin e këtij lloj publiku nga ana e Millosheviqit, analiza që pason tutje përqendrohet si në fjalimet e tij, ashtu edhe në ndikimet që i janë bërë publikut pikërisht përmes oratorisë së tij publike.

18 Kjeldsen & Meyer 2004: 34.

19 Bitzer 1968: 7.

20 Perelman dhe Olbrechts-Tyteca, 1958: 19.

2.2. Teori e perspektiva vështrimi

Teoritë e Perelmanit, Olbrechts-Tytecas dhe Bitzerit, për sa ka të bëjë me fjalën publike, kanë si emërues të përbashkët mendimin; ata e konsiderojnë publikun si diçka cilësore. Kjo nënkupton se publiku mund të ndikohet përmes retorikës, dhe, si rrjedhim, mund të formësohet e të ndryshohet. Përderisa Perelmani dhe Olbrechts-Tytecas e kuptojnë publikun si konstruktiv (krijesë) të oratorit; Bitzeri, në anën tjetër, ndikimin e publikut e sheh në lidhshmëri me rrethanat në të cilat mbahet ligjërimi publik.

Një *publik retorik*, sipas Bitzerit, është një *publik faktik*, ose sipas fjalëve të tij: *“një publik, i cili do të jetë në gjendje të funksionojë si ndërmjetësues i atyre ndryshimeve që bashkëbisedimi kërkon të sajtojë”*.²¹ Një publik retorik (publik i sajuar) përbëhet ekskluzivisht nga persona, të cilët mund të ndikohen nga fjalimmbajtësi. Retorika cilësohet e pranishme kur ajo në njëfarë mënyre arrin ta ndryshojë realitetin.²² Është e afërmentdë që një fjalim ose një bashkëbisedim retorik është në gjendje të ndikojë në veprimet tona. Shi për këtë, Bitzeri e përcakton publikun si një element të rëndësishëm në rrethanat kur mbahet retorika. *“Meqë fjalimet retorike krijojnë ndryshime tek personat, të cilët funksionojnë si ndërmjetësues të ndryshimit, atëherë retorika kërkon gjithmonë një publik”*.²³

Në këtë kontekst, Bitzeri shkruan po ashtu se një situatë retorike *“përbëhet nga ata persona, ngjarje dhe marrëdhënie, që janë pjesë e atyre rrethanave (situatës), sepse ata kanë fuqi të detyrojnë e të çojnë përpara vendime dhe veprime të cilat janë të nevojshme për të ndihmuar problemin e ngutshëm”*.²⁴

Pra, qëllimi është të kuptohet dhe sqarohet *situata retorike* që mbretëronte në kohën kur u mbajtën fjalimet e qëllimshme retorike nga ana e Millosheviqit. Me qëllim të përshkrimit sa më të qartë, zgjedhjet më e mira për këtë analizë kritike pashmangshëm janë *situatat retorike dhe ndikimi te publiku*.

Është me rëndësi të theksohet se që të tri fjalimet retorike të Millosheviqit, që janë objekti shqyrtimor, kanë *situata të ndryshme retorike* e, po kështu, edhe *publik* të ndryshëm. Dhe natyrisht edhe

21 Bitzer 1968: 13.

22 Bitzer 1968: 10.

23 Bitzer 1968: 13.

24 Bitzer 1968: 13.

fjalimet janë të ndryshme për të realizuar ndikimin dhe përpunimin e publikut. Për shembull, fjalimi i Millosheviqit në Gazimestan përbëhet nga disa *probleme të ngutshme, publiku dhe rrethanat imponuese*.

Bitzeri thotë se çdo *situatë retorike* përbëhet nga tri elemente përbërëse:

1. *Ekzistenca e një problemi të ngutshëm*;
2. *Ekzistenca e një publiku*, i cili duhet të orientohet tek ajo që është vendosur të bëhet dhe veprimet që duhen kryer;
3. *Rrethanat imponuese*:

Problemi i ngutshëm, sipas Bitzerit, është diçka e pambaruar, e papërfunduar. Është një “gabim”, një pengesë, diçka që pritet të ndodhë e të bëhet, diçka që nuk është dhe si do të duhej të ishte. Por që *situata të jetë retorike*, duhet që *problemi i ngutshëm* të ketë mundësinë të ndryshohet me ndihmën e shprehjeve gjuhësore, pra, nëpërmjet komunikimit. Bitzeri merr si shembull vdekjen, dimrin dhe katastrofat natyrore si tipike për problemet e ngutshme, të cilat njeriu nuk ka mundësi t’i ndryshojë e as t’i ndalojë. Vdekjen nuk mund ta ndryshojmë e as ta ndalojmë me shprehje gjuhësore dhe me asgjë tjetër.

Publiku është elementi i dytë në një *situatë retorike*. Sepse ashtu siç u tha edhe më sipër, retorika kërkon prorre një publik. Shprehjet retorike mund të ndikojnë apo edhe të ndryshojnë vendime dhe veprime. *Situata retorike* kërkon secilën herë një publik, i cili është në gjendje të ndryshojë rrjedhën e *problemit të ngutshëm*. Sipas Bitzerit, një publik retorik është ai, i cili pranon dhe është në gjendje të ndikohet nga shprehjet gjuhësore dhe, po ashtu, të jetë ndërmjetësues i ndryshimeve në shoqëri në mënyrë që të zgjidhet problemi.

Rrethanat imponuese. Të gjithë ata njerëz, ndodhi, gjësende, besime, fakte, tradita, interesa dhe motive të ndryshme që gjenden të pleksur brenda situatës dhe mundësojnë zgjidhjen e problemit, sipas Bitzerit, janë rrethana imponuese. Nëse njerëzit në situatën kur mbahet fjalimi janë fetarë apo të prirë ndaj besimit në mitologji, do të ishte e këshillueshme që të përdorej zgjidhje e gjuhë tjetër për këta, dhe gjuhë e zgjidhje të tjetërsojtë për kategorinë e atyre njerëzve që janë ateistë.

Jeta na pikëton me gjithfarësoj problemesh, qoftë ato të mëdha apo të vogla: fëmijët vdesin nga kanceri, njerëzit vriten në luftë, vendi pushtohet, dikujt i humbet ora e dorës apo të tjerë zihen me miqtë dhe kolegët e punës. Pra, po të mos ishin të tilla andralla e probleme të ngutshme, nuk do të shfaqej nevoja për përshtatje e as për arnime.

Nuk do të ishte madje nevoja për hulumtime retorike e debate, e as për argumentime e komunikim. Përgjigjja është e thjeshtë: nuk do të kishim kurrfarë arsye për ndryshime; ndryshime këto që kryhen përmes komunikimit.

Jeta është përplot me telashe. Më 2001, kur terroristët sulmuan kullat binjake në New York të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, papritmas u shfaqën një duzinë problemesh: frika, nevoja dhe kërkesa për informacione për njerëzit e vrarë dhe kush ishin ata terroristë që sulmuan Amerikën. Bota në të cilën jetojmë është e mbushur anë e përtej me probleme e gabime. Dhe ajo që vlen të nënvizohet është se nuk janë retorike të gjitha problemet dhe gabimet.

Një *problem i ngutshëm*, i cili nuk mund të zgjidhet përmes gjuhës, nuk është retorik. Gjërat që ndodhin jashtë kontrollit të njeriut, si fjala vjen, nata dhe dita, pleqëria, vdekja dhe sa e sa fatkeqësi natyrore, janë probleme të ngutshme, por ato nuk janë retorike.

Komunikimi retorik nuk ka të bëjë me proceset natyrore; nuk është në tagrin dhe as në mundësinë tonë të ndalojmë vdekjen. Sikur të ishte e mundur kjo, shumë njerëz do ta shtynin vdekjen sa më gjatë e sa më shumë. Por e vërteta është se, edhe sikur të flasin ditë e natë pareshtur, ata as nuk mund të vendosin dhe as të ndikojnë kur do të vdesim. Kjo domethënë shqeto se një *problem i ngutshëm*, i cili mund të zgjidhet përmes mjeteve të tjera, e jo përmes shprehjeve gjuhësore (komunikimit), nuk është retorik. Nëse qëllon të jetë prishur biçikleta dhe nëse është e mundur që biçikleta të rregullohet me çekan, pa e përdorur gjuhën si mjet zgjidhje, atëherë në një rast të këtillë kemi të bëjmë me një problem teknik e jo retorik. Tani pyetja që lind është nëse fjalimet e ish-presidentit serb Millosheviq kishin problemet e ngutshme retorike.

Duhet pasur parasysh se një *publik retorik* përbëhet kryesisht nga njerëzit të cilët me ndihmën e shprehjeve retorike (1) *mund* të ndikohen dhe të binden që të mendojnë apo veprojnë në mënyra të caktuara; (2) *kanë mundësi*; dhe (3) *dëshirë* për të krijuar ndryshime që do t'i ndihmonin zgjidhjes së problemit të ngutshëm të situatës retorike.

Detyra e folësit në një situatë retorike është që, pikësepari, të kuptojë dhe “skanojë” *problemin e ngutshëm*. E dyta me radhë është që folësi duhet ta *bindë* publikun për pikëpamjet e tij lidhur me situatën. Ky folës duhet të sajojë e ta ndërtojë bashkimin dhe pajtueshmërinë mbi këtë pikëpamje, në mënyrë që publiku retorik të mendojë dhe të veprojë në atë mënyrë që ta modifikojë apo ta zgjidhë *problemin e*

ngutshëm. Dhe një shembull në formë vramendje që vlen të evokohet: si e përdori gjuhën Millosheviqi për të bindur publikun e tij për ndryshimet kushtetuese serbe?

2.3. Kushtet retorike

Siç u bë e ditur edhe më sipër, rol të madh në ndikimin, sajimin dhe në ndryshimin e mendimeve të publikut, luajnë tre komponentët e retorikës: karakteri ose autoriteti personal i folësit (*ethos*), strategjia logjike për të bindë (*logos*), si dhe apeli emocional (*patos*), që i mëshon përdorimit dhe manipulimit të ndjenjave.

Kushtet retorike janë pjesë e situatës dhe kanë ndikim si te folësit, ashtu edhe publiku. Në të njëjtën kohë, folësi dhe publiku janë pjesë e situatës. Dhe një fjalim është retorikisht i suksesshëm, nëse ai funksionon si përgjigje e përshtatshme për situatën retorike. Pyetja që natyrshëm ngrihet me këtë rast është nëse përzgjedhja e Kosovës nga Millosheviqi ishte e rastësishme e jodjallëzore?

Së bashku këto tri elemente përbëjnë atë që është e rëndësishme në një situatë retorike, dhe që përcaktojnë se çfarë përbën një përgjigje të përshtatshme retorike për secilën situatë retorike.

Por, sidoqoftë, është një retorikan tjetër që nuk pajtohet me përcaktimin e Bitzerit për marrëdhënien midis *situatave retorike* dhe *diskursit publik*. Ai është Richard Vatz²⁵, i cili haptas kundërshton pikëpamjen e kolegut të tij në këtë domen. Aty ku Bitzeri beson se *situatat kërkojnë retorikë*, Vatz i kundërvihet me pikëpamjen se janë *diskurset retorike* ato që sajojnë dhe krijojnë *situata retorike*. Po kështu, Bitzeri kritikohet edhe për shkak të qëndrimit të tij determinist rreth situatës retorike.

Ai është kritikuar për mosnjohjen e veprimeve të pavarura që ka një folës – folësi në të vërtetë ka edhe përgjegjësi etike. Me këtë rast, Vatz i quante mit pikëpamjen e Bitzerit (*The Myth of the Rhetorical Situation*). Sipas tij, mendimi është cilësi e brendshme e secilit njeri.

Përderisa Bitzeri vlerësonte se është *situata retorike* ajo që e kërkon retorikën, Vatz i nënë tjetër i mbahej asaj se është gjuha, fjalimet, teksti, komunikimi, pra retorika, ajo që sajón dhe kërkon *situatën retorike*.

E gjithë kjo papajtueshmëri e tyre do të përkapej fare mirë nga shprehja shqipe “si është vendi, bëhet kuvendi” apo “si është kuvendi,

25 Vatz, “The Myth of the Rhetorical Situation”, f. 159.

bëhet vendi”. Në çdo rast, fjalimet retorike krijojnë ndryshime duke ndikuar në mendimet, vendimet dhe veprimet e personave të cilët mund të kontribuojnë në krijimin e ndryshimeve.

Nisur nga kjo, Bitzeri dhe Vatzji janë fort të rëndësishëm për analizën e fjalimeve të Millosheviqit. Kjo sepse viza-vi me të është një publik që sajohet e ndikohet nga fjalimi i tij; dhe në prapakthim do të jenë mu këta njerëz të ndikuar që do t’i çojnë më tutje ndryshimet politike që i planifikonte Millosheviqi. Dhe pyetja e radhës që shtrohet është nëse fjalimet e diktatorit serb krijuan situatën retorike apo nëse fjalimet e tij ishin produkt i situatave retorike, apo që të dyja bashkë? Fjalimet retorike të Millosheviqit nuk ndryshojnë edhe aq nga fjalimet klasike oratorike (bombastike). Po u krahasuan me to, ndryshimet e fjalimeve të tij janë të kushtëzuara nga koha dhe vendi ku mbahen. Situata të cilës i referohen fjalimet oratorike të Millosheviqit, është parësisht një e tillë që është e ndikuar dhe e krijuar nga rrethanat e shumëllojshmërisë së shoqërisë. Së këndejmi, fjalimet retorike të tij i janë përshtatur disa kornizave të rrethanave politike, ekonomike e shoqërore të asaj kohe. Kjo ndodhte ngase detyra e fjalimmbajtësit, në një rast të atillë, nuk ishte vetëm që t’u përshtatej kërkesave të situatës, por edhe të ndryshonte mendimin e opinionit publik serb, rrjedhimisht të krijonte situata të reja retorike e politike.

Teoria e Bitzerit për *situatën retorike* është një mjet i dobishëm, atëherë kur ideja është të formulohet një tekst apo fjalim. Kjo sjell një vëmendshmëri mbi atë se në cilën situatë retorike ndodhemi. Vetëm kështu, situata retorike mundëson të zbulohen më lehtë mundësitë që kjo ofron, ashtu sikundër edhe kërkesat që po e njëjta situatë i parashtron për fjalimmbajtësin. Nëse përmes shprehjeve retorike ia dilet mbanë, kjo kërkon nga ne të jemi të vetëdijshëm se cilat probleme të ngutshme duam t’i zgjedhim, cili publik ka mundësinë të zgjedhë këtë *problem të ngutshëm* dhe cilat janë *rrethanat imponuese* që na e lehtësojnë dhe e rregullojnë atë çfarë ne duhet të bëjmë gjatë një fjalimi.

Situata retorike dhe problemi i ngutshëm kanë nxitur shumë publicistë, politikanë dhe analistë që në shkrimet, fjalimet dhe idetë e tyre të përzgjedhin argumentime dikotomike. Dhe pikërisht është propaganda ajo që operon me botën dikotomike, të ndarë në binonim “Ne = të mirët” dhe “Ata = të këqijtë”.

Këto rrëfime mitike, stereotipa dhe prodhime të fotografisë së tjetrit të objektifikuar si “armik”, njihen si strategji e të ashtuquajturës retorikë e tmerrit. Por, debatet liberale e konsiderojnë si problematik

argumentimin dikotomik, sepse shoqëritë e sotme demokratike janë fundamentuar për të pranuar mendimin tjetër si ndër vlerat kuintesenciale të një komuniteti pluralist. Janë të tilla, pra, që i qasen “mendimit ndryshe” si kundërshtar, por jo si armik.

2. 4. Analiza e përbërjes në togfjalësja

Ajo çka pason në vijim bart më vete shqyrtimin e përbërjes në togfjalëshat e përdorur më së shpeshti nga Millosheviqi. Qëllimi i përdorimit të kësaj teorie është analiza dhe interpretimi i asaj që flitej në ato fjalime oratorike, në të cilat qëndronte “themeli” i gojëtarisë së tij. Ky përimitim i grupimeve të fjalëve është një analizë kritike e retorikës e që qendërzohen rreth tri parimeve. *Parimi i parë* i mëshon asaj se retorika është një formë e veprimtarisë njerëzore. Kjo ndërkall kuptimin se retorika është diçka që njeriu bën me fjalët e tij në mënyrë që ato të mund të ndikojnë një palë të tretë. *Parimi i dytë* është se këtu nevojitet një lloj talenti për të kuptuar retorikën, ndërsa *parimi i tretë* është se përmes të kuptuarit të retorikës formohet një këndvështrim i caktuar mbi botën.

Kjo metodë u shpalos dhe u zhvillua për herë të parë nga Kenneth Burke në librin e tij “*Attitudes towards history*”, që u botua më 1937. Ai aty i mbahej asaj se metoda është një mjet ndihmës që mund të na japë një pasqyrë mbi botëkuptimin e oratorit.²⁶

Gjithashtu, ai konsideronte se, me anë të klasifikimit dhe renditjes së grupit të fjalëve (togfjalëshave), është i mundur zbulimi dhe gjetja e “përbërësit të rëndësishëm” në një fjalim retorik. Këta togfjalësja janë përfshirë prej Millosheviqit në “bashkime simbolike”, e që përmbajnë një kuptim të veçantë mistik bazuar në përshkrimin konvencional, por të shpërfytyruar të realitetit. Në këtë mënyrë, sipas Burkes, “gënjeshtra është e pamundur”.²⁷ Ai tutje shkruante se nëse një njeri flet për nderin, por përdor një gjuhë metaforike për shkatërrimin, atëherë tema e tij e vërtetë është shkatërrimi.²⁸

Thënë shkurt, metoda e Burkes ndihmon në pikasjen e togfjalëshave kyç. Kjo njëherazi bën të mundur edhe kuptimin e domethënies së togfjalëshave.

26 Foss 1996: 63.

27 Po aty.

28 Po aty.

Në mënyrë që të zbulojmë botëkuptimin e Millosheviqit përmes shkoqitjes së togfjalëshave të tij tipikë, fillimisht kërkohet të qëmtohen fjalimet e tij dhe të shihet se “*çfarë përshatet me çfarë*”. Burke theksonte se grupimet e njëjta të fjalëve dhe togfjalëshave që një kritik i gjen te fjalimmbajtësi, zakonisht nuk janë të njohura për oratorin; madje ai as nuk është i vetëdijshëm për to.²⁹

Kjo metodë ofron një mundësi ideale për të përcaktuar marrëdhënien me fjalimin e oratorit. Po ashtu, ajo ofron një perspektivë të re për kritikët e retorikës, që dëshirojnë të zbulojnë më tepër rreth motiveve, qëllimeve dhe karakterit të fjalimmbajtësit.

Analiza e *grupit të fjalëve* merret me problematikën se si përmes gjuhës dhe gramatikës interpretohet bota sociale, si kuptohet ajo, si përfjohet dhe si riprodhohet kjo botë përmes përzgjedhjes së fjalëve të ndryshme. Fillimisht, kjo metodë identifikon shprehjet kyçe, dhe më pas zbulon domethënien e këtyre shprehjeve përmes hulumtimit të fjalëve, të cilat grumbullohen përreth togfjalëshave kyç të fjalimit retorik.

2.5. Termat kyç

Ndërkaq, Sonja K. Foss në librin e saj “*Rhetorical Criticism*” sqaron metodën rreth analizës së grupimit të fjalëve si dhe mënyrën si duhet të pikasen togfjalëshat kyç brenda një teksti. Së pari, duhet të bëhet identifikimi i termave kyç (*Identification of Key Terms*). Rëndësia e fjalëve kyçe përzgjidhet në bazë të *shpeshtësisë* apo dendurisë së një togfjalëshi të caktuar³⁰.

Hapi i dytë i rëndësishëm në një analizë retorike është regjistrimi i termave që grumbullohen rreth fjalës kyçe. Pasi të jenë identifikuar togfjalëshat kyç, atëherë studiuesi hulumton grupimin e fjalëve përreth togfjalëshit kyç. Kjo, pra, kërkon një studim më të hollësishëm të retorikës me qëllim të identifikimit të çdo prejardhjeje të togfjalëshave kyç.

Hapi i tretë është zbulimi i modelit tek togfjalëshat. Pasi të jenë identifikuar shprehjet dhe togfjalëshat kyç të oratorisë tërheqëse (fjala vjen, “*fairness*” dhe “*I have a dream*”), atëherë kritiku hulumton grupimin e fjalëve rreth togfjalëshave kryesorë.³¹

Si shembull, Fossi sjell fjalimin e Clintonit “*on health-care reform*” dhe atë të Martin Luther Kingut “*I have a dream...*”. Në fjalimin e Clintonit, fjala “*fairness*” është fjalë kyçe, e cila është përzgjedhur në

29 Burke, 1941: 20.

30 Foss 1996: 65.

31 Foss 1996: 65 – 66.

shumë nga fjalimet e tij mbështetur në dendurinë dhe përqendrimin e fjalimmbajtësit në këtë fjalë. Ndërkaq, në fjalimin e Martin Luther King, fjala “*dream*” është kyçe, ngase është përmendur shpeshherë.

Një mundësi tjetër për të përzgjedhur togfjalëshin apo fjalën kyçe është *intensiteti* (denduria). Fossi ka bindjen se një term mund të mos shfaqet shumë shpesh në fjalimin apo në shkrimin e një retoriku, por mund të jetë ekstreme në shkallë, madhësi, forcë ose në thellësi të ndjenjës që ai përcjell.

Mund të jetë një term që shpreh një ndjenjë veçmas të fortë. Kështu, termat që përzgjidhen në analizën e grupimit të fjalëve mund të ndahen në dy grupe: në “terma të Zotit” (*God terms*) dhe në “terma të djallit” (*devil terms*). Tek të parët përfshihen terma përfundimtarë, që përfaqësojnë idealen e oratorit – pikëpamjen e oratorit për atë që është më e mira ose më e përsosura.

Në anën tjetër, *termat e djallit* janë krejt e kundërta e grupit të parë dhe përfaqësojnë negativen ose të keqen për fjalimmbajtësin³². Duke e shembullzuar me një rast konkret, Fossi shprehet: “*Në fjalimet e shumë politikanëve, për shembull, krimi kuptohet si një ‘term i djallit’, dhe burgu kuptohet si ‘term i Zotit’; që të dyja besueshmërisht funksionojnë si terma kyç*”.³³ Vetëm pasi të jenë identifikuar fjalët kyçe, është e mundur të fillohet me analizën e togfjalëshave kyç.

Së pari, fillohet me identifikimin e togfjalëshave kyç në fjalimet e Millosheviqit. Më pas, përmes *termave të Zotit* dhe *termave të djallit* sqarohet dhe analizohet se si është interpretuar, përjetuar dhe riprodhuar bota sociale dhe politike e Millosheviqit; dhe e gjithë kjo përmes përzgjedhjes së fjalëve në fjalimet e tij.

Burke ka hetuar edhe *rëndësinë* e secilës shprehje dhe metodave për sqarimin e togfjalëshave kyç.

Dhe është pikërisht kjo metodë me anë të së cilës mund të analizohen fjalimet e Millosheviqit. Ajo e ka të domosdoshëm edhe analizimin e gjuhës figurative dhe fjalëve, ashtu sikurse edhe qartësinë dhe fuqinë e fjalëve në secilin fjalim. Duhet theksuar se *togfjalëshat kyç* janë shpesh afër termave kyç në mënyra krejtësisht të ndryshme. Berthold thotë se analiza e fjalëve të *togfjalëshave kyç* nuk është e përfunduar, në rast se analizës së tyre i mungon sensi i konfliktit dhe i dramës³⁴. Pra, pesha e *togfjalëshave kyç* është një gërshtetim i disa faktorëve siç janë: intensiteti krahasues dhe frekuenca e tyre, fuqia dhe qartësia e imazheve, pa harruar këtu edhe frekuencën me të cilën është e lidhur

32 Foss, 1996: 65.

33 Po aty.

34 Berthold, 1976: 306.

me terma të tjerë kyç. Pra, konflikti dhe drama janë të rëndësishme së veçantë për një fjalim retorik bombastik.

Kundërthëniet (antagonizmat) janë të rëndësishme nëse qëllimi është të zbulohen konfliktet dhe tensionet eventuale në një fjalim politik oratorik. Sepse, siç thotë Bertholdi, analiza e një gjendjeje të rëndë shëndetësore ilustron “konfliktin dhe dramën” brenda vetë personit³⁵.

2.6. Krijimi i publikut nga retorika

Teoritë kryesore, që ndihmojnë në zbulimin e mënyrës së përpunimit të publikut nga ana e Millosheviqit, tashmë janë paraqitur nga teoricienët e njohur të retorikës post-strukturaliste si Maurice Charland dhe Michael Calvin McGee. Që të dy në punimet e tyre shkencore kanë hulumtuar se si retorika mund të sajojë, mbajë dhe të konstitujë një publik.

McGee e konsideron *popullin* si një sajim retorik, një sajim sipas mjeshtërisë së gojëtarisë të politikanëve. Sipas tij, i vetmi realitet njerëzor është individi, përderisa të gjitha llojeve të grupeve njerëzore u është “shtuar” një identitet artificial.³⁶ Kështu më artikullin e tij “In Search of ‘the People’: A Rhetorical Alternative”, Michael McGee përdor shprehjen “*the people*” (popull) dhe përshkruan se si diskutohen dhe krijohen grupe të tilla brenda literaturës retorike. Ai e problematizon këtë koncept dhe argumenton se brenda retorikës termi “popull” përdoret më shpesh si një zgjatim për “person”.³⁷

Në vend të kësaj, McGee sugjeron një kuptim alternativ të këtij termi. Ai e zgjidh problemin me mungesën e përkufizimit për “popullin” duke pohuar se populli nuk ekziston në realitet. Në vend të kësaj, populli është i konstruktuar përmes një realiteti retorik dhe se anëtarët marrin pjesë aktivisht në një fantazi kolektive.³⁸

Sipas McGee, “populli” ekziston vetëm përmes retorikës.³⁹ Në këtë mënyrë, “populli” mund të kuptohet si një proces retorik, meqë ekzistenca e grupit bazohet vetëm në retorikën e vazhdueshme e të fuqishme.⁴⁰ Prapa ndërtimit të një identiteti grupor qëndron një zëdhënës që në mënyrë retorike shndërron individët në “popull”.⁴¹ Ai

35 Po aty.

36 McGee, 1975: 240.

37 McGee, “In Search of ‘the people’: A Rhetorical Alternative”, 237.

38 Po aty.

39 Po aty.

40 McGee, 1975: 240.

41 McGee, 1975: 242.

sqaron edhe atë se: *“I gjithë procesi i socializimit nuk është gjë tjetër pos ushtrim i ngjeshur dhe i vazhdueshëm për ta bindur individin”*⁴².

Gjithnjë në këto suaza, McGee e konsideron publikun si një lloj produkti të ideologjisë, politikës dhe retorikës. Ai thotë se publiku reason me dëshirë për t’u bërë *popull*; pra, populli është i dizajnuar nga historia, politika dhe ideologjia.

Një shembull tjetër i rëndësishëm, të cilin McGee në vazhdim e sjell, është përshkrimi i Hitlerit për proceset retorike dhe mënyrën se si një “lider” i shndërron individët në “popull”⁴³. Në lidhje me pikëpamjen e Hitlerit për “popullin”, McGee shprehet se: *“Ai nuk krijon përshkrim të realitetit, por më tepër sajon një mit politik”*⁴⁴.

Dhe bash këto mite⁴⁵ politike shpeshherë janë ngatërruese në përshkrimet e realitetit nga historianët, të cilat i vërejmë edhe në kohët e fundit. Dhe kjo mënyrë e transformimit të individit në “popull” me identitet të ri, nuk sjell asgjë tjetër, e që sipas fjalëve të McGee *“rezultati është argëtimi dhe polemika e pakuptimtë”*.⁴⁶

Pra, si një mit politik “populli” me identitet të ri do të ekzistojë për aq sa do të jetë e fuqishme retorika, e cila e ka përcaktuar dhe formuar këtë identitet të ri. E nesër kur retorika të jetë zbehur apo të mos jetë më e fuqishme, ky “popull” nuk do të jetë asgjë tjetër përveçse një bashkim individësh.

2.7. Të kuptuarit e publikut retorik: rasti i Quebecut

Me emrin e Charlandit mund të asociohet termi për *retorikën konstituive*; është fjala për konceptin të cilin ai e zhvilloi gjatë një studimi analitik të retorikës në lidhje me lëvizjen për pavarësi në rajonin e Quebecut në Kanada (1987). Përmes retorikës konstituive, në rastin në fjalë u krijua njëfarë subjekti ideologjik dhe një identitet nacional për një lloj të ri të subjektit politik. Pra, termi në fjalë presupozon një subjekt dhe një identitet që ekziston falë retorikës.

Charlandi argumentonte se retorika konstituive është element me rëndësi për lëvizjet shoqërore, dhe e tillë është edhe për fushatat politike nacionaliste. Kjo do të thotë se retorika konstituive me ndihmën e lavdërimeve, ligjërimeve dhe mendimeve të formuluarat e të

42 Po aty.

43 Po aty.

44 McGee, 1975: 242.

45 Mitet janë krijime gojore popullore që shtrembërohen me qëllim dhe paraqiten krejt ndryshe nga ç’janë në të vërtetë.

46 McGee, 1975: 240, 241.

llogaritura mirë, mund të bindë, të përmbysë, të fitojë dhe të përgatisë grupe politike, sociale e ideologjike.

Tutje, Charlandi pohonte se identiteti është prodhim i retorikës dhe se kjo e fundit sajón subjektin politik. Ai i mëshonte edhe asaj se edhe ekzistenca e subjekteve sociale tanimë është një efekt retorik. Sipas tij, retorika konstituive ndërton subjekte politike përmes efekteve të identifikimit që:

1. *sigurojnë identitet kolektiv për një publik të adresuar;*
2. *ndërtojnë publikun si lëndë në histori;*
3. *kërkojnë që subjektet të veprojnë në përputhje me identitetin e tyre të miratuar në histori.*⁴⁷

Krijimi i identitetit, si faktor i rëndësishëm për të kolektivizuar dhe ndihmuar kombet, zë vend të rëndësishëm në teorinë e Charlandit kur bëhet fjalë për konstituimin e publikut. Ai shprehej se retorika konstituive është shumë afër retorikës së bindjes. Ndaj, mund të thuhet se bindja është element vendimtar për manipulim. Pra, *“para se të mbajmë një fjalim për publikun, se pari duhet të sajohet dhe të konstituohet identiteti i tyre”*⁴⁸.

Si pikënisje për të shtjelluar përmes shembujsh retorikën konstituive, Charlandi merrte rastin e lëvizjes për pavarësi në Kanada, me saktë pavarësinë e “kuibekasve”. Është me rëndësi të nënvizohet se në kauzën për mëvetësi, ligjërimi retorik luante një rol të madh; në fakt, retorika bëri të mundshme ndërtimin e një identiteti kuibekian. Duke u konstruktuar një popull të ri kuibekian, gjithnjë sipas shpjegimit të Charlandit, u mundësua dhe u legjitimua njëkohësisht legalizimi i rajonit të Quebecut si një shtet i pavarur.

Për këtë arsye, teoria e Charlandit për retorikën konstituive është me rëndësi për këtë analizë, sepse janë fjalimet retorike të Millosheviqit ato që krijojnë dhe legjitimojnë një identitet të ri dhe po ashtu sajojnë një publik të ri nacionalist.

Me këtë rast, Charlandi përmendte Kushtetutën si një mjet për të sajuar një publik të dëshiruar. E vetëkuptueshme është që në sajimin e publikut rol të veçantë kanë edhe simbolet, fotografitë, figurat, ashtu si dhe Kushtetuta, të cilave, sipas Charlandit, mund t’u shtohen edhe tekstet. Janë këto të fundit që qëlluan të jenë ndihmesë e rëndësishme për pavarësinë politike të Quebecut. Me fjalët e këtij autori, *“Libri i*

47 Charland 2001: 617.

48 Po aty.

Bardhë ... ishte një dokument retorik” dhe se populli kuibekas duhet të marrë pavarësinë e vet⁴⁹.

Nga ky pikëvështrim mund të kuptojmë se mbështetësit e një lëvizjeje për pavarësi politike orvaten të ngjallin ekzistencën e një kombi (në këtë rast kombi kuibekas), dhe kësaj të legjitimojnë një shtet të pavarur. Pra, kjo retorikë në mënyrë paradoksale duhet të konstitujë identitetin “Quebecois”⁵⁰. Retorika, në një rast të këtillë, përdoret për të krijuar një identitet, dhe kjo rrah të na bindë se kërkesa për pavarësi të Quebecut ka një ekzistencë historike, politike dhe kulturore. Si rrjedhojë e kësaj, pavarësia është “jetike, e natyrshme dhe e nevojshme”⁵¹.

Një ngjarje e rëndësishme në fjalimet politike të Millosheviqit ishte ndryshimi dhe zëvendësimi i Kushtetutës së vjetër serbe me një të re. Për të sajuar një publik luftëdashës serb në Kosovë (dhe jo vetëm aty), ai, përveç fjalimeve retorike, përdori lëvizjet politike, mobilizimin përmes fjalimeve, deklarata të ndryshme të shtypura dhe, përfundimisht, edhe luftën.

Një element tjetër me rëndësi në retorikë është edhe përdorimi i mitikes. Veçmas kur janë në pyetje popujt e Ballkanit, duhet të mbahet në konsideratë fuqia e legendave dhe miteve si pjesë qenësore e identitetit të tyre kulturor. Duke përdorur Kushtetutën, retorika konstituive pati potencial të fuqishëm sajues. Pra, nëpërmjet përdorimit të kushtetutës, retorika e bënë të mundshme të sipërfaqësohet diçka e re, dhe se bashkësia politike bëhet realitet dhe e mundshme.

2.8. Duke shpikur një identitet

Kësisoj, retorika konstituive është mjet i dobishëm strategjik për prodhimin e identiteteve të reja kulturore, politike dhe shoqërore. Me ndihmën e teorisë së Charlandit për *“Constitutive Rhetoric”*, do të shqyrtohen dhe interpretohen mënyra se si u përdorën mitikja, simbolika, ikonat, historia dhe feja në fjalimet e Millosheviqit për të krijuar një identitet dhe subjektivitet politik. Kjo sepse identiteti është edhe produkt i retorikës konstituive.

Me fjalë të tjera, teoria e Charlandit është një “skaner”, i cili ndihmon të shihet më qartë dhe, kështu, të depërtohet më thellë në mënyrën se si u bë sajimi i publikut të Millosheviqit.

49 Charland 1987: 135.

50 Po aty.

51 Po aty.

Së pari, është e nevojshme të tërhiqet një paralele midis diskursit politik të Quebecut dhe atij të Millosheviqit në Kosovë dhe Serbi. Pas kësaj vijon hulumtimi i fjalimeve të Millosheviqit për të sqaruar identitetin serb si subjekt politik në Kosovë.

Kjo teori, ç'është e vërteta, e lehtëson hulumtimin sesi sajohe publiku sipas ligjërimeve të ndryshme të mbështetura në identitet, siç ishte shembulli i ligjërimit mbi të ashtuquajturin identitet serb në Kosovë.

Gjithnjë duke ndjekur hullinë e Charlandit dhe shembujve që sjell ai mbi retorikën në lëvizjen politike në Kanada (*Mouvement Souveraineté-Association*), do të argumentohet se ligjërimi retorik i Millosheviqit krijoi në mendësinë e popullit serb mitin se Kosova është “zemra e Serbisë”, “djepi” dhe “toka serbe”; pra, kjo e manifakturoi Kosovën si gjoja simbol dhe ikonë të identitetit kombëtar serb.

Në këtë logjikë analize do të shqyrtohen edhe nuancat historike, kulturore dhe politike në fjalimet e Millosheviqit. Për shembull procedohet me pyetje të kësillojta: përse “Serbia e bashkuar” ishte e natyrshme dhe e nevojshme? Përse Kosova është e logjikshme të jetë “zemra e Serbisë”? Ndërfutja retroaktive e mitikes dhe historisë në ligjëratat retorike është gjithashtu një argument i fuqishëm analize për të sqaruar se pse ishte e vetëkuptueshme dhe e natyrshme që Serbia duhej të kishte një Kushtetutë të re.

Teoria e Charlandit qartëson se si ligjërimi retorik konstrukton publikun e tij në një kuptim të dyfishtë; retorika konstituive e trajton publikun si një subjekt të veçantë, por në të njëjtën kohë ajo e pretendon ekzistencën e të njëjtit pozicion të subjektit dhe kërkon të drejta në emër të tij.

2.9. Një botë metaforash

Brenda fushës së retorikës është edhe ajo që njihet si *tropologji*. Ajo përdoret për të ndryshuar gjuhën ose për të “artisticizuar” atë me qëllim që ta bëjë më efektive dhe efikase. Kjo i jep edhe formë të re shprehjes, për shembull përmes metaforave. Një metaforë është njëfarë krahasimi i mbështetur në ngjashmëri.

Sipas një interpretimi të pranuar, metaforat janë figura letrare që mund të luajnë rol të rëndësishëm në përshkrimin e së vërtetës, ose edhe e kundërta. Metaforat përmbajnë krahasime të nënkuptuara, këndvështrime dhe vlerësime.

Përmes tyre shprehen veprime, pikëpamje e formime ideologjike, politike etj., të dikujt ose ndaj gjithçkaje që përshkruajnë oratorët.

Me anë të saj theksohen tiparet e ngjashmërisë, ose, përkundrazi, ndryshimet e sendeve apo të fenomeneve mbi të cilat oratori dëshiron ta tërheqë vëmendjen e publikut. Kjo nënkupton se metaforat mund të përdoren shumë mirë në shërbim të argumentit, ose me ndihmën e tyre të krijohen argumente.

Edhe Millosheviqi në fjalimet e tij përdorte metafora për të ngulitur më mirë në mendjet e dëgjuesve e për ta bërë më të qartë një mendim të caktuar për çështje të veçanta. Kjo bie më së shumti në sy në fjalimin e tij të parë, ku ai përdorte “zemrën” si një element metaforik.

3.0. HISTORIKU

Një depërtim për së afërmi në rrethanat që përftuan luftërat është i pashmangshëm gjatë analizimit dhe dritësimit të fjalimeve retorike të Millosheviqit.

Lufta e fundit në Kosovë nuk mund të kundrohet e izoluar dhe e shkëputur nga historia e saj, e Shqipërisë dhe e Ballkanit. Kosova është pjesë e një historie tragjike të kombit shqiptar, subjekt i padrejtësive të shumta historike. Rrjedhimisht, për të përkapur kuptimisht frymën e përmbajtjen e fjalimeve politike të mbajtura në momentin e dhënë historik, të domosdoshme janë njohuritë mbi rrethanat bukur komplekse historike, shoqërore dhe gjeopolitike të rajonit.

3.1. Ballkani gjatë Periudhës Osmane dhe Kongresi i Berlinit (1878)

Viti 1389 përbën një nga momentet kthesë kur osmanët avancuan me pushtimet e tyre në zemër të Ballkanit. Në qershor të atij viti, sipas një duzine burimesh historike, sundimtarë e zotër të popujve kryesorë në rajon u shtrënguan të organizonin një koalicion të përbashkët për të frenuar mësymjen osmane. Ky bashkim forcash pati, midis të tjerash, edhe sundimtarin serb L Lazar Hrebeljanoviq. Kjo aleancë që mori pjesë në atë që u bë e njohur si Beteja e Kosovës e vitit 1389, në përbërje të së cilës kishte serbë, shqiptarë, boshnjakë dhe hungarezë, u thye nga osmanët, të cilët udhëhiqeshin nga sultan Murati I (1360 - 1389)⁵².

Si epoka më e rëndësishme historike dhe politike për serbët mesjetarë konsiderohet periudha nën Stefan Uroshin IV (1331-1355). Ai bëri emër si udhëheqës i shquar serb, dhe, në vazhden e luftërave dhe pushtimeve të tij, ai më 1346 u kurorëzua nga serbët si “car” i tyre. Koha e tij për shumë nacionalistë serbë mbahet si krenaria e Serbisë dhe epoka e madhështisë. Nga aty rrodhi dhe u projektua misioni, ëndrra dhe termi politik Serbi e Madhe.

Por, për aq sa shkojnë burimet historike të kohës, është e rëndësishme të theksohet se shqiptarët ishin pjesë thelbësore e kësaj aleance, duke u rreshtuar me këtë rast në anën e fqinjëve të tyre të

52 Petritsch 1999: 30ff.

rrezikuar. Kontingjentet shqiptare ishin të pranishme në betejë nën flamujt e familjeve të njohura fisnike si Balshajt, Muzakajt, Jonimët e të tjerë “zotër të Shqipërisë”, po të flasim me gjuhën e kronikave të kohës⁵³. Humbja në betejën e vitit 1389 nga ajo kohë e në mënyrë retroaktive gjatë shekujve vijues u kultivua si miti më i fuqishëm historik i Serbisë.

Pas disfatës së këtij koalicioni, ashtu sikundër edhe përpjekjes së dytë po në Kosovë më 1448, shekujt në vijim do të pasoheshin me të qenët nën sundimin osman.

Pas trazirave në pashallëkun e Beogradit në gjysmën e parë të shekullit të nëntëmbëdhjetë, Serbia do të njihej si shtet i pavarur nga Fuqitë e Mëdha më 1878 përmes Traktatit të Berlinit. Megjithëse rezistenca shqiptare kundër osmanëve vijoi edhe pas shekullit të pesëmbëdhjetë, aq sa shqiptarët konsideroheshin nga Napoli, Spanja e më pas edhe Perandoria e Shenjtë Romake si elementi më kryengritës, shqiptarëve vetëm më 1913 iu njoh një shtet liliput që la më shumë se gjysmën e territoreve dhe popullatës jashtë kufijve të tij.

Por, udhëheqësi shqiptar Gjergj Kastrioti – Skënderbeu (1405-1468) frenoi me sukses për gjysmë shekulli invazionin osman. Pas vdekjes së tij, dhe me pushtimin në dekadat në vijim të Krujës, Shkodrës dhe Durrësit, ledhi që mbronte Evropën, siç quhej Shqipëria në Perëndim, ra përfundimisht nën pushtimin osman. Shqiptarët u ndikuan nga kultura orientale, por fakt është që feja nuk ka qenë kriter vendimtar për identifikim kombëtar.⁵⁴ Megjithëse në shekujt e fundit numri i të konvertuarve përftoi një përqindje që i afrohej një shumice relative, e vërteta është se Islami kurrë nuk pati ndonjë ndikim të fortë ndër shqiptarë.

Në anën tjetër, edhe një pjesë e numërt e serbëve u konvertuan në myslimanë, morën privilegje në hierarkinë dhe administratën osmane, ndërkaq sipas një dëshmie të shekullit të gjashtëmbëdhjetë “*sllavishtja ishte gjuha që përdorej nga jeniçerët*”.⁵⁵

3.2. Kosova si baza e kryengritjeve shqiptare

Një lëvizje serioze kombëtare ndër shqiptarë u ndje fill pas Traktatit të Shën Stefanit dhe veçmas gjatë dhe pas Kongresit të Berlinit, kur u themelua Lidhja e Prizrenit më 10 qershor 1878. Shqipëria u shpall

53 Giovanni Musachi di Berat, *Breve memoria de li discendenti de nostra casa Musachi*, 1510.

54 Mønnesland 1999: 18.

55 Paulus Jovius, *De Legatione Moscovitarum*, 1525.

më “vehte, e lirë e e mosvarme” nga Perandoria Osmane më 28 Nëntor 1912, por ajo u njoh si shtet nga Fuqitë e Mëdha vetëm disa muaj më vonë në Konferencën e Londrës (1913). Në zemër të luftës për çlirim e emancipim kombëtar ishte ideja për veçantinë e gjuhës shqipe, si dallori thelbësor i kombit shqiptar kundrejt fqinjëve.

Faktori gjuhë ishte shenja më e fortë që i shquante shqiptarët nga rajoni i mbizotëruar nga sllavishtja e greqishtja. Kryengritjet antiosmane në gjysmën e parë të vitit 1912 arritën më në fund t'i shkëpusnin Portës së Lartë zotimin për njohjen e një njësie autonome shqiptare (që përfshinte vilajetet me shumicë shqiptare të Kosovës, Shkodrës, Manastirit dhe Janinës).

Të trembura nga ky realitet që pamundësonte synimet imperialiste rajonale të shteteve fqinje, Serbia, Mali i Zi, Bullgaria dhe Greqia, nën maskën e luftës kundër Perandorisë Osmane, e zhytën rajonin në luftëra e kaos të plotë. Ky agresion shumëfrontësh që fshihej pas parullës “Të shpëtojmë të krishterët”, synonte të asgjësonte idenë e ekzistencës së një Shqipërie të pavarur.

Kjo gjendje e re e pushtimit u sanksionua nga Konferenca e Londrës, pasi që shteti i ri shqiptar u privua nga më shumë se gjysma e territoreve të banuara me shumicë shqiptare. Ky “shtrat i Prokustit” vijon me pasojat e tij edhe sot e gjithë ditën: kombi shqiptar në Ballkan jeton i hapërdarë në gjashtë shtete si Republika e Shqipërisë, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Greqia dhe Serbia.

Çdo elaborim i historisë moderne e ka të pashmangshëm përfundimin se popullsia shqiptare në Kosovë ka qenë gjithmonë qendra kryesore e kundërshtimit anti-osman. Pavarësisht kësaj, serbët sajuan *ex nihilo* pretendime historike për Kosovën duke e mohuar të tashmen dhe të kaluarën e elementit shqiptar. Duke interpoluar interpretime dëshirore, historiografia zyrtare serbe dhe publicistika divulgative i mëshonin asaj se këto territore shqiptare qenë pjesë e shtetit serb në shekullin e katërmëdhjetë, duke e pasur aty edhe selinë e Patriarkanës serbe.

3.3. Lufta e Dytë Botërore

Në vigjilje të shpërthimit të Luftës së Dytë Botërore, Shqipëria u pushtua nga Italia fashiste më 7 prill 1939; një fat i tillë pati edhe Jugosllavia, e cila u pushtua nga Gjermania naziste më 8 prill 1941⁵⁶.

56 Griffith: 1963 dhe Pano 1968.

Dy udhëheqësit kryesorë të pasluftës në Jugosllavi dhe Shqipëri, përkatësisht Josip Broz Tito dhe Enver Hoxha ranë në ujdj që të zbatohej Marrëveshja e Atlantikut e gushtit të vitit 1941, ashtu që pas çlirimit të përcaktonin vetë të ardhmen përmes referendumeve popullore.

Tito asokohe kishte thënë se çdo popull në Jugosllavi duhej të kishte të drejtën e vetëvendosjes “deri në shkëputje”. Këshilli Nacionalçlirimtar i Kosovës mbajti një konferencë në Bujan të Tropojës (Malësia e Gjakovës) më 31 dhjetor 1943 deri më 2 janar 1944⁵⁷, i cili e përcaktoi këtë kërkesë. Ky vendim u mor në përputhje me premtimin e bërë në Mbledhjen e Dytë të AVNOJ-it në Jajcë ku ishte pranuar e drejta e vetëvendosjes nacionale deri në shkëputje nga Jugosllavia.⁵⁸ Mirëpo, një vit më pas malazezi Milovan Gjlasi i detyroi ata të rishikonin vendimin e takimit në Bujan sa i përket statusit të ardhshëm të Kosovës, me arsyetimin se projekt-kushtetuta e Jugosllavisë nuk e parashikoi këtë të drejtë të tyre.

Në këtë mënyrë, shqiptarëve të Kosovës nuk iu dha asnjëherë e drejta për të organizuar referendumin e tyre për vetëvendosje, për bashkimin me shtetin e tyre amë, Shqipërinë, sikundër qe vendosur në Konferencën e Bujanit dhe siç ishte zëruar në dekadat në vijim në rezistencën manifeste edhe me demonstrata, protesta e forma të tjera.

3.4. Shpërthimi në Kosovë

Në Ballkan gjendja e luftërave, konflikteve dhe përplasjeve lokale kanë qenë tejet e shpeshtë për qindra vjet. Prej shekullit të nëntëmbëdhjetë e këndej, shtetet e sapokrijuara ballkanike (Serbia, Mali i Zi, Bullgaria dhe Greqia) shpalosën platformat e tyre kombëtare për zgjerim pa përfillur realitetet e larmishme etnike, gjuhësore e kulturore në tokat që i mëtonin si “historikisht” të tyre. Këto zhvillime kaotike e plot gjak e forcuan stereotipin që thuajse nuk u braktis asnjëherë, sipas të cilit “Ballkani është fuçi baroti”. Në të vërtetë, megjithë prejardhjen ende të pasqaruar mirë, emri i rajonit ka të ngjarë të jetë fjalë perse ose e burimit turkik që nënkupton “male të thepisura e me pyje”. Ky emërtim duhet të jetë përhapur gjatë periudhës osmane.

Ajo që për më shumë se gjysmë shekulli u shqua në hartën e Evropës juglindore me emrin Jugosllavi, u krijua më 1918 fillimisht si Mbretëria e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve. Nga 3 tetori i vitit 1929, ky shtet

57 Malcolm 2001: 320.

58 “Shqipëria në dokumentat arkivore ruse”, Tiranë, 2006, f. 105.

u emërtua si Mbretëria e Jugosllavisë; më 1943 partizanët komunistë e shpallën Jugosllavia Federative Demokratike, për t'u riemëruar më 1945 si Republika Popullore Federative e Jugosllavisë, e pastaj, më 1963 si Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë (RSFJ).

Realiteti etnik ishte i tillë që Jugosllavia përbëhej nga një mori kombesh të ndryshme (serbët, kroatët, shqiptarët, boshnjakët, sllovenët, sllavo-maqedonasit, malazezët si dhe disa kombësi të tjera). Gjatë periudhës socialiste, kundërhëniet mes këtyre kombeve nuk u shfaqën haptas, në kuptimin që u shmangen përplasjet e armatosura. Gjatë sundimit diktatorial të Titos, shqiptarët ishin të nëpërkëmbur në një federatë që mbizotërohej nga popuj që flisnin variante e dialekte të sllavishtes.

Në vitin 1968, shqiptarët në RSFJ kërkuar të drejta për arsim në gjuhën amtare si dhe përdorimin e flamurit kombëtar. Parulla më e njohur gjatë demonstratave masive në Prishtinë dhe qytete të tjera në Kosovë e Maqedoni ishte: *"Ne duam Universitetin!"*.⁵⁹ Si pasojë e kundërpërgjigjes represive të autoriteteve federative, qindra shqiptarë përfunduan të arrestuar e të burgosur e shumë të tjerë u vranë.

Por kërkesat e vazhdueshme dhe presioni i përgjithshëm nga ana e popullatës shqiptare, detyruan RSFJ-në që më në fund Kosovës t'i njihte statusin e një autonomie të gjerë, duke u sanksionuar edhe në Kushtetutën e saj. Kjo rrethanë mundësoi hapjen e shkollave në gjuhën shqipe në të gjitha nivelet si dhe përdorimin e simboleve kombëtare shqiptare.

Por mesi i viteve '70 solli shenjat e para të krizës së brendshme politike dhe ekonomike në RSFJ. Në një situatë të atillë, popullsia shqiptare e Kosovës nisi të kërkonte statusin e republikës për Kosovën, njësoj me kombet e tjera që përbënin federatën.

Më 1981, pakënaqësia shpërtheu në mënyrë masive në të gjitha ish-republikat jugosllave ku banonin shqiptarë,⁶⁰ duke kërkuar më shumë të drejta kombëtare. Në rrugë studentët bërtisnin "Kosova Republikë!", gjendje e cila u pasua me arrestime të gjëra. Kjo ndikoi që protestat të bëheshin edhe më masive, duke shpërthyer në demonstrata të fuqishme më 26 mars 1981, e cila më pas fitoi përkrahjen nga popullsia shqiptare më 2 prill 1981, në të gjitha republikat e tjera të RSFJ-së ku kishte shqiptarë (Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi).

Parullat e demonstratave ishin: "Kosova Republikë, o me hir o me pahir", "Ne jemi shqiptarë, jo jugosllavë!" dhe "Duam një Shqipëri të

59 Malcolm 2001: 338.

60 Malcolm 2001: 338.

bashkuar!” Sipas studiuesve të huaj, autoritetet angazhuan njësi të policisë speciale, tanket u shfaqën në rrugë dhe u shpall gjendja e jashtëzakonshme.⁶¹ Në këto demonstrata shumë njerëz u arrestuan dhe numri i të vrarëve nuk dihet nga askush. *“Disa këmbëngulin se vrasjet arritën deri në 1 mijë shqiptarë të vrarë, që sigurisht është një ekzagjerim, por shifra e vërtetë mund të ketë arritur në disa qindra”,* thotë një studiues bashkëkohor.⁶²

Pas këtyre demonstratave, Serbia filloi mësymjen gjithnjë e më të ashpër duke filluar fazën e parë të represionit ndaj shqiptarëve: “Sipas një raporti, në tetë vitet që pasuan protestat, 584.373 shqiptarë, ose thënë ndryshe, gjysma e popullsisë së rritur, u arrestuan, u morën në pyetje, u internuan ose u maltretuan. Shtatë mijë prej tyre u burgosën, qindra të tjerë u pushuan nga universiteti dhe nga puna”.⁶³

Këto dhe zhvillime të tjera në gjithë Jugosllavinë patën si pasojë përfundimtare shpartallimin e RSFJ-së dhe lindjen e disa shteteve të pavarura si Sllovenia, Kroacia, Bosnjë-Hercegovina, Maqedonia, Serbia dhe Mali i Zi.

3.5. Kontradiktat etnike

Në RSFJ gëlonin dallime të mëdha etnike. Gjashtë republikat (Sllovenia, Kroacia, Bosnjë-Hercegovina, Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia), ashtu sikundër edhe dy krahinat autonome në kuadër të Serbisë (Kosova dhe Vojvodina), përfaqësonin secila interesat e veta lokale e etnike. Megjithëkëtë, autoritetet qendrore në Beograd, tashmë në duart e serbëve, filluan bombardimin me avionet të Sllovenisë më 1991, por kjo nuk e ndaloi dot shkëputjen e saj nga RSFJ. Lufta tjetër shpërtheu në Kroaci; ndërsa e treta shpërtheu në Bosnjë dhe Hercegovinë, aty ku Serbia kreu një ndërmarrje gjenocidale e shfarosëse.

Dhe në aktin e fundit të shpërbërjes, përkatësisht në vitin 1997, lufta shpërtheu edhe në Kosovë me qëllimin për mëvetësi dhe shkëputje nga Serbia. Kosova ka dy milionë banorë, nga të cilët 90 për qind janë shqiptarë⁶⁴ dhe vetëm gjashtë për qind janë serbë, ⁴⁴ kurse kusuri tjetër (rreth 4 për qind) janë turq, malazezë, romë, ashkalinj, egjiptas, malazezë dhe kroatë.

61 Judah 2002: 40.

62 Po aty.

63 Judah 2002: 41.

64 Gazeta e përditshme norvegjeze “Dagsavisen”, 03.02.07, f. 18, NTB.

Kërkesës shqiptare për pavarësi, që fillimisht kishte nisur në formë rezistence paqësore, Qeveria serbe iu kundërvu me luftë të armatosur asisoj që të vinte në jetë planin e saj për spastrimin etnik të shqiptarëve në Kosovë, ashtu siç kishte vepruar edhe në Kroaci dhe Bosnjë. Forcat ushtarake dhe policore serbe vranë rreth 12 mijë shqiptarë, përderisa dëbuan afër 1 milion banorë. Shpërthimi i shqiptarëve në rezistencë të armatosur u bë kur Serbia e zhveshi Kosovën nga të gjitha të drejtat, duke filluar nga abrogimi i autonomisë së vitit 1974. Reprezaljet, terrori dhe represioni sistematik nisën në mars të vitit 1989, me ç'rast në Kosovë u vendos praktikisht pushteti ushtarak i Beogradit që të sigurohej kësaj kontrolli absolut i vendit. Këto masa të Serbisë kulmuan me masakra të rënda ndaj popullatës shqiptare e më pas edhe në luftë të armatosur.⁶⁵

3.6. Shfaqja e nacionalizmit serb (1987-1989)

Slobodan Millosheviqi hyri në skenën e pushtetit në Serbi në vitin 1985. Konvertimi i tij prej një komunisti në nacional-shovinist zanafillon në një fjalim që e mbajti në Kosovë. Kështu, ai e instrumentalizoi krejtësisht pakicën serbe duke e përdorur diskursin e viktimizimit.

Në shërbim të këtij projekti, Millosheviqi dhe aparati i tij i mëshonin pretendimit fals se gjoja pakica serbe jetonte në kushte të vështira dhe e shtypur nga shumica shqiptare. Sigurisht që ky ishte vetëm një pretekst, sepse e vërteta është se serbët, tashmë kur RSFJ-ja ekzistonte vetëm në letër, ushtronin kontroll pothuajse absolut në të gjitha instancat qendrore federative, e veçmas në strukturat e sigurisë dhe në ushtri.

Duke përsëritur këtë propagandë vijimisht e me të gjitha mjetet në dispozicion, Millosheviqi u orvat të krijonte bindjen tek publiku serb se ishte i preokupuar pas çështjes kombëtare serbe. Krejt këtë impenjim e maskonte pas shprehjeve post-emocionale që apelonin te audiencat e elektrizuara nga psikoza e nacionalizmit serb.

Ai afishohej në ekran e kudo tjetër si dikush për të cilin Kosova ishte *"qendër e historisë dhe kulturës serbe"*; se në Kosovë u ndodhkan *"kishat dhe manastiret ortodokse serbe"*; se Kosova ishte *"toka e shenjtë kombëtare"*; në Kosovë ishte *"djepi i identitetit serb"* e të tjera të kësaj natyre.

65 "The Serb assault immediately forced hundreds of thousands of Kosovars to flee across the borders to Albania, FYR Macedonia and Montenegro. Ultimately over 800,000 Kosovars sought refuge in neighbouring territories, creating the largest forced deportation in Europe since World War II and straining humanitarian relief organizations ability to respond". (http://web.mit.edu/cascon/cases/case_kos.html).

Të parin fjalim të shkurtër Millosheviqi e mbajti në Fushë-Kosovë më 24 prill 1987. Në fakt, ky miting ishte hapi i parë i politikës shoviniste të Serbisë pas fillimit të shpërbërjes së RSFJ-së.

Ishte kjo hera e parë, prej mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, që mbahej një fjalim me përmbajtje të fortë e eksplicite nacionaliste para pakicës serbe në Kosovë. *“Ndërsa ai hyri në ndërtesë, në Fushë-Kosovë në periferi të Prishtinës, mijëra serbë të ngazëllyer nisën të përplaseshin me policinë kryesisht shqiptare dhe filluan të hidhnin gurë kundër tyre ... Protestuesit bërtisnin: ‘Vrasës’, ‘Ne jemi të Titos. Tito është i yni’”*⁶⁶.

Në këto çaste, Millosheviqi iu drejtua turmave serbe të grumbulluara aty me shprehjen që më pas u bë kredoja e pakicës serbe në Kosovë, e cila u instrumentalizua e tëra nga Beogradi: *“Askush nuk do të guxojë t’ju rrahë!”*

Me këtë shprehje, Millosheviqi e siguroi pakicën serbe të Kosovës se nga ai moment e tutje do të ishin të sigurt në Kosovë dhe, madje, do të ishin ata që do të bënin ligjin, dhe jo shqiptarët. Këto fjalë patën jehonë fatalisht të madhe, ose siç do ta thoshte më vonë një nga udhëheqësit serbë të Kosovës, Miroslav Soljeviq: *“Kjo fjali e kurorëzoi atë si një Car”*.

3.7. “Askush nuk do t’ju rrahë kurrë!”

Deklarata infamoze “Askush nuk do t’ju rrahë kurrë!”, u përsërit aq shumë në televizionin shtetëror si dhe u botua në gazetatat serbe dhe ato shqiptare në Kosovë. Nënteksti i mesazhit të tij ishte se “largimi” i serbëve nga Kosova duhej të ndalohej, dhe se serbët duhej të kontrollonin të gjitha pushtetet në Kosovë.

Brenda pak kohe, Millosheviqi filloi t’i përdorte serbët e Kosovës si figura teatri, duke i angazhuar herë si paramilitarë e herë si njerëz që barteshin në mënyrë të organizuar me autobusë për tubimet që mbaheshin anekënd Serbisë – të ashtuquajturat *“Takimet e të vërtetave”* që soldifikuan edhe më shumë pozicionin e tij prej lideri. Sipas autorit Robert Thomas, qindra takime të tilla u zhvilluan në Serbi në harkun kohor prej korrikut të vitit 1988 deri në pranverën e vitit pasues. Në këto takime u vlerësua se pati “rreth 5 milionë njerëz të tubuar”.⁶⁷

Një vit më vonë, më 28 mars 1989, Kuvendi i Kosovës u detyrua forcërisht të pranonte ndryshimet kushtetuese sipas diktatit të

66 Juda 2002: 52 – 53.

67 Judah 2002: 54.

Milloseviqit. Kështu, ky institucion legjislativ e gjeti veten të rrethuar nga tanket dhe mijëra forca policore serbe. Ky moment kulmoi me vendosjen e gjendjes së jashtëzakonshme në Kosovë që u shoqërua me një varg masash aparteidi që diskriminonin popullatën shqiptare.

Në këto kushte, më 28 mars 1989, Kosova u bë pjesë e Serbisë. Fill pas kësaj shqiptarët u ndaluan të mbanin pozicione drejtuese në sektorin publik; këto masa represioni vazhduan me largimin masiv të shqiptarëve nga vendet e tyre të punës. Fat të njëjtë pësuan edhe nxënësit e studentët shqiptarë – mbyllja e Universitetit të Prishtinës dhe helmimet e nxënësve të shkollave shënuan apeksin e këtij segregacioni të pashembullt në Evropën e pas Luftës së Dytë Botërore. Në këtë mënyrë, Serbia fitoi kontrollin e plotë mbi Kosovën.

Retorika me ngjyrimet nacionaliste e fetare u bë kryetëmë e ditës nëpër mediat serbe. Gjatë gjithë kësaj kohe zuri vend përdorimi i dendur i fjalës serbe “voz”⁶⁸ (udhëheqës) që asocionte presidentin Milloseviq. Ai u pa nga shumica serbe si “Zot”.

Në vitin 1990, kur regjimi i Milloseviqit po forcohej gjithnjë e më shumë, u shpalos një filozofi dhe strategji e re e nacionalizmit serb: “Të gjithë serbët duhet të jetojnë në një shtet” dhe “Serbia është kudo ku ka serbë dhe varre serbe”, sikundër pëlqente ta përsëriste Milloseviqi kudo nëpër mitingje e paraqitje publike. Në këto raporte të përmbysura midis një pushteti totalitar dhe një publiku të manipuluar kolektivisht, ai fliste vazhdimisht për Jugosllavinë, duke e portretizuar veten si dikush që e mbante të bashkuar këtë shtet. Sapo u bind se synimet e tij për sundimin dorëhekurt të të gjithë Jugosllavisë ishin jorealiste, ai sakaq ndryshoi taktikat për të përvijuar një strategji tjetër.

3.8. Gjurmëve të Çubrilloviqit

Është pikërisht ky episod që kërkon të qëmtohet më imtësisht nëpërmjet filozofisë së akademikut dhe historianit serb në Universitetin e Beogradit, Vaso Çubrilloviq (1897-1990). Ai prej kohësh kishte krijuar staturën e tij si akademik; qysh në vitin 1937 ai paraqiti një memorandum për “Dëbimin e shqiptarëve” (*Iseljavanje Arnauta*).⁶⁹

Në këtë tekst, Çubrilloviq, asokohe 40-vjeç, theksonte se “problemi shqiptar” është serioz, pasi që, sipas tij, shqiptarët janë vendosur “në

68 Mønnesland 1999: 245.

69 http://www.Kosovo-aktuell.de/cms/index.php?option=com_content&task=view&id=49&Itemid=43.

zonat historike serbe". Me qëllim të nxitjes së shpërnguljes masive, ai sugjeronte se ishte e domosdoshme që të krijohesh një psikozë e përshtatshme.

Sipas Çubrilloviqit, i cili e theksonte në mënyrë eksplicite, kjo psikozë do të bëhej me anë të presionit nga aparati shtetëror. *"Për t'ua bërë jetën zi të gjithë shqiptarëve, duhet të shfrytëzohen sa më shumë ligjet: gjobitje, arrestime, zbatim i pamëshirshëm i të gjitha rregulloreve të policisë, ndëshkim i kontrabandistëve, prerja e pyjeve, pengimi i kullotave, lëshimi i qenve, dërgimi i njerëzve në punë të detyruar, dhe çdo lloj metodë tjetër që një polic është në gjendje të sajtojë".*⁷⁰ Sipas autorit serb, zgjidhja e problemit shqiptar në Serbi ishte largimi i shqiptarëve me deportim (internime) ose terrorizëm, të gjitha këto me qëllim për t'i detyruar ata të kalojnë në arrati.⁷¹

Por këtë skenar nuk e përfundonte me kaq, andaj Çubrilloviqi shestonte edhe të tjera masa: *"Kolonëve tanë duhet t'iu jepen armë (...), të vihen zjarre fshehurazi dhe të digjen fshatrat dhe rrethet shqiptare".*⁷² *"Kur Gjermania mund të dëbojë dhjetëra mijëra hebrenj dhe Rusia lëviz miliona nga një pjesë e kontinentit në një tjetër, nuk do të ketë luftë botërore thjesht për shkak të disa qindra mijëra shqiptarëve të dëbuar".*⁷³ Akademiku tjetër serb, Dobrica Qosiq në veprën e tij "Deobe" (Ndarjet), të botuar e ribotuar disa herë qysh prej vitit 1961, në një vend shkruante edhe këto: *"Ne gënjejmë që të mashtrojmë veten për të ngushëlluar të tjerët; gënjejmë nga dhembshuria, gënjejmë nga turpi për të inkurajuar, për të fshehur mjerimin tonë, gënjejmë për ndershmërinë. Ne gënjejmë për liri. Gënjeshtra është një formë e patriotizmit serb dhe konfirmim i inteligjencës sonë të lindur. Ne gënjejmë në mënyrë kreative, imagjorative e duke trilluar. [...] Në këtë vend çdo gënjeshtër në fund bëhet e vërtetë".*⁷⁴

Është me rëndësi të vihet në dukje se i gjithë memorandumi i Çubrilloviqit u botua për herë të parë në vitin 1989.⁷⁵ Kjo është bukur domethënëse për realitetin e ri të krijuar pas ardhjes në pushtet të Millosheviqit: tani materiale të tilla shoviniste, siç ishte memorandum

70 Cubrilovic 1937.

71 Mønnesland 1999: 366.

72 Cubrilovic 1937.

73 Po aty.

74 Sipas tekstit original nga libri DEOBE: *"Mi lažemo da bi smo obmanuli sebe, da utešimo drugoga; lažemo iz samilosti, lažemo iz stida, da ohrabrimo, da sakrijemo svoju bedu, lažemo zbog poštenja. Lažemo zbog slobode. Laž je vid srpskog patriotizma i potvrda naše urođene inteligencije. Lažemo stvaralački, maštovito, inventivno." [...]* *"U ovoj zemlji svaka laž na kraju postaje istina".*

75 Malcolm 2001: 134.

i Çubrilloviqit, mund të botoheshin pa pasur frikën e çfarëdo konsekuence.

Mizoritë e kryera nga shteti serb në Kosovë përgjatë një dekade u dëshmuar nga gjenerali i NATO-s, Klaus Nauman. Duke evokuar një takim që kishte pasur me Millosheviqin në tetor të vitit 1998, ai në fjalën e vet para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë me 14 dhjetor 2006 theksoi: *“Millosheviqi tha se ai do të përpiqej të gjente një zgjidhje për problemin e Kosovës në pranverën e vitit 1999, dhe se parakusht për një zgjidhje ishte arritja e ekuilibrit brenda ose midis grupeve etnike. Nuk kishte një shpjegim se çfarë nënkuptonte ekuilibri në këtë rast. Nikolla Shainoviq u shpreh se problemi lidhej me përqindjen e lartë të lindjeve në mesin e shqiptarëve të Kosovës dhe se ata duhej të gjenin një zgjidhje për këtë, e cila nuk do të çonte përsëri në të njëjtin problem vitet e ardhshme”*.⁷⁶

Kur Naumanni dhe Clarku i kërkuan Millosheviqit sqarim për këtë, ai theksoi se “ata do të bënin të njëjtën gjë siç e kishin bërë më 1945 dhe 1946, ashtu që t'i bënin bashkë e t'i vrisnin. Millosheviqi mendonte se problemi do të zgjidhej brenda pranverës”.⁷⁷ Ai i quajti shqiptarët “vrasës”, “përdhunues” dhe “vagabondë”, ishte dëshmia e gjeneralit gjerman.⁷⁸

3.9. Media ose “një mbajtëse mikrofoni”

Mediat luajnë rol të rëndësishëm për formimin e kombit. Ato janë ndërmjetësuese të rëndësishme të identitetit, politikës dhe kulturës dhe, gjithsesi, prodhim i mendësive të kombeve.

Gjatë sundimit të Millosheviqit, në ish-Jugosllavi pothuajse nuk pati media të lira dhe të pavarura. Është e rëndësishme të theksohet se përmes burimeve financiare, profesionalizmit dhe organizimit pronarët e mediave kanë shumë pushtet në shoqëri. Ishte paria kryesore politike (pushteti) ajo që vendoste se çfarë duhej shkruar dhe çfarë jo. Mediat patën shumë pushtet në Ballkan dhe për këtë arsye gazetarët nuk guxonin të shkruanin diçka që mund t’iu kushtonte atyre me largim nga puna.

76 Nauman në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë, 14 Dhjetor 2006.

77 <http://www.un.org/icty/latest-e/index.htm> (Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë).

78 Koha Ditore, 15 dhjetor 2006.




Foto nga fjalimi në Gazimestan: Efektet e fotos nga RTV Serbia⁷⁹

Përmbajtja dhe pavarësia e mediave është edhe sot e ndikuar nga politika, nacionalizmi, ideologjia, joprofesionalizmi dhe vetëcensura. Ata që kanë më së shumti pushtet, kanë poaq mundësi që më së shumti t'i shprehin pikëpamjet e veta. Burimi i lajmit ishte thujasë i paprekur, nuk kishte shkrime kritike ndaj burimit të mediave. Një varësi e tillë tregon se media në Serbi asokohe ishte vetëm një “mbajtëse mikrofoni” për partinë në pushtet.

Fjalimet e Millosheviqit u transmetuan në të gjitha mediat jugosllave, veçanërisht fjalimi i tij në Gazimestan. Kudo nëpër afishe shkruhej se “serbët janë populli më i vjetër në Ballkan” apo “e gjithë bota është kundër serbëve”. Pasi që pushteti i Millosheviqit mori kontrollin e plotë të medias në Serbi, dhe në veçanti të televizionit shtetëror, dialogu midis pjesëve të mëdha të popullatës jugosllave u ndërpre. Shteti serb, gjithashtu, u kujdes që mediat në Kosovë t'i kishte nën

⁷⁹ Foto nga regjistrimi i fjalimit të Millosheviqit në Gazimestan, RTV Serbia.

kontrollin e vet. Ato u instrumentalizuan kryekreje nga regjimi dhe, rrjedhimisht, u bënë aparate propagandistike që përligjin shkeljet e regjimit.

Në 600-vjetorin e Betejës së Kosovës, të komemoruar më 28 qershor 1989 në hapësirën pranë memorialit në Gazimestan, fjalimi i Millosheviqit u shfaq e u rishfaq në televizion disa ditë radhazi, ashtu sikundër edhe u botua në formë të shkruar në të gjitha gazetatat.

Radiotelevizioni Serb (RTS) transmetonte vijimisht pjesëmarrësit serbë në Gazimestan, të cilët mbanin afishe, fotografi, flamuj dhe ikona të Car Lllazarit e të Millosheviqit. Ky fjalim përbën një ngjarje kyçe në mitologjinë serbe – prej tij u ushqye retorika nacionaliste serbe për vitet që do të pasonin.

4.0. FJALIMET

Lufta nuk mund të kundrohet si e izoluar, sepse ajo është pjesë e një procesi të gjatë e të ndërlikuar historik dhe gjeopolitik. Sidoqoftë, për ta kuptuar këtë luftë dhe sfondin e saj kompleks, është e nevojshme që të merren parasysh edhe veprimtaritë e politikanëve, fjalimet si dhe pikëpamjet e tyre politike.

Siç u bë e ditur edhe më herët, analiza ka si strumbullar tri fjalime kryesore. Për mendimin tonë, këto fjalime kanë pasur ndikim thelbësor për zhvillimin e konfliktit dhe se, përveç kësaj, ato ishin bërë objekt diskutimi edhe në rrethin e intelektualëve të pavarur shqiptarë. Fjalimi i mbajtur në Gazimestan – me simbolikën jo rastësisht të zgjedhur pikërisht në 600-vjetorin e Betejës së Kosovës – ishte prova e parë dhe më e rëndësishmja politike e karrierës së Millosheviqit.

Të bashkëngjitur me të gjatë rrjedhës së analizës janë ndërfutur edhe dy fjalime të tjera, të cilat gjithashtu përbëjnë momente interesante dhe japin një pamje të qartë të botëkuptimit të Millosheviqit. Pra, në një aspekt diakronik fjalimet e apostrofuara kanë këtë kronologji:

- **Fjalimi në Gazimestan (1989);**
- **Fjalimi në Beograd (1999);**
- **Fjalimi në Beograd (2000)**

Secila prej këtyre adresimeve është e veçantë për kohën dhe vendin kur u mbajtën. Përtej teksturës së tyre, këto tri fjalime mundësojnë të përkapen edhe kushtet politike dhe sociale të atyre viteve.

Në kohën kur u mbajt fjalimi i parë i Millosheviqit, Jugosllavia ishte ende shtet i bashkuar federativ. Ky entitet ende nuk kishte hyrë në ciklin e luftërave, sado që komunizmi si ideologji politike kishte hyrë në tatëpjetën e mahisjes dhe shpërbërjes.

Përzgjedhja e fjalimit të dytë është bërë me konsideratën se ai në vetvete përshkruan një gjendje krejtësisht të re politike dhe sociale. Në të vërtetë, Jugosllavia si shtet nuk ekzistonte; letra ishte ekzistenca e vetme formale e këtij shteti. Nga gërmadhat e tij lindën gjashtë shtete të reja kombëtare e të pavarura. Pas ndërmarrjes sistematike gjenocidale dhe spastrimit etnik që shteti serb kreu ndaj shqiptarëve të Kosovës, Aleanca Veriatlantike (NATO) u stacionua në Kosovë. Vendosja e saj përkoi me largimin e ushtrisë dhe policisë serbe gjer në ushtarin e

fundit dhe kthimin e popullatës së shpërngulur shqiptare.

Operacioni “Patkoi”, i shënuar nga instancat më të larta ushtarake në Beograd, kishte rezultuar me gjenocidë spastrimetnik. Sipas vlerësimeve më të paanshme përëndimore, numri i të refugjatëve jashtë Kosovës apo atyre që u zhvendosën brenda saj kalonte mbi 1 milion banorë.

Kurse fjalimi i tretë pasqyron një situatë të paqëndrueshme politike, ku partia e Millosheviqit (*Socijalistička partija Srbije* – SPS) u bë gjithnjë e më e dobët. Në anën tjetër, kjo periudhë pa fuqizimin e opozitës në Serbi dhe rritjen e ndikimit të saj tek serbët. Përtej kësaj, Serbia në këtë kohë ishte ende e izoluar ndërkombëtarisht dhe me reputacion negativ kudo në botë si luftënxitësja kryesore në ngjarjet e dekadës së fundit të shekullit të njëzet.

Përveç mbledhjes së shumicës së fjalimeve oratorike të diktatorit serb, për nevoja të studimit janë siguruar edhe video-regjistrimet origjinale të fjalimeve të tij në Fushë-Kosovë (1987) dhe në Gazimestan (1989). Emërues i përbashkët i të tri fjalimeve është se mbajtja e tyre përkon me ngjarje të rëndësishme e të tendosura politike, ushtarake dhe historike.

Gjatë karrierës së vet politike, Millosheviqi mbajti shumë fjalime publike. Tre fjalimet e zgjedhura si “kampion” studimi kanë elemente të veçanta dalluese (si fjala vjen oratoria, gjuha karakteristike, përmbajtja dhe situata retorike), që i bëjnë të rëndësishme e të pakapërcyeshme si nga pikëpamja historike, gjeopolitike dhe retorike. Çdo fjalim mbulon një periudhë të caktuar ose shënon pikat kulmore politike.

Ja disa pyetje të veçanta që ndihmojnë analizimin e teksteve të Millosheviqit:

Situata retorike

- Cilin problem të ngutshëm provon ta zgjidhë fjalimmbajtësi?
- Kush është publiku? (Me fjalë të tjera kush e ka fuqinë të zgjidhë problemin?)
- Cilat janë rrethanat më të rëndësishme imponuese që i tregojnë fjalimmbajtësit çfarë duhet të thotë e çfarë të bëjë?

Përshtatshmëria e tekstit

- Si është përshtatshmëria e brendshme e tekstit? (Ose thënë ndryshe: A ka përputhje në mes të përmbajtjes së tekstit, kompozicionit dhe stilit?)

- Si është përshtatshmëria e jashtme e tekstit? (Ose: A është teksti në përputhshmëri me fjalimmbajtësin, publikun, çështjen dhe rrethanat?)

Vlerësimi i tekstit

- Në ç'shikullë ka arritur teksti (fjalimi) të jetë bindës tek publiku në kuadër të situatës retorike?
- A është fjalimmbajtësi sajues i situatës retorike?

Analiza e grupimit të fjalëve

- Në ç'mënyrë ka ndikuar përdorimi i gjuhës në fjalim të sajimi i publikut?
- Cilin publik e sajoi gjuha e fjalimmbajtësit?

5.0. FJALIMI NË GAZIMESTAN DHE PRAPAVIJA E TIJ (1989)

Në kohën kur u mbajt ky fjalim, Millosheviqi kishte krijuar staturën e politikanit më të fuqishëm dhe më me ndikim në Serbi. Vetëm dy vjet pas mbajtjes së këtij fjalimi në Gazimestan, Jugosllavia nuk ekzistonte më si shtet. Ishte pikërisht koha kur republikat përbërëse të Federatës filluan të kërkojnë pavarësi dhe njohje si shtete kombëtare.

Por, shpërbërja e Jugosllavisë nuk ishte paqësore. Kosova dhe Vojvodina, deri sa filloi kriza, patën statusin e krahinave autonome, që iu hoq më 1989 nga Millosheviqi. Këto vite shënojnë padyshim një pikëkthesë politike për karrierën politike të liderit serb. Në këtë fjalim, Kosova dhe Vojvodina u përmenden në mënyrë implicite si “problem i madh serb”.

Për më tepër, në terma të marrëdhënieve politike, ky fjalim ishte më i njohuri dhe më sfiduesi në të njëjtën kohë. Ky adresim përmbante retorikë nacionaliste (oratori përçmuese e armiqësore ndaj kombeve të tjera), mitike, fetare, historike si dhe ndikime psikologjike, të cilat mbronin pozicionin politik serb. Ishte pikërisht kjo retorikë që ndërtoi një imazh unik për serbët në Ballkan.

5.1. Situata retorike në Gazimestan

Teoria mbi *situatën retorike* u zhvillua për të përshkruar situatën në të cilën gjendet fjalimmbajtësi në momentin kur ai qëndron e flet para një grupi njerëzish. Këtu flitet për një situatë të veçantë që shfaqet në një *kohë të caktuar*, në një *vend të caktuar* dhe me një *publik të caktuar*. Asnjëherë më parë nuk ishin mobilizuar aq shumë njerëz sa më 28 qershor 1989. Në 600-vjetorin e Betejës së zhvilluar më 1389, në një *kohë të caktuar*, u mbledhën rreth 1 milion serbë për të dëgjuar fjalimin e Millosheviqit. Po të krahasohet numri tejet i vogël i serbëve që jetonin në Kosovë asokohe, atëherë numri i të mbledhurve në Gazimestan rezulton vërtet i frikshëm. Nëse i besojmë të dhënave zyrtare të nxjerra nga regjistrimet e popullsisë më 1981 dhe 1991, numri i serbëve rezidentë ishte 209,498 dhe 195,300 respektivisht.⁸⁰

80 Judah 2000: 313.

Ashtu që të përçoheshin mesazhe e të vihej në jetë projekti për zhveshjen e shqiptarëve nga çdo e drejtë, kjo fanfarë e regjimit krijoi një gjendje asisoj që më shumë serbë erdhën me autobusë nga e gjithë Serbia sesa ata që jetonin në Kosovë. Me një aritmetikë të thjeshtë del se drejt memorialit në Gazimestan udhëtuan rreth 800 mijë njerëz nga Serbia dhe republikat e tjera të Jugosllavisë.

Në shërbim të mobilizimit të një numri aq të madh njerëzish, edhe mediat e patën një hisë bukur të madhe: përmbajtjet e tyre diktoheshin gjithnjë nga imperativi i pushtetit për të përhapur versionin e dëshiruar. Mediat u urdhëruan të publikonin lajme, artikuj, filma dokumentarë dhe reportazhe për betejën e zhvilluar më 1389.

Edhe transportimi i njerëzve u organizua nga pushteti, për çka shpenzimet e udhëtimit, ushqimi dhe pijet ishin falas. Pjesëmarrësit u paguan edhe me mëditje. Për njohësit e rrethanave në Jugosllavi, bartja e organizuar e serbëve për mitingje politike u bë praktikë e shpeshtë nga Beogradi.⁸¹

Megjithëse përpjekje për të ndërtuar mite mbi 1389-n kishte pasur ndër dekada, kjo ishte hera e parë që i gjithë arsenalin e simboleve dhe miteve për historinë e betejës mesjetare po përdorej plotësisht. Siç u vu re qysh atëherë – dhe siç dokumentohet edhe nga materialet filmike dhe ato fotografike të mitingut – aty u panë simbole kombëtare serbe, veshje tradicionale sllave, fotografi me ikona mbretërisht e heronjsh mesjetarë si Llazar Hrebeljanoviçi apo edhe vrasësit të supozuar të sulltan Muratit që në propagandën serbe quhej Millosh Obiliq (megjithëse asnjë burim relevant i kohës nuk e quan me mbiemër sllav!), pastaj portrete të Millosheviqit, harta të Serbisë së Madhe, flamuj të vjetër serbë, kryqe ortodokse, ashtu sikundër edhe piktura e afishe të tjera me motive nga beteja e Kosovës. Të pranishëm ishin edhe udhëheqësit kryesorë të kishës serbe.

81 Shih edhe librin e Viktor Meier, *Yugoslavia: A History of its Demise*, Routledge, 2005.



Gazimestan 1989: Përzierja e religjionit dhe politikës⁸²

Nuk ka dyshim se fjalimi i mbajtur në Gazimestan është një më të rëndësishmit kur bëhet fjalë për fuqinë e ndikimit të vet në Evropën e pasluftës. Kështu, sapo Serbia miratoi ndryshimet kushtetuese në shtator të vitit 1989, heqja e autonomisë së Kosovës dhe Vojvodinës u bë *fait accompli* (fakt i kryer).

Në kuptimin politik, ky ndryshim regresiv bëri që Serbia përsëri të shndërrohej në një subjekt të unifikuar. Presidenti Millosheviq e përdori këtë fjalim për ta sajuar një situatë të re retorike duke përshtatur legendat dhe gjithë mitologjinë e 1389-s për nevojat dhe qëllimet e tij politike, përfshirë këtu edhe ekspozimin e fuqisë politike.

Një tjetër moment, jo më i paktë nga rëndësia, është edhe fakti se fjalimi u mbajt në një territor që banohej më shumë se 90 për qind nga shqiptarët. Pra, ky adresim u bë në një *vend të caktuar* ku vetëm 6 për qind e popullsisë ishte serbe. Qysh në atë kohë, fjalimi u vlerësua nga shumë politikanë jo-serbë si kërcënim i hapur për kombet e tjera që ishin ende nën kupolën e shtetit federativ. Një gjuhë si kjo në fjalimin e Millosheviqit nuk linte dyshim për qëllimet dhe mjetet e Beogradit: “Gjashtë shekuj më vonë, sot, sërish jemi në beteja dhe para betejave.

82 Fotografi e shkëputur nga videoja origjinale e RTV Serbia.

Ato nuk janë të armatosura, megjithëse as të tillat nuk përjashtohen". Ky adresim, ç'është e vërteta, ishte më i përfoluri që Millosheviqi kishte mbajtur gjer në atë kohë. Ka shumë pikëpyetje për ngjarjen në fjalë dhe konsekuencat e saj, por një pyetje që vazhdimisht ngre krye është pse u zgjodh pikërisht 28 qershori i 1989-s për mbajtjen e këtij fjalimi? Dhe, pyetja tjetër, pse u zgjodh bash Gazimestani si vend e si hapësirë publike?

Pavarësisht nga disfata e koalicionit të sundimtarëve rajonalë kundër agresionit osman më 1389, poezitë, letërsia dhe mitet serbe ndër shekuj – e veçmas pas krijimit të shtetit serb në gjysmën e dytë të shekullit të 19-të – e kanë portretizuar humbjen në fushë të Kosovës si fitore e shenjtë historike, kulturore, fetare dhe morale.

Me frymën e viktimizimit, humbja do të sekretonte lëndën viskoze të mitit që i paraqiste serbët si "popull i përndjekur dhe qiellor". Paçka se gjithçka trumbetohej për betejën historike ishte shpërfytyruar kryekreje, kjo nuk përbënte farë problemi për sa apelonte tek masat serbe të përshkuara nga psikoza nacionaliste.

Përkundër faktit që "kapitulli serb" i Kosovës nuk ishte gjë tjetër veçse disa episode sporadike që fillonin me zgjerimin e dinastisë nemanjide dhe kolonizimin e tokave të pushtuara, kjo hapësirë ndjesohej si "e shenjtë". Është pikërisht kjo që u referencua aq shpesh në këtë fjalim: *"Ky jubile i madh gjashtëqind vjeçar i Betejës së Kosovës ndodhi në vitin në të cilin Serbia, pas shumë vitesh, pas shumë dekadash, e riktheu integritetin e saj shtetëror, nacional dhe shpirtëror. Prandaj, sot, nuk e kemi të vështirë t'i përgjigjemi asaj pyetjes së moçme: Me çfarë do të dalim para Milloshit? Falë lojës së historisë dhe jetës duket sikur Serbia mu në këtë vit, më 1989, e riktheu shtetin e vet dhe dinjitetin e vet për ta kremtuar ashtu ngjarjen historike nga e kaluara e largët, e cila e kishte një rëndësi të madhe historike dhe simbolike për të ardhmen e saj."*

Të vizitosh vendet që kanë rëndësi të fuqishme historike, mitike dhe simbolike, është strategji dhe mënyrë e mirë për të krijuar ndjenja të fuqishme të identitetit. Kësisoj, duke e mbajtur fjalimin mu në Gazimestan, Millosheviqi ia doli mbanë që me retorikën e vet të prodhonte e sajonte një publik homogjen serb, ose, po të formulohet disi më ndryshe, përftoi një publik të ngarkuar me ndjenja nacional-shoviniste, nënvlerësim dhe urrejtje për kombet e tjera. Kjo situatë e bën të prekshme veçmas teorinë e Charlandit dhe McGeesë, të cilët theksojnë se funksionet konstituive të retorikës vijnë në shprehje sidomos në rrëfimet mitike dhe historike.

5.2. Përmbajtja e fjalimit

Në zemër të fjalimit të Millosheviqit në Gazimestan është rropatja për të evokuar tok mitologjinë, historinë dhe të kaluarën e supozuar para gjashtë shekujsh. Tekstura e tij përmbajtjesore e bën një mikс ngjarjesh, gjysmë të vërtetash e thjeshtëzimesh, duke i mëshuar simbolikës diakronike. Kështu, ai shpaloset si fjalim që nis me 1389-n e mbaron me 1989-n. Në të mund të shkoqiten katër pika kryesore:

- Së pari, kujtesa kolektive; ai u kujton serbëve, por edhe shqiptarëve se Kosova është “zemra e Serbisë”: *“Në këtë vend në zemër të Serbisë, në Fushën e Kosovës, para gjashtë shekujsh, para plot 600 vjetëve ka ndodhur një nga betejat më të mëdha të asaj kohe”*

- Së dyti, bashkimi i tokave serbe; Millosheviqi teksa flet për ndryshimin e kushtetutës serbe, thekson se pas shumë vitesh Serbia më në fund është bashkuar dhe ka rifituar integritetin kombëtar dhe shpirtëror. Sipas tij, *“Serbia sot është unike, e barabartë me republikat e tjera ..., Ky jubile i madh gjashtëqind vjeçar i Betejës së Kosovës ndodhi në vitin në të cilin Serbia, pas shumë vitesh, pas shumë dekadash, e riktheu integritetin e saj shtetëror, nacional dhe shpirtëror.”*

- Së treti, rikthimi në mitologji; fjalimi strumbullohet rreth betejës së fushës së Kosovës. Gjatë mbajtjes së fjalimit, ai i mëshon midis të tjerash “rikthimit të integritetit nacional dhe shpirtëror” dhe “krenarisë” së popullit serb: *“Falë lojës së historisë dhe jetës duket sikur Serbia mu në këtë vit, më 1989, e riktheu shtetin e vet dhe dinjitetin e vet për ta kremtuar ashtu ngjarjen historike nga e kaluara e largët, e cila e kishte një rëndësi të madhe historike dhe simbolike për të ardhmen e saj.”*

- Së katërti, Kosova rikthehet në qendër të mitologjisë; aty fjalimmbajtësi flet edhe për Kosovën dhe përçarjen midis udhëheqësve serbë në vitin 1389: *“Jam i bindur se kjo vetëdije për bashkim dhe unitet do t’ia mundësojë Serbisë jo vetëm të funksionojë si shtet, por të funksionojë si një shtet i suksesshëm. Për këtë arsye edhe jam i mendimit se kjo ka kuptim të thuhet pikërisht këtu në Kosovë, ku dasia një herë e një kohë e ka prapakthyer për shekuj dhe e ka rrezikuar tragjikisht Serbinë dhe ku uniteti i përtërirë mund ta përparojë dhe t’ia kthejë dinjitetin.”*

Përpos këtyre momenteve kryesore, fjalimi tangjenton edhe mbi Perandorinë Osmane si dhe luftën që serbët bënë për të “mbrojtur kulturën, religjionin, dhe shoqërinë evropiane”.

Shi për këtë, Millosheviqi shprehet: *“Para gjashtë shekujsh Serbia këtu, në Fushën e Kosovës, e ka mbrojtur veten. Por e ka mbrojtur edhe Evropën. Ajo asokohe gjendej në bedenat e saj që e mbronin kulturën evropiane, religjionin, shoqërinë evropiane në tërësi.”*

Milloseviqi flet edhe për “tradhtinë” dhe “jounitetin” serb si në të kaluarën, ashtu edhe në tashmen:

“Jouniteti dhe tradhtia në Kosovë do ta përcjellë edhe më tej popullin serb si një kob i zi nëpër gjithë historinë e tij. Madje edhe në luftën e fundit, kjo mungesë e unitetit dhe e tradhtisë e çoi popullin serb dhe Serbinë në agoni, pasojat e së cilës në kuptimin historik dhe moral e tejkaluan agresionin fashist

Madje edhe më vonë pasi u formua Jugosllavia socialiste, kreu serb në atë shtet të ri mbeti i ndarë, i prirë drejt kompromiseve në dëm të popullit të vet. Lëshimet që shumë udhëheqës serbë i bënë në dëm të popullit të vet, as historikisht, as etikisht, nuk do të mund t'i pranonte asnjë popull në botë. Aq më parë që serbët në tërë historinë e vet kurrë nuk i kanë pushtuar dhe eksploatuar të tjerët.

Në këtë rast, teoria e McGee shërben për të vlerësuar se si fjalimi retorik i Milloseviqit krijon dhe mban gjallë mite që forcojnë idenë e një “populli viktimë”.

Në vazhdim, fjalimi përmend “përçarjen” e udhëheqësve serbë dhe dëmet që vinin nga kjo:

“Është më se e sigurt, nëpër gjithë këta shekuj pas nesh, se në Kosovë para 600 vjetësh na ka ndodhur dasia. Nëse e kemi humbur betejën, atëherë ky nuk qe rezultat i superioritetit shoqëror dhe përparësisë në armatime të Perandorisë Osmane, por edhe i përçarjes tragjike në kreun e shtetit serb”.

Fjalimi retorik, pra, kërkon formësimin e “popullit viktimë”, e kjo përsëri e aktualizon teorinë e McGeesë, sipas të cilit prapa ndërtimit të identitetit grupor qëndron një zëdhënës (fjalimmbajtës), i cili retorikisht i shpërndërron individët në “popull”⁸³.

Tutje, fjalimi shtjellet duke i mëshuar frazave për serbët liridashës dhe për shpresën se bashkimi do t'i sjellë përparim popullit serb dhe qytetarëve të tjerë, pavarësisht përkatësisë së tyre kombëtare dhe fetare.

Kah mesi i fjalimit pason edhe një përshkrim i Serbisë së bashkuar e të barabartë kundrejt republikave të tjera: *“Serbia sot është unike, e barabartë me republikat e tjera dhe e gatshme të bëjë gjithçka që ta përmirësojë jetën materiale dhe shoqërore të të gjithë qytetarëve të vet.”* Dhe tutje duke vazhduar: *“Populli serb këtë vit është bërë i ndërgjegjshëm për domosdoshmërinë e pajtimit në radhët e veta, si kusht i domosdoshëm për jetën e tij të tanishme dhe zhvillimin e mëtejshëm.”*

83 McGee, *In Search of ‘the people’: A Rhetorical Alternative*, f. 240.

Fjalimi thekson se në Serbi është i pranishëm kërcënimi nga armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm nga aleancat shumëkombëshe:

“Si një shpatë mbi kokat e tyre, është i pranishëm kërcënimi i vazhdueshëm që një ditë të aktualizohet çështja e rrezikimit të një kombi nga të tjerët dhe kështu të vihet në lëvizje dallga e dyshimeve, akuzave dhe mosdurimit, e cila sipas rregullës rritet dhe është e vështirë të ndalet. Këtë e dinë armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm të bashkësive të tilla dhe për këtë arsye aktivitetin e vet kundër shoqërive shumë nacionale e organizojnë kryesisht në nxitjen e konflikteve nacionale.”

Në fjalim flitet edhe për një botë me tolerancë nacionale dhe bashkëpunim, por ai ngulmon me emfazë se Kosova do të thotë gjithçka për Serbinë dhe kritikon mungesën e unitetit, i cili ndikoi që serbët të humbnin dikur betejën: *“Për këtë arsye edhe jam i mendimit se kjo ka kuptim të thuhet pikërisht këtu në Kosovë, ku dasia një herë e një kohë e ka prapakthyer për shekuj dhe e ka rrezikuar tragjikisht Serbinë dhe ku uniteti i përtërirë mund ta përparojë dhe t’ia kthejë dinjitetin. Heroizmi i Kosovës prej gjashtë shekujsh e frymëzon krijimtarinë tonë, e ushqen krenarinë tonë, nuk na lejon që të harrojmë se dikur ishim një ushtri e madhe, trime dhe krenare, një nga të rrallat që edhe në disfatë mbeti e pamposhtur.”*

Pra, përmes efekteve mitologjike fjalimi sajton një publik retorik apo një “popull”, e kjo përputhet plotësisht me mendimin e McGee ku ai shkruante se “populli” është, përveç të tjerash, sajësë e miteve politike nga udhëheqësi.⁸⁴ Fjalimi i bën jeh edhe avazit sesi Serbia paskësh vuajtur shumë për gjashtë shekuj:

“Me krijimin e rrethanave shoqërore, ky jubile i madh gjashtëqind vjeçar i Betejës së Kosovës ndodhi në vitin në të cilin Serbia, pas shumë vitesh, pas shumë dekadash, e riktheu integritetin e saj shtetëror, nacional dhe shpirtëror... Para gjashtë shekujsh, Serbia e ka mbrojtur veten këtu”.

Për më tepër, “lufta” është fjala që përmendet shpesh në të përfunduar të fjalimit. Në një frymë kërcënuese, ai paralajmëron se *“luftërat nuk mund të përjashtohen”*. Kësisoj, kjo shprehje u bë sinjali i parë i qëllimeve të ardhshme të tij, por që e kamufloi me parullën: *“Le të rrojë përjetësisht kujtimi për heroizmin kosovar! Le të rrojë Serbia! Le të rrojë Jugosllavia!”*

5.3. Pranuesit e fjalimit dhe pasojat

Publiku, që mori pjesë në fjalimin e mbajtur në Gazimestan, u tregua emocional, i hareshëm dhe i lumtur. Të paktën kështu shfaqet në videoregjistrimin e bërë nga televizioni shtetëror serb. Publiku

84 McGee, *vep. cit.*, 240.

asokohe besonte plot optimizëm se Serbia po bëhet sërish e fortë, e pasur dhe e fuqishme. Tejet i rëndësishëm është edhe fakti që deri në momentin e dhënë historik, pra në vitin 1989, popujt e Jugosllavisë ende nuk kishin përjetuar luftëra, vdekje dhe shkatërrime. Ndaj kjo është arsyeja pse publiku ishte homogjen dhe numri i pjesëmarrësve qe mbi një milion.⁸⁵

Aq i madh ishte entuziazmi i përftuar në atmosferën e asaj fanfare saqë turma përnjëherësh filloi ta këndonte në kor këngën nacionaliste serbe: *“Kush thotë, kush gënjen se Serbia është e vogël”*. Njerëzit sollën me vete shumë afishe, ikona e simbole me elemente historike dhe fetare. Mediat gjithandej Jugosllavisë transmetuan drejtpërdrejt në televizion fjalimin e Millosheviqit. Edhe gazetatat kryesore shkruanin në bold e me terma superlativë për *“fjalimin e shkëlqyeshëm”*. Kurse gazeta e vetme ditore shqiptare *“Rilindja”* botoi disa pjesë të fjalimit. Megjithëkëtë, nën rrethanat e lirisë së kufizuar të fjalës dhe shprehjes si dhe gjendjes gjithnjë e më të nderë, askush nuk mori zemër sa të kritikonte ballëhapur atë fjalim që sfidoi hapur gjithë atë që ishte proklamuar për dekada të tëra në Jugosllavi. Në anën tjetër, *“RTV Beograd”* transmetoi fjalimin drejtpërdrejt nga Gazimestani. Gjatë gjithë kohës së fjalimit, redaktorët përgjegjës të televizionit përdorën imazhe të shumta me porosi fetare.

Më poshtë është zgjedhur një fotografi e këtij regjistrimi televiziv nga Gazimestani. Aty shihet një fushë e madhe ku shquan kolona me mijëra njerëz që po shkojnë për të dëgjuar fjalimin. Por, në plan të parë të ekranit bien në sy fotografi të insertuara me ikona fetare ortodokse. Regjistrimi televiziv krijon një përzierje të mitologjisë dhe realitetit. Ky manipulim pamor i mëshon idesë që të galvanizohet një lidhje identitare dhe historike mes 1389-s dhe 1989-s.

Nga ky pikëvështrim mbetet për t’u pranuar se mitet politike përbëhen nga bindjet e njerëzve. Publiku retorik serb i pranoi këto mite si fakte, argumente të mirëqena dhe pjesë krejt normale e sockulturës serbe. Një popull përbëhet pikërisht nga mitet që pjesëtarët e tij i pranojnë dhe i marrin si normale.⁸⁶ Mitet e tilla përbëjnë ngjitesin social të identitetit kolektiv të grupit. Sipas McGee, mitet politike mund të konsiderohen si shprehje për motive kolektive ose bindje, dhe, kështu, ato janë një fenomen retorik që portretizon botën më të mirë sesa që është në të vërtetë.⁸⁷

85 TV Serbia, 28 qershor 1989.

86 McGee, vep. cit. f. 247.

87 Po aty.

Meqë Partia Socialiste e Millosheviqit kishte monopol në të gjitha masmediave, aparati shtetëror serb e pati mundësinë të ushtronte kontroll të rreptë në fushën e lajmit dhe informacionit dhe, po ashtu, edhe të censuronte. Kjo ishte arsyeja pse mediat jugosllave, veçmas TV Beogradi, patën fuqi të madhe propagandistike, ndikuese e manipuluese tek serbët. Kësaj duhet shtuar edhe fakti që atëbotë nuk kishte media të tjera alternative dhe të pavarura, ashtu që të afishonin lajme apo informacione jashtë vijës zyrtare.

6.0 ANALIZA E GAZIMESTANIT

6.1. Analiza e fjalëve simbol

Hyrja (në latinisht *exordium*, greqisht *prologos*) ka një pozitë të rëndësishme në fjalim. Nëse fjalimmbajtësi dështon në hyrje, ai rrezikon që adresimi i tij ta huqë targetin, pra audiencën e synuar. Pikërisht kjo është arsyeja pse i kushtohet rëndësi hyrjes, dhe retorikanë të ndryshëm nënvizojnë plot rregulla dhe këshilla. Më e rëndësishmja syresh është që të merret në konsideratë situata konkrete. Së këndejmi, fjalimmbajtësi duhet të pyes veten “*çka, për kë, kujt, kundër kujt, kur, në ç’vend, në çfarë rrethanash, në çfarë atmosfere, me cilin qëllim mbajmë fjalimin; atëherë natyra vetvetiu do të kujdeset që ne të dimë me çfarë të fillojmë*”.⁸⁸

Dhe, në fakt, Millosheviqi e bëri këtë në mënyrë të shkëlqyer. Nëpërmjet efekteve gjuhësore, Millosheviqi apelonte dhe komunikonte jo vetëm me serbët në Serbi dhe Kosovë, por edhe me serbë të tjerë që jetonin gjithandej Jugosllavisë. Dëgjohej kudo se Serbia është në rrezik dhe se Evropa është dreqi vetë. Kjo sugjeron qartazi se viktimë qenkësh sërish kombi serb, ndërsa hero është “cari” i ditëve tona, Slllobodan Millosheviqi.

Fjalimi është ngjarje e veçantë historike, retorike dhe politike. Ky pohim merr vërtetësi edhe kur kihet parasysh se bëhet fjalë për të parin fjalim të madh politik pas vdekjes së Titos. Në totalitetin e vet, fjalimi është deri diku i gjatë, ose pesë faqe sipas parametrave të formatit A4. Në bazë të përmbajtjes tekstuale, lideri serb lë përshtypjen se ai është sa fanatik e konservator, po aq edhe politikan komunist që dëshiron të përvijojë një strategji të re politike.

Ndërsa shpërvilet teksti i fjalimit, aty imponohen sakaq disa fjalë, pesë prej të cilave spikatin për nga pozicioni qendror e emfatik. Të tilla janë: “Kosova”, “Serbia”, “beteja”, “uniteti” dhe “jouniteti”.

Që në krye në fjalimit, Millosheviqi përdor një metaforë qendrore: “Në këtë vend, në *zemër të Serbisë* (theksimi ynë – G.M), në fushën e Kosovës, para gjashtë shekujsh, para plot 600 vjetëve ka ndodhur një prej betejave më të mëdha të asaj kohe”.

88 Quintilian, *Institutio oratoria*, f. 52.

Si figurë stilistike, metafora ka fuqi dhe shërben si themel për formësimin artistik e retorik të gjuhës. Në fjalimin e tij përdor fjalën “zemër” si fotografi fetare: *“Në këtë vend, në zemër të Serbisë, në fushën e Kosovës...”*.

Zemra mund të kuptohet si epiqendër për të gjitha forcat e jetës, për emocionet, guximin, dijen, vullnetin ose moralin. Në të gjitha fetë, zemra është e mbushur me përmbajtje fetare, madje ka njëfarë statusi të fotografisë fetare. Kështu, ajo ndjesohet si simbol i arsyes, vullnetit dhe emocionit. Edhe sot, njësoj, zemra është bërë simbol për ndërgjegjen.

Millosheviqi këtu përdor fjalën “zemër” në rrafsh metaforik gjithnjë brenda suazave ideologjike. Meqenëse metafora është e hapur dhe e shumëkuptimshme, nuk është aq e lehtë të përkapet interpretimi i drejtë i saj. Zemra është shenjë e jetës; një simbol, i cili duhet të ruhet dhe, nëse është nevoja, të mbrohet me jetë. Dhe asocimet tek publiku dëgjues vetëkuptueshëm marrin formë në pyetjen: Po kush në këtë botë do ta linte zemrën e vet në trup të huaj? Asocimet nuk ndalen me kaq: edhe trupi i serbëve po sulmohet, Serbia është plagosur, e asaj duan t’ia marrin edhe zemrën (Kosovën). Sugjerimi sërish i qartë: duhet bërë diçka, madje çmos, për ta shëruar e për ta ndaluar heqjen e zemrës nga trupi, nga Serbia! Ky sugjerim metaforik që përcillet tek publiku është i thjeshtëzuar: “Kosova = Zemra” dhe “Serbia = Trupi”.

“Serbia” dhe “Kosova” luajnë rol vendimtar në fjalim dhe këto fjalë ngjeshën edhe brenda një fjalie:

“Për këtë arsye nuk ka në Serbi një vend më të përshtatshëm se Fusha e Kosovës që kjo të thuhet. Dhe për këtë arsye nuk ka një vend më të përshtatshëm, se Fusha e Kosovës, që të thuhet se uniteti në Serbi do ta mundësojë prosperitetin edhe për popullin serb dhe Serbinë”.

Tek publiku dëgjues në Gazimestan dhe tek të gjithë marrësit e mesazhit të fjalimit, është një rrjetë e tërë silogjizmesh. Zemra duhet të jetë në trupin e saj. Si mund të jetojë dhe funksionojë një trup pa pjesën më të rëndësishme? Meqë trupi i Serbisë është amputuar, edhe ne, serbët, jemi të gjymtuar dhe të paralizuar. Trupi ynë ka vetëm kokën: është vetëm Republika e Serbisë, por pa Kosovën dhe territoret e tjera serbe.

Me deklaratën e Millosheviqit sugjerohet se serbët tanimë janë të vetëdijshëm për diagnozën e sëmundjes së tyre. Andaj, ata do ta kthejnë ose do ta implantojnë sërish zemrën e vet në trupin e Serbisë. Ata do të bëjnë gjithçka u vjen ndoresh për të shëruar trupin. Dhe Millosheviqi shton:

“Gjashtë shekuj më vonë, përsëri jemi në beteja, dhe para betejash. Ato nuk janë të armatosura, megjithëse as të tillat ende nuk përjashtohen. Por, pa marrë parasysh çfarë do të jenë, betejat nuk mund të fitohen pa vendosmëri, trimëri dhe shpirt vetëmohues. Pa ato veçori të mira që ishin të pranishme në ato kohë të hershme në Fushën e Kosovës”.

Me kontekstin e saj, rrjedhën pararendëse dhe pasuese metaforike, kjo deklaratë ka edhe këtë kuptim: Serbia sërish do ta ketë Kosovën nën kontrollin e vet. Kosova do të shkrihet në Serbi.

Gojëtaria publike e Millosheviqit në këtë fjalim u konsiderua si kërcënim në Jugosllavi, e veçmas në ato territore ku jetonin serbë. Gjithnjë duke evokuar asocimet e fjalimit, sugjerimi ishte që trupi, përveç zemrës, ka edhe duart dhe këmbët. Ishin serbët në Kroaci, Bosnjë dhe Slloveni që u trazuan nga porosia e këtij fjalimi. Rebusi plotësohet edhe më kur evokohet deklarata tjetër e Millosheviqit, jo më pak eksplicite: *“Serbia është kudo, ku ka serbë dhe ku varre serbe”*.⁸⁹ Situata retorike (*kairos*) mund të jetë një burim i mirë, sepse folësi përfiton nga mundësitë në një situatë. Një folës i mirë e di se *çfarë* dhe *si* duhet thënë *diçka* dhe e di se *çfarë* i përshtatet situatës në të cilën ndodhet (*aptum*). Dhe Millosheviqi e shfrytëzoi po këtë mundësi.

Pastajshmëria e deklaratës së tij kuptohet edhe si vijon: amputimi i trupit do të kishte pasoja të mëdha politike, kulturore dhe ekonomike për identitetin serb dhe të ardhmen e tyre. Kjo është arsyeja pse “të gjithë serbët duhet të jetojnë në një shtet”. Prandaj trupi ynë duhet të funksionojë dhe të jetë përsëri i gjallë. Serbia duhet të ribashkohet dhe kjo të ndodhë *“Gjashtë shekuj më vonë, përsëri jemi në beteja, dhe para betejash. Ato nuk janë të armatosura, megjithëse as të tillat ende nuk përjashtohen”*, gjithnjë sipas fjalëve të liderit serb.

Duke i analizuar metaforat në këtë fjalim infamoz, mund të përfundohet se Millosheviqi u përpoq të sajonte mënyrën e tij origjinale në shprehjet oratorike. Black thotë se ideologjitë *“përrën të kenë një ndikim vendimtar në karakterin psikologjik të mbështetësve të tyre”*.⁹⁰

Në këtë fjalim, fjala “Serbi” është e shenjtë dhe “term zoti”. *“Le të rrojë Serbia!”*, thërret Millosheviqi.

89 Mønnesland 1999: 257.

90 Black 1999: 10.

6.2. Fjalët kyçe

E nënshtuar një ekzaminimi sasior, fjala “Serbi” përmendet 36 herë, ndërsa fjala “Kosovë” 18 herë. Që të dyja janë përzgjedhur si nje kyçe që ndërkallin fjali të rëndësishme, dhe kjo duke u mbështetur në dendurinë dhe shpeshtësinë e përdorimit të tyre. Edhe fjala “serb” në fjalim paraqitet si *term Zoti*, ndërsa fjala “Kosovë” paraqitet dhe përfaqëson dualisht edhe termin e zotit, edhe atë të djallit.

Mirëpo fjala më e veçuar për nga shpeshtësia e përdorimit është “Serbia”. Asaj i bashkëngjiten përmendje të shpeshta të fjalëve “jouniteti”, “luftë”, “krenari e rikthyer” dhe “tradhti”:

“Jouniteti dhe tradhtia në Kosovë do ta përcjellë edhe më tej popullin serb si një kob i zi nëpër gjithë historinë e tij. Madje edhe në luftën e fundit, kjo mungesë e unitetit dhe e tradhtisë e çoi popullin serb dhe Serbinë në agoni, pasojat e së cilës në kuptimin historik dhe moral e tejkaluan agresionin fashist”.

Për Millosheviqin, Kosova ka dy dimensione morale. Njëri është ideologjik dhe tjetri mitologjik. E mirë është vetëm Kosova ideologjike dhe ajo mitike, por Kosova aktuale është “e keqe”. Dhe kjo sepse ajo nuk është nën kontrollin e Serbisë.

Duke ekzaminuar tekstin vihet re se fjalët që i ndajngjiten “Serbisë” janë: “beteja”, “dhimbje”, “tradhti” dhe “Kosovë”. Folësi retorik e lidh “Serbinë” edhe me gjashtë fjalë të tjera kyçe: “Kosova”, “tradhtia”, “viktimizimi”, “jouniteti”, “skllavëri” dhe “beteja”:

“Mungesa e unitetit dhe e tradhtisë në Kosovë do të vazhdojë ta ndjekë popullin serb si një fat i keq gjatë gjithë historisë së tij. Madje edhe në luftën e fundit, kjo mungesë e unitetit dhe e tradhtisë e çoi popullin serb dhe Serbinë në agoni, pasojat e së cilës në kuptimin historik dhe moral e tejkaluan agresionin fashist. Prandaj është e vështirë të thuhet sot nëse Beteja e Kosovës ishte një disfatë apo një fitore për popullin serb, nëse falë saj ne ramë në skllavëri apo mbijetuam në këtë skllavëri”.

Duke e përfshirë “jounitetin”, “skllavërinë” dhe “tradhtinë” serbe, dikur dhe në momentin e pikërishtë historik, në një kolektiv kombëtar, Millosheviqi pranon rolin e viktimës në realitetet politike serbe.

Nga kjo rezulton thjesht se lidhjet më të forta japin kombinimet midis fjalëve “Serbi”, “Kosovë” dhe “jouniteti”. Pra, duke analizuar togfjalëshat, pason vlerësimi se “Kosova”, sipas këtij fjalimi, është ngjarje e veçantë. Ajo shënon fundin e madhështisë dhe pavarësisë së Serbisë, por njëherazi “Kosova” mbart edhe një identitet simbolik.

Shumica e fjalëve brenda grupimit të parë janë mbiemra që e përshkruajnë pozitën e Serbisë në sistemin politik jugosllav. Mbiemrat nuk janë neutralë; ata janë të fuqishëm dhe i japin fjalës intensitet në shkallë të lartë. Fjala “Kosovë” është e qarkuar të shumtën e herëve nga fjalët “betejë” dhe “legendare”:

“Por, më duhet ta them këtu, në këtë fushë të madhe, legendare, të Kosovës, se serbët atë përparësi të të qenit një popull i madh nuk e kanë shfrytëzuar kurrë as për veten e tyre. Sot është e vështirë të thuhet çfarë është e vërtetë historike në Betejën e Kosovës, e çfarë është legendë”, thotë Millosheviqi.

Në këtë mënyrë, Millosheviqi përfshin gjithë popullin në publikun retorik të fjalimit. Kjo bën që Kosova të shndërrohet në një argument nacionalist. Ajo referohet si pjesë e territorit të shenjtë të Serbisë. Duke përdorur fjalë me ngjyrimë fetare, territori serb portretizohet si diçka mitike dhe e pacenueshme. Kjo fjali thotë shumë: *“Prandaj, sot, nuk e kemi të vështirë t’i përgjigjemi asaj pyetjes së moçme: ‘Me çfarë do të dalim para Milloshit?’ (këtu referohet për të ashtuquajturin Millosh Obiliqi, si hero i betejës së Kosovës – shënimi ynë, G.M). Falë lojës së historisë dhe jetës duket sikur Serbia mu në këtë vit, më 1989, e riktheu shtetin e vet dhe dinjitetin e vet për ta kremtuar ashtu ngjarjen historike nga e kaluara e largët, e cila e kishte një rëndësi të madhe historike dhe simbolike për të ardhmen e saj”.*

Mjaft shpesh Kosova përmendet edhe si “atdhe”. Në një rast gjatë fjalimit, Millosheviqi thotë: *“Prandaj, këto fjalë që i kushtohen solidaritetit, unitetit dhe bashkëpunimit mes popujve nuk kanë askund në tokën e atdheut tonë kuptim më të madh sesa këtu në fushën e Kosovës, e cila është një simbol i përçarjes dhe tradhtisë”.*

Pyetja që lind gjatë leximit analitik të këtyre frazave është se çfarë nënkupton fjalimmbajtësi me fjalën “atdhe”? A është vallë ky sinonim për një komb apo për një shtet? Çfarë nënkuptohet atëherë kur ky e përdor një fjalë-simbol të tillë? Kjo kushtëzon fillimisht qëmtimin e asaj se çfarë nënkuptohet në ligjërimitin e përgjithshëm në Serbi me fjalën “atdhe”. Për serbët, “atdheu” është vetëm Serbia si një komb i veçantë, në kuptimin e një populli ose grupi etnik. Kjo do të thotë që Serbia me Kosovën është “atdheu serb”. Meqë shqiptarët ndryshonin për nga trashëgimia kulturore dhe ajo kombëtare, ata fare lehtë, sipas rezonimit të ndërtuar në këtë egoitizëm përjashtues, mund të konsideroheshin si “tumor kancerogjen” në atdheun serb.

Por “atdheu” ka gjithashtu përshtirje konotative territoriale; te kjo fjalë rëndom bashkëngjiten shprehje të forta emocionale. Sipas

përdorimit kontekstual të fjalimit, kjo fjalë ka edhe dimensionin e vet territorial që lidhet me luftën e zhvilluar në Kosovë. Vetëm në këtë mënyrë Millosheviqit i mundësohet të pozojë si mbrojtës i interesave kombëtare dhe territoriale historikisht të përcaktuara të Serbisë.

6.3. Kosova, mit dhe identitet

Nga përmbajtja e fjalimit retorik dhe përdorimi i fjalëve të caktuara nënvizohen përpjekjet e tij në mbrojtje të territorit të “shenjtë” të Serbisë. Për të, Kosova ka një lloj fuqie Perëndie, pra mbart njëfarë autoriteti politik dhe kulturor: ai krijon idenë se për serbët Kosova do të thotë gjithçka dhe çdo gjë. Ajo është për ta një vend mitologjik dhe mit politik. McGee thotë se: *“Çdo mit politik presupozon një ‘popull’, i cili mund të rregullojë realitetin me besimin e tij kolektiv. Për sa kohë që ‘populli’ beson në mitet themelore, do të ekzistojë uniteti dhe identiteti kolektiv”*⁹¹. Për Millosheviqin ishte e rëndësishme që publiku retorik të jetë i bashkuar me një identitet të fuqishëm e i prirë të besojë në mitologji.

Përkundër faktit se fjala “betejë” në fjalimin e tij përmendet vetëm 13 herë, mund të përfundohet se ajo paraqet një “term Zoti”. Është e tillë sepse kjo fjalë zë vend qendror në fjalimin oratorik. Përtej kësaj, substantivi “betejë” është i ndajmbathur nga mbiemrat që e përshkruajnë atë në shumë hollësira. Kjo, për më tepër, tregon edhe për karakteristikat dhe nuancat e betejës. Nga e gjithë kjo rezulton se “betejë”, sipas fjalimit, është fjalë kyçe bazuar në shpeshtësinë dhe intensitetin e përdorimit të saj.

Fjalimmbajtësi e përdor këtë fjalë me një intensitet veçanërisht të lartë. Le të veçohen si shembuj edhe këta dy pasusa: *“Atëherë kur u zhvillua beteja e famshme në Kosovë”* ose *“një nga betejat më të mëdha në histori u zhvillua 600 vjet më parë”*.

Në fjalim, Millosheviqi e vlerëson dhe lavdëron “fitoren heroike” të serbëve në betejën e Kosovës. Nga analiza e tekstit shihet se fjala “betejë” përdoret shpesh edhe në lidhje me “tradhtinë” dhe “jo-unitetin” në mesin e serbëve.

91 McGee 1975: 245.

Fjalët që grumbullohen rreth fjalëve “Serbia” dhe “Kosova” mund të ndahen në dy epoka kohore dhe në dy grupe. Millosheviqi flet për “Serbinë” dhe “Kosovën” në dy kuptime të ndryshme. Arsyeja për këtë është se fjalët që tokëzohen rreth “Serbisë” dhe “Kosovës” kanë një intensitet të fuqishëm. Rrjedhimisht, ato mund të ndahen në dy grupe. Këto janë fjalë që krijojnë tensione, dramatike dhe konflikte.

Por, fjalët mund të tubëzohen edhe sipas epokës kohore; kjo sepse fjalët konotojnë dhe përshkruajnë fatin serb në të kaluarën dhe në të tashmen. Më poshtë janë paraqitur në mënyrë tabelare fjalët që grumbullohen rreth “Kosovës” dhe “Serbisë” të ndara në grupe:

Tabela 1.

Serbia dhe Kosova	
1389 – E kaluara	1989 – E tashmja
Jouniteti	Uniteti
“Mungesa e unitetit dhe tradhtisë në Kosovë e ka ndjekur popullin serb si një fat i keq gjatë gjithë historisë së tij”.	“Por këtu ne jemi tani në fushën e Kosovës dhe mund të themi se nuk është më kështu”.
Viktimë e poshtëruar	Dinjiteti i flijimit
Humbje	I rifituar
Pa integritet	Integritet
I harruar	Kujtesë
Tradhti	Heroizmi
Skllavëri	Nuk ka skllavëri
Tragjike	E ardhmja
E keqja/ Dhimbja	Përparim
Vdekje	Festim
Dëm	I konsoliduar
Në dëm të popullit	Kushtetuta
Betejë	Vlera
Të poshtëruar	Status
Fatkeqësi	Optimizëm

Analizat e fjalëve kyçe nuk mund të quhen të plota nëse nuk shoqërohen edhe me shqyrtimin e figurave stilistike të antitezave dhe antonimeve.⁹² Është pikërisht analiza e agonisë ajo që i jep analizës së grupimit të fjalëve konfliktin dhe dramën. Këto shprehje duken se janë në marrëdhënie tensioni me njëra-tjetrën.

6.4. “Vetëm Uniteti do të shpëtojë Serbinë”

Duke përdorur mbiemrat dhe lidhëzën “dhe”, Millosheviqi fillimisht përshkruan pasojat e jounitetit të politikanëve serbë. Le ta marrim një shembull:

“Mungesa e unitetit dhe e tradhtisë në Kosovë do të vazhdojë ta ndjek popullin serb si një fat i keq gjatë gjithë historisë së tij. Madje edhe në luftën e fundit, kjo mungesë e unitetit dhe e tradhtisë e çoi popullin serb dhe Serbinë në agoni.”

Pastaj, ai i vë përballë mbiemrat me cilësinë e jounitetit. Me antiteza të tilla, ndërtohet një mesazh i qartë, një dramë dhe fotografi e gjallë e përfshirë nga tensioni. Mesazhi i fjalimit është i qartë: vetëm uniteti mund ta shpëtojë Serbinë! Millosheviqi përdor gjithashtu elementët mitikë të cilët ndikojnë që Beteja e Kosovës të kuptohet si mit dhe si realitet i sotëm. Për shembull, ai thotë: *“Jouniteti midis politikanëve serbë e ka lënë Serbinë në prapambeturi, ndërsa inferioriteti i tyre e ka poshtëruar Serbinë.”*

Fjala “jounitet” është e bashkëshoqëruar me fjalët “i poshtëruar”, “Kosovë”, “humbje”, “fatkeqësi” dhe “tradhti”. Këto kanë kuptim dhe konotacion të dyfishtë. Janë, pra, fjalë kyçe dhe si të tilla janë zgjedhur prej tij si përfundim në fjalim. Prandaj, është e nevojshme që kjo analizë të plotësohet edhe me një shqyrtim për së afërmi për mënyrën se si i lidh ai këto fjalë.

Togu “mungesë e unitet” përmendet vetëm një herë, ndërsa fjala “tradhti” përmendet pesë herë. Ashtu si u theksua më sipër, një fjalë simbol mund të përmendet pak herë, por ajo megjithatë mund të funksionojë si kyçe tekqë përmendet me intensitet të fuqishëm. Në një rast, Millosheviqi zë në gojë edhe shprehjen “jouniteti tragjik”:

“Nëse e kemi humbur betejën, atëherë kynuk qe rezultat i superioritetit shoqëror dhe përparësisë në armatime të Perandorisë Osmane, por edhe

92 Sipas një përkufizimi shpesh të cituar, antiteza (që vjen si kompozitë prej dy fjalëve greke *ἀντί* „kundër” dhe *θέσις* „vendosje”) është një figurë stilistike që vë përballë dy gjendje, dy kënde të kundërta për ta ndriçuar me forcë një ide kryesore. Për të formuar antitezën shërbejnë antonimet.

i jounitetit tragjik në kreun e shtetit serb. Asokohe, në atë motin e largët 1389, Perandoria Osmane jo vetëm që ishte më e fuqishme se ajo serbe, ajo ishte edhe më e lumtur se perandoria serbe.”.

Përmes fjalimit të tij, lideri serb kthehet prapa në kohë, në vitin 1389, dhe i referohet asaj që e quan jounitet dhe tradhti midis Vuk Brankoviqit dhe Llazar Hrebeljanoviqit. Megjithëkëtë, kjo fjalë mund të nënkuptohet sikur Millosheviqi edhe sot po përballet me “jounitetin” dhe “tradhtinë” që ekziston midis politikanëve jugosllavë.

Në terma të legjendës, pamja e gjërave thjeshtëzohet fare: nga njëra anë, Llazari dhe Millosh Obiliqi si heronj serbë, kurse Vuk Brankoviqi, në anën tjetër, si tradhtar. Por, fjalimi lë të kuptuar subliminalisht sikur Serbia sot ka unitet serb, sepse ajo ka princin dhe heroin e ri, Millosheviçin, si mishërim i Llazarit. Kategoria e tjetrit, ose “të këqijtë”, sipas tij, janë turqit dhe, veçmas, të “tjerët”. Të gjithë bashkë ngjallin figurën e tradhtarit Brankoviq.

Këto nuanca mitike luajnë rol të rëndësishëm në fjalim. Miti natyralizohet si fakt historik, pavarësisht se në një vend Millosheviqi thotë me sa vijon:

“Sot është e vështirë të thuhet çfarë është e vërtetë historike në Betejën e Kosovës, e çfarë është legjendë”.

Por, kjo është mënyra si Millosheviqi e mban të gjallë legjendën. Duke e përsëritur vlerësimin e bërë më parë, fjalët më të rëndësishme në këtë fjalim janë binomi i antitezës “uniteti” dhe “jouniteti”. Me bagazhin e tyre tensionues, ato zënë vend kudo në fjalim. A nuk vjen në shprehje kjo kur fjalimmbajtësi thotë: *“Jouniteti dhe tradhtia në Kosovë do ta përcjellë edhe më tej popullin serb si një kob i zi nëpër gjithë historinë e tij”.*

Në këtë pasus, autori përpiket të përftojë tek marrësit përshtypjen sikur serbët janë viktima, jo dhe aq si pasojë e veprimeve të tjerëve, sa prej përçarjes së brendshme dhe tradhtisë brenda kombit serb. Dhe fjalimi këtë poentë e intensifikon edhe me këtë pjesë:

“Për këtë arsye ndoshta askund në truallin e atdheut tonë nuk kanë aq shumë kuptim fjalët kushtuar unitetit, solidaritetit dhe bashkëpunimit midis njerëzve sa kanë kuptim këtu, në Fushë të Kosovës, e cila është simbol i përçarjes dhe i tradhtisë. Jouniteti dhe tradhtia në Kosovë do ta përcjellë edhe më tej popullin serb si një kob i zi nëpër gjithë historinë e tij. Madje edhe në luftën e fundit, kjo mungesë e unitetit dhe e tradhtisë e çoi popullin serb dhe Serbinë në agoni, pasojat e së cilës në kuptimin historik dhe moral e tejkaluan agresionin fashist”.

Grupimet e fjalëve, e sidomos mbiemrat, krijojnë dhe shprehin identitetin krenar serb në të kaluarën, përderisa fjalët simbol dhe

mbiemrat që konotojnë të tashmen janë përdorur si instrument ndikues për të sajuar “rilindjen dhe krenarinë e Serbisë”.

Grupimi i dytë, i cili është paraqitur në tabelën e mësipërme, përshkruan “unitetin” dhe fjalët që grumbullohen rreth tij. Millosheviqi thotë se:

“Për këtë arsye edhe jam i mendimit se kjo ka kuptim të thuhet pikërisht këtu në Kosovë, ku jouniteti një herë e një kohë e ka prapakthyer për shekuj dhe e ka rrezikuar tragjikisht Serbinë dhe ku uniteti i përtërirë mund ta përparojë dhe t’ia kthejë dinjitetin.”.

Fjalimi tek audienca përfton kuptimin se më në fund populli serb mund të ketë një të ardhme të ndritur me një “unitet të ripërtërirë” duke pasur në krye Millosheviqin.

Një tjetër faktor i rëndësishëm sa i përket fjalës “unitet” është se fjala simbolike mban një lidhje logjike me fjalën “Kosovë” dhe “Serbi”. Kjo do të thotë se, nëpërmjet unitetit të ripërtërirë, Serbia dhe Kosova mund të kenë një dinjitet dhe status të lartë. Sepse që të dyja këto bashkë formojnë një trup.

Kosova + uniteti = përparim tek Serbia e serbëve

Gjithnjë sipas fjalimit millosheviqian, fjala “unitet” paraqet një lidhje e natyrshme ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, dhe nëse kjo lidhje e natyrshme nuk respektohet ekziston rreziku që historia të përsëritet. Sipas këtij rezonimi, serbëve iu është sosur durimi dhe nuk mund të tolerojnë më politikat e Jugosllavisë që e shkatërruan plotësisht “unitetin” nacional të popullit serb. Prandaj, i gjithë populli serb duhet ta ketë parasysh se “uniteti” nuk është vetëm një fjalë boshe oratorike, por edhe një lidhje e natyrshme që e shpëton kombin.

6.5. Tradhtitë e vjetra, tradhtitë e reja

Kur ai flet për historinë, ose më saktë kur i referohet Luftës së Dytë Botërore, Millosheviqi përdor të kundërtën e “unitetit”, përkatësisht “mungesën e unitetit”, që paraqitet si fakt serb gjatë Luftës së Dytë Botërore: *“Madje edhe në luftën e fundit, kjo mungesë e unitetit dhe e tradhtisë e çoi popullin serb dhe Serbinë në agoni, pasojat e së cilës në kuptimin historik dhe moral e tejkaluan agresionin fashist”.*

Edhe këtu, Millosheviqi i mëshon sërish jounitetit që ekzistonte midis popullit serb si dhe “çmimin” që serbëve iu desh ta paguanin gjatë Luftës së Dytë Botërore. Në fakt, peizazhi politik gjatë Luftës së Dytë Botërore u mbizotërua prej çetnikëve dhe partizanëve.

Të parët ishin një lëvizje pro-monarkiste, ndërsa të dytët e proklamnin veten si lëvizje antifashiste çlirimtare. Gjatë kësaj lufte të ndërsjellë për pushtet e fuqi politike, çetnikët e kthyen frontin e tyre kundër komunistëve dhe, me këtë rast, nisën të bashkëpunojnë me nazistët. Ata gëzonin një mbështetje të konsiderueshme në mesin e popullatës serbe.

Pas vitit 1942, njësitë e armatosura çetnike iu bashkuan operacioneve gjermane dhe italiane kundër partizanëve. Sipas një studiuesi, “bashkëpunimet e drejtpërdrejta ishin së pari me italianët, e më pas, më 1943, edhe me gjermanët”.⁹³ “Shumica e komandantëve ... këshilltarë ishin nacionalistë serbë të vijës së ashpër, mbrojtës të Serbisë së Madhe, nga e cila do të duhej ‘të spastroheshin’ elementë të padëshirueshëm sikurse myslimanët dhe shqiptarët”.⁹⁴

Kështu, strategjia dhe politika e Drazha Mihajloviqit u orientua drejt krijimit të një Serbie etnikisht të pastër ose më saktë një Serbie të Madhe.⁹⁵ Në shërbim të kësaj politike, çetnikët kryen masakra të rënda kundër popullatës shqiptare, myslimane si dhe popujve të tjerë.

Në këtë fjalim, tangjenta e Millosheviqit zë në gojë edhe “jounitetin” që kishte lindur edhe pas luftës, pra gjatë periudhës socialiste në Jugosllavi. Shi për këtë, ai thotë: *“Madje edhe më vonë pasi u formua Jugosllavia socialiste, kreu serb në atë shtet të ri mbeti i ndarë, i prirë drejt kompromiseve në dëm të popullit të vet. Lëshimet që shumë udhëheqës serbë i bënë në dëm të popullit të vet, as historikisht, as etikisht, nuk do të mund t’i pranonte asnjë popull në botë. Aq më parë që serbët në tërë historinë e vet kurrë nuk i kanë pushtuar dhe eksploatuar të tjerët”*.

Nga një optikë e tillë e gjërave, sipas tij, politikanët serbë ishin të dobët, të papërgjegjshëm, të përçarë dhe se nuk mbronin interesat serbe. Ata ishin përfaqësues të “jounitetit” që e kishte shkatërruar popullin serb me shekuj. Jouniteti nuk është vetëm një kolerë e mynxyrë e llojit të vet, por edhe një fyerje e poshtërim për kombin serb. Në instancë të fundit, fjalimi ia doli mbanë të sajonte një publik (e popull) me ndjesinë dhe mendimin se serbët qenë trajtuar padrejtësisht pas luftës.

Arsyeja, të cilën e sjellë Millosheviqi për të shpjeguar këtë ndjenjë dhe për këtë mendim, ishte se brenda territorit të Serbisë ekzistonin edhe dy provinca autonome. Në mënyrë të nënkuptuar, Millosheviqi

93 Noel 2002: 298.

94 Po aty.

95 Mønnesland 1999: 192.

u kujton serbëve se udhëheqësit serbë nuk kishin krenari kombëtare dhe se ata nuk ishin as patriotë serbë, prandaj sipas tij:

“Për meritat e prijësve dhe politikanëve të tyre dhe mentalitetit të tyre prej vasalësh, ata madje ndjeheshin për këtë fajtorë para të tjerëve, madje edhe para vetes. Kështu ka qenë me dekada, me vite. Ja ku jemi sot në Fushën e Kosovës që ta themi – se më nuk është ashtu. Jouniteti i politikanëve serbë e ka lënë Serbinë në prapambeturi, ndërsa inferioriteti i tyre e ka poshtëruar Serbinë”.

Ai thotë se jouniteti i përket së kaluarës. Por ai dëshiron të bindë dëgjuesit se udhëheqja e Serbisë në vitin 1989 është unike, është e re, më e fortë dhe e përgatitur të shkojë në luftë, nëse kjo është e nevojshme për kauzën serbe. Për të gjitha këto, Millosheviqi është në paqe me vetveten sepse, ashtu siç u theksua më herët në këtë kapitull, ai e ka bërë sërish Serbinë një shtet të tërë e të bashkuar, madje edhe në kuptimin kushtetues.

6.6. Ambivalenca e “unitetit”

Për të thelluar kuptimin e fjalimit të mbajtur në Gazimestan, dhe veçmas mënyrën si e përdorë fjalën “unitet”, do të ishte në funksion përnjohës edhe një tangjentë tjetër që vë në pah historinë e shqiptarëve. Ashtu siç ekziston konsensusi mes historianëve të huaj e vendas, Fuqitë e Mëdha, me rastin e Kongresit të Berlinit (qershor 1878), nuk përfillën Shqipërinë dhe realitetet e saj etnike.

Derisa Traktati në fjalë legjitimoi spastrimin etnik dhe pushtimin e hapësirave të tëra kompakte shqiptare nga Serbia në dimrin e po atij viti (edhe burimet serbe i referoheshin sanxhakut të Nishit si *Arnautlluk*), objekt aneksimi u bënë edhe toka shqiptare në veriperëndim dhe jug. Këto rrethana të vështira, që u pasuan me vendime arbitrare të Fuqive të Mëdha edhe më 1913 dhe 1919, kushtëzuan që fjala “unitet” të vishej me aureolën e një mesazhi të fortë kombëtar për shqiptarët që mbetën jashtë kufijve të shtetit shqiptar.

Në vetëdijen e tyre kolektive ekziston “uniteti” i Shqipërisë: është fjala për bindjen e përhapur gjerësisht se shqiptarët u ndanë forcërisht nga atdheu i tyre, Shqipëria.

Por, fjala “unitet”, sipas konotimit millosheviqian, ka mesazh dhe perceptim të dyfishtë. Ajo ndërtoi një popull me motiv nacionalist. Dhe, si kundërvënie, shqiptarët gjykuan se duhej të organizoheshin e të bënin gjithçka ishte e mundur për ribashkim me atdheun e tyre,

Shqipërinë. “Sloga” serbe nuk qe kërcënim vetëm për shqiptarët në Kosovë, por të pambrojtur e të kërcënuar drejtpërdrejtë ishin edhe ata që jetonin në Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi. Është ky “kairosi” kur shqiptarët menduan se duhej të luftonin okupimin serb e për t’i çuar përpara interesat kombëtare.

Së këndejmi, “uniteti” i proklamuar në Gazimestan u bë “benzinë për zjarrin” për të dy popujt, në hendekun tashmë të pakapërcyeshëm që u krijua në marrëdhëniet mes shqiptarëve dhe serbëve. Fjalimi krijoi një popull serb të elektrizuar dhe të agjituar, por njëkohësisht ngacmoi edhe shqiptarët.

6.7. Heroizmi për të sotmen

Fjala “Kosovë”, ashtu siç u përdor nga demagogu në Gazimestan, shoqërohej me çifte fjalësh që sillnin intensitet të fortë emocional si “unitet”, “krenari”, “trim”, “i pamposhtur” dhe “heroizëm”. Me këto intenca në mendje, Millosheviqi shprehej:

“Është më se e sigurt, nëpër gjithë këta shekuj pas nesh, se në Kosovë para 600 vjetësh na ka ndodhur jouniteti. Nëse e kemi humbur betejën, atëherë ky nuk qe rezultat i superioritetit shoqëror dhe përparësisë në armatime të Perandorisë Osmane, por edhe i jounitetit tragjik në kreun e shtetit serb. Asokohe, në atë motin e largët 1389, Perandoria Osmane jo vetëm që ishte më e fuqishme se ajo serbe, ajo ishte edhe më e lumtur se perandoria serbe”.

Kësaj ia shtonte edhe fjalët në vijim:

“Heroizmi i Kosovës ka frymëzuar dhe ka ushqyer krijimtarinë tonë për 6 shekuj, dhe nuk na lejon të harrojmë se dikur ishim një ushtri e madhe, e guximshme dhe krenare, një nga të paktët që mbetëm të pamposhtur edhe kur humbëm”.

Sipas pasazheve të cituara, lideri serb e përdorte gjithnjë fjalën “unitet” si kontrast me “jounitetin”. Substantivi “Kosova” dhe përdorimi i shpeshtë i fjalës “unitet” (i cili lidhet me fjalën “Serbi” të fjalimit), për Millosheviqin luanin rol qendror në atë se si duhet të duket e ardhmja e serbëve. Botëkuptimi i fjalimit është se e ardhmja e serbëve varet nga “uniteti serb” dhe vendosmëria për Kosovën.

Më tej, Millosheviqi vazhdon: *“Për këtë arsye nuk ka në Serbi një vend më të përshtatshëm se Fusha e Kosovës që kjo të thuhet. Dhe për këtë arsye nuk ka një vend më të përshtatshëm, se Fusha e Kosovës, që të thuhet se uniteti në Serbi do ta mundësojë prosperitetin edhe për popullin serb dhe Serbinë”.*

Mbështetja e idesë se serbët janë “viktima” ose “kompromiset gjithmonë bëheshin në dëm të popullit serb”, është temë kryesore në fjalimin e Millosheviqit. Ishin dhe ende janë “të tjerët” që janë mëkatarë. Është kjo kategori binare, të cilës i atribuohen krimet, kurse “ne” jemi viktima. Serbët, siç rezonon ai, janë të pafajshëm. Roli i viktimës dhe domosdoshmëria e popullit serb për të mbrojtur veten e tij, sidomos kundër armiqve të jashtëm, por edhe atyre të brendshëm, përmendet disa herë në fjalimin e tij. Ja një prej tyre:

“Në kujtesën e popullit serb jouniteti qe vendimtar për humbjen e betejës dhe fatin e kobshëm që e pësoi Serbia plot pesë shekuj”.

Në fjalim zë vend shpesh edhe fjala “betejë”. Duke e përdorur atë, Millosheviqi thotë se *“Gjashtë shekuj më vonë, përsëri jemi në beteja, dhe para betejash.”* dhe se *“Pa marrë parasysh çfarë do të jenë, betejat nuk mund të fitohen pa vendosmëri, trimëri dhe shpirt vetëmohues”.*

Si rezultat i kësaj, fjalimi krijon te publiku retorik serb mendimin dhe bindjen se ata sërish janë një popull i kërcënuar. Duke e përdorur kartën e diskursit sikur kombi serb është i rrezikuar, Millosheviqi lë të kuptohet se vetëm një sulm ndaj kombit mund të konsiderohet si vetëmbrojtje e nevojshme. Në këtë mënyrë, ai sajoi një lloj klime lufte në të cilën Serbia duhet të ishte e gatshme të sulmojë të tjerët, ashtu që kjo të ndodhë para se “ata” të jenë të gatshëm t’i sulmojnë “këta”.

Mesazhi subliminal i fjalimit është se kombi që do të sulmohet duhet të konsiderohet si agresori i vërtetë. Kjo është, në të vërtetë, mënyra si filloi rilindja e mitit për Kosovën me synimin e parë dhe të fundit për justifikimin dhe legjitimimin e sulmit ushtarak dhe politik serb në Jugosllavi, dhe veçmas në Kosovë:

“Gjashtë shekuj më vonë, përsëri jemi në beteja, dhe para betejash. Ato nuk janë të armatosura, megjithëse as të tillat ende nuk përjashtohen. Por, pa marrë parasysh çfarë do të jenë, betejat nuk mund të fitohen pa vendosmëri, trimëri dhe shpirt vetëmohues. Pa ato veçori të mira që ishin të pranishme në ato kohë të hershme në Fushën e Kosovës”.

Kjo dëshmon kristal qartë se nënteksti, diku më i qartë e diku më tacit, është se serbët dhe Serbia mund dhe duhet të përballen me luftë. Aty nuk thuhet drejtpërdrejt se do të ketë beteja të armatosura, porse ato nuk mund të përjashtohen.

A është lufta një kërcënim për “të tjerët”? A po e bën këtë me qëllim dhe në një mënyrë diplomatike?

Duke thënë *“Ato nuk janë të armatosura, megjithëse as të tillat ende nuk përjashtohen”*, fjalimi rrënjos te publiku marrës mendimin se ushtria serbe është e përgatitur të shkojë në luftë për të mbrojtur dhe për të

mbledhur “*të gjithë serbët në një shtet të vetëm*”, dhe, e nënkuptuar me këtë, për ta mbajtur Kosovën brenda Serbisë. Sepse “*Kosova është zemra e Serbisë*”, siç përsërit regjimi e të gjitha zgjatimet e tij.

Le të rikujtohet se fjala “luftë” është përdorur nga Millosheviqi në lidhje me situatën shumë të tensionuar politike në Kosovë. Ai e ndajmbath atë me fjalët “vendosmëri” dhe “fushë e Kosovës”. Përsëritja e planifikuar në tekst rrah të krijojë idenë se Kosova do të thotë shumë për Serbinë dhe se ajo ka një vend të rëndësishëm në historinë kombëtare serbe.

Me anë të analizës së grupimit të fjalëve zbulohet kësioj një botëkuptim që shndërrohet në sindromë të viktimës; për më tepër, ai thekson idenë se jouniteti ka shkatërruar të ardhmen e popullit serb. Fjalimi përfton tutje edhe ndjesinë se tani nuk ka më tradhtarë midis politikanëve serbë dhe kjo është një arsye e rëndësishme pse Serbia do të jetë një shtet i bashkuar dhe i fuqishëm politikisht, ekonomikisht dhe ushtarakisht.

6.8. Një kod i vjetër lufte

Përveç kësaj, fjalimi sajton një publik retorik që duhet të mendojë dhe të besojë se Kosova historikisht ka qenë trashëgimi historike e Serbisë dhe se ajo nënkupton gjithçka për serbët. Me të thënat dhe ato që nënkuptohen sublimalisht, serbët gjithmonë paskërkan shkuar në luftë për të mbrojtur dhe mbajtur Kosovën në Serbi; në këtë frymë, memoriali në Gazimestan, Llazari, beteja e 1389-s dhe e gjithë Kosova shndërrohen në simbole për identitetin serb. Kjo është arsyeja, sipas Millosheviqit, që Kosova nuk duhet të jepet kurrë. Populli serb duhet ta arrijë këtë me “mjete legjitime ose jolegjitime”.

Të gjitha kulturat kanë normat e tyre se si njerëzit do të duhej të sillleshin brenda kodit të tyre kulturor, dhe nëse dikush i thyen këto norma ai do të pritej me reagime negative. Përveç kësaj, mënyra sesi njerëzit shprehen gjuhësisht është e rregulluar përmes normave. Kësioj nëse qëllimi është për të bindur një grup njerëzish, është e rëndësishme që të respektohen këto norma; rrjedhimisht edhe të shmangen reagimet negative.

Me fjalë të tjera, ideja është që të shkruhet e flitet në atë mënyrë që të jetë në kongruencë me kulturën që folësi apo autori i përket. Sipas shkrimeve të retorikanëve latinë, fjalimi duhej të ishte *aptum*, e që në shqip do të përkthehej “i përshtatshëm”. Millosheviqi, në këtë rast, flet serbisht, pra gjuhësisht ka respektim e përshtatje të normave kulturore.

Duke qenë *aptum*, fjalimi identifikohet me kulturën dhe normat serbe. Në fakt, identifikimi është i nevojshëm për të bindur një publik, madje vetë procesi është një efekt retorik. Bindja e një njeriu është e mundur për aq sa flitet në gjuhën e tij me anë të fjalës, gjesteve, tonalitetit, rregullave, imazhit, qëndrimit, idesë, duke identifikuar mënyrat e folësit me të tijat.⁹⁶

6.9. Ndërtimi i publikut të dyzuar

Në artikullin “Retorika” që i kushtohet librit “Lufta ime” të Adolf Hitlerit, Burke shprehet se çdo lëvizje që rekruton mbështetësit e saj nga grupe të ndryshme duhet të ketë një pikë fikse.⁹⁷ Ai thotë se Hitleri doli me idenë që libri i tij “Mein Kampf” të ishte jo vetëm një ide qendrore, por edhe një Mekë gjeografike.⁹⁸ Përderisa Hitleri zgjodhi qëllimisht Mynihun si pikë fikse të materializuar, Millosheviqi zgjodhi Kosovën. Në perceptimin e masave, ai po vinte në “zemrën e Serbisë”. Kjo pikë fikse, kjo epiqendër e bashkuar, tani është Kosova.

Fjalimi i Millosheviqit është një shembull i mirë i retorikës konstituive, fjalim që mund t’i japë publikut identifikimin. Ai aty, *inter alia*, deklaroi se Serbia tani ka ndryshuar kushtetutën e saj dhe ka rifituar “krenarinë e saj kombëtare”. Ky ndryshim kushtetues është një lloj dokumenti retorik. Charlandi e përdorë termin “dokument retorik” në lidhje me pavarësinë e Quebecut dhe kushtetutën e tij.⁹⁹

Fjalimi sajoi një identitet serb, duke përmendur kushtetutën serbe dhe duke theksuar ekzistencën e popullit serb në Kosovë, por edhe kudo tjetër në Jugosllavi ku jetonin serbë. Duke përmendur ndryshimin e kushtetutës serbe, aty përshfaqet një oratori politike, e cila Kosovën e trajtoi *de jure* si pjesë e shkrirë në territorin e bashkuar dhe të shenjtë të Serbisë. Në adresim e sipër, Millosheviqi thotë:

“Falë lojës së historisë dhe jetës duket sikur Serbia mu në këtë vit, më 1989, e riktheu shtetin e vet dhe dinjitetin e vet për ta kremtuar ashtu ngjarjen historike nga e kaluara e largët, e cila e kishte një rëndësi të madhe historike dhe simbolike për të ardhmen e saj”.

Shqiptarët, të cilët përbënin shumicën dërmuese prej më shumë se 90 për qind të popullsisë së gjithmbarshme të Kosovës, humbën shumë sa i përket të drejtave njerëzore, politike, sociale dhe kombëtare me rastin e “rivendosjes së statusit të Serbisë” më 1989. E ndryshuar

96 Burke, 1969: 55.

97 Burke 1997: 9.

98 Po aty.

99 Charland 1987: 135.

sa ishte gjallë Tito, Kushtetuta që u njoh gjerësisht si “Kushtetuta e 1974-s” u vlerësua gjerësisht si hap i rëndësishëm progresiv politik për shqiptarët. Ashtu siç është përmendur në kapitujt e mëparshëm të librit, këtij avancimi të statusit i kishin paraprirë disa vjet më parë demonstrata masive në gjithë Kosovën, por edhe në qytete të Maqedonisë dhe Malit të Zi. Këto ngjarje të shënueshme, tok me organizime të tjera të rezistencës edhe në formë ilegaliteti, patën një faturë jo të lirë: pati shqiptarë të vrarë, qindra të burgosur e mijëra të arrestuar e të maltretuar në duart e organeve të rendit.

Kjo rrethanshmëri bëri që fjala “kushtetutë” të shqiptarët të kuptohej si liri e fituar me gjak. Por, gjatë shpërbërjes së Jugosllavisë, fuqizimit të nacionalizmit serb dhe etablimit në skenën politike të Millosheviqit, serbët në mënyrë retroaktive filluan ta perceptonin Kushtetutën e 1974-s si turp kombëtar, dështim politik, e madje edhe tradhti. Me ndryshimet kushtetuese që u diktuan përmes forcës më 1989, Kosovës iu hoq autonomia dhe, si pasojë, shqiptarët u reduktuan në qytetarë të dorës së dytë.

Duke e theksuar me emfazë se “*Serbia më 1989 e riktheu shtetin e vet dhe dinjitetin e vet për ta kremtuar ashtu ngjarjen historike nga e kaluara e largët*”, fjalimi sajoi edhe një popull që kishte frikë për identitetin e vet. Të zhveshur nga të drejtat kolektive, shqiptarët me të drejtë po druhashin se kishin hyrë në atë fazë të skajshme, në një situatë kufitare *Grenzsituation* siç e përdorte Karl Jaspersi, ku do të humbnin shumë në fushën politike dhe kombëtare.

Në këtë mënyrë, fjalimi sajoi popuj të elektrizuar; një popull retorik që pretendonte se ka rifituar statusin e tij, ashtu sikurse edhe një popull tjetër retorik që po e përjetonte ndjenjën asgjësuese të humbjes së statusit të vet. Kjo gjendje, në të cilën përzihehin bashkë frika, pasiguria dhe paniku kolektiv, solli një valë protestash e demonstratash anëmbanë Kosovës duke shprehur kundërshtimin kategorik ndaj ndryshimeve kushtetuese. Më 20 shkurt 1989, në një përpjekje të fundit për të shpëtuar autonominë e krahinës, 1350 minatorë të kombinatit metalurgjik “Trepça” filluan një grevë urie në horizontet e nëndheshme të minierës në Stantërg. Kërkesa e parë që zërua nga grevistët ishte: “*Asnjë tërheqje nga parimet themelore të kushtetutës së 1974*”.¹⁰⁰

Gjatë këtyre protestave, 22 protestues u vranë, shumë të tjerë u arrestuan; aty pati të dënuar edhe me nga 20 vjet burg për të

100 Judah 2002: 55.

ashtuquajturin “krim politik”. “Për ta bërë gjithçka të ligjshme, Kuvendi i Kosovës duhej ta votonte, në fakt ta mbështeste politikën e Millosheviqit, dhe të miratonte ndryshimet e nevojshme kushtetuese ... Më 23 mars, Kuvendi i Kosovës, i rrethuar nga tanke dhe forca policore, votoi për ndryshimet kushtetuese”¹⁰¹. Kjo është arsyeja pse ky ndryshim kushtetues njihet si “Kushtetuta e tankeve”.

Pikërisht, fjalët “status” dhe “kushtetutë” sajuan një popull retorik serb, i cili u bë i bindur dhe konotoi elemente krijuese të identitetit; ndërsa, nga ana tjetër, po këto dy fjalë ndërtuan një popull që ndjehej i kërcënuar nga ndryshimi i kushtetutës. Pasoja e menjëhershme ishte se adresimi i mbajtur në Gazimestan solli dy situata të kundërta: populli serb që pretendonte se kishte rifituar identitetin, dhe populli shqiptar që e humbi identitetin e vet. Duke theksuar se Serbia *“ka rivendosur statusin e saj dhe ka rifituar dinjitetin e saj”*, fjalimi, në fakt, u drejtohet dy popujve, por në mënyra të ndryshme. Për popullin shqiptar, fjalimi ndërtoi një popull pa të ardhme, i cili përmbante elemente shkatërruese të identitetit; ndërsa për popullin serb, kjo ishte një shenjë optimiste për të ardhmen e tyre. Që të kesh mundësi ta bindësh, së pari publiku duhet të identifikohet me një identitet dhe ideologji tjetër, vë në dukje Charlandi. Dhe këtë identitet tjetër Millosheviqi e gjeti tek “statusi” dhe ndryshimet “kushtetuese”.¹⁰²

“Statusi” dhe “kushtetuta” sajuan popuj të grupuar sipas interesave kombëtare. Fjalët kanë domethënie plotësuese duke përshkruar dy qëllime të kundërta politike. Dy fjalët e sipërme, të thëna e stërthëna nga Millosheviqi, kuptohen ndryshe-ndryshe në varësi të përkatësisë kombëtare. Po të paraqiteshin sipas një grafikoni, ato do të dukeshin kështu:

101 Judah, Tim 2002: 55-56.

102 Po aty.

Tabela 2

Ndryshimi i kushtetutës në vitin 1989



Për serbët	Për shqiptarët
Liri	Humbje e lirisë/robëri
Guxim	Frikë
Krenari	Poshtërim
Serbia e madhe	Kosova e vogël
Pasuri	Varfëri
Ardhmëri	Prapakthim
Identitet krijues	Identitet shkatërrues

Ky ligjërim që, përmes fuqisë politike, fitoi statusin e rrëfimit unik rezononte kështu: kombi serb nuk mund të ekzistojë pa shtetin e tij nacional e homogjen. Ekzistenca dhe e ardhmja e shtetit serb bazohet në ndryshimin e kushtetutës serbe. Nëse kushtetuta ndryshohet, kombi serb do të jetë më i sigurt; nëse kjo nuk ndodh, kombi serb do të dobësohet. Kjo është pjesë e funksionit ontologjik të retorikës, e cila krijon një subjekt të ri politik. Armiqtë që ishin kundër serbëve shpesh lidheshin me këtë kushtetutë. Të gjithë ata që ishin mjaft të guximshëm për të vepruar, ose që kishin folur kundër kësaj kushtetute, u cilësuan si irredentistë, nacionalistë, terroristë, shovinistë dhe separatistë. Ata shiheshin si armiq të Serbisë.

6.10. Demonizimi i “tjetrit”

Historia është një element i rëndësishëm në fjalimet publike. Shkrirja e së kaluarës kulturore, fetare dhe kombëtare me të tashmen dhe të ardhmen, mund të krijojë një ndikim të fortë tek publiku. Në fjalimin e vet retorik, Millosheviqi flet serbisht dhe njeh kodet e shoqërisë së tij, mentalitetin dhe qëndrimet e saj. Me këtë oratori, ai shkrihet e bëhet një me masat popullore.

Duke përdorur përemrat vetorë e pronorë si “ne”, “tonat” dhe “e jona”, fjalimi mundëson një identifikim me publikun. Sidoqoftë, Charlandi thotë se publiku nuk ekziston i pavarur nga retorika, porse ai konstituohet përmes retorikës.

Fjalët kyçe “Serbia” dhe “dinjiteti” në këtë fjalim mbartin një domethënie të madhe dhe marrin shumë kuptime. Nëse evokohet fryma e agjitur e vitit 1989, fjala “dinjitet” asokohe kishte kuptimin e ekzistencës, duke pasur edhe nuanca nacionaliste dhe ideologjike. Përmes retorikës konstituive, fjalimi në Gazimestan ndërtoi një popull me “vlera të mëdha”, domethënë popull me rëndësi të madhe; njëkohësisht edhe një popull “të pa vlerë”, pa ndonjë domethënie të madhe. Nuk ishte rastësi që fill pas atij fjalimi pati edhe gazetarë që filluan t’i përshkruanin shqiptarët si “njerëz me bisht”.



Gazimestan, Millosheviqi duke iu drejtuar të pranishmëve¹⁰³.

Ndër mesazhet që fjalimi e shpërvjel është se Serbia nuk paskësh qenë shtet me dinjitet nën Jugosllavinë e Titos.

Tek publiku marrës u rrënjos bindja se deri asokohe serbët ishin pa identitet kombëtar dhe politik, por vetëm pasi ndryshuan kushtetutën e Serbisë, ata e vunë nderin në vend. “Ne kemi rifituar dinjitetin përsëri”, pohon Millosheviqi.

103 Foto: Epa Rade Preliq, Ras Srbija

Profesori dhe intelektual serb, Aleksandar Molnar thotë se me rastin e ndryshimeve kushtetuese, që kaluan më 28 mars 1989, dy krahinat humbën të drejtën për të ndikuar dhe për të vënë veton mbi ndryshimet kushtetuese në Serbi.¹⁰⁴ Sipas tij, ndryshimi kushtetues tregon se “populli... ekziston në retorikë dhe jo në një lloj historie neutrale”.¹⁰⁵ Kushtetuta është “një subjekt kolektiv” dhe ajo është “efekti i parë ideologjik i retorikës konstituive”.¹⁰⁶

Rrëfimi mbi periudhën e lulëzimit serb mbështet teorinë e Charlandit për rolin e mitologjisë si krijuese e identitetit fiktiv. Vetë fjalimi përmban rrëfimtari kombëtare dhe kjo flet shumë për vazhdimësinë e kombit serb:

“Në kohën që ngjau kjo betejë e famshme historike në Kosovë, njerëzit shikimin e kishin drejtuar tek yjet duke pritur ndihmë nga ato. Sot, pas gjashtë shekujsh, përsëri shikimin e kanë drejtuar tek yjet, në pritje që t’i pushtojnë. Herën e parë ata mund t’ia lejonin vetes jounitetin, urrejtjen, tradhtinë, sepse jetonin në botë më të vogla, me lidhje të dobëta midis tyre. Sot, si banorë të planetit, të përçarë, nuk mund ta pushtojnë as planetin e vet, e aq më pak planetët e tjerë, nëse nuk do të jenë të bashkuar dhe solidarë me njëri-tjetrin. Për këtë arsye ndoshta askund në truallin e atdheut tonë nuk kanë aq shumë kuptim fjalët kushtuar unitetit, solidaritetit dhe bashkëpunimit midis njerëzve sa kanë kuptim këtu, në Fushë të Kosovës, e cila është simbol i përçarjes dhe i tradhtisë”.

Lufta nacionalçlirimtare, simbolet dhe sloganet e Jugosllavisë së pasluftës u nyjëtuan me osmanët, të cilët sipas këtij versioni sikur reduktohen rreth figurës së sulltan Muratit I. Sipas fjalimit, të gjithë ata janë papërgjashimisht armiq të Serbisë, paçka se diskursi retorik sajton një publik që do të bëjë gjithçka që është në fuqinë e vet për të hedhur Jugosllavinë e pasluftës në koshin e historisë.

Kështu, viti 1989 merr përmasën e një epoke të re për misionin serb. Po sipas fjalimit, serbët në këtë vit kthese janë sërish një dhe, si rezultat i këtij bashkimi, ata e kanë rikonsoliduar statusin e tyre. Serbia e rilindur tani ka Millosheviqin, këtë “Car Llazar” të ri, sipas sugjestionimit retorik. Po kështu, nënteksti tjetër është se Serbia tani ka mbledhur mend për të mos u sakrifikuar për të tjerët, por vetëm për veten e saj.

104 Molnar 2006: 6.

105 Charland 1987: 138.

106 Charland 1987: 139.

Tabela e mëposhtme mund të ilustrojë më konkretisht se si fjalimi i 1989-s i jep rëndësi vendimtare mitologjisë.

Tabela 3

Viti 1989

Shkaku	Efekti
Luftë	Krenaria serbe
Milloshieviqi	Cari i ri serb
Uniteti/Pajtimi	Rikthim i statusit
Ndryshimet kushtetuese	Kosova e rifituar
Bashkimi i Serbisë	Identiteti i rilindur

Vetë fjalimi përfaqëson diçka origjinale “serbe”. Shqiptarët në Kosovë dëshirojnë pavarësi nga Serbia, dhe ndryshimi kushtetues në sistemin politik serb është një faktor i rëndësishëm legjitimues në konstituimin e një populli të unifikuar; kështu ai kthehet në një gur miliar në krijimin e identitetit serb.

Duke e situar tekstualisht fjalimin e Gazimestanit rezulton se ai e vë me ngulm theksin te ekzistenca e gjatë e kombit serb. Është kjo periudha kur Serbia gjakon të jetë shtet “unitar” me Kosovën si “zemra” e saj. Millosheviqi vazhdon më tutje:

“Aq më parë që serbët në tërë historinë e vet kurrë nuk i kanë pushtuar dhe eksploatuar të tjerët. Qenia e tyre nacionale dhe historike nëpër gjithë historinë dhe në dy luftërat botërore, ashtu si edhe sot, është – çlirimtare. Gjithmonë e kanë çliruar veten dhe, kur e kanë pasur mundësinë, i kanë ndihmuar edhe të tjerët që të çlirohen. Ndërsa fakti që ata janë në këto hapësira një popull i madh, nuk është kurrfarë mëkati serb, as turp. Kjo është një përparësi, të cilën ata nuk e kanë përdorur kundër të tjerëve. Por, më duhet ta them këtu, në këtë fushë të madhe, legjendare, të Kosovës, se serbët atë përparësi të të qenit një popull i madh nuk e kanë shfrytëzuar kurrë as për veten e tyre”.

Me referime të vazhdueshme në kushtetutën e kopsitur me ndryshimet e reja, shihet se fjalimi konstituon një publik serb të homogjenizuar. Përtej kësaj, serbët, ashtu sikurse kombet e tjera, duhet t’i besojnë udhëheqësit të tyre. Arsyeja e kësaj, siç sugjeron teksti retorik, është se tani serbët kanë një kushtetutë, një shtet dhe një udhëheqës. Pra, folësi sendërtton një publik të përshkuar nga uniteti.

Që të ilustruhet kjo, është tejte dobisjellëse të përdoret sërish analiza e fjalëve të veçanta ashtu që të ndriçohet ndërtimi i publikut nga fjalimi retorik. Nuk është rastësi që Millosheviqi ngulmon me dëshirën e tij që të theksojë se Kosova është “legjendare” për serbët. Me teorizimet e përmendura në kapitujt paraprakë, edhe këtu rezulton se “Kosova” dhe “Serbia” janë *terma* *Zoti*, ndërsa kategoria e të tjerëve është me *terma* *djalli*. I gjithë fjalimi ka si bosht rrëfimin nacional serb. McGee shprehet se “Mitet politike teknikisht nuk mund të përfaqësojnë asgjë tjetër përveçse një ‘vetëdije të rreme’, por megjithatë ato janë funksionalisht reale dhe të rëndësishme”.¹⁰⁷

6.11. Shkrirja e mitit dhe historisë

Kësodore, mitet politike në fjalim janë funksionale dhe të rëndësishme, sepse ato krijojnë një lidhje midis të kaluarës dhe të tashmes. Vetëm kështu fjalimi sjell në jetë një publik që nuk është në gjendje të vërejë ndryshimin midis botës reale dhe asaj mitologjike.

Derisa shprehjet retorike të Millosheviqit priren të konstituojnë një identitet të ri serb në Kosovë, argumentet e tij konfirmojnë se në “*Kosovën legjendare*” ekziston një popull unik serb midis kombeve të tjera në Ballkan. Përtej kësaj, ai ngre në fjalim edhe një pyetje retorike¹⁰⁸.

Qëllimi i tij është që të pozicionojë publikun drejtë veprimeve mitologjike, historike, fetare dhe politike, diçka që është karakteristikë e veçantë e retorikës konstituive. Përdorimi i një game argumentesh të ndryshme bëhet me qëllimin e arritjes së efektit më të madh të mundshëm te publiku i tij.

Preokupimi kryesor i publicitetit dhe propagandës është tërheqja e vëmendjes së një publiku indiferent; ky është kushti i domosdoshëm për të kryer çdo lloj argumenti. Kjo është pseja e Millosheviqit kur këlthet: “*Me çfarë do të dalim para Milloshtit?*”

Ajo çka manifestohet në Gazimestan është një shkrirje e mitikes dhe historisë me aktualitetet e sotme. Ky rreng retorik mund të krijojë emocione të forta në publik. Përdorimi i patosit është i dukshëm. Ideja që shfaqet e rishfaqet kudo në fjalim është se serbët janë populli i zgjedhur i Zotit. Duke e theksuar me patos pyetjen retorike “*Me çfarë do të dalim para Milloshtit?*”, fjalimi shkrin brenda një tërësie mitologjinë, faktet dhe gjysmë të vërtetat.

¹⁰⁷ McGee 1975: 245.

¹⁰⁸ Diçka që thuhet në trajtën e një pyetjeje, e cila e ka vetë përgjigjen brenda.

I ndërtuar me intencën për të apeluar në emocione, fjalimi shpalos besimin se serbët në Jugosllavi më parë preferojnë të zgjedhin “mbretërinë e qiellit” sesa të jetojnë me turp. Sipas krijimeve mitike që qarkulluan brenda serbo-sferës, “Car” Llazari zgjodhi vdekjen, ngaqë nuk e donte një jetë me turp nën osmanët. Sa kohë ky version i thjeshtëzuar i historisë përqafohej gjerësisht në opinion, askush nuk pozonte pyetje që do ta vinin në pikëpyetje atë; fjala vjen, vetë Stefan Llazareviqi u bë subjekt varës i osmanëve, duke luftuar për sulltanin. Ky vasalitet do të vijohej edhe nga pasrendësi i tij, Gjuragj Brankoviqi. Por, “car” Llazari në përfytyrimin serb zuri vend si martir, si figurë e Krishtit, që e dinte se do të vdiste për kryqin dhe lirinë.¹⁰⁹ Sipas miteve që gëluan vazhdimisht, një natë para betejës Llazari pyetet nga Perëndia nëse do të zgjedhë midis mbretërisë tokësore dhe asaj qiellore. Por, “cari” serb bën zgjedhjen e parë, përcaktimin qiellor, e shkon drejt vdekjes.

Në raportin e vënë me publikun, fjalimi sajoi një popull që edhe sot është i vendosur të mos jetojë në një Serbi të dobët, si ajo që ekzistonte para se Millosheviqi të ngjitej në pushtet. Serbia, e cila ekzistonte para kësaj kohe, është veçse një sinonim për Perandorinë Osmane.

Në një rast të këtillë, McGee do të thoshte se ky është një mit politik ose trillim retorik. Bashkë me të u krijua edhe një popull që besonte në vendosmërinë e vet, madje edhe për të hyrë në luftë për mbrojtjen e interesave kombëtare. Thjesht, një publik që do të vdesë për Serbinë e Madhe!

Qartësisht duket se fjalët e Millosheviqit krijojnë kuptim dhe përfundojnë me kuptim. Ato përftojnë iluzione kolektive duke ndikuar në mendimet, vendimet dhe veprimet e individëve. Monologu oratorik me këta individë përbën një shpresë për strategjinë e Millosheviqit; kjo sepse mu përmes tyre ai synon të arrijë qëllimin e vet politik. Kjeldsen thotë se një “publik retorik përbëhet ekskluzivisht nga persona që mund të ndikohen nga retorika e dërguesit, dhe të cilët mund të kontribuojnë në ndërmjetësimin e ndryshimeve”.¹¹⁰

[Duke folur mbi mitin e shpalosur në Gazimestan, historiani anglez Noel Malcolm përmend se Beteja e Kosovës është pjesë e rëndësishme e mitit mbizotërues kombëtar serb për serbët si “popull qiellor”.¹¹¹ Po sipas këtij autori, ishin shumë elementë të ndryshëm si poezia epike, shkrimet e historisë dhe kisha që e bënë Kosovën të zhvillohej në

109 Mønnesland 1999: 94.

110 Kjeldsen 2004: 34.

111 Malcolm 2001: 82.

statusin e simbolit kombëtar serb. Pikërisht mbi këtë çështje, Malcolm vlerëson se ideologjia nacionale serbe ishte më e shqetësuar për pushtimin dhe mbajtjen e Kosovës nën kontrollin e saj.¹¹²

Ai e paraqet “unitetin” për kombin serb si dritë në fund të tunelit. Të gjitha këto konsiderata nuk lënë shteg për dyshim se publiku u sajua retorikisht mbi themelet e mitologjisë. Gjatë periudhës osmane, kur Patriarkana e Pejës dhe mileti serb gëzonin pozita të privileguara, qarqet kishtarë, shkrimtarët dhe rapsodët ndihmuan në krijimin dhe mirëmbajtjen e mitit të Kosovës dhe ndërftjen e tij në vetëdijen e popullatës së gjerë. Një nga mbledhësit më të njohur të folklorit të sllavëve të jugut, Vuk Karaxhiq, u përpoq të mblidhte këngë me motive të tilla.¹¹³ Megjithëkëtë, ai nuk arriti të gjente “*stare pesme*” (këngë të vjetra), ndaj iu kthye konceptit për fabrikimin e epit kombëtar.¹¹⁴

6.12. Roli i liderit të kombit

Nëpër fjalim endet sugjerimi se Serbia bashkëkohore ka vazhdimësi tragjike me të kaluarën, ashtu që kjo i jep mbështetje kërkesës politike për të ripushtuar Kosovën. Millosheviqi përdor në mënyrë të stërholluar të njëjtat argumente dhe strategji oratorike si Adolf Hitleri.

Është fakt i njohur tashmë se udhëheqësi nazist i Gjermanisë në fjalimet e tij, prej 1933-s e tutje, përdori të kaluarën mitologjike, fenë dhe historinë si argumente për të ndikuar te populli gjerman. Sipas Hitlerit dhe eksponentëve të NSDAP-it (akronim për *Nazional Sozialistische Deutsche Arbeiter Partei*), Gjermania u trajtua padrejtësisht pas Luftës së Parë Botërore, me dëmshpërblimet e luftës dhe me territoret që iu privuan. Hitleri synonte që vendi i tij të shkëputej nga marrëveshja e Versajës. Gjermania e këtyre viteve përballej me papunësi të lartë, krizë ekonomike dhe politike. Gjatë Luftës së Parë Botërore, shumica e gjermanëve humbën besimin të udhëheqësit e tyre, ata kishin nevojë për diçka të re për të besuar, dhe kështu nazizmi u bë për shumicën gjermane besim për një fillim të ri. Në këtë mënyrë, nacional-socialistët fituan mbështetje të madhe brenda një kohe të shkurtër.

Ashtu sikurse Hitleri, edhe Millosheviqi përdori mitologjinë dhe historinë për të ndikuar në publikun e tij. Dhe ky pasus është shembulli

¹¹² Malcolm 2001: 82-83.

¹¹³ Po aty.

¹¹⁴ Enver Mehmeti, Morfologjia e mitit serb të Kosovës në <https://www.radiokosovaelire.com/prof-dr-enver-mehmeti-morfologjia-e-mitit-serb-te-kosoves/> (qasur për here të fundit 17 janar 2022).

më i kulluar i kësaj orvatje: “Në këtë vend në zemër të Serbisë, në Fushën e Kosovës, para gjashtë shekujsh, para plot 600 vjetëve ka ndodhur një nga betejat më të mëdha të asaj kohe. Si të gjitha ngjarjet e mëdha edhe atë e përcjellin shumë pikëpyetje dhe sekrete; ajo është objekt i hulumtimeve shkencore të pandërprera dhe i kërkimit të zakonshme popullorë”.

Një element tjetër i rëndësishëm është mënyra si e përdor fjalën “lider”. Millosheviqi kritikon, denoncon dhe akuzon udhëheqësit e tjerë serbë për “jounitet”. Për ta thotë se “nuk kanë qenë besnikë ndaj Serbisë” sa i përket betejës për çështjen serbe.



Ikonat dhe simbolet në fjalimin e Gazimestanit¹¹⁵

Rrjedhimisht, sugjerimi është se ata nuk janë liderë të mirë dhe as udhëheqës kolosalë. Prandaj, populli serb ka nevojë për një lider të ri: një udhëheqës që di dhe mund të konkretizojë atë që e do i gjithë kombi. McGee, duke folur për Hitlerin, shtjellon sesi në proceset retorike një lider (i kuptuar si udhëheqës i mirë) mund të shndërrojë individët në “popull”.

Ai vë re se vizioni i Hitlerit nuk përqendrohet vetëm në një publik e në një kohë të caktuar, por në një komb të tërë dhe një hark kohor prej shumë shekujsh.¹¹⁶ Nëpërmjet emfazimit të liderit, publiku sugjestionohet me idenë se kombi ka vetëm individë, por jo edhe një lider për së mbari. Me këtë rast, silogjizmi retorik që pason është kjo që arsyeya pse Serbia u katandis kaq e varfër dhe pa identitet kolektiv. Prandaj nuk është rastësi pse lideri serb zgjodhi të kthehej 600 vjet

115 TVSerbia.

116 McGee 1975: 240.

prapa në historinë e kombit. Sipas shtjellimeve të autorit McGee, njerëzit mendojnë dhe veprojnë ndryshe si një bashkësi e ndryshe si individë të pavarur. Populli rrumbullakon një ekzistencë objektive kur njerëzit pranojnë mitet dhe vazhdojnë të veprojnë brenda tyre.

Megjithëkëtë, ky realitet është edhe mitik. Fundja, populli është i varur nga një lider ashtu që të krijojë një identitet kolektiv apo grupor.

Ashtu sikurse Adolf Hitleri që donte që Gjermania t'i kishte duart e lira nga Traktati i Versajës, edhe Millosheviqi këmbëngulte që Serbia të lirohej nga kushtetuta e vitit 1974. Që të dy papërfundimisht instrumentalizuan historinë e mitologjinë në shërbim të projektit madhor nacionalist. Në të dyja rastet, publiku retorik e gjeti liderin që do të vinte në vend “nderin e humbur”.

Millosheviqi shtyn përpara bindjen se ndarja e Kosovës nga Serbia është kërcënuese, jo e përshtatshme dhe e pamundur. Fjalimi i tij retorik u bë pikë fokale për ruajtjen dhe ringritjen e identitetit, ashtu sikurse edhe për të pasur një referencë në historinë e shtetit nacional. Qëllimi, pra, është sendërtimi i një publiku, i cili e rilind konstituivën e identitetit kolektiv serb. Sipas Millosheviqit, ky është bazamenti që Kosova, natyrshëm dhe domosdoshëm, duhet t'i përkasë Serbisë. Pra, fjalimi në Gazimestan u përdor për qëllime politike dhe jo për ngjarje kulturore.

Fjalimi përshkruan një histori, e cila theksin e vë te padrejtësitë e supozuara në rrjedhën e ngjarjeve të së kaluarës dhe të së tashmes. Mesazhi që lideri u jep serbëve ishte se ata dikur ishin hem viktima, hem heronj, por që megjithatë u shpagan sepse tani kombi serb u bë sërish madhështor dhe krenar!

Qenia njerëzore në kapacitetin e masës sillet, vepron e beson krejt ndryshe prej asaj që ndodhet në izolim. Ngjarja e Gazimestanit, që ngre në nivel të paparë memorien për të ashtuquajturën epokë madhështore të lulëzimit serb, shënon një pikë kthese në terma retorikë.

Gjatë gjithë kohës, fjalimmbajtësi thekson rolin e popullit si krijues i historisë, por edhe rolin udhëheqës dhe organizues të partisë si një organizëm i gjallë.

Në këtë fjalim vërehet se audiencës i është përbrendësuar besimi se “kushtetuta e vjetër” është kancer në shoqërinë serbe. McGee thekson se lideri është vazhdimisht në kërkim të historisë së kombit “me një ndjeshmëri të vazhdueshme ndaj karakterit të ‘popullit’ që e ekzekutoi atë”.¹¹⁷

117 McGee 1975: 240.

Milloseviqi bëri bash të njëjtën gjë në Gazimestan, duke i rikujtuar popullit se Kosova është “Mynihu” ose “Meka” për Serbinë.

Në fjalimin e mbajtur në një cep të fushës ku supozohet se u zhvillua beteja e njohur kundër ushtrisë osmane, Milloseviqi përdori edhe simbolet e mitit për Kosovën. Ai theksoi me këtë rast se: *“Jouniteti dhe tradhtia në Kosovë do ta përcjellë edhe më tej popullin serb si një kob i zi nëpër gjithë historinë e tij. Madje edhe në luftën e fundit, kjo mungesë e unitetit dhe e tradhtisë e çoi popullin serb dhe Serbinë në agoni ...”*.

Si antidot ndaj kësaj e për të ndërtuar një Serbi të re, Milloseviqi kërkon prej popullit të tij sakrificë, hakmarrje dhe guxim. Duke analizuar nuancat e tij gjuhësore, ka shumë të ngjarë që të qëllojë në shenjë vlerësimi i autorëve Perelman dhe Olbrechts-Tyteca, sipas të cilëve fjalimi mendon pak-a-shumë me vetëdije për publikun.¹¹⁸

Mbi të gjitha, fjalimi synon që bindjen e publikut ta arrijë nëpërmjet përdorimit të përbërësve mitologjikë. Serbët janë brumosur me këngë heroike e kalorësiake. Dhe të tilla krijime nuk protagonizojnë njerëz me zemër të mirë; përkundrazi, ato glorifikojnë gjindje hakmarrës, të guximshëm, të pamëshirshëm, të dhunshëm dhe e psikologjikisht të ndërlikuar.

6.13. “Mesjeta e gjallë”

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, feja dhe mitet u përdorën mjeshtërisht nga Hitleri si mjete ndikuese politike, por edhe si identifikim. Edhe për Milloseviqin njësoj, miti dhe feja konvertohen në përbërës të rëndësishëm ndikimi për mobilizim kombëtar dhe për ndërtimin e publikut.

Feja dhe miti bëhen kushte për ekzistencën e vazhdueshme të popullit serb në Kosovë. Po kështu, përdorimi i Kosovës si simbol në disa raste mund të interpretohet si strategji dhe politikë për të legjitimuar kërkesën e vazhdueshme për ta kontrolluar dhe zotëruar Kosovën.

¹¹⁸ Perelman and Olbrechts-Tyteca, 1958: 19.



TVS: Ikonat serbe dhe serbët duke vërsuar për ta dëgjuar Millosheviqin

Për ta shpënë përpara ideologjinë e tij, Millosheviqi përdori gjerësisht e me shumë sukses simbolet.¹¹⁹ Simbolet gjithërë kanë një përmbajtje. Ato janë të përcaktuara nga ana kulturore dhe mesazhi i tyre kuptohet dhe pranohet në mënyra ndryshe-ndryshe. Le të shërbehemi me një shembull: nëse flamuri serb dhe mbreti serb Karagjorgjeviq kishin domethënie historike pozitive për serbët dhe ofronin një lidhje të ngushtë emocionale, po këto simbole për shqiptarët ishin një kujtesë për vrasjet, gjenocidin, zjarret, shkatërrimet, vdekjet dhe lotët.

I rëndësishëm për t'u theksuar është edhe vlerësimi tejet i saktë se fjalimi sendërton një popull me mentalitet kolektiv ku nocionet "luftë", "betejë" dhe, veçanërisht, "vdekja", nuk konsiderohen humbje njerëzore. Përkundrazi, "vdekja" për atdheun konsiderohet si triumf, vlerë dhe si veprim patriotik.

Rada Trajkoviç, kryetare e Asamblesë Kombëtare Serbe në Kosovë, me rastin e një debati në radio më 21 gusht 2006, theksoi: "*Vetëm vdekja e Car Lllazarit është ajo që mohon që disa vdekje mund të kenë vlerë të madhe. Arsyeja për këtë është se kjo vdekje sot ka një efekt të gjatë dhe të fortë*".¹²⁰

Lideri populist asokohe përdorte me të madhe religjionin, simbole të caktuara, kode dhe ikona nga kultura serbe, me qëllim që ndikimi mbi popullatën të ishte sa më i madh. Po u shkoqit kjo metodë e fjalimmbajtësit në fraza e pohime, atëherë bëhet edhe më e qartë

¹¹⁹ Simboli personifikon në vetvete me forcën më të madhe tiparet më karakteristike të ndonjë fenomeni, personifikon idenë e tij vendimtare.

¹²⁰ Përkthimi është bërë nga autori i librit.

se ai apelonte emocionalisht dhe amplifikonte edhe më psikozën e polarizimit. Të tilla janë frazimet e tij kur betejën mesjetare e interpreton si mbrojtje edhe të Evropës (“*Para gjashtë shekujsh Serbia këtu, në Fushën e Kosovës, e ka mbrojtur veten. Por e ka mbrojtur edhe Evropën. Ajo asokohe gjendej në bedenat e saj që e mbronin kulturën evropiane, religjionin, shoqërinë evropiane në tërësi.*”), se evropianët janë si ca borxhlinj (“*Sot duket jo vetëm e padrejtë, por edhe johistorike dhe krejtësisht absurde të flitet për përkatësinë e Serbisë në Evropë*”) dhe të gjitha këto i japin asaj moralisht të drejtë për gjithçka (“*Ajo është në të pandërprerë, sot si edhe dikur. Kuptohet, në mënyrën e vet*”).

Për të ndërtuar dhe për t'i dhënë një identitet publikut të adresuar, retorika konstituive e folësit është thelbësore. Duke folur për Serbinë dhe historinë serbe, Millosheviqi pretendon në mënyrë tacite ekzistencën e një “*subjekti kolektiv, protagonist i dramës historike, i cili përjeton, vuan dhe vepron*”.¹²¹ Kështu, ai krijon homogjenizimin, një komb me vlera të mëdha dhe një shtet të bashkuar.

Tipar thelbësor i fjalimit të Millosheviqit është lidhja e pandashme midis mitologjisë, fesë dhe politikës. Qysh në fillim ngre krye një frymë ekstremizmi fetar. Kufiri mes fesë, mitologjisë dhe identitetit kombëtar janë të padukshëm në rastin serb. Në oratorinë e tij, feja nuk konsiderohet si vlerë kulturore. Ai përdori nuanca nacionaliste që theksojnë ndjenjat nacionaliste, por duke cituar e duke u shërbyer me shprehje nga mitologjia dhe feja.



Feja dhe politika në Gazimestan (TV Serbia)

121 Charland 1987: 139.

6.14. “Kryqi dhe gjysmëhëna”

Siç u bë e njohur nga kampionët e nxjerrë për analizë, fjala “bastion” mbart një domethënie të madhe, pa lënë anash as kuptimin e fortë figurativ. Kjo fjalë konoton një fortesë të madhe që përdoret për të qëlluar dhe për ta dëbuar armikun. Në vitin 1989, gjashtëqind vjet më vonë, Millosheviqi e gjeti kohën për të rizbuluar këtë betejë historike. Kryqi serb humbi nga gjysmëhëna osmane. Duke mos përmendur askund kontributin e kontingjenteve shqiptare që patën një hise të madhe në rropatjen për të frenuar invazionin osman, Millosheviqi dëshiron t’i japë popullit serb atributin e heroit të pavdekshëm.

Sipas interpretimit të tij, beteja nuk qe vetëm një humbje e radhës për serbët, por një dështim e turp për krejt evropianët. Me këtë rezonim krijohet bindja që Evropa duhet t’i kuptojë serbët dhe borxhin e vetër ta shlyejë me ndihmë kundër feve të tjera, por duke targetuar veçmas kulturën shqiptare në Kosovë e duke e identifikuar atë *a priori* si islamike. Prandaj, fjalimmbajtësi në Gazimestan lë të nënkuptohet nga publiku se serbët ishin meritoret kryesorë që civilizimi evropian u ruajt. Shi për këtë, ai thotë:

“Para gjashtë shekujve Serbia, këtu, në fushën e Kosovës e ka mbrojtur veten. Por e ka mbrojtur edhe Evropën. Ajo ... e mbronte kulturën, religjionin, dhe shoqërinë evropiane në përgjithësi”.

Sugjerimi që përftohet nga kjo është se serbët u bënë kurban për lirinë e mirëqenien e kontinentit, e po kështu historia po përsëritet ciklikisht. Serbët janë popull tragjik, gjithnjë sipas vizionit retorik, prandaj edhe sot ata janë si bastion dhe mur i gjallë midis botës së krishterë dhe asaj islamike. Tek publiku krijohet sakaq bindja se ishin vetë serbët ata që sprapsën marshin e sulltanit që deshi ta bënte Evropën “tokë myslimane” që në vitin 1389.

Fillimisht, lideri me gjashtë heq dorë nga individualiteti i tij për “të mirën” e publikut të tij. Andaj, edhe Millosheviqi i përshtat bindjet dhe mendimet e tij me vizionin që “populli” në krijim e sipër dëshiron ta dëgjojë.

Më tej, populli mund të bëhet i vërtetë përmes bindjes dhe sjelljes së vet, por në instancë të fundit si realitet ai është veçse një iluzion masiv. Në çastin kur populli nuk e pranon më mitin, ai bëhet përsëri vetëm një bashkësi individësh.¹²² E bash atëherë kërkohet një retorikë e re, një mitologji e re, për të rimbledhur popullin dhe për të shmangur kështu një krizë. Prandaj, as “populli” nuk është fenomen konstant, por një proces që ndryshon me kalimin e kohës.¹²³

122 McGee, 1975: 243.

123 Po aty, 244.

Fjalimi retorik i Millosheviqit vjen dora-dorës duke e përforcuar idenë se Serbia ka të drejtë historike dhe morale ndaj Kosovës. Territori i saj u paraqit si një “Jerusalem” serb. Dhe siç e dramatizon emocionalisht fjalimi, në Kosovë është derdhur “gjak serb”. Kësaj i shtohet edhe një mëlmesë ekskluzivizmi edhe nga “shkenca”: Kosova është vend i shenjtë edhe për gjenin serb (ADN). Për Millosheviqin, kjo është një tjetër arsyeje pse Kosova duhet dhe do të jetë gjithmonë serbe.



Ikona fetare në Gazimestan (RTV Serbia)

Në një vend, Burke shpjegon se tufat e fjalëve, të cilat syri i vëmendshëm i kritikut i zbulon në fjalim, zakonisht janë të panjohura për oratorin, bile ai vetë as që është i vetëdijshëm për to.¹²⁴

Si për nazistët ashtu edhe për Millosheviqin, fjalimi me përbërës fetarë ishte pjesë e rëndësishme e komunikimit retorik. Po ashtu Millosheviqi nuk ka drejtpeshim politik në fjalimin e tij. Këtë përpiqet ta bëjë vetëm drejt fundit të fjalimit. Ai as që është i vetëdijshëm se fjalët simbol në fjalimin e tij zbulojnë botëvështrimin e tij nacionalist.

Retorika e Hitlerit prodhoi një publik nazist që i solli botës një

124 Burke 1941: 20: “...he cannot possibly be conscious”.

humbje prej rreth 55 milion njerëzve, ndërsa retorika e Millosheviqit prodhoi një publik nacionalist serb që i solli kombeve në ish-Jugosllavi një kosto të paimagjinueshme humbjesh prej rreth 400 mijë njerëzish.

6.15. Katër “S”-të

Një element i rëndësishëm në sendërtimin e publikut është edhe skena gjigande e krijuar veçanërisht për këtë ngjarje. Në prapavijën kolosale të podiumit ishin ngritur katër shkronja të mëdha cirilike “C” (ekuivalenti i “S”), ashtu sikurse edhe dy vitet, 1389 dhe 1989. Të katër “S” janë akronim që qëndrojnë për “Samo Sloga Srbina Spašava” (*Vetëm Bashkimi Shpëton Serbinë*). Përmbajtja ishte ashiqare përjashtuese, kërcënuese dhe frikësuese për shqiptarët. E tillë lexohet edhe për kombet, kulturat dhe fetë e tjera. Tjetra, por jo më pak e rëndësishme, është se katër “S”-të kishin kuptim të dyfishtë hermeneutik, sepse ato shëmbëllenin në njëfarë mënyre edhe svastikën (kryqin) nazist.

Duke deklamuar gjatë fjalimit: *“Le të rrojë përjetësisht kujtimi për heroizmin kosovar! Le të rrojë Serbia! Le të rrojë Jugosllavia!”*, fjalimi krijon ndjesinë sikur Jugosllavia është shtet me themele demokratike. E, megjithatë, tendenca është krijimi i mitit për një botë të së kaluarës ku “popujt ishin të bashkuar dhe të vëllazëruar”.

Më parë u përmend se retorika dëshiron të bëjë *diçka* me publikun; përkatësisht, synimi i saj është ta bëjë publikun që ta pranojë mesazhin, pra t’i bindë pjesëtarët e tij. Me vetë faktin se publiku është në fokus, kjo bën që formulimi i porosisë të ketë domethënie dhe peshë të madhe. Në prapaktim, kjo kushtëzon rrethanën që fjalimmbajtësi (Millosheviqi në këtë rast) dhe qëllimet e tij të kthehen në çështjen kryesore. E kuptueshme një gjë e tillë: fjalimmbajtësi synon të arrijë *diçka* të caktuar tek publiku. Të gjithë popujt dhe kombet kanë rrëfimet e tyre që shërbejnë si themel për krijimin e identitetit. Këto histori tregohen dhe përsëriten shumë herë brenda teksteve historike, si dhe përjetësohen ndër monumente e mite popullore. E veçanta e këtij fjalimi retorik, është se për publikun serb ai u bë pjesë e pavetëdijshme e jetës së përditshme politike dhe kulturore. Retorika e Millosheviqit ishte një tablo ligjëruese e jetës sociale të serbëve. Sloganet e përdorura nga Millosheviqi në fjalimin retorik përbëjnë një fjalim konstituiv, pikëpamje të cilat zbulojnë botëkuptimin e tij nacionalist. Kështu, patetika dhe nacionalizmi janë ato që zënë vendin kryesor në të. Këtu duhet kërkuar pseja e përsëritjes aq të shpeshtë të parullave që veç ishin rrënjësuar në ideologjinë dhe mitologjinë kulturore të serbëve.

Përmes përdorimit të fjalëve “fusha e Kosovës”, “viktimë”, “betejë”, “Car Lllazar”, “luftë” si dhe “unitet”, “jounitet”, e veçanërisht përmendja e dendur e fjalëve “Serbi” dhe “Kosovë”, u sajua një lloj realiteti fiktiv mbi gjuhën, duke i dhënë publikut një lloj ndjenje identiteti që përputhej me gjendjen e gjërave ashtu siç donte ai popull të ishin.

6.16. “Zemra” e Serbisë

Në studimet për retorikën është fakt i ditur kaherë se për të ndikuar në popull bëhet përzgjedhja e fjalëve më të përshtatshme; pra zgjedhja e gjuhës ka për qëllim ndikimin sa më të madh e të efektshëm. Siç është evidentuar përmes shembujve të shumtë në kapitujt paraprakë të librit, shumë fjali në atë fjalim luajnë me elementet e identitetit të nacionalizmit serb. A nuk është një e tillë edhe vetë fjala “Serbia”? Frazologjitë e radhitura në këtë pjesë shërbejnë si shembull tipik i saj: *“Gjithmonë e kanë çliruar veten dhe, kur e kanë pasur mundësinë, i kanë ndihmuar edhe të tjerët që të çlirohen. Ndërsa fakti që ata janë në këto hapësira një popull i madh, nuk është kurrfarë mëkati serb, as turp. Kjo është një përparësi, të cilën ata nuk e kanë përdorur kundër të tjerëve. Por, më duhet ta them këtu, në këtë fushë të madhe, legjendare, të Kosovës, se serbët atë përparësi të të qenit një popull i madh nuk e kanë shfrytëzuar kurrë as për veten e tyre”*.

Përmes formulimit “Ndërsa fakti që ata janë në këto hapësira një popull i madh”, autori kërkon të bindë dëgjuesit se ekziston një identitet serb i përcaktuar biologjikisht; madje identiteti dhe ekzistenca e tij është e lidhur në mënyrë të veçantë me Gazimestanin. Togfjalëshi i përzgjedhur “Kosova është zemra e Serbisë”, me të cilin Millosheviqi i thërret ndërgjegjes së bashkatdhetarëve të tij, në fakt reflekton edhe vetë botëkuptimin e Millosheviqit se kombi serb i ka rrënjët e thella të identitetit të tij në Kosovë. Millosheviqi përmes fjalimit orvatet të zgjidhë një problem të ngutshëm; e ky problem i ngutshëm për të është kthimi i zemrës (Kosovës) në Serbi.

Gjuha e përdorur në shumicën e rasteve luan me kujtesën narrative historike të Serbisë dhe të serbëve si “viktima”. Në shumë nga fjalët e përzgjedhura, kombet e tjera të përfshira paraqiten si tejet negative. Përndryshe, fjalimi politik luan me rrymat nacionaliste të popullin serb. Në këtë pikë Millosheviqi afrohet plotësisht me retorikën e Adolf Hitlerit.

Bota që vjen nga fjalimet e tij është e ndarë në dy taborë: të mirë dhe të këqij. Më të parin janë “tokat ortodokse”, “uniteti serb”, “kushtetuta e re serbe” ashtu siç e mirë është vetëm “ajo që është serbe”. Për

antinomi, tabori tjetër me të "këqij" është thjesht bashkësia e gjithçkaje që nuk është serbe dhe ortodokse. Ato shëmbëlajnë gjithçka të bëjë me armikun, si "territori islamik", "jouniteti" dhe "kushtetuta e vjetër".

Bash për këtë qëllim, ai nënvizon disa herë radhazi mungesën e unitetit midis politikanëve serbë, ashtu sikurse edhe mes vetë popullit serb. Ndjesia që jepet nëpërmjet tij është ajo e një bote të perënduar tashmë (para 1989-s), dhe lindjes së një Serbie që e ka çliruar veten nga diktatura dhe politikanët e saj të pandërgjegjshëm. Dhe vetëm tani, Serbia mund të pretendojë se ka në dorë të drejtat e saj politike dhe nacionale.

Retorika luan edhe me rrengje të tjera, të zëmë edhe atë për madhështinë dhe fuqinë e popullit serb, i cili, sipas fjalimmbajtësit, kurrë nuk e ka shfrytëzuar për të mirën e vet, por vetëm për çlirimin dhe për mbrojtjen e Evropës.

Është interesant se në këtë fjalim shqiptarët nuk përmenden asnjëherë. Por, ai nuk kishte nevojë ta bënte këtë: prej muajsh ai veç kishte realizuar një nga projektet kryesore të tij kundër shqiptarëve, nëpërmjet etablimit të ndryshimeve kushtetuese. Në shtator, Kushtetuta e re serbe tashmë e kishte bërë autonominë e Kosovës si tregim të së kaluarës.

Madje, fjalimmbajtësi kujdeset që retorika e tij të mos jetë armiqësore ndaj Perëndimit; përkundrazi, ai përpiqet të hiqet si politikan i moderuar. Në të vërtetë, fjalimi tregon se Millosheviqi ishte i vetëdijshëm për rolin e tij si udhëheqës i fortë serb e që mund të pyetet për gjithë rajonin. Megjithatë, fjalimi si tërësi ishte veçmas provokues dhe fyes ndaj shqiptarëve, teksa fliste për serbët dhe "zemrën e Serbisë", duke nënkuptuar të tillë Kosovën. Millosheviqit, fundja, aq i bënte për "kulturën serbe" në Kosovë; ai i kishte vënë syrin territorit dhe pasurive natyrore të Kosovës.

Duke shkoqitur këtë aspekt, profesori norvegjez Mønnesland thotë: "Më e rëndësishme se Kosova si djep i kulturës serbe, janë pasuritë natyrore (të Kosovës) dhe rëndësia e saj si territor strategjik. Në Beograd në kohët e fundit ka qarkulluar një plan për ndarjen e Kosovës. Serbia do të mbajë pjesët veriore dhe lindore, të cilat janë të pasura me burime natyrore. Planet ishin që shqiptarët e Kosovës të shtyreshin në jugperëndim, poshtë në drejtim të Shqipërisë. Gjëja më qesharake është se në këtë plan, ai aspak nuk u interesua për monumentet e kulturës që zakonisht përdoren në argumentin për nacionalizmin serb."¹²⁵

125 Svein Mønnesland, profesor i gjuhëve sllave, Universiteti në Oslo. Komment për NRK 7.mars 1998. <http://home.online.no/~dagoj/Kosovo-1.html>.

Nëpërmjet zhbirimit analitik vihet re sa shumë ushtronte ndikim të dukshëm e të padukshëm bindja për një Serbi e komb serb të fortë, duke aluduar në të edhe si të zgjedhur Zoti për të sunduar gjithë Ballkanin. Ai i mëshon gjithnjë një ndjesie që, sipas tij, Serbia për herë të parë prej vitit 1389 është bërë sërish e fuqishme dhe krenare. Duke i siguruar bashkëkombësit, Millosheviqi u bën atyre me dije se asnjë fuqi në botë nuk mund të shkatërrojë serbët, sepse ata, më në fund, janë unikë.

Po kaq qendror mbetet edhe besimi se Kosova është historikisht djepi i Serbisë, dhe se pa të Serbia as që mund ta imagjinojë mbijetesën si shtet modern. Publikut i shërbehet sugjestionimi se serbët tanimë pas krahatah e vuajtjesh kanë një lider që di t'i vë gjërat në vend. I tillë që nuk ka ekzistuar prej 1389-s, ky lider trim është i gatshëm të sakrifikojë gjithçka për kombin e tij.

Duke u përdorur vijimisht e kudo në fjalim fjalët “betejë”, “i madh” dhe “tradhtar”, sugjestionimi tjetër është se serbët duhet të sakrifikojnë veten e tyre pa ngurrim për të drejtat kombëtare.

6.17. “Populli qiellor” gati për luftë

Fjalimi, midis të tjerash, ideon besimin se për serbët të jetuarit në turp është më i rëndë se vdekja. Sipas fjalëve të Millosheviqit, vdekja ose sakrifikimi për vendin është patriotizëm dhe privilegj, sepse Serbia nuk i harron patriotët e saj. Që nga viti 1389, serbët nuk i kanë harruar patriotët që sakrifikuan veten për Serbinë; dhe është një fakt, thotë ai, që ne do ta bëjmë të njëjtën gjë edhe sot. Ai i bie shkurt kësaj: për serbët të qenit tradhtar është një turp i madh, dhe se tradhtari është një trup i vdekur.

Në veçanti, fjala “unitet” ka një ndikim të fortë e pozitiv në fjalim. Është një term Zoti, ashtu sikurse, nga ana tjetër, “jouniteti” është “djalli” që kurrë nuk duhet të gjendet në mesin e popullit dhe të politikanëve serbë.

“Populli”, “uniteti”, “jouniteti” dhe “Kosova” kanë një lidhje të fortë mes vete. Mesazhi i fjalës “unitet” tregon se ai është mjeti i vetëm që është në gjendje të konkretizojë qëllimin e arritjes së të drejtave kombëtare serbe: një Serbi të Madhe me Kosovën në qendër.

Kësisoj, fjalimi i mbajtur në Gazimestan konstituon jo vetëm një publik retorik homogjen por edhe një publik fiktiv që jeton me iluzionin e një rrëfimi që vjen nga mitologjia e jo nga historia si disiplinë shkencore. Nënteksti i tij është ky: serbët janë një super-komb dhe ata kanë një

super-president me fuqi mitologjike. Është publiku serb ai që duhet të zgjedhë problemin e ngutshëm.

Duke e sajuar publikun, i cili beson se për çdo serb Kosova është tokë e shenjtë, fjalimi çimenton domosdonë që secili duhet të jetë në gatishmëri për t'u sakrifikuar për "djepin serb".

Përmes fjalimit, Millosheviqi konstituon një publik që nuk ka frikë nga luftërat dhe kombet e tjera; kësodore serbët nuk duhet të kenë frikë të luftojnë për Serbinë e Madhe. Ishte vetëm kushtetuta e vjetër pengesa që i përzihej ndër këmbë në synimin për Serbinë e përtërirë, e tani që kjo u tejkalua askush nuk i pengon më si heronjtë e trimat e qëmotit. Që t'i jepet fund historisë tragjike, vijon më tej sugjestionimi nga ana e Millosheviqit, populli serb duhet të fitojë pavarësinë, duke bërë që të gjithë serbët në Jugosllavi të jetojnë në një shtet.

Në çdo rast e nga çdo kënd që të shihet, ky fjalim ia doli të krijojë bindjen se serbët ishin viktimat gjatë gjithë kohës dhe se kushtetuta e Jugosllavisë iu kishte ngrënë hakun. Serbëve u kërkohet që të kujtohen se kush kanë qenë para vendosjes së sistemit socialist e kush i poshtëroi.

Fjalimi u sjell si pajë serbëve edhe ndjesinë e të qenit krenarë, por edhe kritikë e kërkues ndaj Evropës, sepse kjo e fundit nuk i kishte kuptuar mirë, përkundër sakrificave të bëra për Evropën. Është koha që Evropa thjesht t'i hapë sytë e t'i njohë meritat e "popullit qiellor". Pikërisht ky cilësim u përdor si forcë mobilizuese për publikun. Tani serbët janë plotësisht në paqe me veten e vet kur i kanë kuptuar "padrejtësitë" që i kishin duruar në zverk. Ata janë të gatshëm që pa frikë t'i mbrojnë të drejtat e tyre edhe me luftë, gjithnjë sipas kushtimit "një për të gjithë, të gjithë për një".

Populli, që lindi nga ky fjalim në Gazimestan, është i tillë që duhet të bëjë gjithçka për ta mbajtur Kosovën si pjesë integrale të Serbisë dhe të arrijë një pastrim të brendshëm kombëtar.

Fjalimi bindi publikun për nevojën e njëfarë rilindje të domosdoshme kulturore dhe kombëtare. Kjo rilindje duhet të ketë në themel traditat serbe që i japin fund ndikimeve të huaja. Është e nevojshme për Serbinë që të fillojë me rindërtimin e vendit, jo vetëm nga maja përmes reformave politike si ndryshimet kushtetuese, por edhe nga poshtë përmes ndikimit kulturor, historik dhe fetar.

7.0. FJALIMI NË BEOGRAD (1999)

7.1. Prapavija

Si fjalim i dytë për t'iu nënshtruar zhbirimit analitik, është zgjedhur fjalimi i Millosheviqit, me 10 qershor 1999, si adresim i drejtuar për tërë kombin. Merret me mend, ai u mbajt në një situatë tjetër historike dhe politike. Derisa fjalimi i parë u mbajt në kohën kur Jugosllavia ende ekzistonte si shtet unik të paktën në letër, tani kishte rrjedhur shumë ujë nën urë. Pas luftërave që kishin përgjakur disa nga republikat kryesore, Jugosllavia më nuk ekzistonte si shtet. Sllovenia, Kroacia, Bosnjë-Hercegovina, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia tashmë ishin shtete të njohura ndërkombëtarisht. Edhe lufta e fundit, ajo në Kosovë, sapo kishte mbaruar dhe e gjithë shoqëria ishte në një gjendje tjetër.

Në kohën e mbajtjes së këtij fjalimi, karriera e Millosheviqit si president tashmë kishte bërë një dekadë. Po bëheshin 10 vjet prej asaj dite kur Millosheviqi mbajti fjalimin në Gazimestan.

Gjithçka kishte pasuar ishin ndryshime aq të mëdha politike, ekonomike, gjeografike dhe historike. Për 78 ditë me radhë, aviacioni i Aleancës Veriatlantike (NATO) kishte bombarduar makinerinë dhe infrastrukturën serbe të luftës. Kjo fushatë e detyroi Millosheviqin të nënshkruante në Kumanovë, më 10 qershor 1999, marrëveshjen e cila e detyroi Serbinë t'i largonte tërësisht forcat e ushtrisë dhe policisë nga Kosova. Në vazhden e ndërhyrjes humanitare për të ndaluar gjenocidin serb kundër popullatës shqiptare, forcat e NATO-s u vendosën në tërë territorin e Kosovës, i cili tashmë kaloi në administrim ndërkombëtar. Janë këto, pra, disa nga ngjarjet më të shënueshme në kohën kur u mbajt ky fjalim.

7.2. Situata retorike

Ky fjalim u mbajt në kryeqytetin e Serbisë, në Beograd, më 10 qershor 1999. I dhënë para ndërtesës së qeverisë, fjalimi përkoi pikërisht me ditën kur reshtën bombardimet mbi dymujore kundër Jugosllavisë. Vargu i gjatë i luftërave që nisi në Slloveni kishte mbaruar me Kosovën.

Në pellgun e gjakut që e shkaktoi vetë, Serbia u gjend para një gjendje të tendosur në aspektin politik dhe atë ekonomik. Kostoja e agresionit

të saj kundër rajonit la të vrarë në radhët e personelit ushtarak, policor, por edhe në civilë. E gjithë bota e Millosheviqit, sistemi i ngritur prej tij, u shpërbë me lehtësi të pabesueshme, krejt ndryshe nga pretendimet e tij të dikurshme. Pra, situata retorike kishte një *problem të ngutshëm* dhe ky duhej të zgjidhej përmes gjuhës (komunikimit). Rrjedhimisht, kjo gjendje diktoi që Millosheviqi të sajonte “argument” të ri, i cili do të mundësonte formimin e një publiku të ri.

Me fjalë të tjera, fjalimi tani duhej të përfizonte një situatë të leverdishme retorike për Millosheviqin. Imperativi i kohës, sipas tij, kërkonte sajimin e një publiku, te i cili do të krijohesh besimi se humbja e “zemrës së Serbisë” ishte vetëm e përkohshme.

Fushata e NATO-s, e përqendruar kryesisht në ndërhyrje ajrore, nisi me 24 mars 1999. Duke goditur caqet e ushtrisë dhe policisë serbe, ashtu sikurse edhe asetet dhe instalimet e tjera ushtarake, fushata 78-ditore kushtëzoi një ngjarje madhore në terma politike e ushtarakë, siç ishte nënshkrimi i Marrëveshjes së Kumanovës për armëpushim midis Serbisë dhe NATO-s.

Pas përcaktimit të një zone të sigurisë ajrore prej 25 kilometrash dhe sigurisë tokësore prej 5 kilometrash rrotull kufijve të Kosovës, një nga stipulimet më të rëndësishme të Marrëveshjes në fjalë ishte vendosja e forcave civile dhe ushtarake paqeruajtëse në vend. Një nga rrjedhimet e para, madje më të rëndësishme të saj, ishte krijimi i rrethanave për kthimin e sigurt të mbi 1 milion refugjatëve shqiptarë. Me tërheqjen e personelit ushtarak dhe policor jugosllav, forcat ndërkombëtare morën përgjegjësinë për sigurinë dhe paqen. Edhe administrata civile e okupimit serb u desh të largohesh nga Kosova, duke u zëvendësuar nga Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Sado që këto ishin zhvillime brenda Kosovës, ato ishin heraldi i një epoke të re për Ballkanin.

Të gjitha këto, bashkë me koston e luftërave të njëpasnjëshme, ishin shkaqet pse karizma e fortë politike e Millosheviqit u plasarit në pakthim.

Fjalimi i dikurshëm Gazimestan, me premtimin e tij kryesor për ta kthyer Kosovën nën kontrollin serb, tani ngjante një iluzion. Kjo gjendje, e cila i shëmbëllente një përpëllitje për mbijetesë në pushtet, bëri që Millosheviqi të përcaktohej për një fjalim të ri, ashtu që të argumentohej pse Serbia ishte katandisur në këtë situatë. Pra, lideri u detyrua të heqë dorë nga individualiteti i tij për “të mirën” e publikut. Edhe kësaj here, Millosheviqi po përpiquej të zëronte bindjet e vizionin që “populli” i ri, në krijim e sipër, dëshironte ta dëgjonte. Populli mund

të bëhet i vërtetë përmes bindjes dhe sjelljes së vet, por në fund të fundit ai është veçse një iluzion masiv. Ashtu siç është provuar në kapitujt pararendës, në momentin kur populli nuk e pranon më mitin, ai përsëri bëhet vetëm shuma e një bashkësie individësh.¹²⁶

Meqë tani situata retorike nuk ishte e përshtatshme për politikën e Millosheviqit, imperativi i ngushtëm kërkonte një fjalim të madh publik ashtu që të krijohej publiku i dëshiruar. Merret me mend, një gjë e tillë kërkon një retorikë e mitologji të re, për të mbledhur popullin dhe për të shmangur një krizë eventuale.¹²⁷ Pra, “populli” nuk është një fenomen konstant, por një proces që ndryshon me kalimin e kohës.¹²⁸

Si mënyra e vetme për t’i eskivuar kësaj gjendje të pafavorshme për autoritetin e tij, presidenti Millosheviq duhej të kapej pas diçkaje ashtu që të mund ta manipulonte përsëri popullin. Kjo duhet të jetë arsyeja përse ai u përqendrua tek Marrëveshja e Rambujesë, duke i premtuar publikut serb se “*ne kemi marrë garancinë se Serbia do të ruajë sovranitetin dhe integritetin e saj territorial*”. Duke u ndalur te kjo çështje, ai i shpjegon publikut se populli serb ka mbrojtur shtëpitë e tij me heroizëm e trimëri. Pra, bëhet fjalë ashiqare për një fjalim me mjete dhe strategji krejtësisht të reja retorike.

7.3. Përmbajtja e fjalimit

Fjalimi ka të bëjë kryesisht me luftën në Serbi dhe për situatën e re politike në Kosovë, ashtu sikurse edhe me statusin e saj të pazgjidhur politik. Duke iu adresuar popullit serb, Millosheviqi u shpjegon njerëzve se “agresioni” i NATO-s kundër Serbisë ka mbaruar. Me këtë rast, ai nis përshkrimin e gjendjes së pasluftës në Serbi duke vënë theksin te policët dhe ushtarët serbë të rënë. Ndaj tyre, ai rezervon cilësime në superlativ, duke nënvizuar se ata vdiqën duke mbrojtur atdheun në luftën për liri dhe për dinjitetin e popullit serb. Fjalimi thekson “akte heroike” të ushtarëve serbë që, sipas tij, kanë mbrojtur njerëz, qytete, ura e fabrika. Populli, shton ai, është hero i kësaj lufte; ata ndjehen heronj dhe veprojnë si të tillë.

Një çështje e rëndësishme që ngrihet në fjalim është Kosova: Millosheviqi e ndjen të nevojshme t’i sigurojë serbët se e gjithë Serbia u desh të protestonte për të dërguar mesazhin se nuk do të heqë dorë nga Kosova. Ai thotë veç të tjerash:

126 McGee, 1975: 243,

127 Po aty,

128 Po aty,

“Në fillim të këtij viti, tubime të shumta u mbajtën në të gjithë vendin. Mesazhi i tyre i përbashkët ishte se NE NUK DO TA DORËZOJMË KOSOVËN (theksimi ynë – G.M). Dhe ne nuk kemi hequr dorë nga Kosova”.

Përveç kësaj, Millosheviqi përmend edhe rolin që Grupi i tetë vendeve më të zhvilluara në botë dhe të OKB-së do të jenë në Kosovë. Ai, me këtë rast, e siguron publikun se këto shtete garantojnë sovranitetin dhe integritetin territorial të Serbisë. Ai thekson se atyre u është dhënë një garanci në formën e një projekt-rezolute, e cila e përjashton pavarësinë e Kosovës. *“Integriteti territorial i Serbisë nuk kërcënohet”,* thotë ai.

I mbizotëruar të shumtën e kohës nga tema e “heroizmit” të popullit serb, presidenti serb flet sesi populli i bëri rezistencë një armiku më të madh e më të fortë, siç është NATO. Por, ai nuk kursen në të njëjtën kohë as disa “frikacakë” që, sipas tij, ikën nga vendi për të siguruar lëkurën e tyre deri në përfundimin e luftës.

7.4. Pasojat e fjalimit

Numri i pjesëmarrësve gjatë fjalimit të Millosheviqit në Beograd ishte pakrahasimisht më i vogël se sa numri i atyre që ishin mbledhur një dekadë më parë në Gazimestan. Sipas vlerësimeve, nuk pati më shumë se 50 mijë pjesëmarrës.

Njerëzit më nuk ishin të lumtur e optimistë siç kishin qenë në vitin 1989. Ata kishin përjetuar shkatërrimin ekonomik të vendit bashkë edhe me një luftë tjetër të humbur. Si rezultat i kundërshtimit kryeneç për të nënshkruar Marrëveshjen e Rambujesë, aviacioni i NATO-s e bombardoi infrastrukturën ushtarake të Serbisë ashtu që ajo të detyrohej t’i kthehej tavolinës së negociatave. Urat, rrugët kryesore dhe ngrehina e medias kryesore të regjimit millosheviqian, RTS (Radio Televizija Srbija), ishin ndër caqet e goditjeve ajrore. Për 78 ditë radhazi, ajo përjetoi pasojat e luftërave që i provokoi vetë. Parulla e stërpërsëritur se Kosova është “zemra e Serbisë”, tani ngjante si e kundërta e saj.

Iluzioni kolektiv u pasua me një periudhë të deluzionit me një numër gjithnjë e më të madh serbësh të depresionuar. Përkundër propagandës së mirë-organizuar mediatike, pjesa më e madhe e publikut pushoi së besuari në gjithçka vinte prej partisë së Millosheviqit dhe mediave të kontrolluara nga pushteti i tij. Është signifikative për gjendjen e re të krijuar se fjalimi nuk u botua në shumë nga gazetat që qarkullonin në vend, teksa pati edhe media elektronike që bojkotuan lajmet ose raportuan vetëm sipërfaqësisht në lidhje me fjalimin e tij.

7.5. Analiza e fjalimit në Beograd

Megjithëse nuk krahasohet me fjalimin e Gazimestanit, edhe ky adresim përbën një ngjarje unike politike dhe historike. Fjalimi është i shkurtër dhe përbëhet nga dy faqe tekst në formatin A4.

Në këtë fjalim, fjala “popull” është e shenjtë. Ka gjithsej 10 përmendje dhe, për nga pozicioni tekstual, është fjala më kyçe. Millosheviqi thotë:

“Hero është populli – dhe ky është, ndoshta përfundimi më i shkurtër i mundshëm sa i përket kësaj lufte. Hero është populli dhe kjo është arsyeja pse ata duhet të ndihen heroik”.

Fjala “popull” është zgjedhur si fjalë kyçe bazuar në frekuencën dhe intensitetin e përdorimit. Edhe këtu, “populli” paraqitet si *term* *Zoti*. Nëpërmjet përdorimit të shpeshtë të fjalëve, “populli” përpiqet të ndezë asocimin me krenarinë dhe madhështinë e Serbisë; në të njëjtën kohë, kjo fjalë ka identitet simbolik.

Në një analizë tekstuale vërehet qartësisht se, gjatë përdorimit të fjalës “popull”, ndërfiten edhe togfjalësja që kanë intensitet të madh. Ata mund të ndahen tutje në dy grupe sipas cilësive (shih tabelën e mëposhtme). Sugjestionimi nuk mjaftohet vetëm në pohimin se populli serb është komb luftarak, por ai gjithashtu mbart vlera kulturore. Rreth “popullit” tubëzohen fjalët “hero”, “heroik”, “luftë”, por edhe “i denjë”, “fisnik” dhe “përgjegjës”.


Por, kjo bashkësi fjalësh që satelitojnë rreth *termit të Zotit* prodhon edhe njëfarë gjendje tensioni e dramaticiteti. Të jesh “heroik” ose të bëhesh “hero” mund të japë asociacione sikur të jetosh dhe të ekzistosh në truallin e legjendares apo mitikes, ndërsa të jesh “i përgjegjshëm” dhe “fisnik” është të përshtatesh me realitetin, ashtu siç duket se është shoqëria tani sipas botëkuptimit të Millosheviqit. Ai thotë:

“Hero është populli – dhe ky është ndoshta përfundimi më i shkurtër i mundshëm sa i përket kësaj lufte. Hero është populli dhe kjo është arsyeja pse ata duhet të ndihen heroik si dhe të veprojnë në mënyrë heroike, do të thotë në një mënyrë dinjitoze, fisnike dhe të përgjegjshme”.

Rreth fjalës “popull” njëherazi grumbullohen edhe cilësime të tjera që nuk i lënë asgjë mangut karakteristikave të “arianizmit” të Hitlerit. Studiuesi i retorikës, McGee thotë se: “Kohë pas kohe ... organizojnë angazhime të veçuara ideologjike në mite fillestare politike, vizionet e jetës kolektive varur para individëve me shpresën për të krijuar një ‘popull të vërtetë’”.¹²⁹

129 McGee 1975: 243,

Tabela e mëposhtme sjell në mënyrë grafike fjalët që grumbullohen rreth “popullit” të ndara në dy grupe:



Në arsenalin e municioneve retorike të Millosheviqit, patosi është një nga mjetet ndikuese më të rëndësishme. Fjalimi sajoi një popull që mund të jetë i lumtur vetëm deri në atë shkallë që identifikohet me patriotizmin, domethënë me kombin serb. “Njerëzit” janë të lidhur ngushtë me “luftën” dhe “heroin”, duke lënë të nënkuptohet se ka një gatishmëri për sakrificat të mëtejshme. Millosheviqi apeloi tek populli:

“I gjithë populli mori pjesë në këtë luftë: duke filluar nga foshnjat në repartet e maternitetit, pacientët e sëmurë rëndë në repartet e kujdesit intensiv, e deri tek ushtarët në istikame, ata të mbrojtjes kundërajrore si dhe në njësitë kufitare.”

Për të krijuar patos, pra për të apeluar më efektivisht përmes ndjenjave, Millosheviqi nuk ngurroi t’i kujtojë publikut *“foshnjat në repartet e maternitetit dhe pacientët e sëmurë rëndë në njësitë e kujdesit intensiv”*.

7.6. Duke ruajtur homogjenitetin

Fjalimi e copëzon shoqërinë serbe në sa e sa grupe sociale, por në të njëjtën kohë edhe i mban bashkë. Në studimet e tij, McGee përmendte edhe atë se në politikë njerëzit janë një ide e fuqisë së përbashkët që tejkalon si individualitetin, ashtu edhe arsyen.¹³⁰ Edhe ky fjalim kërkon t’i trajtojë serbët jo si individë me arsye, por si një grup shoqëror homogjen që është në gjendje të bëjë gjithçka për të mbrojtur lirinë. Duke folur për mbrojtjen e lirisë, Millosheviqi thotë:

“Ne kemi demonstruar se ushtria jonë është e pathyeshme dhe më e mira në botë. Kur them armata, unë mendoj në një kuptim të përgjithshëm ku përfshihen forcat e armatosura, policia dhe të gjitha forcat e mbrojtjes

¹³⁰ McGee, 1975: 238.

shtetërore. Ata i kanë treguar të gjithë botës sesi njerëzit duhet të mbrohen, si të qëndrojnë të vendosur dhe të bashkuar sepse populli ishte ushtri dhe ushtria ishte popull. Asnjëherë më parë në të gjithë historinë e mëparshme, populli nuk ka qenë më i bashkuar sa në këtë luftë.”

Imazhet që prodhohen nga retorika e Millosheviqit janë ato të një populli serb të patrembur në rrjedhat e historisë, me heronj e njerëz të gatshëm për t’u sakrifikuar për kombin e tyre. Asnjë fuqi në këtë botë nuk mund ta shtypë vullnetin e popullit serb; ai vetë është në gjendje ta mbrojë lirinë.

Po kështu, fjalimi priret t’i mëshojë vazhdimisht idesë se populli serb është i fortë, trim dhe heroik, ndaj të gjithë ata që marrin guximin të sulmojnë Serbinë duhet t’i bëjnë hesapet mirë. Dhe ja si e shpjegon ai këtë:

“Asnjëherë më parë në të gjithë historinë e mëparshme, populli nuk ka qenë më i bashkuar sa në këtë luftë. Ne kurrë nuk kemi pasur kaq pak frikacakë që ikën nga vendi për të pritur të sigurt deri në fund të luftës”.

Një konsideratë tjetër që duhet të merret në shqyrtim është edhe fakti që “popullit” i ndajmbathet edhe fjala “unitet”. Por, po ashtu, aty është edhe antinomia e kësaj, gjegjësisht “frikacakët”. Duke i përbashkuar këto tri fjalë, fjalimi krijon konflikt dhe e shndërron ligjërimin në një lloj katharsisi për publikun. Në këtë mënyrë, fjalimi kërkon të formësojë dhe të shfrytëzojë edhe ndjenjat kombëtare të popullit serb, sepse “*populli justifikon filozofitë politike*” (po aty). Loja e fjalëve me patosin është e fuqishme.

7.7. Luftë për veten, luftë për botën

Pikërisht këtu është vendi të tërhiqet një paralele midis Hitlerit dhe Millosheviqit, përkatësisht të ilustrohen mënyrat se si ata e përdorën publikun për të ngjallur emocione (*patos*).

Hitleri besonte asokohe se Gjermania ishte shtypur dhe keqtrajtuar nga Traktati i Versajës. Duke e absolutizuar pohimin se populli gjerman hiqte të zitë e ullirit nga ky traktat, ai i instrumentalizoi këto realitete për t’i shndërruar në argumente e për ta përfshirë popullin në projektin nazist për një Gjermani të Madhe. Hitleri, me fjalë të tjera, ia doli mbanë të përhapte besimin se Gjermania që në gjendje t’i kthente të gjitha ato që i kishte humbur në Luftën e Parë Botërore.

Edhe Millosheviqi u bë kritik dhe agresiv ndaj vendeve perëndimore pas bombardimeve të NATO-s. Këtë situatë ai e përdori duke e paraqitur si një përpjekje për mbrojtjen e kulturës dhe kombit serb nga “agresioni perëndimor”. Pavarësisht divergjencave që kishin nisur

të dilyn mbi sipërfaqe, shumica e serbëve e pëlqyen këtë narracion dhe sakaq e përvetësuan si qëndrim. E përbashkëta mes tyre është se te dy papërbashkuesit e përdorën popullin, historinë dhe ndjenjat e njerëzve; kjo është arsyeja pse si Hitleri, ashtu edhe Millosheviqi, u panë si liderë kombëtarë.

Megjithë dallesat e konsiderueshme, lideri serb seç ruan njëfarë vazhdimësie përmbajtjesore dhe gjuhësore me fjalimin e tij të mbajtur në Gazimestan. Kjo dëshmohej edhe nga kjo pjesë e adresimit:

“Duke dalë para Kombeve të Bashkuara, ne jo vetëm që e mbronim vendin tonë, por ne i kthym Kombet e Bashkuara në skenën politike pasi që ato nuk ishin duke funksionuar që para fillimit të agresionit, 80 ditë më parë. Ky është kontributi ynë në përpjekjet e të gjithë botës liridashëse, në tendencat për të krijuar një botë multipolare dhe për të mos pranuar krijimin e një bote, e cila do të qeveriset nga diktatura e një fuqie të vetme nga një qendër. Unë besoj se për historinë, ky kontribut do të jetë edhe më i madh dhe se heroizmi i popullit tonë duke rezistuar ndaj një armiku më të madh dhe më të fortë do të shënojë fundin e shekullit 20. Dhe unë jam i sigurt për këtë. Ne kemi demonstruar se ushtria jonë është e pathyeshme dhe më e mira në botë. Kur them armata, unë mendoj në një kuptim të përgjithshëm ku përfshihen forcat e armatosura, policia dhe të gjitha forcat e mbrojtjes shtetërore. Ata i kanë treguar të gjithë botës sesi njerëzit duhet të mbrohen, si të qëndrojnë të vendosur dhe të bashkuar sepse populli ishte ushtri dhe ushtria ishte popull”.

Jehona retorike e Gazimestanit kishte qenë tejet e fuqishme, për aq sa Millosheviqi ia doli ta homogenizonte diskursin e krejt hapësirës publike serbe. Ashtu siç është shtjelluar në kapitujt pararendës, presidenti serb kishte evokuar betejën e 1389-s si mbrojtje e vetvetes (*“Para gjashtë shekujve Serbia, këtu, në Fushën e Kosovës, e ka mbrojtur veten”*), Evropës dhe gjithë vlerave perëndimore (*“Serbia ishte atëherë bastioni që mbronte kulturën evropiane, fenë dhe rendin shoqëror evropian”*).

Dhjetë vjet më vonë nga kryeqendra e Serbisë, në Beograd, ai do të shprehej retorikisht në të njëjtën mënyrë. Për Millosheviqin, serbët mbrojtën më shumë sesa veten (*“ne i kthym Kombet e Bashkuara në skenën politike”*); shkundën botën nga letargjia (*“ato nuk ishin duke funksionuar që para fillimit të agresionit”*); dhanë kontribut për botën liridashëse (*“në tendencat për të krijuar një botë multipolare”*) si dhe e luftuan sundimin e botës nga një fuqi e vetme (*“për të mos pranuar krijimin e një bote, e cila do të qeveriset nga diktatura e një fuqie të vetme nga një qendër”*).

Togfjalëshi *“për t’u mbrojtur”* është konstruktuar asisoj që të krijojë kuptimin sikur të gjithë serbët janë të një mendje në këtë pikë. Përmbajtja retorike e fjalimit di të luajë sa me krenarinë e serbëve, po aq edhe me viktimizimin e tyre. Pohimi i tij se: *“Ky është kontributi ynë në përpjekjet e të gjithë botës liridashëse”*, lë hapësirë të kuptohet nga marrësi sikur serbët janë, si të thuash, edhe hisedarë në lirinë e të tjerëve.

Por, ky togfjalësh shkallëzon edhe një mundësi tjetër interpretative. Është edhe njëfarë sugjestionimi tjetër se serbët, si komb “qiellor”, ishin të gatshëm të sakrifikoheshin edhe për të tjerët, porse tani ata kanë mbledhur mend dhe, siç siguron Millosheviqi, tani do të luftojnë vetëm për “lirinë serbe”.

Fjala tjetër që pason, gjykuar nga shpeshtësia dhe intensiteti, është “qytetar” që ka gjithsej nëntë përmendje. Si fjalë kyçe brenda tërësisë tekstuale të fjalimit, ajo merr një funksion si *term Zoti*. Në fjalim, Millosheviqi e përdorë fjalën e apostrofuar në relacion me luftën dhe lirinë. Si shprehje misterioze, “qytetari” megjithatë përdoret vetëm sipërfaqësisht e me qëllime kozmetike.

Jo më pak vëmendje meriton edhe kjo pjesë e adresimit ku fjalimmbajtësi thotë:

“Të dashur qytetarë, agresioni ka mbaruar. Paqja ka mbizotëruar mbi dhunën. Të dashur qytetarë, ju uroj një paqe të lumtur”.

7.8. Qytetarë dhe “qytetarë”

Një observim që mbështetet në përshtypjen e parë, veçmas kur nuk është i njohur me kodin shoqëror të serbëve dhe shqiptarëve, sikur është i paracaktuar të përfundojë në lajthim. Kjo sepse shqiptarët gjatë regjimit të Millosheviqit shiheshin si një komb me më pak vlera se serbët. Ndaj pyetja duhet të formulohet nëse jemi të vetëdijshëm se çfarë nënkupton fjala “qytetar” për serbët e çfarë për shqiptarët.

E parë nga perspektiva shqiptare, ndërhyrja e NATO-s në Kosovë ishte një “mrekulli” politike dhe ushtarake që solli lirinë dhe çlirimin e shumëëndërruar. Por nga perspektiva zyrtare serbe, kjo ndërhyrje qe sulm dhe pushtim i territorit serb. Kësisoj, fjala “qytetare” ka kuptim të dyfishtë hermeneutik, ashtu sikurse edhe një forcë të fuqishme përçarëse e polarizuese midis dy kombeve në hasmëri. Për shqiptarët e Kosovës, madje edhe ata të të gjithë rajonit, NATO u bë simbol i lirisë dhe demokracisë; ndërsa serbët zgjodhën të krijojnë bindjen se ajo ishte simbol i tiranisë dhe i agresionit.

Duke depërtuar edhe brenda shtresës nëntekstuale të fjalimit, është mjaft evidente që fjala “qytetar” megjithatë është e rezervuar për serbët, dhe jo për shqiptarët. Kjo sepse për paradigmen diskursive millosheviqiane, “shqiptar i ndershëm” (*poštteni Albanac*) ishte vetëm ai që pranonte lojalitetin e pakusht ndaj Serbisë. Kjo ishte arsyeja që më shumë se 100 mijë punëtorë shqiptarë u flakën nga vendet e tyre të punës vetëm e vetëm se nuk nënshkruan një dokument politik, me anë të të cilit të pranonin Serbinë si shtetin e tyre.¹³¹ Vetëm ata pak shqiptarë që pranuan të vinin firmën e tyre në këso akte absurde u “mëshiruan” dhe fituan statusin e të “ndershmit”.

Parë nga këndvështrimi legal i gjërave, “qytetarët” janë anëtarë të të njëjtit shtet. Por, kjo nuk vendos shenja barazimi me kombin, pra ata nuk i përkasin domosdoshmërisht të njëjtit komb. Dhe këtu është elementi paradoksal dhe konfliktuoz i fjalimit. Si mund t’u thuhet “të dashur qytetarë” një milion shqiptarëve që u dëbuan me dhunë nga presidenti i tyre? Përveçse i ndan sipas përkatësisë kombëtare, fjalimi shtyn përpara idenë që të formohet një shtet pa “qytetarë” shqiptarë dhe “qytetarë” pa përkatësi shqiptare.

Edhe fjala “hero” ka rol thuajse vendimtar dhe, si e tillë, përmendet mjaft shpesh në të njëjtën fjali. Kështu, Millosheviqi u ngre himne ushtarëve serbë që kanë humbur jetën në “mbrojtje” të Serbisë. Fjala “hero” përmendet shtatë herë dhe është e shoqëruar me tone patosi. Millosheviqi deklamon:

“Hero është populli – dhe ky është ndoshta përfundimi më i shkurtër i mundshëm sa i përket kësaj lufte. Hero është populli dhe kjo është arsyeja pse ata duhet të ndjehen heroik si dhe të veprojnë në mënyrë heroike, do të thotë në një mënyrë dinjitoze, fisnike dhe të përgjegjshme”.

Edhe kjo fjalë, gjykuar nga frekuenca dhe intensiteti i saj, duhet konsideruar në rangun e fjalës kyçe. Fjala “hero” shfaqet në përdorim kontekstual e jashtëkontekstual si *term Zoti*. Shumë nga fjalët e grupit të parë janë mbiemra që përshkruajnë se si Serbia ka mbrojtur vendin e saj. Mbiemrat nuk janë neutralë, përkundrazi ata janë të fuqishëm. Rreth “heroit” tubëzohen kryesisht fjalë si “popull”, “mbrojtje” dhe “liri”. Bie fjala, Millosheviqi thotë:

“Askush nuk do ta harrojë heroizmin e atyre që mbronin qytetarët, ata që mbronin fabrikat, sheshet, qytetet e tyre, shtetin e tyre si dhe popullin e tyre. Hero është populli.... në mbrojtje të atdheut, në luftën për lirinë dhe dinjitetin e njerëzve”.

131 Doucette 2004: 223.

Mesazhi subliminal është se populli serb, me madhështinë e dëshirës së tij, ishte i gatshëm të sakrifikonte veten me trimëri për atdheun.

7.9. Përsëri Kosova

Edhe pse “Kosova” përmendet vetëm dy herë në këtë fjalim, ajo ka statusin e një fjale të shenjtë tekqë ka vend qendror gjatë të folurit. Ajo është kyçe për faktin se përmendet me intensitet, ashtu sikurse edhe intensiteti rreth fjalës “Kosovë” është tepër i fuqishëm. Gjithashtu, substantivi “Kosovë” avitet me foljen “të japësh” ashtu sikurse edhe me mohuesen “jo”, që e përshkruan atë në më shumë hollësi.

E gjithë kjo është dëshmi e faktit se Kosova zë një vend të rëndësishëm në Serbi. Raste që flasin për intensitetin e fjalës së apostrofuar janë të shumta, por le të shërbejemi me dy shembuj më përfaqësues. Në një vend, Millosheviqi deklaroi: *“Ne nuk kemi hequr dorë nga Kosova. Ne nuk do ta dorëzojmë Kosovën. Dhe ne nuk kemi hequr dorë nga Kosova”*. Diku tjetër, ai thotë edhe këtë: *“Kjo do të thotë që vetëm autonomia, dhe asgjë tjetër më shumë se aq, mund të përmendet në këtë proces politik”*. Por nuk është vetëm kjo: Millosheviqi i jep vetes të drejtë të flasë edhe në emër të shqiptarëve. Kjo automatikisht presupozon bindjen se shqiptarët nuk mund të përfaqësojnë dëshirat e tyre politike dhe as nuk dinë të vetëparaqiten; ata mund të jenë të përfaqësuar vetëm nga Millosheviqi. Përveç kësaj, “lideri” e di edhe si mendojnë shqiptarët politikisht, sepse ai e njih varësinë e tyre nga personalitete të tilla si ai. Kjo hap shtegun e racionalizimit të çdo racizmi të mundshëm: shqiptarët janë një popull inferior që dominohet prej një populli që i njih shqiptarët, dhe e di se çfarë është e mirë dhe çfarë është e keqe për ta, madje më mirë sesa vetë shqiptarët.

Fjalimi përmban vlerësime e lavdërime për “mbrojtjen heroike” të serbëve në luftën kundër “agresorit”. Grumbujt e fjalëve, dhe sidomos mbiemrat, përdoren si mjet për të krijuar dhe shprehur vlerat e njerëzve. Populli serb, i udhëhequr nga Millosheviqi, nuk do t’i harrojë kurrë ata që ranë për të mbrojtur Serbinë dhe Kosovën kundër agresorit NATO. Sepse, sikur sugjeron ai, është e vështirë për serbët të ndahen nga “zemra” dhe shpirti i tyre.

Fjalët që sillen rreth “agresionit” dhe “Kosovës” janë superiore në kontekstin e luftës. E para, e cila ka gjithsej katër përmendje, është sipas standardeve retorike e klasifikueshme si *term djalli*. Në fakt, pjesa fillestare e fjalimit është: *“Të dashur qytetarë, agresioni ka marrë fund”*.

Fjalët që i ndajngjiten “agresionit” janë “Kosova” dhe “liria”. Me ndihmën e togfjalëshave ku përmenden këto fjalë, është e mundshme që të vijnë te vlerësimi se fokusi kryesor i fjalimit është “agresioni”, i cili nënkupton humbjen e integritetit dhe “*krenarisë së Serbisë*”.

7.10. Daullet e luftës ende rrahin

Me një shkallë të gjerë shpeshësie është edhe fjala “luftë”. Millosheviqi e përdor këtë fjalë gjithsej gjashtë herë brenda fjalimit, i cili, siç u përmend më herët, është pakrahasimisht më i shkurtër sesa ai i mbajtur në Gazimestan. Me funksion të *termit të Zotit*, fjala “luftë” shkon dorë për dorë me përdorimin e fjalës “popull”. I kësillojshëm është edhe një përdorim si ky:

“Asnjëherë më parë në të gjithë historinë e mëparshme, populli nuk ka qenë më i bashkuar sa në këtë luftë. Në këtë moment, mendimet tona të para duhet të jenë me heronjtë që dhanë jetët e tyre në mbrojtje të atdheut, në luftën për lirinë dhe dinjitetin e njerëzve”.

Dhe fill pas kësaj ka edhe formulime me shprehje të djallit: “*Ne kurrë nuk kemi pasur kaq pak frikacakë që ikën nga vendi për të pritur të sigurt deri në fund të luftës*”.

Në dobi të një analize më të thuktë është edhe nëse shihet për së afërmi mënyra sesi Millosheviqi e lidh “luftën” dhe “popullin” në raporte korrelative. Sipas tij, “*populli ishte ushtri dhe ushtria ishte popull*”.

Pason sugjerim pas sugjerimi: mbrojtja e Serbisë është detyrë morale poaq sa edhe qytetare, sepse bëhet fjalë për një luftë kundër “pushtuesve”. Është veçse luftë mbrojtëse. Sipas Millosheviqit, lufta që NATO e ndërmoi kundër caqeve serbe, për të mbrojtur dy milionë shqiptarë, nuk është një detyrë morale. Në frymën e fjalimit, kjo e shpjegon pse lufta e NATO-s formulohet me *shprehje djalli*. Që të avancojë me synimin e tij brenda mjeteve retorike, Millosheviqi askund në fjalim nuk zë në gojë dhjetëra mijëra civilë shqiptarë të vrarë nga forcat ushtarake e policore serbe në Kosovë prej vitit 1997 e deri në kohën e mbajtjes së fjalimit. Përkundrazi, ai theksin e vë te humbjet në radhët e personelit të forcave të sigurisë: “*Sidoqoftë, në këtë moment dëshiroj t’ju informoj se nga 24 marsi e deri më sot, 462 anëtarë të Armatës Jugosllave si dhe 114 anëtarë të policisë së Republikës së Serbisë u vranë në luftën njëmbëdhjetë javore*”.

Edhe me këtë rast, siç ishte ky fjalim, zbulohet lakuriq botëvështrimi i tij në lidhje me gjithçka jashtë asaj që ishte serbe: kombet, gjuhët, kulturat e fetë e tjera. Është ideologjia përjashtuese, tipike e

ekskluzivizmit nacionalist serb, ajo që përshkon fjalimin, tekstin e nëntekstin e tij. Vetëm kjo e shpjegon faktin që, përkundër gjenocidit e spastrimit etnik të ushtruar në Kosovë kundër popullatës shqiptare, ai përmend vetëm serbët e vrarë, si dikush që kanë më shumë vlera dhe janë “të ndryshëm” nga “të tjerët”. Ky gjak serb është derdhur e do të derdhet gjithnjë në mbrojtje të “Jerusalemit” serb.

Kjo mendësi, sa te autori i fjalimit e po aq edhe te publiku marrës, është e tillë që gjaku dhe jetët e humbura të kombit “armik” nuk janë të rëndësishme. Këtu është me vend të përmendet vlerësimi i autorit McGee, sipas të cilit ideologjia është një gjuhë politike që ruhet nëpër dokumente retorike, me të cilat ajo ka aftësinë për të diktuar vendime dhe për të kontrolluar bindjet dhe sjelljen publike.¹³² Nisur nga ky përcaktim, edhe fjalimi i Millosheviqit është një lloj ideologjie që përpiket të diktojë proceset politike dhe të kontrollojë opinionin dhe sjelljen publike në Serbi.

7.11. Viktimizimi

E dukshme jo vetëm në fjalim, por edhe nëpër krejt kontekstin e jashtëm të fjalimit, është perceptimi se gjoja serbët janë “viktima”. Ai i jep jehonë kësaj kur deklamon ndër të tjerash edhe këto:

“Në këtë moment, mendimet tona të para duhet të jenë me heronjtë që dhanë jetët e tyre në mbrojtje të atdheut, në luftën për lirinë dhe dinjitetin e njerëzve”.

Nënteksti i një formulimi të këtillë është se janë ende “të tjerët” ata që po kryejnë krime kundër serbëve, dhe se ata, siç e thotë historia, duhet ta mbrojnë veten e tyre. Ky pretendim bën një lidhje të së tashmes me të kaluarën e afërt e të largët ku serbët projektohen si “viktima” të përjetshme e rrugëtimi i tyre si “golgotë”.

Siç u përmend edhe më parë, fjala “luftë” i referohet fushatës ajrore të NATO-s, por që, sipas përdorimit retorik, përthyeret në gjoja agresion ndaj Serbisë. Vend jo të paktë në fjalim zënë ata që mbrojtën “vendin tonë”. Te publiku dëgjues krijohet edhe bindja tjetër se Kosova vuajti prej NATO-s. Kur është fjala te kjo çështje, Millosheviqi përpiket ta sigurojë audiencën se Kosova për Serbinë nuk është e humbur. Në adresim e sipër, presidenti që një muaj para fjalimit ishte akuzuar për krime kundër njerëzimit nga Tribunali Ndërkombëtar i Hagës, siguroi publikun në Serbi se:

132 McGee 1980: 5.

“Kjo do të thotë që vetëm autonomia, dhe asgjë tjetër më shumë se aq, mund të përmendet në këtë proces politik”.

Gama asociative e atyre që thuhen në fjalim është e gjerë, por sidoqoftë Millosheviqi provon disa gjëra njëherësh:

Së pari, ai përpiket të bindë popullin serb se Kosova nuk është e humbur.

Së dyti, ai i shpjegon popullit serb se forcat ndërkombëtare që hynë në Kosovë janë vetëm për të garantuar sigurinë e të gjithë qytetarëve. Është pikërisht ky udhëkryq ku aksidentohet koherenca e atyre që ngrihen si poenta në fjalim. Deklarata e tij është edhe e palogjikshme: si është e mundur që trupat e NATO-s që e paskan bombarduar dhe masakruar Serbinë të jenë një partner pune dhe paqeruajtës?

Së treti, Millosheviqi nuk është prapëseprapë në gjendje të mbyllë sytë e të hiqet sikur nuk ekzistojnë një mal problemesh akute sociale që kishin shpërthyer në Serbi gjatë kësaj kohe. Kjo duhet të jetë arsyeja pse ai thotë:

“Ne do të fillojmë menjëherë t’i rindërtojmë urat tona, rrugët tona, fabrikat dhe të ringjallim një zhvillim të madh, i cili do të shprehë gatishmërinë dhe vitalitetin e popullit tonë, qytetarëve tanë, shtetit tonë”.

Por kjo “dobësi” kundërpeshohet nga një duzinë formulimesh e shprehjesh të tjera grandioze. Pavarësisht se ushtria dhe policia serbe kishte ndërmarrë fushata gjenocidale ndaj popullatës civile, Millosheviqi zgjedh një aspekt tjetër për t’iu adresuar publikut serb. Për të, kjo ushtri ishte superiore (*“Ushtria jonë është e pathyeshme dhe më e mira në botë”*); serbët duhet të ishin borxhli ndaj të gjithë njerëzve të uniformuar të shtetit (*“unë mendoj në një kuptim të përgjithshëm ku përfshihen forcat e armatosura, policia dhe të gjitha forcat e mbrojtjes shtetërore”*); se ajo paskësh zhvilluar luftë mbrojtëse (*“Ata i kanë treguar të gjithë botës sesi njerëzit duhet të mbrohen, si të qëndrojnë të vendosur dhe të bashkuar”*) dhe populli e shteti ishin një (*“populli ishte ushtri dhe ushtria ishte popull”*).

Në këtë konstelacion tekstual, fjala “popull” vihet në relacion gjithëherë me fjalën “ushtri”. Në retorikën e Millosheviqit, populli dhe ushtria bashkohen rreth idesë së tij për pavdekësinë e popullit. Që të dy termat fundamentohen si *terma të Zotit*, pra me një bashkëlidhje të ngushtë mes vete. Me postulatën se populli dhe ushtria janë një trup i vetëm, ushtria do të mbrojë popullin, por edhe populli si shpagesë do të sakrifikojë vetveten dhe do të shndërrohet në ushtri. Ushtria, sipas fjalimit, referohet si simbol i fortë që nënkupton trimërinë, guximin dhe sakrificën.

Me gradacionin e fallacive logjike, Millosheviqi rreket të thotë në mënyrë tacite se të gjitha këto cilësi pozitive i ka edhe populli serb. Vështruar nga aspekti simbolik, nuk është vetëm populli që ka mbrojtur dhe ringritur kombin serb, por është edhe ushtria. Prandaj, kjo dikton që Millosheviqi ta ketë thelbësore personifikimin dhe bashkimin e popullit me ushtrinë. Dhe nuk është aspak rastësi kur ai thotë: *“populli ishte ushtria dhe ushtria ishte popull”*. Mesazhi që del thuajse në mënyrë eksplicite është se Serbia është popull dhe ushtri që ndërkëmben mes vete.

Në kohën kur po bëhej e qartë se Tribunali i Hagës do të akuzonte hierarkinë e shtetit dhe të ushtrisë, Millosheviqi përpiqet t'i paraprijë një situatë të tillë duke e përhapur masivisht besimin sikur ushtria ishte pjesa më e shenjtë e popullit serb. Si e tillë, vijonte ky sugjerim, ajo meritonte të adhurohej, të lartësohej dhe të nderohej. Simbolikisht, ushtria është peshku, populli është uji. Në këtë mënyrë “populli” është fjalë kyçe dhe me fuqi pajtuese; kjo lidhje retorike mundëson që shprehjet “populli” dhe “ushtria” të mos jenë në kundërshtim me njëra-tjetrën.

7.12. Ndërtimi i publikut

Meqë retorika konstituive, pra diskursi retorik, konstituon publikun e vet, analiza do të strumbullohet rreth fjalimit e, veçanërisht, ndaj publikut që konstituohet retorikisht. Adresimi i bërë, pikërisht në ditën kur përfunduan bombardimet e NATO-s, përmban shprehje që përforcojnë identitetin serb dhe krijojnë homogenizimin e publikut. Oratoria që Millosheviqi e përdori në fjalimin e tij në Beograd ishte e përshtatshme për fushatat aktuale politike e nacionaliste në Serbi. Edhe këtu vërehet një tendencë për të përdorur Kosovën si instrument për krijimin e një publiku të homogenizuar. Kjo për arsye se Serbia është tashmë në një pozitë krejt tjetër. Kur Millosheviqi thotë: *“Në fillim të këtij viti, tubime të shumta u mbajtën në të gjithë vendin. Mesazhi i tyre i përbashkët ishte se NE NUK DO TA DORËZOJME KOSOVËN (nënvizimi ynë – G.M). Dhe ne nuk kemi hequr dorë nga Kosova”*.

Në tërësinë e vet, fjalimi nëpërmjet përmbajtjes retorike sendërton një publik ose popull që e ka mbushur mendjen top që të mos dorëzohet asnjëherë.

Tekqë Kosova në fjalim përdoret atëherë si simbol dhe ikonë e identitetit serb, Millosheviqi është i interesuar të sajojë një publik që do ta mbështesë dhe forcojë edhe më fushatën e tij politike. Së këndejmi, Kosova përdoret si një instrument për të rikrijuar dhe mirëmbajtur lëvizjen politike dhe sociale në Serbi.

Sado që pozicioni ndërkombëtar i Serbisë ishte rrëgjuar dhe kredibiliteti i saj ishte vënë në pikëpyetje, udhëheqja politike në Beograd, në krye me Millosheviqin, përpiqet që Kosovën ta shndërrojë në një konstantë të panegociueshme. Kur ai përdorë kastile fraza të tilla si: *“Ne nuk do ta dorëzojmë Kosovën. Dhe ne nuk kemi hequr dorë nga Kosova”*, del qartësisht se qëllimi i tij është që ta lidhë Kosovën sa më afër me Serbinë dhe me popullin serb.

Asgjë e re në këtë drejtim: është, në fakt, përpjekja e mirëmenduar shtetërore që Kosova të imponohet sa më shumë që është e mundur në traditën dhe kulturën serbe. Është pikërisht brenda këtij formulimi i gjithë *Weltanschauung* (botëvështrimi) i Millosheviqit, përpjekja e nisur qysh para Luftës së Parë Botërore për të vënë nën kontroll kombet jo-serbe.

Janë këto të fundit, siç lë të kuptohet nënteksti i fjalimit, ato që duhet t'i përshtaten Serbisë dhe identitetit serb. Kjo botë e ndërtuar përmes retorikës dhe mjeteve të saj mund të kuptohet më mirë duke aktualizuar teorinë e Charlandit mbi retorikën konstituive. Sipas këtij autori, retorika konstituive është një element i rëndësishëm nëpër fushatat politike nacionaliste.

Për më tepër, teksa përmendet fjala “hero”, fjalimi jo rrallëherë përqendrohet në karakterin e publikut. Kështu, fjalimi i jep publikut shpresë, krenari dhe vlera pozitive. Është një rast kur Millosheviqi thotë:

“Askush nuk do ta harrojë heroizmin e atyre që mbronin qytetarët, ata që mbronin fabrikat, sheshet, qytetet e tyre, shtetin e tyre si dhe popullin e tyre. Hero është populli – dhe ky është ndoshta përfundimi më i shkurtër i mundshëm sa i përket kësaj lufte. Hero është populli dhe kjo është arsyeja pse ata duhet të ndihen heroikë si dhe të veprojnë në mënyrë heroike”.

Ashtu sikurse në rastin e Gazimestanit ku publiku u ndërtua sipas një avazi që i mëshonte ringjalljes dhe nacionalizmit, edhe ky fjalim krijon njësoj një identitet themelor kolektiv. Ai, po ashtu, kërkon një publik që duhet të mendojë dhe të veprojë ashtu siç thotë politika nga lart. Në cilësinë e oratorit, presidenti serb krijon një shtet të idealizuar dhe ngre lartin kultin e ushtrisë dhe të ushtarit. Të gjitha këto mundësohen nga përdorimi i fjalëve të tilla si “hero”, “i denjë”, “fisnik” dhe “i përgjegjshëm”.

Duke e pohuar në formë maksime se *“populli është hero”* dhe se serbët duhet të ndjehen heronj e të veprojnë si të tillë, fjalimi ia del mbanë të sjellë në jetë një publik që beson në fuqinë e Serbisë dhe nacionalizmit. Kjo mpirje thuhetse hipnotike e bën publikun dëgjuar që

të krijojë besimin se populli serb dhe ushtria e tij nuk kanë frikë nga lufta. Po sipas këtij rezonimi, luftërat janë vetëm për një ushtri, e cila përbëhet nga një komb që përbëhet vetëm nga serbë.

7.13. Pikëpamja për botën dhe sajimi i publikut

Mënyra e ndërtimit të publikut si dhe shqyrtimi i imtësishëm i togfjalëshave dhe cilësorëve të përdorur në fjalim, japin kristal qartë gjithë vizionin dhe botëkuptimin e Millosheviqit, i cili mbizotëroi në mënyrë absolute hapësirën publike serbe. Autori McGee thotë se një lider nuk bën një përshkrim të realitetit, por ai krijon vetëm një mit politik.

Duke e marrë të mirëqenë Kosovën si diçka serbe, fjalimi nuk përshkruan realitetin për publikun serb. Ç'është e vërteta, ai më tepër e krijon një trillim në publikun retorik: një ëndërr, një fantazmë dhe një mit politik. Pra, alkimia e autorit është për të transponuar imazhe mitike në të tashmen ashtu sikurse edhe nga e tashmja të projektojnë të shkuarën.

Duke pasur parasysh të gjitha këto, është me rëndësi të theksohet se retorika e Millosheviqit në Beograd e ka të theksuar disafish më shumë elementin nacionalist po qe se krahasohet me fjalimin e mbajtur në Gazimestan. Në një situatë të përmbysur, Millosheviqi i jep të drejtë vetes që të zhytet në një gjuhë pamëshirshëm agresive. Duke i pasur si kryefjalë “populli” dhe “qytetarët”, ai liston një bashkësi përdorimesh të fjalëve “luftë”, “identiteti”, “pavarësia”, “liria” dhe “integriteti me Kosovën”. Ngjyra dhe toni i fjalimit është rreptësisht polarizues, meqë Kosova, sipas mentalitetit të sapokrijuar politik në Serbi, konsiderohej ende si një nga çështjet më të rëndësishme e të pazgjidhura.

McGee shprehet se “qenia njerëzore në masë të madhe sillet dhe mendon ndryshe nga qeniet njerëzore në izolim”.¹³³ Ky fjalim është pikërisht prova më e gjallë që e mbështet këtë teori, duke përdorur fjalë të tilla si “hero”, “identitet”, “Ne nuk do ta japim Kosovën” si dhe “agresion”.

Vizioni i fjalimit shpaloset nëpërmjet elementesh të ndërtimit të identitetit; poende ka edhe ndikime konfliktnxitëse. McGee shton: “Kur dikush duket se ‘mendon’ dhe ‘sillet’ kolektivisht, ai është mashtruar, vetëmashtruar apo manipuluar për të pranuar ekzistencën e egër të fantazive të tilla si ‘mendime publike’ ose ‘filozofi publike’”.¹³⁴ Po e njëjta gjë ndodhi me publikun serb.

133 McGee, 1980: 2.

134 Po aty.

7.14. “Populli ishte ushtri dhe ushtria ishte popull”

Fjalimi luan gjithnjë me terma grandiozë duke theksuar komunitetin serb dhe unitetin e kombit. Aty theksohet me emfazë se Kosova historikisht ka qenë pjesë e Serbisë dhe kështu do të jetë gjithmonë.

Në këtë mënyrë, fjalimi nënvizon vazhdimësinë e supozuar historike të shtetit serb mbi Kosovën.

Kur përdoret togfjalëshi *“populli ishte ushtri dhe ushtria ishte popull”*, bota e fjalimit sjell heronj që nesër do të kenë një status dhe do të funksionojnë si modele kombëtare. Ky përfundim vjen pashmangshëm, sepse fjalimi në këtë mënyrë u referohet ushtarëve serbë; ata kanë sakrifikuar jetën e tyre për të mbrojtur dinjitetin serb. Duke i transponuar ushtarët në plan të parë, Millosheviqi apelon për aq sa mundet në ndjenjat patriotike të serbëve. Për shembull, ai thotë: *“Në këtë moment, mendimet tona të para duhet të jenë me heronjtë që dhanë jetët e tyre në mbrojtje të atdheut, në luftën për lirinë dhe dinjitetin e njerëzve. Ne kurrë nuk do të jemi në gjendje për t'i shpërguar ata për këtë”*.

Fjalimi, më tutje, këshillon publikun që të ndjehet borxhli ndaj ushtarëve dhe policëve në front, duke i mëshuar bindjes ndaj autoritetit të shtetit serb, ashtu siç dëshmohej nga kjo pjesë e fjalimit:

“Ne duhet të bëjmë atë që mundemi dhe çfarë është detyra jonë e ajo është që të përkujdesemi për familjet e tyre dhe të jemi gjithmonë të gatshëm për të mbrojtur dinjitetin e lirisë dhe pavarësinë e këtij vendi për të cilin ata dhanë jetën”.

Nëse dot të kërkohej evidencimi i karakteristikës më gjithëpërfshirëse të këtij fjalimi, atëherë nuk do të ishte larg së vërtetës vlerësimi se Millosheviqi e shet lehtësisht figurën e tij si dikush që shqetësohet vetëm për fatet e popullit të tij. I parë përtej publikut serb, gjuha e shfrenuar ekstremiste e fjalimit krijon tek të gjithë popujt e tjerë kërcënim e frikë.

Një frymë të tillë bartin edhe fraza e fjali të tilla si *“Ne nuk do të heqim dorë nga Kosova. Ne nuk kemi hequr dorë nga Kosova”*, nënteksti i të cilave është se populli serb ka ende gatishmëri për të luftuar kundër shqiptarëve dhe “djallit ndër kombëtar”, shprehje kjo me të cilën aludon për ShBA. Në këtë mënyrë, Millosheviqi shpërfill shumicën dërrmuese të popullatës së Kosovës, që përbënte mbi 90 për qind të shqiptarëve, teksa në të njëjtën kohë mbivlerëson serbët.

Situata retorike e krijuar përmes fjalimit, sikur faktin se edhe tani ka një *problem të ngutshëm*, i cili kërkon zgjidhje përmes një publiku

retorik. Në këtë pikë, ai është veçse vazhdimësi politike dhe retorike e fjalimit të parë me aspiratën e krijimit të Serbisë së Madhe. Për më tepër, ai e ruan të njëjtën lidhje me fjalën “popull”. Sepse, sipas fjalëve të Millosheviqit, populli nuk do të kapitullojë. Rrjeta e fjalëve që ndjek “popullin” përbëhet gjithnjë nga aso që theksojnë anë grandioze si “fuqia”, “trimëria”, “liria” dhe “heronjtë”.

Përderisa në fjalimin e parë përdorën argumente nga trualli mitologjik për mungesën e unitetit në Serbi, Millosheviqi këtu cyt publikun për “fuqinë e tij, “trimërinë” dhe “heronjtë”, të cilët, sipas fjalimit, janë të gatshëm të mbrojnë vendin ndaj “agresionit”.

Mbivlerësimi i popullit serb dëshmon se “nga perspektiva retorike, i gjithë procesi i socializimit nuk është gjë tjetër veçse ushtrime të ngjeshura dhe të vazhdueshme për bindje: individët duhet të joshen në tejkalimin e individualitetit të tyre, të bindur për socializimin e tyre (...) më vonë gjatë jetës kur pushtetet u kërkojnë atyre t’i binden një ligji ose të vdesin në luftë për Perëndinë dhe shtetin/vendin”, po ta citonim një vlerësim të autorit McGee.¹³⁵

7.15. Paradoksi i luftëtarit dhe viktimës

Fjalimi është mbarështruar edhe në njëfarë mënyre disi diplomatike. Fjala vjen, kur ka pjesë që shqiptojnë njëfarë përshëndetje abstrakte: “*Unë i uroj shumë fat dhe lumturi të gjithë qytetarëve të Jugosllavisë*”, fjalimi vetëm sa e fuqizon pozicionin politik të Millosheviqit.

Ai etablohet si një udhëheqës të cilin askush nuk është në gjendje ta akuzojë për aq sa kujdeset vetëm për kombin serb. Por as këtu Millosheviqi nuk përmend dhjetëra mijëra civilët shqiptarë të vrarë e të masakruar, as rreth 1 milion të shpërngulurit me dhunë dhe as 20 mijë femrat e përdhunua shqiptare, viktima të popullit, ushtrisë e unitetit që u arrit nëpërmjet fjalimeve të tij.

Edhe në gërmadhat e botës së gjakut që solli Millosheviqi, edhe kur vendi ishte pokaqisur ekonomisht, presidenti serb nuk heq dorë nga pozicionet e pakompromis për Serbinë dhe serbët. Më pas, po të njëjtat pozicione do të bëheshin edhe të opozitës që pretendonte se ishte e kundërta e Millosheviqit. Kur është fjala për Kosovën, ai thekson se asnjë opSION tjetër nuk vinte në shprehje përveç atyre që i ofronte Beogradi (“*vetëm autonomia, dhe asgjë tjetër jashtë kësaj, mund të përmendet në këtë proces politik*”).

135 McGee, 1975: 242.

Sikundër edhe në shumë vende të tjera gjatë fjalimit, Millosheviqi e lë të hapur mundësinë për një cikël të ri dhune, ashtu siç e dëshmon edhe kjo pjesë:

“Populli është hero dhe kjo është arsyeja pse ata duhet të ndjehen heroik dhe të veprojnë heroikisht, duke nënkuptuar në një mënyrë dinjitoze, fisnike dhe të përgjegjshme”.

Me shprehje e përdorime të qëllimshme të fjalëve me rremb emocional si “liria”, “humbja”, “populli” e “mbrojtja”, duke lartësuar policinë e ushtrinë serbe si dhe duke zëruar kërkesat për të mos hequr dorë nga Kosova, fjalimi sajton një publik që e merr si të mirëqenë dhe krejt të natyrshëm faktin se serbët duhet të hyjnë në luftë e të vdesin duke e mbrojtur Kosovën.

E gjithë kjo logjikë është e shitshme tek publiku serb, të cilit përgjatë një dekade indoktrinim i është mbushur mendja top që Kosova do të thotë liri për Serbinë. Publiku tashmë gjendet brenda kristalit të situatës retorike ku besohet se vdekja për liri është gjëja më e mirë që një serb mund të bëjë për vendin e tij. Pra, fjalimi në të gjitha instancat është kujdesur që të transmetojë idenë për një pikëpamje ekskluziviste të gjërave: “liria” vlen vetëm për popullin serb, por jo edhe për qytetarët e tjerë të Jugosllavisë.



Shkëputje nga fjalimi në Gazimestan (TV Serbia)

Duke depërtuar me anë të analizës së togfjalëshave dhe fjalive, ***fjalimi ka një paradoks thelbësor, por i cili nuk vihet re nga publiku marrës. Sado që vizionohet imazhi i një populli luftarak, gjithnjë e më shumë theksohet ndjenja e të qenit viktimë.*** Populli serb, sipas tij, është i bashkuar dhe ka sakrifikuar veten për lirinë e vet dhe të të tjerëve. “Populli” është tema kryesore për Millosheviqin: populli serb mbrojt Serbinë me trimëri e vetëflitim. Si produkt i gjithmbarshëm i fjalimit del edhe sindroma e viktimës, ashtu siç ishte rasti me fjalimin e Gazimestanit.

Me fjalë të tjera, fjalimi dhe gjuha e Millosheviqit ia doli ta sajonte dhe formësonte situatën retorike të dëshiruar, por e cila, për hir të së vërtetës, nuk ishte e determinuar paraprakisht. Kjo nënkupton se fjalimi nuk ishte i detyruar t’i përshtatej situatës retorike. Është më se e qartë se në rrethanën kur u mbajt fjalimi, folësi kishte goxha shumë mundësi që të zgjedhte përdorimin e shprehjeve gjuhësore. Kësisoj, këto konsiderata e bëjnë edhe më të qartë faktin se nuk bëhet fjalë për një *situatë retorike* imponuese. Arsyeja është se këtu që më parë, pra para situatës retorike, ishte një person që mbante fjalime e ndikonte tek masat e gjëra.

7.16. Të “tjerët”

Nga situata retorike e përfutur dhjetë vjet më herët në Gazimestan, publiku e besonte me të madhe se Serbia, qysh prej 1389-s, e mbrojt jo vetëm veten e saj, por edhe gjithë Evropën. Tani, në një mënyrë larg më të sofistikuar, nënteksti i fjalimit thotë se serbët jo vetëm që e mbrojtën Serbinë, porse ata gjithashtu ndihmuan në rikthimin e Kombeve të Bashkuara (OKB) si lojtar me rëndësi në skenën botërore.

Posi në rastin pararendës, ashtu edhe me fjalimin në Beograd Millosheviqi bën çmos për ta fshehur dështimin masiv politik. Këtu duhet kërkuar pseja që në fjalim sërish drejtohet gisht i fajit tek “të tjerët”.

Megjithëkëtë, duke harruar viktimizimin nga rreshti në rresht, fjalimi sakaq bën edhe një hap tutje. Publikut i injektohet ideja se populli serb është mjaft i fuqishëm dhe se ai kurrë nuk do të kapitullojë para NATO-s.

Sa i përket çështjes së Kosovës, pikëpamja e fjalimit përpiqet të duket si e baraspeshuar. Si në vitin 1989, edhe këtu fjalimi shpalos

bindjen se Serbia kurrë nuk do të heqë dorë nga Kosova dhe se populli serb e do një bashkim të territorit të Serbisë me territorin e saj “të shenjtë”. Edhe “uniteti”, aq shumë i proklamuar në të dyja ngjarjet, e racionalizon në ndërgjegjen kombëtare agresionin: të vdesësh për Kosovën nuk është turp.

Ndryshe prej fjalimit të Gazimestanit kur përpara ishin objektivë të tjerë politikë, fjalimi i dytë nuk kishte si t’i eskivonte ngjarjeve të përjetuara. Ndaj kjo është arsyeja pse fjalori ka prirje të bëhet agresiv e luftëdashës. Fjalimi është një monolog veç për publikun serb, aq sa krijon përshtypjen e njëfarë pafajësie, se gjoja lideri shqetësohet vetëm për lirinë e popullit të tij e nuk merret me të tjerët. Por, fjalimi nuk shqitet nga substrati nacionalist që përshkohet nga urrejtja ndaj “të tjerëve”.

Duke përdorur fjalën “hero”, fjalimmbajtësi e merr të mirëqenë, por edhe vetë marrësit e mesazhit, një publik që është i guximshëm e krenar. Ideja e dhënë, drejtpërdrejtë e tërthorazi, është se serbët janë një popull trim, që janë në gjendje të mbrojnë kombin e tyre nga “agresioni” i NATO-s.

Ashtu si në rastin e Gazimestanit, me çështjen e pashmangshme të Kosovës, fjalimi sendërton një publik të fuqishëm e të përshkuar nga ndjenja nacionaliste. “Kosova”, si fjalë, merr veti të forta ndikuese e morale në këtë fjalim. Mbipërdorimi i saj në ligjërimin e përgjithshëm publik në Serbi, ashtu sikurse edhe në fjalim, ka për qëllimin sajimin e një publiku që nuk ka nevojë të shqetësohet për varfërinë sociale dhe as mos të jetë kritik ndaj problemeve të brendshme ekonomike në Serbi. Intenca parësore është që publiku dhe udhëheqësi të jenë në sintoni mes vete, pra të kenë të njëjtat pikëpamje për çështjet madhore. Është pak a shumë njëfarë *homo politicus* që, duke i lënë anash problemet e përditshme të jetës, mendon e bën atë që thotë Millosheviqi.

Përveç ngjashmërive, dy fjalimet që ndahen nga një dekadë mes vete kanë edhe dallime të shumta. Më poshtë do të jepen në mënyrë sinoptike disa prej tyre:

Dallimi i parë, dhe madje më i rëndësishëm, ka të bëjë me përdorimin e fjalorit karshi Perëndimit. Fjalët “agresion” dhe “armik” janë më të dukshme dhe të ngarkuara në këtë fjalim sesa në atë të Gazimestanit.

Ashtu siç është analizuar tekstualisht e me mjete të retorikës, fjalimi i 1989-s nuk kishte gjuhë të tillë sa të interpretohej si agresivitet verbal ndaj Perëndimit, siç është rasti me këtë që po shqyrtohet tani. Madje, në adresimin e mbajtur në Gazimestan, Perëndimi shihej si një aleat i mundshëm i Serbisë; tani në këtë fjalim Perëndimi ishte vetë

“djalli”. Po ashtu, është interesante të vihet në dukje se në fjalim më nuk përmendet as për kortuazi lajelulja e ideologjisë komuniste që shqiptohet si deklamim: “*Rroftë vëllazërim-bashkimi!*”.

Në fjalimin e Beogradit, fjala “popull” ka një shqiptim të fuqishëm; thjesht ai është epiqendra e adresimit. “Populli” është materializuar, është diçka konkrete, ai është edhe një lloj arme e atomizuar që Millosheviqi e përdor në çdo kohë për të arritur një publik të bashkuar.

Duke e krahasuar me Gazimestanin, fjalimi ka edhe dallime të tjera të rëndësishme. Në fjalimin e mbajtur në Beograd, vërehet prania e një publiku serb më agresiv e më të ashpër.

Fjalimmbajtësi përdor të gjitha mjetet oratorike që i vijnë në dorë për të mbajtur gjallë besimin në publik se Kosova nuk është e humbur. Ndërkaq, fryma e fjalimit të Gazimestanit shquhet për besimin e publikut në rikthimin e Kosovës në Serbi.

Ndërkohë, edhe ngjashmëritë kapërthuren në plot vende. Me situatën e re të krijuar, theksi nuk po vihej aq te “armiqtë e brendshëm” si dikur, por te “armiqtë” e jashtëm e agresivë, dhe që prapëseprapë serbët do të ishin të fituar.

7.17. Kulti i vdekjes

Është e rëndësishme se si në të dyja rastet Millosheviqi bashkon idenë e “vdekjes” me idenë e Serbisë. Pjesëtarët e publikut, tashmë të shkrirë në një tërësi uniforme, binden që ia vlen barra qiranë çdo sakrificë që bëhet për Serbinë, duke mos përjashtuar as vdekjen. Sipas Millosheviqit, vetë atdheu është i lidhur me brezat që kanë sakrifikuar jetën e tyre për Serbinë.

Një tjetër konsideratë, e cila vë shenjat e barazimit midis dy fjalimeve, në Gazimestan dhe Beograd, është figura e “armikut”. Thuhet se është një “armik” që historikisht e ndjek pas popullin serb. Duke thënë se “agresioni ka mbaruar”, fjalimi synon të bindë publikun se bashkësia ndërkombëtare (përndryshe “djalli” sipas retorikës millosheviqiane) është hija që vazhdimisht ndjek serbët. Si rrjedhim, edhe fjala “viktimë” mbart po të njëjtin mesazh në këto fjalime.

Përfundimi që del nga këto observime është se Millosheviqi, duke përdorur vazhdimisht fjalë të tilla si “viktima”, “populli”, “Kosova” dhe “Serbia”, nuk heq dorë nga ndërtimi i një imazhi për madhështinë kombëtare të Serbisë, forcat e saj ushtarake dhe aftësinë për të mbrojtur veten kundër “agresionit” të “okupatorëve perëndimorë”.

Kjo triadë fjalësh, “popull”, “viktima” dhe “ushtri”, janë përbashkuar nga një ind i vetëm. Është, summa summarum, derivati i ideologjisë komuniste dhe asaj nacionaliste të Millosheviqit. Kishte qenë kjo e para që kishte shërbyer si fasadë për nacionalizmin serb.

Vetëflijimi e sakrifica, që emfazohen veçmas në fjalimin e parë në Gazimestan, përbëjnë themelin e ndërtimit të një publiku luftëdashës. Këto elemente spikasin edhe në këtë fragment fjalimi që është cituar edhe më parë: *“Heroizmi i shfaqur në Kosovë ka qenë frymëzues për gjashtë shekuj, ai ka formuar bazën e krenarisë sonë dhe na bën të mos harrojmë se dikur kishim një ushtri të madhe, të guximshme dhe krenare, një nga të paktat që qëndroi e pamposhtur, madje edhe pse ajo humbi. Gjashtë shekuj më vonë, ne jemi të përfshirë edhe një herë në luftime dhe do të presim betejat e reja. Këto nuk janë lufta të armatosura, edhe pse të tilla nuk mund të përjashtohen plotësisht”*.

Duke përdorur mitologjinë, fenë dhe të panjohurën, fjalimi arriti të saldojë një lidhje të pashqitshme mes fesë dhe politikës. Fjalimi ka mbitheksuar fenë, gjuhën dhe përkatësinë etnike, që, sipas vizionit millosheviqian, përbënin të drejtën për të kontrolluar dhe dominuar *“tokën e shenjtë serbe”*.

Fjalimi, megjithatë, ia doli me sukses të sendërtonte një publik e popull që e transpononte botën e 1389-s si të ishte e tashmja. Për ironi, kjo ëndërr që nisi me 1989 vdiq më 1999 në pellgun e gjakut që e shkaktoi vetë Millosheviqi. Me situatën retorike të krijuar, rezultatja e kësaj oratorie ishte publiku, i cili që më shumë i preokupuar me mitologjinë dhe të kaluarën sesa me stadin e jetës bashkëkohore, realitetin ekzistues dhe të ardhmen.

8.0. FJALIMI NË BEOGRAD, 2000

8.1. Prapavija

Si i treti fjalim me radhë që është marrë në shqyrtim, fjalimi i Millosheviqit, i mbajtur në vitin 2000 në Beograd, përfaqëson plasaritjen më të thellë në karrierën e tij si udhëheqës politik. Edhe këtu bëhet fjalë për një rrethanshmëri ekzigjente: aty janë në ekuacion edhe një *problem i ngutshëm* dhe një *situatë retorike* e re. Për dallim nga konteksti i dy fjalimeve paraprake, te ky fjalim ka një ndryshim rrënjësor politik brenda sistemit politik në Serbi.

Në fillim të vitit 2000, në skenën politike në kryeqytetin serb u lajmërua prania e një opozite të fortë karshi Partisë Socialiste të Millosheviqit. Kësaj radhe, fjalimi sërish ka kthyer tytat kundër atyre që perceptoheshin si armiq të brendshëm e të jashtëm: “tradhtarët serbë” dhe NATO.

Për trembëdhjetë vjet me radhë, sa zgjati sundimi i hekurit i Millosheviqit, qytetarët e vendeve që përbënin dikur Jugosllavinë përjetuan pesë luftëra të përgjakshme. Ky cikël filloi me luftën në Slloveni (1991), vijoi në Kroaci dhe Bosnjë-Hercegovinë (1992), për të vazhduar më së fundi edhe në Kosovë (99-1998).

Viti 2000 nuk shënonte vetëm agimin e shekullit dhe mijëvjeçarit të ri, por edhe fundin e mjerimit për mbi 1 milion shqiptarë që iu nënshtruan spastrimit etnik dhe dhjetëra mijëra të tjerëve që u vranë. Akti i fundit i këtij cikli luftërash mbaroi me Kosovën. Shumica e refugjatëve të dëbuar me përdhunë, që ishin vendosur në Shqipëri, Maqedoni, Mal të Zi dhe në Evropën perëndimore, u kthyen në shtëpitë e tyre. Me largimin e forcave ushtarake dhe policore të Serbisë, Kosovën e lëshuan vullnetarisht disa dhjetëra mijëra serbë, një numër i të cilëve i druhej edhe hakmarrjeve eventuale për shkak të bashkëpunimit me aparatin e Millosheviqit. Në këtë kohë, personeli ushtarak i NATO-s u vendos në krejt territorin e Kosovës, ashtu sikurse edhe stafi civil i administratës ndërkombëtare. Me pak fjalë, gjithçka diktonte një situatë të re politike dhe retorike për Millosheviqin.

Duhet theksuar se në kohën kur u mbajt ky fjalim, si Serbia, ashtu edhe Kosova ishin të shkatërruara rëndë ekonomikisht, politikisht dhe moralisht.

Brenda Serbisë ultra-nacionalizmi vazhdonte të ishte faktor vendimtar në politikë; ekonomia ishte në krizë të thellë, përderisa institucionet shtetërore ishin shumë të dobëta. Ndaj, edhe fjalimi ka si poligon qitje NATO-n dhe shtetet e Evropës Perëndimore. Duke injoruar sistemin e dobët politik serb, Millosheviqi krejt fokusin e kthen drejt Perëndimit dhe NATO-s, tek të cilët e hedh fajin për vrasjet dhe masakrat e ushtrisë serbe ndaj shqiptarëve në Kosovë.

8.2. Situata retorike

Edhe ky fjalim u mbajt para ndërtesës së qeverisë në Beograd; televizioni shtetëror siguroi transmetim të drejtpërdrejtë të fjalimit. Në shtator të atij viti, Millosheviqi organizoi mbajtjen e zgjedhjeve presidenciale. Megjithëse pësoi humbje, ai e mohoi rezultatin e zgjedhjeve të para. Fjalimi, në fakt, u mbajt vetëm tri ditë para se qeveria e Millosheviqit të rrëzohej përballë protestave të gjëra në Beograd. Ndryshe nga dy herët e tjera, fjalimi kësaj radhe përftoi vlime të mëdha në Beograd: tani qytetarët nuk i bindeshin Millosheviqit, por po ngriheshin kundër tij. Megjithatë, kjo nuk solli ndryshim substancial: në të vërtetë ishte një nationalist me bindje, si Vojislav Koshtunica, ai që e mori detyrën e presidentit të Jugosllavisë më 6 tetor 2000.¹³⁶



*Pamje nga trazirat në Beograd, 6 tetor 2000
(Foto e marrë nga www.wikipedia.org)*

¹³⁶ http://no.wikipedia.org/wiki/Den_f%C3%B8derale_republikken_Jugoslavia.

Të katër luftërat e humbura dhe kostoja e rëndë ishin aq të paevitueshme, sa njerëzit në Beograd e qytete të tjera të Serbisë nuk mund të flisnin më me krenari për disfatat e as t'i shihnin si fitore. Vendi tani po kalonte në një rënie të paimagjinueshme politike e ekonomike.

Janë këto rrethana që kushtëzuan lindjen e një publiku tjetër; ai i mëparshmi, fantazmë, thuajse nuk ekzistonte më. Ky fjalim, pra, u mbajt pasi që shoqëria serbe po vinte në terma me realitetin: ishte kjo lufta e katërt me radhë që ishte humbur nën udhëheqjen e Millosheviqit.

E gjithë bota ishte në dijeni për totalitetin e asaj që ndodhi për pjesën më të madhe të viteve '90: luftime, rrethime, shkatërime totale, tortura, masakra, dhunë, plaçkitje dhe përdhunime. Edhe marrëdhënia me Malin e Zi po kalonte momente krize: zgjedhjet federale u bojkotuan nga autoritetet e Podgoricës.¹³⁷

Në krye të protestave kundër Partisë Socialiste të Millosheviqit u vunë organizatat studentore. Më prominentja prej tyre ishte Lëvizja "Rezistenca", e cila përbënte organizimin më të madh që ishte shfaqur ndonjëherë në Serbi kundër Millosheviqit. Në prill të vitit 2000, thirrjes së "Rezistencës" për demonstrata kundër regjimit të Millosheviqit iu përgjigjen rreth 100 mijë njerëz që vërshuan rrugët e sheshet qendrore në Beograd. Jugosllavia më as që ekzistonte, madje edhe Serbia e tashme nuk i përgjigjej askund atij imazhi, i cili ishte ndërtuar nëpërmjet fjalimeve të Millosheviqit.

Është viti 2000 dhe Serbia po jeton pa "zemrën" e saj – i gjithë Perëndimi ishte shokuar nga krimet kundër njerëzimit që shteti serb kreu në atë që e propagonte si "tokë e shenjtë". Për shkak të luftërave, Serbisë iu vunë sanksione ekonomike nga Perëndimi; zgjatja e tyre u kushtëzua me qëndrimin e Millosheviqit në pushtet.

Fjalimi karakterizohet nga një strategji e rryer oratorike me anë të së cilës ai u përpoq të justifikojë për kapitullimin politik dhe ushtarak. Partia Socialiste e Serbisë dhe Millosheviqi asokohe ishin në fundin e popullaritetit. Pavarësisht kësaj dhe kundër të gjitha basteve, Millosheviqi ende po përpiqej të shmangte përcarjen jo vetëm brenda radhëve të partisë, por edhe në shoqërinë serbe përgjithësisht.

Njerëzit dhe përkrahësit e tij nuk kishin më shumë kontroll mbi institucionet e rëndësishme në Jugosllavinë e mbetur. Madje katër ditë pas këtij fjalimi, Millosheviqi u detyrua të jepte dorëheqjen. Prandaj, e vetmja mënyrë mbijetese për të ishte sajimi i një armiku ashtu që

137 <http://www.regjeringen.no/nb/dep/ud/dok/regpubl/stmeld/20002001/Stmeld-nr-49-2000-2001-/2.html?id=195155>.

karriera e tij politike të mos quhej e mbaruar. Sërish e gjejmë atë duke e sajuar një bosht të “djallit”: janë “të tjerët” ata që po i bëjnë gjëmën serbëve. Këta të fundit vetëm sa kishin mbrojtur veten. Me këto nota viktimizuese, fjalimi u shpalos në Beograd.

8.3. Përmbajtja e fjalimit

Shqetësimi i Millosheviqit për gjendjen e sapokrijuar në Serbi, me tendenca përkeqësimi, zë vendin kryesor në fjalim. Ai e nis adresimin me një përshkrim të situatës politike para rrethit të dytë të zgjedhjeve në Serbi. Shi për këtë, Millosheviqi nuk resht së kritikuari vendet perëndimore dhe, sipas tij, krijimin e autoriteteve proamerikane në Serbi. Kreu i Partisë Socialiste rezervon jo pak agresivitet verbal ndaj opozitës në Beograd dhe kreut të Partisë Demokratike (*Demokratska stranka*), Zoran Gjingjiq.

Duke iu adresuar publikut të tij, Millosheviqi shpjegon, ndër të tjerash, mbi sovranitetin e kufizuar të Serbisë si rezultat i “politikave agresive” të Perëndimit. Është kjo pjesë ku ai bën tirada sesi Perëndimi qenkësh fajtor për shkaktimin e luftërave civile, eliminimin e luftëtarëve të lirisë kombëtare, zhytjen e shteteve dhe kombeve të tëra në varfëri e të tjera si këto.

Me këtë rast, ai përpiket t’i mveshë shtetit dhe kombit serb një funksion “anti-imerialist”. Sipas tij, Serbia është një pengesë për sundimin e plotë të Gadishullit Ballkanik. Fjalimi ka shumëçka për të thënë për opozitën politike që asokohe njihej si “Opozita Demokratike e Serbisë”. Në këtë sens, Millosheviqi akuzon rivalët e tij politikë për bashkëpunim me koalicionin ushtarak që bombardoi dhe sulmoi Serbinë. Opozita serbe, sipas tij, përbëhet vetëm nga “tradhtarë” dhe se ata janë në një vijë me “agresorët” që iu vërsulën Jugosllavisë.

Në fjalim, Millosheviqi shpjegon pse ai është kundër vendosjes së forcave të NATO-s në Kosovë. Teksa përshkruan situatën politike të Serbisë, ai thotë se Serbia do të ndahet në shumë provinca autonome; madje diku në fjalim edhe tund gogolin e organizatave radikale islamike në konstelacionin e ri të krijuar.

Udhëheqësi serb, që sundoi prej vitit 1987, flet shumë për Kosovën, e cila, sipas tij, do të jetë viktimja e parë; edhe Mali i Zi paralajmërohet se do të jetë nën dorën e mafies. Përmes aftësive retorike, ai dëshiron t’ia bëjë me dije publikut se një qeveri kukull do të thotë vetëm dhunë e luftë, por jo paqe.

Një temë e rëndësishme e fjalimit është edhe identiteti. Millosheviqi, nëpërmjet aludimeve, lë të kuptohet se identiteti serb do të vihet në rrezik nëse serbët shkëputen nga mbështetja për Millosheviqin dhe SPS-në. Ai i referohet Serbisë si shtet sovran që ka kushtetutën dhe institucionet e veta.

Dhe më në fund, ai ngre pretendimin se NATO-ja nuk po sulmon Serbinë për shkak të Millosheviqit; kjo aleancë po e sulmonte Millosheviqin për shkak të Serbisë.

8.4. Pasojat e fjalimit

Por, publiku serb duket se po shfaq shenjat e para të sflitjes nga fjalët e mëdha. Për më shumë se dhjetë vjet radhazi, serbët dëgjuan veçse shprehje, formulime e fraza bombastike e grandomane. Gjatë kësaj dekade, jeta e tyre u bë gjithnjë më e vështirë dhe e keqe.

Kjo u reflektua edhe në shkallën e ulët të pjesëmarrësve në krahasim me dy fjalimet pararendëse. Sipas disa vlerësimeve të kohës, aty nuk ishin më shumë se 30 mijë serbë që e dëgjuan liderin deri në atë kohë të pakontestueshëm. Zhgënjimi me luftën dhe mjerimin ekonomik ishte evident kudo.

Publiku e pa me sytë e vet sesi brenda dy muajsh e gjithë ngrehina ushtarake dhe institucionale e Serbisë, që pandehej si simbol plotfuqie, u shkatërrua lehtësisht nga avionët e NATO-s. Angazhimi i të gjitha resurseve në agresionet në vendet fqinje kishte pasur edhe një kosto të rëndë njerëzore. Edhe papunësia preku nivele stratosferike duke arritur në mbi 60 për qind.

Për herë të parë, hapësira politike përftoi një aktor të ri, siç ishte opozita e re. Sado që ajo përbënte një konglomerat heterogjen formacionesh e ngjyrash politike, opozita fillimisht u angazhua për të shpartalluar censurën. Përmes kësaj, ata po përpiqeshin t'u shpjegonin masave se Millosheviqi është djalli dhe jo "të tjerët".



Pamje nga protestat kundër Millosheviqit, Beograd: 5 tetor 2000.

(Foto e marrë nga www.wikipedia.org)

Deri në atë periudhë, pushteti i Millosheviqit kishte pasur kontroll absolut në mediat kryesore në vend. Si rrjedhojë, të shumtë ishin njerëzit që kishin humbur besimin në stacionin televiziv shtetëror RTV-Beograd. Monopoli mbi publikun nuk mund të ruhej më: serbët tani kishin media të tjera alternative, si interneti dhe mediat e huaja. Në këtë periudhë turbullirash, mediat alternative më të njohura ishin B92 dhe BBC. Kryeqyteti i Serbisë u bë arenë përplasjesh masive: aty pati demonstrata edhe nga përkrahësit e Millosheviqit, edhe nga kundërshtarët e tij. Ky konflikt pasqyrohej edhe në mediat që u vunë në anë të ndryshme.

8.5. Analiza e fjalimit në Beograd (2000)

Për lehtësi të analizës, fjalimi do të ndahet në përmbajtje, prirje (anim) dhe gjuhë. Ky adresim është relativisht i gjatë dhe përfshin shtatë faqe të formatit A4. Në këtë fjalim, sikundër në pararendësit e tij më 1989 dhe 1999, fjala “Serbi” është një *term Zoti* që ka gjithsej 19 përmendje, e pasuar nga fjala “vendi” që përmendet 24 herë. Të dyja ato janë zgjedhur si fjalë kyçe, bazuar në frekuencën dhe intensitetin e përdorur. Në fjalim zënë vend edhe fjalët “Serbia” dhe “vendi ynë”, që përdoren në raporte korrelacioni.

Megjithëse fjala “NATO” në këtë fjalim përmendet vetëm gjashtë herë, ajo është një *term i djallit*. Është i tillë edhe për nga pozicioni

qendror që zë brenda tërësisë së fjalimit, por edhe nga shkalla e intensitetit të fortë.

Kurse NATO përshkruhet si djalli vetë, sepse kjo aleancë donte t'i merrte Serbisë shpirtin dhe zemrën e saj, Kosovën. Millosheviqi është kujdesur që në fjalim t'i vë në një paralele krahasimore NATO-n dhe demokratët (opozita serbe). Pra, kjo zbulon tekstualisht një marrëdhënie shkak-pasojë midis dy fjalëve kyçe. "NATO" dhe "demokratët" janë *terma djalli* sepse ata gjymtojnë Jugosllavinë.

Fjalimi, tutje, targeton NATO-n, të cilës i mvishen attribute që lidhen me vdekjen dhe errësirën:

"Por këto nuk janë qëllimet e vetme të NATO-s. Këto janë premtimet parazgjedhore të Opozitës Demokratike të Serbisë".

Një rreng i fjalimmbajtësit është edhe ajo që në logjikën formaliste njihet si "apelim te frika" (*argumentum in terrorem*). Kështu, publikut serb i tërhiqet vërejtja se nëse zgjedh opozitën, Jugosllavia, e cila është një *term i Zotit*, do të "gjymtohet". Kjo folje përmban një dimension shkak-pasojë; ndaj jo rastësisht përbri "gjymtimit" përdoret edhe fjala "Kosovë".

Tabela 4

Shkak	Pasojë
NATO	Gjymtimi i Jugosllavisë
Opozita serbe	Gjymtimi i Jugosllavisë

Në këtë fjalim, fjala "Kosovë" ka vetëm dy përmendje, por prapëseprapë ajo zë vend qendror dhe është e ngarkuar me patos. Millosheviqi thotë: *"Brenda kësaj politike të copëtimit të Jugosllavisë, Kosova do të ishte viktimja e parë. Statusi i saj aktual do të shpallej ligjor dhe përfundimtar. Është pjesa e parë e territorit serb, të cilës Serbia do t'i duhej t'i jepte lamtumirën, pa shpresë se ne mund ta rimarrim këtë pjesë të vendit tonë".*

Kosova është një shembull i rëndësishëm politik për Millosheviqin. Ajo është njëfarë fakti i gjallë dhe argument i fortë se çfarë mund të ndodhë nëse serbët nuk janë të bashkuar dhe hezitojnë të votojnë për Partinë Socialiste të Millosheviqit.

Megjithë frekuencën e vogël të përmendjes, fjalët që ndajngjiten "Kosovës" janë tejet konfliktuoze, siç dëshmohet nga shembujt: "Serbia", "viktimat e para", "pjesa e parë e vendit tonë" dhe "toka serbe".

Pasi i nënshtrohet analizës kjo bashkësi fjalësh, përfundimi është se Kosova e fjalimit ende është ngjarja më e veçantë, pra e një vlere të pazëvendësueshme për ligjërimin publik serb. Edhe këtu, si në raste të

tjera, ajo konsiderohet si njëfarë “Jerusalemi” serb. Por tani ligjërimi merr disa nuanca të reja: sado që ajo është pjesa më e rëndësishme e tokës serbe, Kosova është viktimë e parë politike. Ky kuptim vjen nga kjo pjesë e fjalimit: *“Kosova do të ishte viktimë e parë. Statusi i saj aktual do të shpallë ligjor dhe përfundimtar. Është pjesa e parë e territorit serb, të cilës Serbia do t’i duhej t’i jepte lamtumirën, pa shpresë se ne mund ta rimarrim këtë pjesë të vendit tonë”*.

8.6. Analiza e grupimit të fjalëve

Fjalimi riciklon ato që ishin trumbetuar ndër dekada nga publicistika e media serbe se gjoja kisha dhe shteti serb i kanë rrënjët vetëm në Kosovë. Ky ingranazh i propagandës retorike funksionon mu në saje të këtyre elementeve. Ato mund të krijojnë një ndjenjë identiteti që kërkon që subjektet të funksionojnë në përputhje me identitetin e tyre që u miratua në histori.¹³⁸

Përndryshe, Millosheviqi përdor disa sinonime për NATO-n, një prej të cilëve është edhe “Evropa Perëndimore”.

Pra, fjalimi si tërësi vetëm sa përzmadhon në formë altoparlanti përshkrimet politike që Millosheviqi ia rezervonte “djallit” ndërkombëtar, d.m.th Perëndimit. Nga kjo logjikë retorike, “Perëndimi” kategorizohet si *term i djallit*. Ai përmendet vetëm një herë, porse ka një intensitet të madh; madje që në fillim të fjalimit ai u thotë të pranishmëve që e dëgjonin:

“Siç e dini, përpjekjet janë duke u zhvilluar për një dekadë të tërë për të vënë të gjithë Gadishullin Ballkanik nën kontrollin e fuqive të caktuara perëndimore. Një pjesë e madhe e asaj pune u arrit duke krijuar qeveri kukullash në disa vende, duke i transferuar ato në vende me sovranitet të kufizuar ose pa sovraniteti fare”.

Duke e transponuar këtë qysh në krye të fjalimit, analiza jonë është në gjendje të hetojë faktin se sërish “të tjerët” bëhen adresa ku kërkohet fajtori për kapitullimin ushtarak dhe fiaskon politike të Serbisë. Nuancimet emocionale nuk mungojnë: sipas Millosheviqit, NATO-ja është kundërshtarë në dramën e jetës serbe. Kudo nëpër fjalim, “Fuqitë perëndimore” konsiderohen si fajtorë për luftën, mjerimin dhe masakrat në të gjithë hapësirën e ish-Jugosllavisë.

Let’i kthejmë gjërat në perspektivë: në fjalimin embajtur në Gazimestan, Perandoria Osmane ishte akuzuar dhe mallkuar si përgjegjëse dhe fajtorë

¹³⁸ Charland 2001: 617.

për keqtrajtimin e popullit serb. Me të njëjtin avaz, Millosheviqi sërish akuzon dhe mallkon vendet e Evropës Perëndimore dhe NATO-n. Janë këto dy formulime që në të dëgjuar, për publikun dhe situatën retorike në momentin e dhënë historik, bëhen pothuajse sinonime të vdekjes dhe djallit. Fjalimi, midis të tjerash, ka edhe këtë pjesë:

“E gjithë përvoja që Fuqitë e Mëdha fituan në gjysmën e dytë të shekullit të 20-të në përmbyshjen e qeverive, duke shkaktuar trazira, duke nxitur luftëra civile, duke nënçmuar ose likuiduar luftëtarët e lirisë kombëtare, duke sjellë shtete dhe kombe në prag të varfërisë – dhe të gjitha këto janë zbatuar në vendin tonë dhe për popullin tonë. Territori që do t’i lihej ta mbante emrin Serbi, do të pushtohej nga forcat ndërkombëtare, ShBA apo ndonjë shtet tjetër. Ata do ta trajtonin tokën tonë si terren të tyre të stërvitjeve ushtarake, si rezervat të tyre privat, për t’u kontrolluar në përputhje me interesat e fuqisë pushtuese. Për një kohë të gjatë ka pasur grupime mes nesh, e të gjitha ishin nën maskën e të qenit prodemokratik, në fakt i kanë përfaqësuar interesat e qeverive që e sulmojnë Jugosllavinë e në veçanti Serbinë”.

Pra, Millosheviqi e ndjen të nevojshme që publikut t’i argumentojë dhe shpjegojë arsyen se përse forcat e NATO-s erdhën të pafuara në “tokën serbe”.

Çdo pikëpamje që shtresëzohet në fjalim vetëm sa e thekson sindromën e viktimës. Ende vazhdojnë të jenë “të tjerët” fajtorë, kurse serbët (kategoria e “ne”) janë viktima. Sipas tij, serbët gjatë gjithë historisë iu desh të mbroheshin kundër armiqve të jashtëm, por tani ata duhej të mbroheshin edhe prej kolaboracionistëve të brendshëm. Kjo dikotomi përmendet disa herë radhazi në fjalim. Millosheviqi thotë:

“Gjatë zgjedhjeve, një grup e quajti veten ‘Opozita Demokratike’ e Serbisë. Udhëheqësi i tij nuk është kandidati presidencial. Ai është vetëm presidenti i Partisë Demokratike. Për vite me radhë, ai ka bashkëpunuar me aleancën ushtarake, e cila e sulmoi vendin tonë. Dhe ai nuk mund ta fshehë bashkëpunimin e tij. Në fakt, i gjithë populli e di se ai i bëri thirrje NATO-s për ta bombarduar Serbinë për aq javë sa ishte e nevojshme për të thyer rezistencën e saj”.

8.7. Boshti i së keqes

Fjalimi bazohet në një strukturim të “boshtit të së keqes”. Në këto sajime retorike, janë gjithnjë “të tjerët” ata që po e shkatërrojnë çështjen serbe. Serbët vetëm po e mbrojnë veten. Një pikë tjetër e rëndësishme është se fjalët “tradhti” dhe “opozita” janë të lidhura mjaft ngushtë me njëra-tjetrën.

Mirëpo ka edhe një element tjetër me rëndësi brenda fjalimit, i tillë që e tejkalon edhe ideologjinë dhe botëkuptimet e fjalimmbajtësit. Kudo gjatë fjalimit, drejtpërdrejt ose tërthorazi, bëhen krahasime mes opozitës serbe dhe NATO-s. Kritikë në këtë fjalim kanë si adresë opozitën serbe, përkatësisht Partinë Demokratike Serbe. Është Millosheviqi ai që zbulon lidhjen mes opozitarëve në Beograd dhe “forcave të huaja”.

Në këtë mënyrë, fjalimi e vendos opozitën serbe në të njëjtin stol “tradhtarësh” me ata që bashkëpunojnë me NATO-n, domethënë me forcat e huaja.

Format e sulmit janë të llojllojta: diku me një vend Millosheviqi përdor shprehjen “kolaboracion”. Sado që përdoret tekstualisht vetëm dy herë, fjala sidoqoftë ka ende një nënkuptim të madh. Ajo, në fakt, vjen nga folja latine *collaborare* që do të thotë “të bashkëpunosh”. E përfutur nga kjo, “kolaboracionist” do të thotë personi që bashkëpunon me armikun.¹³⁹ Kjo fjalë është përdorur gjerësisht në Luftën e Dytë Botërore për të shënuar forca e grupe lokale që bashkëpunuan me forcat naziste dhe aleatët e tyre. Si *term djalli*, me “kolaboracion”¹⁴⁰ i referohet forcave të brendshme që bashkëpunonin ose kishin simpati për gjermanët.

Në sajë të këtyre përdorimeve dhe nënkuptimeve, fjalimi apelon emocionalisht teksa sugjeron se opozita në Serbi është “tradhtarë” njësoj si homologët e tyre gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Gjykuar nga tradita negativiste e përdorimit të këtij termi thellësisht linçues për mendësinë e shoqërive në Ballkan, dëmi është shkatërrues për atë që i adresohet. Pra, publiku që ende po krijohet retorikisht nga Millosheviqi nis të asociojë kolaboracionizmin me opozitën serbe.

Duke opozuar me kundërshtarin e tij kryesor nga radhët e opozitës, Millosheviqi fillimisht e lëçit Gjingjiqin si njeri që është bërë vegël e të huajve (“*Vite me radhë, ai ka bashkëpunuar me aleancën ushtarake, e cila e sulmoi vendin tonë*”); se kjo tradhti është kaq e dukshme (“*Dhe ai nuk mund ta fshehë bashkëpunimin e tij*”); se bombardimet lidheshin me të (“*Në fakt, i gjithë populli e di, se ai i bëri thirrje NATO-së për ta bombarduar Serbinë për aq javë sa ishte e nevojshme për të thyer rezistencën e saj*”).

Fjalimmbajtësi kërkon të bindë publikun se në dështimin e tij politik kanë gisht politikanët e opozitës të cilët tradhtuan dhe bashkëpunuan në interes të qeverive të huaja. Jo rastësisht fjala “fuqi të huaja” vihet në

139 Fjalor norvegjez, 1998: 306.

140 Sinonim i njeriut pa shtyllë kurrizore dhe me zemër tradhtari.

relacione kundrejt fjalës “demokratët tanë”. Me sa duket, kjo e fundit përdoret me një ironi të qëllimshme, ashtu që tek publiku të krijohet bindja se ata nuk janë as serbë, por veçse marioneta të huaja:

“Prandaj, ky grup ‘demokratik’ i organizuar për këto zgjedhje i përfaqëson ushtritë dhe qeveritë të cilat së fundmi zhvilluan luftë kundër Jugosllavisë. Me urdhër të këtyre fuqive të huaja, demokratët tanë u thanë njerëzve se ata do ta bënë Jugosllavinë të lirë nga lufta dhe dhuna, se Jugosllavia do të përparonte, standardi i jetesës do të përmirësohej dukshëm dhe shpejt, dhe që Jugosllavia do të ribashkohej me institucionet ndërkombëtare, etj. etj.”.

Fjalimi kudo i kriminalizon kundërshtarët politikë. Për shembull, bri fjalës “*president i demokratëve*” vendoset fjala “boss”, që siç dihet rëndom ka konotacion negativ dhe përfton imazhet e mafies siciliane. Këtë ka parasysh kur në fjalim thotë: “*Bossi i tij nuk është kandidati i tij presidencial. Ai është vetëm presidenti i Partisë Demokratike*”.

Teksa i referohet situatës në Serbi dhe luftës përreth, Millosheviqi përdor fjalën “pushtues”. Si term i shenjtë, kjo fjalë zotëron një vend qendror në fjalim. Megjithëse brenda tekstit të fjalimit ka vetëm tetë përmendje, “pushtues” ende ka funksionon e fjalës kyçe; për më tepër, ajo ka përmendje me shumë intensitet. Kjo fjalë, pra, është *term i djallit* dhe aludon e sinonimon për forcat e NATO-s.

Krahas kësaj, Millosheviqi përdor me po kaq intensitet të madh fjalën “fuqi e madhe”. Sipas tij, “Fuqitë e Mëdha” janë një nga aktorët kryesorë që sjellin mjerim dhe varfëri jo vetëm në Serbi, por në të gjithë botën. Duke abstraktuar se këto “fuqi të mëdha” janë në gjendje të shkatërrojnë të gjithë botën, publikut i sugjerohet se është mjaft e qartë se ato gjithashtu mund ta shkatërrojnë Serbinë dhe popullin serb.

Prandaj, Millosheviqi ngulmon në evokimin e përvojave “kolonialiste” (“*në gjysmën e dytë të shekullit të 20-të në përmbysjen e qeverive*”); metodat e pandershme të tyre në përmbysjen e qeverive (“*duke shkaktuar trazira, duke nxitur luftëra civile, duke nënçmuar ose likuiduar luftëtarët e lirisë kombëtare*”); varfërimet të qëllimshme (“*duke sjellë shtete dhe kombe në prag të varfërisë*”) dhe se, në fund, edhe Serbisë i ka rënë hise një fat i këtillë (“*dhe të gjitha këto janë zbatuar në vendin tonë dhe për popullin tonë*”).

8.8. Një identitet as andej, as kënde

Shprehjet më së shpeshti të përdorura në këtë fjalim – e që kanë cilësi të *termave të Zotit* – janë fjalët “Serbi”, “sovrانيت”, “identitet” dhe sinonimi i saj “ne”, ndërkohë që fjalët kyçe, ose si *terma djalli*, janë “NATO” dhe sinonimet “ata”, “pushtuesit” dhe “Opozita Demokratike e Serbisë”.

Vetëm kështu, fjalimi ndërton botën e mirë dhe atë të keqe, e cila jep përshtypjen se ato janë vazhdimisht në konflikt me njëra-tjetrën. Edhe opozita në Serbi, në plot përmendje, e ka të rezervuar sinonimin “kolaboratorët”.

Pra, Millosheviqi procedon kudo me formulime dikotomike që thjeshtëzojnë gjithçkajën në një botë të ndarë midis “atyre” dhe “neve”, midis “djallit” dhe “engjëjve”.

Mirëpo, fjalimi bën edhe një hap më tej: bota e tij ndahet midis Orientit dhe Oksidentit.

Tash “Orienti” ka fituar një perceptim më pozitiv në kundërvënien ndaj “agresorëve” perëndimorë. Kjo është mbase një nga paradokset më të mëdha jo vetëm të këtij fjalimi, por edhe e të gjithë diskursit politik e nacional në Serbi. Ai përbën një sjellje politikisht të çuditshme, kur kihet parasysh fakti se Millosheviqi orvatej gjatë gjithë kohës ta krijonte imazhin e tij si dikush i lidhur pas “Oksidentit”. Por, me përmbyshjen e situatës, ai tani e ndjen të nevojshme t’i përmbyshë edhe botëkuptimet dhe animet. Tanimë “Oksidenti” është bërë djalli vetë.

Kjo kundërtënie duket se nuk vihet re nga publiku në krijim e sipër, por as nga publiku i opozitës. Nëse në fjalimin e Gazimestanit “Orienti” përshkruhej si irracional, i papjekur dhe agresiv, tani papandehur “Oksidenti” bëhet pushtues, irracional dhe i shturur.

Në këtë fjalim shihet se Millosheviqi mjaft shpesh përdor përemrat vetorë “ne” dhe “ata”. Përemri i parë ka nëntë përdorime, derisa përemri i dytë ka tetëmbëdhjetë përdorime. Mu ky i fundit, pra “ata”, në mënyrë tacite ka konotacione negative në lidhje me “Fuqitë e Mëdha” dhe “Opozitën Demokratike në Serbi”. Si *term djalli*, ky përemër nënkupton jo vetëm vendet perëndimore dhe NATO-n, por edhe opozitën serbe në Beograd.

Në anën tjetër, përemri “ne”, si *term Zoti*, nënkupton shtetin dhe popullin serb. Millosheviqi identifikohet gjithnjë me “ne”. Në këto kombinatorika përdorimesh, ai e çon tutje imazhin e një njeriu të

fuqishëm, i cili mendon se është përfaqësues i të gjitha të mirave për kombin e tij dhe në historinë serbe. Kështu, autori i fjalimit me një vend nënvizon:

“Territori që do të lihej ta mbante emrin Serbi, do të pushtohej nga forcat ndërkombëtare, ShBA apo ndonjë shtet tjetër. Ata do ta trajtonin tokën tonë si terren të tyre të stërvitjeve ushtarake, si rezervat të tyre privat, për t’u kontrolluar në përputhje me interesat e fuqisë pushtuese”.

Fjalimi ngulmon në synimin e tij për të sendërtuar një publik, i cili duhet të besojë se në Serbi ekzistojnë dy forca të liga: njëra është aleanca perëndimore, kurse tjetra është kolaboracionizmi i opozitës. Që të dy këto forca të liga, në dritën e fjalimit, përshkruhen si djaj dhe me imazhin e armikut.

Ashtu si herëve të tjera, edhe kWY fjalim, me qëllim të arritjes së një homogjeniteti diskursiv, kërkon që populli serb të qëndrojë i bashkuar, sepse vetëm bashkimi ruan identitetin serb. Sepse mu përmes tij, siç sugjeron fjalimi, publiku ia del mbanë të shquhet nga anëtarët e grupeve të tjera etnike.

Përveç dimensioneve sociologjike e kulturore, formimi i një grupi identiteti ka edhe implikime gjuhësore. Ideja e fjalimit është se për serbët është e rëndësishme të krijohet një *“ne - grup”*. Në politika identitariste, kjo mundëson një perceptim të identitetit si *“i yni”* që është i ndarë nga *“i tyre”*.

T’i përkasësh një identiteti do të thotë të ekzistosh në të njëjtin territor. Kjo duhet të jetë arsyeja pse fjalimi përmban edhe ndajfolje hapësinore si *“këtu”* dhe *“atje”*. Duke përdorur përemrin vetor *“ata”*, fjalimi i bën thirrje opozitës serbe. Millosheviqi thotë:

“Qytetarë, ju duhet të vendosni vetë nëse do të më besoni apo jo. Dëshira ime e vetme është që ata të mos e kuptojnë që unë po e them të vërtetën kur të jetë shumë vonë, që ata të mos e kuptojnë kur të bëhet shumë më e vështirë për t’i korrigjuar gabimet që disa njerëz i kanë bërë në mënyrë naive, sipërfaqësisht ose gabimisht. Disa nga ato gabime do të ishte vështirë për t’i korrigjuar dhe disa nuk do të korrigjoheshin kurrë”.

Këtu, Millosheviqi përdor fjalët *“besoj”* dhe *“e vërteta”*. Ai, pra, dëshiron që publiku në Serbi të ketë një *“të vërtetë”* politike.

Por, monopolizimi i së *“vërtetës”* është një emër tjetër për të fasaduar qenësinë e një numri gënjeshtrash, të cilat ose e mohojnë të vërtetën, ose e shtrembërojnë atë. Dhe kjo bëhet më akute kur, sipas Millosheviqit, nuk ka asnjë të vërtetë tjetër pos asaj që ai thotë. Sipas autorit McGee, *“e vërteta në politikë, pa marrë parasysh sa fuqishëm*

besohet në të, është gjithmonë një iluzion”.¹⁴¹

Përbri fjalës “qytetarë” zënë vend fjalët “besoj” dhe “e vërteta”, të cilat përdorën me një intensitet të madh. Kësisoj, “qytetarët” janë të ndryshëm dhe ndahen nga “ata”. Fjala “qytetarë” përdoret kuptimisht si shumë e afërt me “ne”, përderisa përemri “ata” është larg “qytetarëve”.

Referenca të “ata”, aq shumë e theksuar dhe si aludim konstant tek opozita, i ka të qarta qëllimet. Pra, e gjithë përpjekja është që çdo alternativë jashtë Millosheviqit të mos ketë gjasa. Kjo pjesë e fjalimit e ilustron për bukuri këtë prirje:

“Qytetarët duhet ta dinë këtë, se nëse ata disa marrin pjesë në këtë përmbysje, objektivi i të cilit është dominimi i huaj si dhe pushtimi i vendit të tyre, atëherë ata do të mbajnë përgjegjësinë historike jo vetëm për t’i mohuar vendit të tyre të drejtën për të ekzistuar, por edhe për të humbur kontrollin mbi jetën e tyre. Duke ua lënë vendin e tyre të tjerëve dhe një vullneti të huaj, ata gjithashtu do t’i dorëzojnë një vullneti të huaj jetët e tyre dhe të fëmijëve të tyre si dhe jetët e shumë njerëzve të tjerë”.

Kudo, fjalimi krijon një hendek midis “ata” dhe “qytetarët”. Përemri “ata” është i karikuar me të keqen, ndërsa “qytetari” është i pafajshëm dhe i pastër. “Ata” janë kanceri i kombit serb.

“Identiteti” është një fjalë tjetër e rëndësishme në fjalimin e Millosheviqit. E përdorur pesë herë në tekst, kjo fjalë është *term* Zoti. Megjithë frekuencën jo edhe aq të madhe, fjala “identitet” ende ka funksionin e fjalës kyçe, sepse përmendet me intensitet të madh; po ashtu edhe intensiteti rreth kësaj fjale është shumë ndikues. Është tejet interesante sesi Millosheviqi gjithnjë me apelin në frikë (argumentum in terrorem), e tutë publikun se “identiteti ynë kombëtar do të shqyrtohej në mënyrë të padukshme në fillim” (sic!).

Por, kjo sipas tij, do të ishte vetëm fillimi sepse ky atak ndaj identitetit do të shpeshtohej (“në mënyrë shumë më efikase dhe të pamëshirshme”); se ky identitet do të reduktohej në “disa dëshira të kërkuara lokale” (“disa këngë dhe valle popullore me emrat e heronjve kombëtarë të përdorur si emrat e markave të produkteve ushqimore apo kozmetike”).

Fjalët që tubëzohen rreth “identitetit” janë “asgjësimi”, “autoriteti marionetë”, “disfata më e madhe” dhe “kolonizimi”. Pak më tej ai shton:

“Humbja e identitetit kombëtar është disfata më e madhe që mund të përfetojë një komb, dhe është e pashmangshme nën formën bashkëkohore të kolonizimit”.

141 McGee 1980: 4.

Duke vënë në llupën e shqyrtimit këto grupime fjalësh, analiza mundëson të kuptohet se “identiteti” është një element i rëndësishëm, i cili nënkupton rrezikun më immanent për Serbinë.

Fjalimi aty-këtu është spërkatur edhe me përdorime të ironisë dhe metaforave. Kjo shkakëzon konflikt rreth fjalës “identitet”, ngase identiteti është i përjasur ngushtë me antagonizëm që krijon dramë dhe emocione; të tilla janë edhe fjalët e shprehjet si “torturë”, “avokatët e pronarëve të huaj” dhe “pushtuesit”.

Qysh në shikim të parë kuptohet se fjalët në tufën e parë janë mbiemra që përshkruajnë se çfarë ndodh nëse një komb humb identitetin e vet kombëtar. Edhe këtu si në rastin e dy fjalimeve pararendëse, mbiemrat nuk janë asnjans.

Si të tillë, ata janë të fuqishëm dhe ndikojnë shumë në fjalën “identitet”. Në këtë fjalim, fjala e apostrofuar përshkruhet si një shënjestër e mundshme nga “kolonialistët”. Në një vend, ai thotë:

“Një nga pasojat reale të dukshme të pushtimit të shteteve nga fuqitë e mëdha në shekullin e 20-të është asgjësimi i identitetit kombëtar të njerëzve”.

Gjithnjë sipas fjalimit, humbja e identitetit konsiderohet edhe si humbje e fjalës së lirë. Teksa përdorën fjalë me ngarkesa dukshëm negative, “të tjerët” vazhdimisht portretizohen si djaj. Sepse siç paralajmëron ai:

“Humbja e identitetit kombëtar është disfata më e madhe që mund të përjetojë një komb, dhe është e pashmangshme nën formën bashkëkohore të kolonizimit”.

Sado që Millosheviqi është në dijeni fare mirë se Marrëveshja e Kumanovës stipulonte që forcat ushtarake të NATO-s të stacionoheshin vetëm në territorin e Kosovës, ai manipulon me publikun e tij duke e kërcënuar se Serbia ishte ajo që po vërshohej nga “të huajt”.

8.9. Diskursi “antikolonialist”

Duke i eskivuar faktit që thua prej një viti Tribunali Ndërkombëtar në Hagë kishte ngritur aktakuzë për krime kundër njerëzimit, Millosheviqi bën çmos që vëmendjen ta mbajë të ngulitur drejt një projekcioni imagjinar të gjoja robërimit të Serbisë nga të huajt. *“Për më tepër, nga vetë natyra e saj, kjo formë e re e kolonizimit përjashton çdo mundësi të fjalës së lirë ose vullnetit të lirë”,* thotë ai duke përvijuar këtë logjikë manipulante.

Edhe rreth “kolonizimit” ndajngjiten fjalë që përshkruajnë substantivin me shprehje veçanërisht të forta emocionale e negative. Në këtë mënyrë, fjalimi thekson rëndësinë që publiku serb të jetë “vigjilent” kur bëhet fjalë për zgjedhjen e një partie. Ndaj, ata duhet të vendosin për një politikan si Millosheviqi dhe për Partinë Socialiste të Serbisë, e jo të përcaktohen për rivalen Partia Demokratike e drejtuar prej një “kolaboracionisti” dhe “bossi” si Zoran Gjingjqi.

Jo vetëm ky publik që ishte në krijim e sipër, por edhe opinioni në Jugosllavi për disa dekada me radhë ishte mishëruar me fjalorin e “Third Worldism” që i mëshonte një projekcioni imagjinar të një bote që nuk anonte as nga ShBA, e as nga Bashkimi Sovjetik. Madje, Jugosllavia ia kishte dalë mbanë t’i mbushte mendjen një duzine shtetesh që të bëheshin pjesë e të ashtuquajturës “Lëvizja e të Painkuadruarëve” (*Pokret Nesvrstanih*).

Është pikërisht ky kontekst historik që evokohet prej Millosheviqit, por tani si mburojë për të shpëtuar lëkurën e tij. Sipas tij, territori serb do të ngushtohet, identiteti dhe kultura serbe rrezikojnë të asimilohen dhe “ata do të trajtonin tokën tonë si rezervat të tyre”.

Publikun e alarmon me atë se Serbisë së pushtuar do t’i lihej vetëm emri (“do të pushtohej nga forcat ndërkombëtare, ShBA apo ndonjë shtet tjetër”); se ajo do të bëhej një lodër në duart e tyre (“ata do ta trajtonin tokën tonë si terren të tyre të stërvitjeve ushtarake, si rezervat të tyre privat”); dhe se gjithçka do të ishte e mbaruar e nën kontrollin e tyre (“në përputhje me interesat e fuqisë pushtuese”).

Me këtë rast, streha e fundit qëllon të jetë nacionalizmi e apeli në të, si e vetmja mënyrë e mbetur për të siguruar homogjenizim të publikut. Ai sikur sugjeron se nacionalizmi e shpëtoi kombin serb nga ndarja për interesa të grupeve të huaja armiqësore. Nëse ndodh segmentimi, paralajmëron ai, kombi serb do të pushtohej nga forcat ndërkombëtare, ShBA apo ndonjë shtet tjetër. Në këtë frymë është edhe përshkrimi në vijim, sipas të cilit konfliktet në Ballkan do të përjetësoheshin. Ai thotë: “Shtetet nën komandën e huaj e harrojnë shpejt historinë e tyre, të kaluarën e tare, traditën e tyre, simbolet e tyre kombëtare, mënyrën e tyre të jetesës, e shpesh edhe gjuhën e tyre letrare. Këto fuqi imperiale nuk duan paqe apo prosperitet në Ballkan. Ato duan që kjo të jetë një zonë e konflikteve dhe luftërave të përhershme që do t’u siguronin atyre një alibi për mbajtjen e një pranie të qëndrueshme”.

Duke tërhequr çfarëdo lloj paralele absurde, fjalimi përpiqet të sendërtojë publikun, i cili beson se Serbia po sulmohet nga “otomanët”

modernë, përkatësisht nga NATO-ja. Në një plan më të përgjithshëm, McGee thotë se ideologjia është një sistem bindjeje me qëllim që njerëzit të jenë efektiv për të përbashkëtën.¹⁴² E, po kështu, edhe ideologjia e Millosheviqit synon të sajojë një publik që ka bindjen se populli serb është i viktimizuar. Fjalimi, për më tepër, plotëson të gjithë parametrat që të konsiderohet si një përpjekje për të ushtruar kontroll mbi të menduarit kolektiv.

Në këtë fjalim, ekzistojnë dy grupe kryesore që janë karakteristike për identitetin dhe kanë ndikim të madh si në humbjen, ashtu dhe në kultivimin e tij:

Identiteti serb	
Fuqitë perëndimore	Ne (serbët)
Qeveri kukull	Politika jonë
Fuqitë e Mëdha	Kosova
Opozita Demokratike e Serbisë	Populli serb
NATO	Qytetarët
Fuqitë e huaja	Vetadministrim
Okupatorët	Populli ynë
Organizata separatiste myslimane	Popull i ri

Kur shihet nga një perspektivë më e gjerë “identiteti” dhe fjalët e tjera që e bashkëshoqërojnë, analiza është në gjendje të shquajë dy pikëpamje. E para, si *term djalli*, është ajo që i parashkruhet autoriteteve ndërkombëtare që po e shkatërrojnë identitetin serb; dhe, e dyta, si *term Zoti*, është pikëpamja që ka në qendër dhe i parashkruhet popullit serb. Serbët në këtë fjalim përshkruhen vazhdimisht si viktimat të komplotit ndërkombëtar; megjithatë aty ka edhe riprodhim të po të njëjtave projeksione e formulime mitike, të tilla që ishin përdorur në Gazimestan dhe Beograd.

¹⁴² McGee 1980: 6.

Tabela 5**Viti 2000**

Shkak	Pasojë
NATO	Kolonizim
Opozita serbe	Qeveri marionetë
Myslimanët	Copëtim – Sanxhaku
Jouniteti	Disfata e madhe
Humbja e SPS-së	Humbja e Kosovës
Copëtimi i Serbisë	Humbja e identitetit
Lufta për fuqizimin e Kombeve të Bashkuara	Viktimë

Fjalimi i Millosheviqit ka implikime mitike dhe historike që lidhen fuqimisht me vitin 1389 (shih Tabelën 7), një situatë e ngjashme edhe me vitin 2000 (shih Tabelën 5). Nëse në vitin 1389, ekzistenca dhe identiteti i serbëve u viktimizua dhe u rrezikua nga “pushtimi turk”, në vitin 2000, ekzistenca dhe humbja e identitetit të serbëve u viktimizua dhe u sulmua nga NATO.

Të njëjtat ngjarje historike (dhe mitologjike) që kishin ndodhur më 1389 në fushën e Kosovës, gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore dhe në Jugosllavinë e Titos nga 1941-1974 (shih Tabelën 6), po ndodhin edhe sot. Si shumë agregate e projeksioneve dhe rinegocimit të identitetit, fjalimi synon të ngulisë mirë në publik se janë “tradhtarët”, “të tjerët” dhe “kolaboracionistët” ata të cilët po e shkatërrojnë Serbinë, po e gjymtojnë si dhe po e pengojnë përparimin e “popullit qiellor”.

Tabela 6**Viti 1941 - 1974**

Pasojë	Shkak
Jugosllavia e Titos	Kolonizim
Çetnikët / jouniteti	Qeveri marionetë
Jouniteti	Disfata e madhe
Kushtetuta	Humbja e Kosovës
Copëtimi i Serbisë	Humbje e identitetit
Serbët luftuan për Evropën	Viktimë

Tabela 7

Viti 1389

Pasojë	Shkak
Turqit	Kolonizim
Feja islame	Asimilimi
Milosh Obiliqi/jouniteti	Qeveri marionetë
Jouniteti	Disfata e madhe
Vdekja e Car Lllazarit	Humbja e Kosovës
Copëtimi i Serbisë	Humbja e identitetit
Lufta për Evropën	Viktimë

Vizioni i fjalimit, në ditët kur fuqia e Millosheviqit po shkatërrohej në pakthim, është se identiteti serb do të ishte në duar të sigurta vetëm kur gardian i tij të ishin forcat e brendshme serbe, d.m.th populli serb që përkujdeset për “serben” si kulturë e si politikë. Në të kundërtën, “të tjerët” janë kërcënim dhe rrezik i përhershëm për kulturën dhe traditën serbe. Edhe kësaj radhe, fjalimi nënvlerëson identitetin e kombeve të tjerë dhe mbivlerëson identitetin serb.

8.10. Sajimi i publikut

Kombet perëndimore portretizohen si “kombe të këqija”. Teksa shpaloset fjalimi, imazhi i serbëve si viktima vetëm sa përforcohet edhe më shumë. Serbia dhe kombi serb galvanizohen në një imazh thuajse statik të të qenit viktimë e përvetshme, të pakuptuar nga të tjerët, madje edhe të paragjykuar. Kudo shpërthen postulati se serbët janë një “popull qiellor” dhe “komb i mirë”.

Fjalimi në Gazimestan e kishte përhapur masivisht besimin se Serbia që flijuar më 1389; teksa të dyja fjalimet në Beograd vetëm sa e përsërisin këtë: Serbia dhe serbët u flijuan sërish. Viktimë paraqitet Serbia edhe pas luftës në Kosovë dhe fushatës së NATO-s.

Fjalimbajtësi, në mënyrë të vetëdijshme ose jo, seç ka sajuar një publik që është i bindur se historia përsëritet në një mënyrë ciklike: serbët u flijuan më 1389, por ata u flijuan edhe më 1999 dhe 2000. Fjalimi ngulmon që tek publiku të krijohet besimi se historia për 1389-n është e gjallë. Duke i fryrë edhe njëherë miteve të vjetra që u lansuan gjatë fjalimit në Gazimestan, fjalimi e çelnikos sindromën e viktimës si pjesë e vetëkuptimit serb.

Pra, diskursivisht, Millosheviqi akuzon “forcat e jashtme” që kontribuojnë në atë se “*asgjësimi i identitetit kombëtar të popullit*”, po bëhet realitet. A nuk e kanë këtë kuptim këto formulime, të cilat ia vlen të citohen edhe njëherë:

“Identiteti ynë kombëtar do të shqyrtohej në mënyrë të padukshme në fillim, por pastaj në mënyrë shumë më efikase dhe të pamëshirshme, dhe disa aspekte të identitetit kombëtar do të zgjidheshin, duke e reduktuar atë në disa dëshira të kërkuara lokale, disa këngë dhe valle popullore me emrat e heronjve kombëtarë të përdorur si emrat e markave të produkteve ushqimore apo kozmetike. Një nga pasojat reale të dukshme të pushtimit të shteteve nga fuqitë e mëdha në shekullin e -20të është asgjësimi i identitetit kombëtar të njerëzve”.

Kështu, fjalimi e funksionalizon një situatë retorike, e cila bind serbët për rolin e “viktimës”, por edhe për “rolin çlirimtar”. Të qenit viktimë u bë një fat tragjik e i pandashëm për serbët. Pra, publiku është më i prirur se kurrë që të mos e pranojë realitetin. Atij i janë pjekur dy bindje: e para se “të tjerët” ishin ata që sulmuan serbët, dhe e dyta që serbët luftuan në vetëmbrojtje për vendin dhe identitetin e tyre.

Qysh në vitin 1939, Kenneth Burke tregoi se gjuha mund të çojë në diçka të gabuar në shoqëri, por, sipas tij, është lehtë të kuptohet qëllimi i gjuhës nëse e di mënyrën për një gjë të tillë. Le të kihet parasysh se asokohe kur dikush fliste me këso terma, në të shumtën e herëve situata shoqërore ishte e tillë që kishte përplot mjerim.

Fillimisht, ekziston prirja për të krijuar një armik të përbashkët.¹⁴³ Ose ndodh të projektohet manifestimi fizik i “djallit ndërkombëtar”, siç e quan po i njëjti autor. Nëse Hitleri i bëri gjermanët ta shihnin “djallin” tek hebrenjtë, njësoj edhe Millosheviqi i bindi të vetët që jo vetëm djallin, por edhe frikën e rrezikun ta shihnin te NATO-ja, ShBA-ja, feja islame dhe opozita serbe.

Fjalimi përmban fjalë e përshkrime për identitetin, traditën dhe kulturën serbe. Kjo është mënyra se si fjalimi bashkon popullin dhe ndërton një publik që është në gjendje të besojë plotësisht në udhëheqësin e tij. Fjalimmbajtësi thekson se simbolet e identitetit serb janë të pavlefshme nën “pushtuesit”.

Të gjitha njësitë kulturore serbe, tërheq vërejtjen ai, rrezikojnë të katandisen në marka produktesh ushqimore. Është pikërisht ky alarmizëm që përshkon pjesën e cituar edhe më herët:

“... disa aspekte të identitetit kombëtar do të zgjidheshin, duke e reduktuar atë në disa dëshira të kërkuara lokale, disa këngë dhe valle

¹⁴³ Burke 1997: 10.

popullore me emrat e heronjve kombëtarë të përdorur si emrat e markave të produkteve ushqimore apo kozmetike”.

Pra, publiku tashmë është i përshkuar nga psikoza e frikës së identitetit të tij vërtet qenqesh në rrezik ekzistencial. Është pasiguria dhe paniku gjendja që përftohet nga ky fjalim. Adresimi nuk i referohet të tashmes dhe as nuk sjell ndonjë provë për secilin nga pretendimet e ngritura; përkundrazi, Millosheviqi merr lirinë që t'i referohet një të ardhme alternative e hipotetike nën “kolonializmin” perëndimor. Këtë qëllim duket se ka e gjithë kjo pjesë: *“Një nga detyrat thelbësore të një qeverie kukull në çdo vend, duke e përfshirë edhe vendin tonë nëse do të kishim një qeverisje të tillë, është humbja e identitetit. Një nga pasojat reale të dukshme të pushtimit të shteteve nga fuqitë e mëdha në shekullin e 20-të është asgjësimi i identitetit kombëtar të njerëzve. Identiteti ynë kombëtar do të shqyrtohej në mënyrë të padukshme në fillim, por pastaj në mënyrë shumë më efikase dhe të pamëshirshme, dhe disa aspekte të identitetit kombëtar do të zgjidheshin, duke e reduktuar atë në disa dëshira të kërkuara lokale, disa këngë dhe valle popullore me emrat e heronjve kombëtarë të përdorur si emrat e markave të produkteve ushqimore apo kozmetike”.*

8.11. Frikë e paranojë

Është evidente se fjalimi përdor kartën e humbjes së identitetit si armë për të ndërtuar një publik që nuk duhet t’iu besojë “të tjerëve”. Charlandi shprehet se para se t’i drejtohem publikut, identiteti i tyre duhet të konstituohet.¹⁴⁴ Ngjashëm me teorinë e Charlandit, veçse në mënyrë të kundërt, fjalimi fillimisht përpiket të japë ndjenjën sikur identiteti serb po rrezikon të shpërbëhet. Reagimi i publikut automatikisht është frika dhe pasiguria. Mirëpo, frika ka një rol të rëndësishëm në arritjen e bashkimit të publikut. Sapo publiku homogjenizohet, nën frikën nga një gogol i caktuar, atëherë rriten gjasat që ai të kontrollohet e të manipulohet më lehtë.

Por, identiteti nuk mbetet me kaq, në kuptimin që autori i fjalimit gjithnjë përpiket të krijojë njëfarë imperativi për “rilindjen” e tij. Kjo amplifikohet edhe më shumë teksa tundet kambana e “pushtuesve” që kërcënojnë gjithçka serbe. Kjo është “arsyeja” pse serbët duhet të jenë syçelë, por edhe t’i luftojnë “kulturat e tjera”, sidomos Perëndimin, ashtu që të mbijetojnë përballë zgjerimit kulturor “kolonialistëve”.

¹⁴⁴ Charland 2001: 617.

Le ta tërheqim një paralele historike: edhe Adolf Hitleri apelonte tek frika për të bashkuar popullin gjerman. Në fjalimet e tij, Hitleri fliste për kulturën gjermane, fenë, racën ariane dhe, natyrisht, për identitetin. Ai u shpjegonte gjermanëve për frikën dhe rrezikun nga hebrejtë dhe “të tjerët”. Duke valëvitur gogolin frikëndjellës të NATO-s, mendësinë viktimizuese dhe rrezikun nga “kolonialistët”, Millosheviqi veçse ka përmbushur synimin e një publiku të homogjenizuar që i frikësohet djallit të madh e të rrezikshëm ndërkombëtar.

Ashtu si në Gazimestan, edhe ky fjalim përmban përdorime të theksuara të ndjenjave dhe elementeve fetare. Në fakt, instrumentalizimi i fesë ka qenë një nga pikat kryesore të propagandës së Millosheviqit për të krijuar një imazh pozitiv para Perëndimit e duke e paraqitur Serbinë si gardiane kundrejt çdo inkursioni islamik në Ballkan e Evropë. Meqë kjo propagandë kishte dështuar kryekrejtë në Kosovë – të dy krahët e rezistencës shqiptare, ai paqësor dhe ushtarak, kishin përcaktime kategorike sekulariste e laike – Millosheviqi në ditët e tij të fundit po bënte me gisht kah krahina e Sanxhakut (Peshterit). Në këtë hapësirë – e cila deri në vitet ‘70 banohej me shumicë shqiptare, por që u boshnjakizua gjuhësisht – lideri serb provon të sajojë rreziqe fetare që, sipas tij, do të përfundonin me autonomi dhe ndarje nga Serbi. Kështu, fjalimi ka edhe këtë pjesë:

“Ne kemi dëgjuar nga përfaqësuesit e tyre se regjioni i Serbisë i njohur si Sanxhak do të merrte autonominë e mbrojtur nga një prej anëtarëve të saj të koalicionit, Sulejman Uglanin, udhëheqës i një organizate separatiste myslimane. Zbatimi i kësaj autonomie, të cilën Sulejman Uglanini e ka mbrojtur për dhjetë vjet, në fakt do të nënkuptonte një ndarje të caktuar të Sanxhakut nga Serbia”.

Gjuha është më se e qartë. Serbia u kërcënuaka sërish nga myslimanët! Nënvetëdijshtë, porosia është që serbët të mobilizohen e të bëjnë gjithçka u vjen ndoresh për të parandaluar një përsëritje të 1389-s.

Prandaj edhe këtu e ka vendin një vlerësim i autorit McGee, i cili shpjegon se “ne bëjmë retorikë të luftës për të bindur për domosdoshmërinë e luftës”¹⁴⁵. Me sa duket, formulime të qëllimshme si e ashtuquajtura “*organizatë myslimane*” brenda një shteti e shoqërie ortodokse, sjellin rrethanën që lufta të duket si opsion i paevitueshëm dhe i domosdoshëm. Me sulmet e pareshtura verbale në adresë të NATO-s, ligjërimi millosheviqian krijon ndjesinë se Serbia e ka për armike jo vetën fenë islame, por edhe atë katolike.

145 McGee 1980: 6.

8.12. Pikëpamja mbi botën dhe ndërtimi i publikut

Fjalët “pushtues”, “Serbia”, “identitet” dhe “NATO” janë me valencë shumëkuptimëshe brenda tërësisë së fjalimit. E gjithë oratoria e Millosheviqit duhet interpretuar në dritën e nevojës për të legjitimuar fuqinë e tij politike. Megjithë përpjekjet për të eskivuar nga realiteti, fjalimi prapëseprapë e ka të vështirë, në mos të pamundur, fshehjen e shtrëngicës totale politike.

I mësuar politikisht për të jetuar vetëm përmes temave e subjekteve të mëdha dhe vizioneve grandomane, për të është traumatike përballja e papritur me krizën sociale, e cila është peshqesh i luftës që e nxitë vetë ai.

Varfëria që po progresonte dita-ditës çoi në pakënaqësi të gjerë ndaj qeverisë së Millosheviqit. Ashtu siç është përmendur dhe elaboruar edhe më parë teoria e Charlandit mbi krijimin e identitetit kolektiv, retorika konstituive mund të theksojë të përbashkëtën dhe unitetin kombëtar. I parë nga një prizëm i tillë, fjalimi i Millosheviqit rezulton të jetë i motivuar nga dëshira për të krijuar një identitet kolektiv popullor si parakusht për të konsoliduar unitetin dhe fuqinë e tij politike.

Fushata e bombardimeve ajrore të NATO-s, e pasuar nga vendosja e forcave ushtarake dhe civile ndërkombëtare në Kosovë, ishin ngjarjet thuajse më të rëndësishme të viteve ‘90.

Publiku serb më nuk mund të operonte me paradigmat e dikurshme të regjimit të Millosheviqit; ndaj kjo shpërbërje mitesh i hapte shtegun një krize të përgjithshme morale. Prandaj kjo shpjegon tendencën e udhëheqësit, tashmë të braktisur nga të gjithë, që të ruajë me çdo çmim homogenitetin e brendshëm.

Me humbjen e plotë të kontrollit mbi Kosovën, që dikur sigurohej vetëm përmes ushtrisë dhe policisë, ky moment ishte “një poshtërim i madh” në politikën serbe, po të shërbehemi me termin që e përdori Millosheviq në Gazimestan.

Kjo del të jetë një nga shkaqet pse përqendrimi i fjalimit ishte ripushtimi i territorit të humbur, pra rimarrja e Kosovës. Millosheviq ende e projektonte veten si njeri që kishte aftësinë për ta përfunduar “projektin serb”. Që ky lloj ligjërimi të racionalizohet, fjalimmbajtësi ngulmon e ngulmon në integritetin, identitetin dhe territorin serb si simbolikat më të rëndësishme. Millosheviq thotë diku në fjalim:

“Të gjitha shtetet që e gjejnë veten me sovranitet të kufizuar dhe me qeverisje të kontrolluar nga fuqitë e huaja, do të varfërohen shumë shpejt, në atë mënyrë që do të shkatërrohet çdo shpresë për marrëdhënie të drejta shoqërore dhe njerëzore. Një ndarje e madhe në një shumicë të varfër dhe një pakicë të pasur ka qenë e shfaqur në Evropën lindore vite me radhë, dhe atë të gjithë kemi mundur ta vërejmë. Edhe ne do të kishim situatë të ngjashme”.

Edhe në këtë pjesë të fjalimit vërehet ndarja e botës në dy në dy taborë. Në njërën anë, është populli serb dhe partia e Millosheviqit, teksa përkarshi, në anën tjetër, qëndron Perëndimi dhe “tradhtarët” (opozita serbe). Me anë të fjalëve të zgjedhura, fjalimi e rrënjos tek marrësit imazhin e serbëve si populli i përndjekur që në krye të herës. Npërmjet një procesi të brendshëm seleksionues, fjalimi ndjek po të njëjtën hulli si të nazistëve të cilët, gjatë Luftës së Dytë Botërore, krijuan imazhin e hebrenjve si armiq të popullit gjerman: Millosheviqi, me këtë rast, i bëri vendet perëndimore si adresë ku duhej të kërkohej shkak, faji dhe përgjegjësia. Pra kur bëhet fjalë për “armikun”, të tri fjalimet (1989, 1999 dhe 2000) e kanë këtë emërues të përbashkët. Por, sipas fjalimit, “armiku” i popullit, aludim për NATO-n dhe “të tjerët”, do të vazhdojë t’i ndjekë ata edhe për gjatë kohë posi një hije. Përmes analizës së togfjalëshave, analiza vë në pah se fjalimi si derivat ka shpërhapjen e ndjenjës së të qenit nën rrethim (nga NATO), por edhe së brendshmi prej bashkëpunëtorëve të tyre (kolaboracionistët). Dhe i dyti derivat, po kaq i rëndësishëm, është edhe mbitheksimi i çështjeve që kanë të bëjnë për dhe rreth identitetit. Ashtu siç e ka bërë të qartë ky libër, “sindromi” i identitetit është ajo fija që lidh fjalimin në fjalim në harkun kohor 1989-2000.

Në të parin fjalim në Gazimestan, kur nacionalizmi serb në krye me Millosheviqin po ngjiste shkallët e pushtetit dhe kontrollit të të gjitha autoriteteve qendrore federative, shenja kryesore e ligjërimit retorik ishin imazhet të cilat e paraqitnin Serbinë si një mbrojtëse e të gjithë Evropës, duke filluar prej vitit fatal 1389. Me gjendjen radikalisht të ndryshme, pikëpamjet mbi Evropën në dy vitet e fundit të pushtetit të Millosheviqit ndryshuan plotësisht. Tash, Evropa perëndimore, e cila paraqitej si tërësi, ishte një fjalë ndryshe për vdekjen dhe djallin.

Këtu, më shumë se kurrë, etablohet sindroma e viktimës.

Nënteksti i fjalimeve përmbledhet në sugjerimin: “ne” i mbrojtëm ata, por “ata” na sulmuan ne. Nëse në Gazimestan fjalimi u përdor për

të justifikuar ardhjen në pushtet dhe kontrollin absolutist të shtetit, dy fjalimet e fundit të Millosheviqit janë përpjekja e fundit për të fshehur, ose edhe relativizuar, disfatën shumëdimensionale. Ndaj, kjo është arsyeja pse ai e ngre gishtin e fajit kaq shpesh e kaq shumë tek “të tjerët”. Fjalimi oratorik kudo e përsërit bindjen se kombi serb është në buzë të humbjes së identitetit kombëtar dhe se historia tragjike po përsëritet ciklikisht.

8.13. Përsëri Kosova

Tema e Kosovës është, si të thuash, syzheu i të tria fjalimeve. Në të gjitha paraqitjet, Millosheviqi i bën jehonë pohimit se Serbia kurrë nuk do të heqë dorë nga Kosova dhe se kombi serb e do një Serbi të bashkuar me Kosovën si pjesë të saj.

Në Gazimestan Millosheviqi kishte kalkuluar se do të gëzonte simpatinë e Perëndimit sa i përket ndërmarrjeve e aventurave të tij politike, por kjo pritshmëri rezultoi të ishte e gabuar. Nga politika hiq-e-mos-këput, te ashpërsimi i gjuhës diplomatike e, më në fund, edhe aksioni ushtarak, Perëndimi ndëshkoi rëndë projektin ekspansiv serb.

Dhe kjo “tradhti” e perëndimorëve u bë vegëza që Millosheviqi të radikalizonte gjuhën kundër “të tjerëve”. Për konsum të brendshëm, e me qëllim që t’i shembej dheu nën këmbë çdo opozicioni, fjalimet nisën t’i vënë në përdorim edhe akuzat për “tradhtarë” dhe “kolaboracionistë”.

Megjithëse gjithçka kishte përfunduar me fiasko në shumë rrafshe, Millosheviqi asnjëherë nuk e vë në dyshim projektin e tij. Gjithçka bën është zhvendosja e vëmendjes kudo tjetër, por jo tek vetja e tij. Publiku duhet ta ketë mendjen vetëm te armiqtë që janë të gatshëm të ngrenë dorë edhe në gjërat më të shtrenjta për secilin serb, si identiteti dhe krenaria kombëtare.

Edhe fjala “kushtetutë” përqendrohet dhe fuqizohet qartë, mu si në fjalimin e mbajtur në Gazimestan.

Por ndryshe nga dy fjalimet paraprake, theksi e përmbytja në të tretin ka përfshirë në ekuacion edhe gjëra të reja. Ai, më shumë se kurrë, vikat se ka “tradhtarë” në mesin e serbëve dhe se opozita është e tëra e vënë në shërbim të NATO-s. Pra, në shërbim të djallit!

“Uniteti”, kryefjalë e fjalimeve më 1989 dhe 1999, tashmë tingëllon i ndryshkur dhe nuk duket apelues për publikun e targetuar. Në shënjestër ai ka “jounitetin”, që është vetë vdekja dhe e cili, sipas tij,

është produkt i forcave të huaja dhe “kolaboracionistëve”. Prandaj, Millosheviqi e projektonte veten si udhëheqësi besnik që nuk i ndahet Serbisë dhe serbëve, pavarësisht “gjëmës” që iu erdhi prej komplotit ndërkombëtar dhe atyre që e shitën veten tek “pushtuesit”.

Me referencime në fjalët “Kosovë”, “kolonizim” dhe “identitet”, analiza jonë vë në dukje se fjalimi ia del të konstitujë një publik homogjen; serbët konstituohen si komb që mund të mbrojë traditën e tij përballë asimilimit nga vendet perëndimore, dhe veçmas NATO-s.

“Kosova”, e pashmangshmja e ligjërimeve populliste në Serbi, ka vetëm një përmendje brenda fjalimit, pasi që theksi është vënë më tepër kah “opozita serbe” dhe “kolonialistët”. Ideja e autorit të këtij adresimi është sendërtimi i një publiku që duhet të jetë i predispozuar armiqësisht ndaj partive tjera politike që i kundërvihen rrugës së Millosheviqit. Meqë “kolaboratorë” është si mallkim, publiku i dëshiruar është vetëm ai që nuk bën pyetje kritike sa i përket proceseve politike.

Mënyra më e mirë për t’i neutralizuar problemet e brendshme, ashtu siç u vu re në të tri fjalimet e marra në shqyrtim, është përmendja e Kosovës si sfidë, aspiratë dhe domosdoshmëri. I treti fjalim me radhë vë në lojë edhe fjalën “boss”, që si e tillë ruan një lidhje të fortë me spiunët dhe tradhtinë. Në këtë mënyrë, fjalimi ndërton një publik me “Millosheviqë” të riprodhuar sipas një modeli.

Të tri fjalimet kanë dallime në vija të përgjithshme në gjatësi, fokus dhe kontekst. Më i rëndësishmi mbase është fjalori i përdorur kundrejt Perëndimit. Fjala “okupator” tani përdoret më shumë sesa në dy fjalimet paraprake. Po kaq e dukshme për nga sasia dhe cilësia është edhe fjala “armiku”.

Në fjalimin e Gazimestanit, një dekadë para fjalimit të fundit, Perëndimi kishte një vend krejt periferik. Përkundrazi, historia serbe projektohej e tillë që të krijohej përshtypja se Serbia dhe Perëndimi ishin në një reciprocitet moral. Serbia u bë “ledh” i Evropës më 1389, por tani ishte radha që Perëndimi t’i kthente borxhin këtij “ledhi” përmes mbështetjes ose, të paktën, mospërzierjes. Nga “aleati” i imagjinuar në Gazimestan, Perëndimi sakaq u bë për publikun millosheviqian “vdekja dhe djalli”. Tash e tutje, “pushtuesit” perëndimorë janë ikona të së keqes në çdo rrafsh të mundshëm, kurse ajo çka ishte antiperëndimore merr statusin e diçkaje moralisht të pranueshme, d.m.th aset vleror i anës së mirë.

Me keqlexime e shtrembërime të historisë, ashtu sikurse edhe me krahasime që nuk përkojnë aspak, fjalimi tani i shërben publikut

pohimin se Hitleri e Clintoni qenkëshin njësoj banditë. Është si një imazh i konstruktuar nga një afresk me motive biblike: drita dhe errësira, ose Serbia dhe Perëndimi. Serbia është paqësore, liberale, logjike dhe e aftë të ketë vlera të vërteta, por Perëndimi i degjeneruar nuk ka asnjë nocion për këto vlera e virtyte.

Sado që përdor logjikën dhe thjeshtëzimet tipike të ideologjisë komuniste, Millosheviqi në fjalimin e fundit askund nuk e përmend më shprehjen përshëndetëse: “Rroftë vëllazërim-bashkimi!”

Tipari përbashkues i të tri fjalimeve është politika identitariste e përqendruar rreth fjalës “Kosovë”. Ajo, sipas kësaj bote retorike, është vetë shpirti i Serbisë, por në të njëjtën kohë ka edhe velin e një misteri. Gjithçka ndodh për shkak të saj. Ajo është kuptimi për të cilën serbët janë në gjendje të fllojnë veten, ashtu që të kenë identitet. “Kosova” është ajo për të cilën sakrifica bëhet domosdoshmëri.

Duke përdorur analizën e togfjalëshave, fjalive, frazave dhe teorive të ndërtimit të publikut, përfundimi i fundit është se fjalimi veç ka krijuar një publik, i cili e ka të ndaluar ta harrojë “zemrën e Serbisë”.

9.0. PËRMBLEDHJE

Qëllimi i gjithë kësaj analize ishte të evidentonte pikëpamjet ideologjike të Millosheviqit dhe mënyrën se si ai, përmes tri fjalimeve të tij, ndikoi, sajoi, bindi dhe përgatiti popullin serb për të mësyre në luftë kundër kombeve të tjera në Federatën Jugosllave. Sikur pak të ishte gjendja e rënduar politike e ekonomike e trashëguar nga dështimi i eksperimentit socialist, fjalimet retorike të Millosheviqit, që liruan nga llamba xhindin e nacionalizmit serb, shkaktuan vuajtje të paimagjinueshme njerëzore. Fill pas fjalimit të mbajtur në Gazimestan u nismuan një numër i madh ligjesh diskriminuese në Kosovë: “Shqiptarëve, pak nga pak iu shkurtuan të gjitha të drejtat dhe u shndërruan në qytetarë të rendit të dytë. Në korrikun e vitit 1990 u rigatua ligji për marrëdhënien e punës në kushte të jashtëzakonshme në Kosovë në bazë të cilit qindra mijëra shqiptarë u pushuan nga puna,... U ndalua “Rilindja”, gazeta e vetme ditore në gjuhën shqipe.”¹⁴⁶

Duke e vendosur një gjendje të paprecedentë aparteidi, të gjitha ndërmarrjet kryesore me punëtorë shqiptarë u zëvendësuan nga serbët. Gjithashtu, në korrik të vitit 1990 Serbia miratoi një ligj, i cili diskriminonte shqiptarët në vendin e punës. Si rezultat i këtyre politikave përjashtuese e drakonike, vetëm 20 për qind e shqiptarëve ishin të punësuar më 1994.¹⁴⁷

Ndër të tjerash, ishte e ndaluar që shqiptarët të mbanin poste drejtuese në sektorin publik. Pati largime masive të punëtorëve shqiptarë dhe rritjet e fenomenit të migrimit drejt vendeve perëndimore. Fëmijët dhe të rinjtë shqiptarë u diskriminuan kur pranoheshin në shkolla dhe universitete.¹⁴⁸ Shqiptarët mund të pushoheshin nga puna nëse nuk nënshkruanin një deklaratë besnikërie ndaj autoriteteve serbe.

Fjalimet retorike të Millosheviqit janë të përshkuara nga nacionalizmi, motivet mitologjike, jotoleranca ndaj kulturave e feve tjera dhe urrejtja. Përmes shqyrtimeve të grupeve të fjalëve dhe përmes ndërtimit të publikut, analiza ka zbuluar se fjalimet krijuan një ndjesi kolektive që luhatej mes kërcënimit dhe pasigurisë për serbët.

146 Koha.net, 17. 12. 2018.

147 Mønneslan 1994: 24.

148 Malcolm 2001: 361.

Fjalimet e Millosheviqit, sidomos i pari, flasin për frymë “vëllazërie” e “bashkimi”, por pa shpjeguar asnjëherë sesi përfytyroheshin ato.

Analiza e fjalimeve e bën të dukshme dhe jep një pamje të plotë të botëkuptimit të Millosheviqit. Që të arrihej kjo, analiza është shërbyer me teori nga studimet më të fundit mbi retorikën, ashtu sikurse edhe me zbardhjen e rrethanave historike. Ato janë përthyer dhe kontekstualizuar me deklaratat, fjalimet e argumentet që Millosheviqi i mbajti gjatë pushtetit të tij. Kjo analizë provon një tjetër perspektivë për të kuptuar lidhshmëritë kauzale mes nacionalizmit serb dhe luftërave në Jugosllavi.

Pasi u studiuan nga afër të tri fjalimet tekstualisht dhe kontekstualisht, analiza ka shkoqitur edhe fjalët dhe togfjalëshat më të rëndësishëm të Millosheviqit si: “uniteti”, “jouniteti”, “beteja”, “e përbashkëta”, “identiteti”, “populli”, “NATO”, “Serbia”, “Kosova”, “ata”, “ne” dhe “kushtetuta”.

Janë këto, pra, shprehjet e fjalët kryesore, herë si *terma djalli* e herë si *terma Zoti*, ashtu sikurse edhe në funksione fjalësh kyçe, që mbizotërojnë fjalimet e marra në shqyrtim. Duke përdorur këto arsenal leksikor e retorik, fjalimet kërkojnë të ndikojnë e të sendërtojnë një publik që e pranon Millosheviqin si një udhëheqës të përsosur për të gjithë serbët kudo që jetojnë në Jugosllavi. Prandaj, vlerësimi i McGeesë se njerëzit në bashkësi veprojnë, sillen dhe i shohin gjërat ndryshe nga njerëzit në izolim, merr një fuqizim konkret.¹⁴⁹ Sepse ngjarjet që pasuan secilin nga fjalimet flasin shumë në favor të këtij pohimi, aq më tepër që agresioni ndaj fqinjëve asnjëherë s’u vu në diskutim, porse pati divergjenca vetëm sa i përket rrugës së ndjekur.

9.1. Vizione serbocentrike

Para ardhjes së Millosheviqit në pushtet, nacionalizmi serb kishte vepruar në mënyrë disi subversive. Rregullimi i brendshëm kishte siguruar të paktën formalisht një ekuilibër që shmangte përplasjet direkte. Për një kohë, madje katër dekada, kombe e etni të ndryshme jetuan relativisht qetë me njëri-tjetrin. Por, ardhja e Millosheviqit në majat e pushtetit e bëri të qartë projektin serb që bazohej në përjashtim dhe dominim.

Janë tri gjëra të posaçme që përsëriten nga fjalimi në fjalim prej Millosheviqit.

149 McGee 1980: 2.

E para; “Kosova” ka një vend qendror dhe paraqitet si “shpirti i Serbisë”.

E dyta; “sindroma e viktimës” luan një rol vendimtar në ndërtimin e publikut.

E treta; “jouniteti” (fati i zi serb siç kuptohet nga gjuha retorike e fjalimeve) përshkruhet si një hije që i paska ndjekur serbët që prej vitit 1389 (shih për më tepër Tabelat ilustruese 3, 5, 6 dhe 7).

Veçanërisht te fjalimi i parë është e mundur të vërehet një tipar thelbësor i këtij botëkuptimi. “Uniteti” dhe antipodi i tij, “Jouniteti”, janë dy fjalët që mbizotërojnë të tri fjalimet. Nëpërmjet teorive të përdorura e të kontekstualizuara, analiza ka vënë në pah mënyrën sesi oratori (Millosheviqi në të tri rastet) arriti të krijonte perceptimin tek serbët se, pas ndryshimeve kushtetuese dhe sistemit të ri politik, ata përfaqësonin një “popull të veçantë”. Serbia e bashkuar ishte vendi meritore i “popullit të zgjedhur” nga Zotit; ky botëkuptim nuk ndryshoi asnjëherë, siç shihet në të tri fjalimet e tij.

E përdorur, sidomos në fillimet e tij politike, është edhe fjala “kushtetutë”. Analiza e fjalimeve tregon se kushtetuta është posi një fjalë magjike për Millosheviqin. Ajo është sa e ëmbël, po aq edhe e hidhur. E ëmbël kur ajo i shërben interesave serbe, dhe shijehidhur kur ajo i ndan serbët.

Në fjalimin e Gazimestanit, i cili theksin e ka thuar vetëm te imperativi për ndryshimin e Kushtetutës, fjalimi vizionon dominimin serbocentrik, rikthimin e krenarisë dhe përkushtim për fuqinë serbe.

Aty vjen në jetë një publik që e konsideron të natyrshme e të drejtë të tij të jetë sundues mbi popujt e tjerë. Është, pra, publik i sajuar për t’u vënë në shërbim të realizimit të Serbisë së Madhe. Në fjalimin e mbajtur disa kilometra në veriperëndim të Prishtinës, ka shumë dëshmi për këtë prirje agresioni e ekspansioni, sidomos kur Millosheviqi e zëron pa teklif që: *“luftërat nuk mund të përjashtohen”*.

Duke përmbledhur konsideratat e shumta si dhe rezultatet e analizës, mund të argumentohet me plot siguri se fjalimet, sidomos ai i Gazimestanit, krijuan një publik reaksionar sa i përket Kushtetutës së Jugosllavisë. Duke përmendur aq shpesh ndryshimet kushtetuese, qëllimi i Millosheviqit ishte etablimi i gjendjes së para vitit 1974, d.m.th para autonomisë së gjerë që gëzoi Kosova.

Një motiv që nis të përhapet më shumë e më shumë, sidomos kur projekti serbomadhi dështoi, është lufta kundër “djallit” ndërkombëtar siç demonizohet NATO. Ky ligjërim, i ngarkuar me luftë verbale, është karakteristik vetëm për dy fjalimet e fundit.

Fjala “NATO”, rrjedhimisht, paraqitet si e lidhur ngushtë me “Kosovën” dhe “pushtuesit”. Duke ndjekur teoritë nga fusha e retorikës, “Kosova” në të gjitha fjalimet e tij ka statusin e *termit të Zotit*, një temë e përhershme dhe e nxehtë. Morali që buron nga këto fjalime është se politikani serb duhet të jetë i pakompromis kur bëhet fjalë për Kosovën. Publiku fiton besimin që është e drejtë serbe jo vetëm ta administrojë Kosovën, por edhe ta posedojë e ta zotërojë atë.

Në fjalimin e dytë dhe të tretë ka prani të dukshme të fjalëve më agresive e më ofenduese në adresë të Perëndimit. Kjo është mënyra se si fjalimet farkëtojnë një publik luftëdashës, por edhe një gjendje të përhershme lufte përballë Perëndimit, i cili paraqitet në dritën më negative të mundshme.

Ndryshe nga dy fjalimet e fundit, fjalimi i parë, në Gazimestan, nuk është i ngarkuar me fjalë agresive dhe ofenduese ndaj Perëndimit. Në vijë me atmosferën politike brenda dhe jashtë Jugosllavisë, fjalimi kufizohet vetëm në sendërtimin e një publiku që ka në mendje vetëm interesat e veta kombëtare. Me sintagmën e shndërruar vite më vonë në kult kombëtar se “Kosova është zemra e Serbisë”, fjalimi me siguri se apelon në sentimentet nacionaliste të publikut serb.

Në fjalimin në Gazimestan, fjalimi nuk përmban asnjë përmendje të shqiptarëve si popull, pavarësisht se ky adresim u mbajt në një mjedis ku shumica dërrmuese e popullatës ishte shqiptare. Mbase kjo është pika ku më së shumti spikat megalomania e nacionalizmit serb.

Publiku beson se serbët i përkisnin një populli shpirtëror, të shenjtë dhe të madh, domethënë një populli me shumë rëndësi, ndërsa “të tjerët” ishin hiçmosgjë. Porosia e fjalimeve është se serbët duhet vazhdimisht të luftojnë për të mbajtur “zemrën” brenda Serbisë.

9.2. Kosova, një ide mitike

Me pak fjalë, botëkuptimi i Millosheviqit është nacionalist dhe i ndërtuar mbi përjashtimin e të tjerëve. Megjithatë fjalimi i parë u mbajt në Kosovë, duke përdorur elemente historikë dhe mitikë, ai zhvilloi ndjenjën që identiteti serb të ndërtohej në gjëra të caktuara.

Duke lënë anash faktin se identiteti e shtetësia serbe e kishte pasur epiqendrën e zhvillimit në *buffer*-zonën e përplasjeve habsburgo-osmane, pra aty ku ishte Pashallëku i Beogradit, tani identiteti i “rilindur” serb u vu në kërkim të një djepi të ri. Me ndihmën e miteve të reja e të vjetra, serbët krijuan iluzionin se zanafilla e tyre shpirtërore ishte në botën që më nuk ekzistonte.

Rrjedhimisht, “Kosova” ishte një nga fjalët më të rëndësishme që pati një intensitet të madh në fjalimin e parë. Rreth saj përdorëshin të ndajngjitura fjalë të rëndësishme, të tilla si “disfata”, “humbja” dhe “identiteti”.

Përmes kësaj triade fjalësh (Kosovë + disfata + identitet), fjalimi sajoi një popull që u dha i tëri pas imazheve historike, kuazihistorike e mitike. Rrëfimi retorik krijoi besimin se osmanët dhe Lindja islamike iu shkaktuan serbëve një humbje fyese dhe poshtëruese më 1389.

Fjalimi inxhineroi një gjendje në prag të absurditetit e surreales ku e tashmja politike e sociale lexohej si vijimësi e së shkuarës dhe historisë 600 vjeçare. “Të tjerët” u akuzuan si agresorë historik ndaj kombit dhe identitetit serb. Duke i fosilizuar mitet dhe episode të keqlexuara historike mbi “të tjerët”, fjalimi nxiti një vetëdije të tillë që i thoshte të rrinin vigjilentë e me gishtin në këmbëz ndaj sulmeve eventuale të fqinjëve.

Me ndryshimin e situatës, fjalimi i mbajtur në vitin 2000, pra kur Millosheviqi veç i kishte të numëruara ditët, ka krijuar një publik të tillë që është i bindur se Serbia është nën rrethimin nga “armiq” agresivë e të fuqishëm ndërkombëtarë. Kësaj retorike i shtohet edhe një element i ri: tani publiku është i vetëdijshëm edhe për “armiq” të brendshëm.

Emërues i përbashkët i fjalimeve të marra në shqyrtim është edhe mënyra se si Millosheviqi bashkon idenë e “Serbisë” me idenë e “Kosovës”. Populli i sajuar nga fjalimet, më 1989, 1999 dhe 2000, është i tillë që do të bëjë gjithçka për ta mbajtur Kosovën nën Serbi. Në të tre fjalimet jepet sugjerimi që populli – sado abstrakt të tingëllojë koncepti! – nuk duhet të ketë frikë nga vdekja. Sidomos kur kjo vdekje i përjetëson dhe i bën të paharrueshëm heronjtë serbë. Duke depërtuar më tej në thellësitë e fjalimeve, analiza thekson se Millosheviqi, përmes përdorimit të fjalëve të tilla si “uniteti”, “Kosova”, “pushtuesit”, “asimilimi”, “identiteti” dhe “Serbia”, shfrytëzoi pakënaqësinë e popullit serb, ashtu sikurse edhe gjendjen e rënduar ekonomike në vend.

Nëse shkrihen analizat e tre fjalimeve brenda një konteksti të vetëm, është më e qartë lindja e një publiku me ndjenja të forta nacional-shoviniste. Ky rrugëtim u bë veçanërisht i dukshëm në ngjarjet që pasuan fjalimin infamoz të mbajtur në Gazimestan.

Përmes analizës së fjalive, togfjalëshave dhe fjalëve simbolike dhe mënyrës sesi u përshtat publiku me ndjenjën e shpërthimit të luftës, është i mundur konstatimi se kundërthëniet etnike midis serbëve, shqiptarëve, kroatëve dhe boshnjakëve janë të forta.

Duke përdorur fjalët “unitet”, “jounitet”, “popull”, “NATO”, “kolaboracionistë”, “humbje e identitetit”, “Kosova”, “ne”, “ata” dhe “Serbia”, fjalimet përftuan një publik dhe situatë retorike që jepte ndjesinë se kombi serb ishte në prag të një katastrofe të re ekzistenciale dhe kombëtare. Antidoti për këtë situatë ishte lufta. Nëpërmjet luftës dhe armëve, serbëve u sugjestionohet mendimi se tani kanë shansin e fundit për t’u bashkuar, për të punuar së bashku dhe për të ndihmuar njëri-tjetrin.

Agjenda më me ndikim e fjalimeve të Millosheviqit është marrëdhënia e Serbisë me Kosovën. Për shembull, Kosova u përmend për herë të parë si një çështje madhore e kryesore në fjalimin e tij të shkurtër që e pati mbajtur në Fushë-Kosovë, më 24 Prill 1987.

Por, ajo fitoi terren prominence gjithnjë e më shumë, sidomos kur erdhi momenti i ndryshimeve kushtetuese që ndërmori Serbia, dhe pas të cilave gjithçka ndryshoi. Retorika që i parapriu ndryshimeve kushtetuese, veçmas fjalimi i Gazimestanit, krijoi besimin sikur serbët ishin të shkelur, të nëpërkëmbur e më me pak fuqi politike sesa republikat e tjera të Jugosllavisë. Është ky një hap para se të lancoheshin pa kurrfarë droje e konsekuence edhe mëtime serbomadhe se Serbia duhet të jetë kudo ku ka serbë dhe varre serbe.

9.3. “Nderi i humbur”

Strukturimi i fjalimeve, veçmas atij të mbajtur më 1989, është i tillë që përpiqet të sjellë “argumentime” mbi rëndësinë që Serbia duhet ta vë “nderin në vend”, fillimisht përmes ndryshimeve kushtetuese, e pastaj përmes kontrollit mbi Kosovën. Sepse, në frymën e fjalimeve dhe mesazheve të nënkuptuara, Kosova ka një status “të shenjtë” e “fetar” për Serbinë dhe serbët në përgjithësi.

Përshkrime të tilla sikurse *“ata bënë kompromis në dëm të Serbisë”*, (fjalimi i parë, 1989), *“ne jo vetëm që po mbronim vendin tonë, por kemi kthyer Kombet e Bashkuara në skenën botërore”* (fjalimi i dytë, 1999) dhe *“Për shkak se rezistua, ne kemi qenë nënshtruar të gjitha presioneve që mund të ushtrohen ndaj popujve në botën e sotme”* (fjalimi i tretë, 2000), papërgjashtim dhe unanimisht rreken ta krijojnë si të vërtetë të mirëqenë bindjen sikur serbëve historikisht nuk iu është dhënë haku, janë trajtuar padrejtësisht dhe prandaj janë viktime të përhershme.

Është ky përfundim që edhe nëse nuk thuhet nga fjalimi, kuptohet nga publiku: “Serbët ishin viktime në vitin 1389, por ata edhe sot po

bëhen sërish viktima. Por kjo nuk do të ndodhë më!” Kësodore, fjalimet hodhën secili nga një gurë në ndërtimin e mureve dhe urrejtjes midis kombeve që jetuan në Jugosllavi, në vend se t'i shembnin ato siç kishte bërë Evropa e pas Luftës së Dytë Botërore.

“Identiteti” dhe “populli” është binomi tjetër që thajse është i mbitheksuar në fjalimet e Millosheviqit. Në këtë raport midis këtyre dy koncepteve, secili fjalim, diku më pak e diku më shumë, zotëron ndjenjat dhe ushqen pasigurinë mes serbëve, duke krijuar ndjesinë e kërcënimit dhe rrezikut nga “të tjerët” për serbët e “pafajshëm”. Pra, çdo vuajtje e së sotmes është rezultat i padrejtësive të bëra dikur në kurriz të kombit serb.

Fjalimet (sidomos fjalimi i tretë) tregojnë se Millosheviqi është nxehtësisht i interesuar për largimin e opozitës serbe nga skena politike, të cilën ose si tërësi, ose si emra të përveçëm, i klasifikon si “tradhtarë”. Sepse konotacioni i “tradhtar” (*izdajica*) është i dyfishtë për nga implikimet asociative.

Fillimisht, opozita vendoset në të njëjtën kategori me bashkëpunëtorët serbë të nazistëve gjatë Luftës së Dytë Botërore. Pastaj, kjo shprehje ekskomunikuese sjell imagjinimin e opozitarëve si “turq” dhe, veçmas, me ikonën e tradhtisë sipas përrallave mitike serbe, Vuk Brankoviçi. Pra, publiku i sajuar është fort i predispozuar t'i luftojë vazhdimisht “tradhtarët” e targetuar.

Kjo është deriçka e vetme me anë të së cilës Millosheviqi përpiqet të ikë nga katastrofa që e kishte sjellë në Serbi. Ai kujdeset që ta minojë moralisht e fizikisht anën kundërshtare, e cila po i kërkonte llogari për humbjen e luftës dhe Kosovës, ashtu sikurse edhe tërheqjen e ushtrisë dhe policisë serbe.

Pra, përmbajtja e fjalimeve është e varur gjithnjë nga rrethanat dhe statet ku gjendet Serbia. Fjalimi i Gazimestanit ka një qëllim të caktuar (legjitimitimin e ndryshimeve kushtetuese), ndaj nuk është se përshkallëzon në agresivitet verbal për të krijuar fronte të reja armiqësie. Nacionalizmi serb bëhet më dominues duke shfrytëzuar historinë dhe fenë, veçanërisht nga fjalimi i parë në Kosovë. Të gjitha këto sheshuan rrugën që Millosheviqi të përdorte gjithë kapitalin ushtarak dhe të ndërmernte edhe fushata gjenocidale për të realizuar Serbinë e Madhe.

Analiza e çdo fjalimi veç e veç ka ndriçuar plotësisht rolin e këtyre fjalimeve në sendërtimin e një publiku dhe situatë të caktuar historike; imazhet e shkëputura aty-këtu nga historia e trualli i mitikes sollën një

publik të gatshëm për të luftuar për një Serbi të fortë. Edhe serbët u bindën se ishin “trima” dhe “luftëtarë” si në kohërat e qëmotit. Gjithnjë, publikut i përkujtohet se “kush kanë qenë” dikur, sa madhështorë e të fuqishëm!

Të tri fjalimet përbashkohen edhe me një tipar unik: ato jetojnë në histori dhe ëndërrojnë mitiken. Në to e përmes tyre rigjallërohen humbjet, sakrificat, vrasjet, gjaku, hakmarrjet e mizoritë. Fjalimet e kthejnë popullin serb disa shekuj prapa. Dhe nuk është rastësi që ekziston edhe një libër i shkruar nga Tim Judah me një kapitull: “*Serbët: Vendi i së kaluarës së gjallë*”. Fjalimi i parë, veçanërisht, e bën të gjallë këtë të kaluar fiktive; nga aty lind ideja se kombi serb kishte rrënjë të thella kulturore dhe fetare në Kosovë.

Dhe përfundimi tjetër i analizës, jo më pak i rëndësishëm, është se fjalimet sajuan një publik e bindje se interesat e serbëve qëndrojnë në shkallë më sipër sesa ato të kombeve të tjera “me më pak vlera” të Jugosllavisë. Një shembull oruellianizmi! Fjalimet ndërtuan një vetimazh ku populli e shikonte veten si viktimë e pafajshme, heroike dhe e keqkuptuar gjatë gjithë kohës.

9.4. Retorika politike përçan ...

Kështu, e gjithë analiza e mbarështuar në libër mbyllet me kontributin e saj për të ndihmuar në qartësimin e një pjese të përgjakshme të historisë më të re të Ballkanit: fjalimet nacionaliste, që nisin fillimisht si thirrje për të vënë në vend nderin e humbur, përfundojnë me pasoja të tmerrshme për njerëzit. Kjo sepse retorika nacionaliste krijon pashmangshëm konflikte midis grupeve etnike.

Mund të thuhet se kjo analizë i ka dalë haku qëllimit të saj që brezat e rinj të mund të mësojnë diçka nga ligjërimi retorik, fuqia e tij dhe pasojat. Përmes fjalimeve të tij, Millosheviqi ia doli të krijonte një situatë retorike dhe klimë lufte.

Kur një vullnet politik hyn në truallin e historisë, mitikes dhe fesë, atëherë hapen dyert e ferrit, në kuptimin që demonizimi i “të tjerëve”, duke shënjestruar shenjat kombëtare (gjuhët, identitetet e kulturat), është akti i parë në drejtim të asgjësimit fizik të tyre.

Siç e ka treguar me një duzinë shembujsh kjo analizë, instrumentalizimi i historisë dhe mitikes e vendosja e saj në raporte me të tashmen është burim luftërash e gjakderdhjesh.

Derisa është në natyrën njerëzore që të gjendet një gjuhë të përbashkët e pajtim për gjithçka, është retorika politike, sidomos kur ka teh agresiv, ajo që helmon marrëdhëniet midis shteteve e kombeve e që krijon humnera mes njerëzve.

Një popull nuk e krijon vetveten!

Millosheviqi nuk është më në këtë botë, por fatkeqësisht retorika nacionaliste e tij jeton dhe është gjerësisht e dukshme në gjuhën e politikanëve serbë. Fjalimet e Millosheviqit, zgjedhja e shprehjeve gjuhësore nga ana e tij, krijuan një popull me kërkesa e nevoja për më shumë “Lebensraum” në Jugosllavi; ky popull i sajuar arriti të besonte në idenë e Serbisë së Madhe. Ai që i gatshëm të kalonte mbi kufoma për të arritur këtë gjë.

9.5. Për fund

Le ta kujtojmë këtu, edhe njëherë, retorikën e fuqishme të Adolf Hitlerit. Udhëheqësi gjerman që në vitin 1939, ashtu sikurse bëri edhe Millosheviqi në vitin 1989, u drejtohej masave dhe luante, ndër të tjerash, me zemërimin e votuesve dhe frikën e tyre lidhur me pasigurinë ekonomike e politike të kohës (*patos*). Edhe pasiguria gjermane erdhi nga kriza ekonomike që kishte goditur Gjermaninë disa vite më parë, e cila solli me vete varfëri dhe papunësi, mu ashtu sikurse ndodhi edhe me Jugosllavinë në vitet e fundit të ekzistencës së saj.

Strategjia e fushatës zgjedhore të Adolf Hitlerit, ashtu sikurse edhe ajo e liderit serb, mbështetej në një formë propagande masive, mesazheve të dyfishta dhe përshkrimit të situatës së vendit, e quajtur edhe përshkrim i frikës dhe mjerimit, ku, në të dyja rastet, u “gjet” fajtori.

Një shembull i mesazheve të tilla të dyfishta mund të jetë fokusi i tyre tek paqja, por në të njëjtën kohë edhe impenjimi për të ndjekur qëllime ekspansioniste. Kështu, Hitleri donte t’i riktheheshin Gjermanisë tokat e “humbura” nga Traktati i Versajës, ashtu sikurse edhe Millosheviqi i vuri vetes detyrë e mision kombëtar që ta ripushtonte Kosovën e “humbur”. Prirja e Hitlerit për të shmangur vendimet e Traktatit të Versajës dhe dëshira e Millosheviqit për ta ndryshuar Kushtetutën, dëshmon për një qëndrim izolues të tyre.

Për më tepër, përshkrimi i mjerimit të Serbisë nga Millosheviqi ishte një kopje e mirë e fjalimeve të Hitlerit. Në fjalimet e udhëheqësit

nazist dëgjohej se si Gjermania kishte dy lloje armiqsh që ishin fajtorë për mjerimin dhe varfërinë e gjermanëve: armiq të jashtëm dhe të brendshëm. Hebrenjtë u portretuan si armiq të brendshëm të gjermanëve, ndërsa armiq të jashtëm u shpallën Fuqitë e huaja që, ndër të tjera, qëndronin pas Traktatit të Versajës. Këto elemente retorike i gjejmë edhe tek Millosheviqi. Edhe për serbët u gjetën dy lloje armiqsh që ishin fajtorë për mjerimin dhe varfërinë e tyre: armiq të jashtëm dhe të brendshëm. Kushtetuta, jouniteti, opozita serbe, shqiptarët dhe të tjerët e padëshiruar ishin armiq të brendshëm të Serbisë, ndërsa armiq të jashtëm ishin NATO dhe fuqitë e huaja.

Edhe Millosheviqi, sikurse Hitleri, e përdori këtë strategji retorike në mënyrë aktive gjatë fjalimeve të tij publike. Ai, posi Hitleri, përmes fjalimeve të tij publike bënte thirrje nacionaliste.

Dëshira dhe misoni i tij për ta nxjerrë Gjermaninë nga varfëria, poshtërimi e mjerimi dhe, për ta bërë atë përsëri krenare, të madhe dhe të fuqishme, ishte qendrore në retorikën e Adolf Hitlerit. Vetëm 60 vjet më pas, në Ballkan, u shfaq një njeri që ëndërronte dhe dëshironte ta bënte Serbinë krenare, të madhe dhe të fuqishme ...

23 nëntor 2021. Mediat në Beograd njoftojnë se presidenti serb, Aleksandar Vuçiq është shprehur se *“Kosova është vend i shenjtë serb dhe se Serbia kurrë nuk do ta njohë Kosovën si shtet të pavarur”*.

TRE FJALIMET

Shtojca 1: Kremtimi i 600-vjetorit të Betejës së Kosovës në Gazimestan (1989)

“Jouniteti është fatkeqësia serbe”¹⁵⁰

Sllobodan Millosheviq

Në këtë vend në zemër të Serbisë, në Fushën e Kosovës, para gjashtë shekujsh, para plot 600 vjetëve ka ndodhur një nga betejat më të mëdha të asaj kohe. Si të gjitha ngjarjet e mëdha edhe atë e përcjellin shumë pikëpyetje dhe sekrete; ajo është objekt i hulumtimeve shkencore të pandërprera dhe i kërshërisë së zakonshme popullore. Me krijimin e rrethanave shoqërore, ky jubile i madh gjashtëqind vjeçar i Betejës së Kosovës ndodhi në vitin në të cilin Serbia, pas shumë vitesh, pas shumë dekadash, e riktheu integritetin e saj shtetëror, nacional dhe shpirtëror. Prandaj, sot, nuk e kemi të vështirë t'i përgjigjemi asaj pyetjeje së moçme: Me çfarë do të dalim para Milloshit? Falë lojës së historisë dhe jetës duket sikur Serbia mu në këtë vit, më 1989, e riktheu shtetin e vet dhe dinjitetin e vet për ta kremtuar ashtu ngjarjen historike nga e kaluara e largët, e cila e kishte një rëndësi të madhe historike dhe simbolike për të ardhmen e saj.

Sot është e vështirë të thuhet çfarë është e vërtetë historike në Betejën e Kosovës, e çfarë është legjendë. Sot kjo as që ka rëndësi. Populli ka mbajtur mend dhe ka harruar i ndrydhur nga dhembja dhe i përmbushur me shpresë. Ashtu si, fundja, edhe çdo popull i botës. Është turpëruar nga tradhtia, e ka madhëruar trimërinë. Për këtë arsye është e vështirë të thuhet sot nëse Beteja e Kosovës është një disfatë apo fitore e popullit serb, nëse duke iu falënderuar asaj kemi rënë në robëri, ose duke iu falënderuar asaj në atë robëri kemi mbijetuar. Përgjigjet në këto pyetje do t'i kërkojnë pandërprerë shkenca dhe populli. Është më se e sigurt, nëpër gjithë këta shekuj pas nesh, se në Kosovë para 600 vjetësh na ka ndodhur jouniteti. Nëse e kemi humbur betejën, atëherë ky

¹⁵⁰ Ky tekst është i tërë teksti i fjalimit infamoz të Millosheviqit të mbajtur më 28 qershor 1989, në Gazimestan, disa kilometra në veri të Prishtinës.

nuk qe rezultat i superioritetit shoqëror dhe përparësisë në armatime të Perandorisë Osmane, por edhe i jounitetit tragjik në kreun e shtetit serb. Asokohe, në atë motin e largët 1389, Perandoria Osmane jo vetëm që ishte më e fuqishme se ajo serbe, ajo ishte edhe më e lumtur se perandoria serbe.

Jouniteti dhe tradhtia në Kosovë do ta përcjellë edhe më tej popullin serb si një kob i zi nëpër gjithë historinë e tij. Madje edhe në luftën e fundit, kjo mungesë e unitetit dhe e tradhtisë e çoi popullin serb dhe Serbinë në agoni, pasojat e së cilës në kuptimin historik dhe moral e tejkaluan agresionin fashist.

Madje edhe më vonë pasi u formua Jugosllavia socialiste, kreu serb në atë shtet të ri mbeti i ndarë, i prirë drejt kompromiseve në dëm të popullit të vet. Lëshimet që shumë udhëheqës serbë i bënë në dëm të popullit të vet, as historikisht, as etikisht, nuk do të mund t'i pranonte asnjë popull në botë. Aq më parë që serbët në tërë historinë e vet kurrë nuk i kanë pushtuar dhe eksploatuar të tjerët. Qenia e tyre nacionale dhe historike nëpër gjithë historinë dhe në dy luftërat botërore, ashtu si edhe sot, është – çlirimtare. Gjithmonë e kanë çliruar veten dhe, kur e kanë pasur mundësinë, i kanë ndihmuar edhe të tjerët që të çlirohen. Ndërsa fakti që ata janë në këto hapësira një popull i madh, nuk është kurrfarë mëkati serb, as turp. Kjo është një përparësi, të cilën ata nuk e kanë përdorur kundër të tjerëve. Por, më duhet ta them këtu, në këtë fushë të madhe, legjendare, të Kosovës, se serbët atë përparësi të të qenit një popull i madh nuk e kanë shfrytëzuar kurrë as për veten e tyre.

Për meritat e prijësve dhe politikanëve të tyre dhe mentalitetit të tyre prej vasalësh, ata madje ndjeheshin për këtë fajtorë para të tjerëve, madje edhe para vetes. Kështu ka qenë me dekada, me vite. Ja ku jemi sot në Fushën e Kosovës që ta themi – se më nuk është ashtu. Jouniteti i politikanëve serbë e ka lënë Serbinë në prapambeturi, ndërsa inferioriteti i tyre e ka poshtëruar Serbinë. Për këtë arsye nuk ka në Serbi një vend më të përshtatshëm se Fusha e Kosovës që kjo të thuhet. Dhe për këtë arsye nuk ka një vend më të përshtatshëm, se Fusha e Kosovës, që të thuhet se uniteti në Serbi do ta mundësojë prosperitetin edhe për popullin serb dhe Serbinë, edhe çdo qytetar të saj, pa marrë parasysh përkatësinë kombëtare ose fetare. Serbia sot është unike, e barabartë me republikat e tjera dhe e gatshme të bëjë gjithçka që ta përmirësojë jetën materiale dhe shoqërore të të gjithë qytetarëve të vet. Nëse do të ketë unitet, bashkëpunim dhe seriozitet, ajo do t'ia arrijë. Për këtë arsye, optimizmi që sot është i pranishëm në masë të konsiderueshme në Serbi për ditët që po vijnë është real, për aq sa mbështetet në lirinë

që ua mundëson të gjithë njerëzve që t'i shprehin aftësitë e veta pozitive, kreative, humane për përparimin e jetës shoqërore dhe vetjake. Në Serbi kurrë nuk kanë jetuar vetëm serbët. Sot në të, më shumë se më parë, jetojnë edhe qytetarë të popujve dhe kombësive të tjera. Ky nuk është një handikap për Serbinë. Jam shqetësuar që bindur se kjo është një përparësi e saj. Në këtë kuptim ndryshon përbërja nacionale e gati të gjithëve, e posaçërisht e vendeve të zhvilluara të botës bashkëkohore. Gjithnjë e më shumë dhe gjithnjë e më suksesshëm jetojnë së bashku qytetarë nacionalitetesh të ndryshme, besimesh dhe racash të ndryshme.

Veçanërisht socializmi, si një shoqëri progresive dhe e drejtë e demokratike, nuk guxon të lejojë që njerëzit të ndahen në baza kombëtare dhe fetare. Dallimet e vetme që mund të tolerohen në socializëm dhe duhet të tolerohen janë midis punëtorëve dhe jopunëtorëve, midis të ndershmeve dhe të pandershmeve. Për këtë arsye, të gjithë ata që në Serbi jetojnë nga puna e vet, me ndershmëri, duke i respektuar njerëzit e tjerë dhe popujt tjerë – janë në Republikën e vet. Fundja, mbi këto themele duhet të jetë i rregulluar i gjithë vendi ynë. Jugosllavia është një bashkësi shumë nacionale dhe ajo mund të mbijetojë vetëm në kushtet e barazisë së plotë të të gjitha kombeve që jetojnë në të.

Kriza që e goditi Jugosllavinë solli dasi nacionale, por edhe sociale, kulturore, fetare dhe shumë dasi të tjera më pak të rëndësishme. Midis gjithë atyre dasive, si më dramatike u dëshmuar dasitë nacionale. Shmangia e tyre do ta lehtësojë shmangien e dasive të tjera dhe do t'i zbusë pasojat që i kanë shkaktuar ato dasitë tjera. Qëkur ekzistojnë bashkësitë shumë nacionale, pikë e tyre e dobët janë marrëdhëniet që vendosen midis kombeve të ndryshme. Si një shpatë mbi kokat e tyre, është i pranishëm kërcënimi i vazhdueshëm që një ditë të aktualizohet çështja e rrezikimit të një kombi nga të tjerët dhe kështu të vihet në lëvizje dallja e dyshimeve, akuzave dhe mosdurimit, e cila sipas rregullës rritet dhe është e vështirë të ndalet. Këtë e dinë armiqët e brendshëm dhe të jashtëm të bashkësive të tilla dhe për këtë arsye aktivitetin e vet kundër shoqërive shumë nacionale e organizojnë kryesisht në nxitjen e konflikteve nacionale. Në këtë moment, ne në Jugosllavi po sillemi sikur një përvojë të këtillë nuk e kemi të njohur fare. Dhe sikur në të kaluarën tonë, të afërt dhe më të largët, nuk e kemi provuar gjithë tragjiken e konflikteve nacionale, të cilën mund ta përjetojë një shoqëri, e prapëseprapë të mbijetojë.

Marrëdhëniet mbi themelet e barazisë dhe unitetit midis popujve jugosllavë janë kusht i domosdoshëm për mbijetesën e Jugosllavisë, për daljen e saj nga kriza, e posaçërisht janë kusht i domosdoshëm për

prosperitetin e saj ekonomik dhe shoqëror. Me këtë Jugosllavia nuk veçohet nga mjedisi social i botës bashkëkohore, veçanërisht i botës së zhvilluar. Atë botë gjithnjë e më shumë e karakterizon toleranca nacionale, bashkëpunimi nacional, e madje edhe barazia nacionale. Zhvillimi bashkëkohor ekonomik e teknologjik, por edhe politik e kulturor, popujt e ndryshëm i nxit për bashkëpunim, i bën të varur ndërsjelltazi dhe gjithnjë e më tepër edhe të barabartë midis tyre. Në qytetërimin drejt të cilit po shkon njerëzimi, mund të shkojnë para së gjithash njerëzit e barabartë dhe të bashkuar. Nëse nuk mund të jemi në krye të rrugës drejt një qytetërimi të tillë, sigurisht që nuk duhet të jemi as në fund të saj. Në kohën që ngjau kjo betejë e famshme historike në Kosovë, njerëzit shikimin e kishin drejtuar tek yjet duke pritur ndihmë nga ato. Sot, pas gjashtë shekujsh, përsëri shikimin e kanë drejtuar tek yjet, në pritje që t'i pushtojnë. Herën e parë ata mund t'ia lejonin vetes jounitetin, urrejtjen, tradhtinë, sepse jetonin në botë më të vogla, me lidhje të dobëta midis tyre. Sot, si banorë të planetit, të përçarë, nuk mund ta pushtojnë as planetin e vet, e aq më pak planetët e tjerë, nëse nuk do të jenë të bashkuar dhe solidarë me njëri-tjetrin. Për këtë arsye ndoshta askund në truallin e atdheut tonë nuk kanë aq shumë kuptim fjalët kushtuar unitetit, solidaritetit dhe bashkëpunimit midis njerëzve sa kanë kuptim këtu, në Fushë të Kosovës, e cila është simbol i përçarjes dhe i tradhtisë.

Në kujtesën e popullit serb jouniteti që vendimtar për humbjen e betejës dhe fatin e kobshëm që e pësoi Serbia plot pesë shekuj.

Po, madje edhe nëse nga perspektiva historike nuk do të ishte kështu, është më se e sigurt se populli e ka përjetuar jounitetin e vet si fatkeqësinë e vet më të madhe. Dhe, për këtë arsye, është obligim i popullit që ta mënjanojë vetë, që kështu ta mbrojë veten nga disfata, mosesuesi dhe ngecja në të ardhmen. Populli serb këtë vit është bërë i ndërgjegjshëm për domosdoshmërinë e pajtimit në radhët e veta, si kusht i domosdoshëm për jetën e tij të tanishme dhe zhvillimin e mëtejshëm.

Jam i bindur se kjo vetëdije për bashkim dhe unitet do t'ia mundësojë Serbisë jo vetëm të funksionojë si shtet, por të funksionojë si një shtet i suksesshëm. Për këtë arsye edhe jam i mendimit se kjo ka kuptim të thuhet pikërisht këtu në Kosovë, ku jouniteti një herë e një kohë e ka prapakthyer për shekuj dhe e ka rrezikuar tragjikisht Serbinë dhe ku uniteti i përtërirë mund ta përparojë dhe t'ia kthejë dinjitetin. Ndërkaq, një vetëdije e tillë për marrëdhëniet e ndërsjella përfaqëson një domosdo elementare edhe për Jugosllavinë – sepse fati i saj qëndron në duart e

bashkuara të të gjithë popujve të saj. Beteja e Kosovës përmban në vete edhe një simbol tjetër të madh. Ky është simboli i heroizmit. Atij i janë kushtuar këngë, valle, letërsia dhe historia. Heroizmi i Kosovës prej gjashtë shekujsh e frymëzon krijimtarinë tonë, e ushqen krenarinë tonë, nuk na lejon që të harrojmë se dikur ishim një ushtri e madhe, trime dhe krenare, një nga të rrallat që edhe në disfatë mbeti e pamposhtur.

Gjashtë shekuj më vonë, përsëri jemi në beteja, dhe para betejash. Ato nuk janë të armatosura, megjithëse as të tillat ende nuk përjashtohen. Por, pa marrë parasysh çfarë do të jenë, betejat nuk mund të fitohen pa vendosmëri, trimëri dhe shpirt vetëmohues. Pa ato veçori të mira që ishin të pranishme në ato kohë të hershme në Fushën e Kosovës. Beteja jonë kryesore sot ka të bëjë me realizimin e prosperitetit ekonomik, politik, kulturor dhe të përgjithshëm shoqëror. Për afrimin më të shpejtë dhe më të suksesshëm drejt qytetërimit në të cilin do të jetojnë njerëzit në shekullin 21. Për atë betejë na nevojitet veçanërisht trimëria. Kuptohet, paksa tjetërfare. Por, ajo trimëri, pa të cilën asgjë në botë, serioze dhe e madhe, nuk mund të arrihet, mbetet e pandryshueshme, mbetet përjetësisht e nevojshme.

Para gjashtë shekujsh Serbia këtu, në Fushën e Kosovës, e ka mbrojtur veten. Por e ka mbrojtur edhe Evropën. Ajo asokohe gjendej në bedenat e saj që e mbronin kulturën evropiane, religjionin, shoqërinë evropiane në tërësi. Për këtë arsye, sot duket jo vetëm e padrejtë, por edhe johistorike dhe krejtësisht absurde të flitet për përkatësinë e Serbisë në Evropë. Ajo është në të pandërprerë, sot si edhe dikur. Kuptohet, në mënyrën e vet. Por në mënyrën e tillë që në kuptimin historik kurrë nuk e ka privuar nga dinjiteti. Në atë frymë, ne sot bëjmë përpjekje që ta ndërtojmë një shoqëri – të begatë dhe demokratike. Dhe kështu t'i kontribuojmë prosperitetit të vendit tonë të bukur dhe në këto çaste të përvuajtur pa meritë. Por, që kështu edhe t'u kontribuojmë përpjekjeve të të gjithë njerëzve përparimtarë të kohës sonë, të cilat ata i bëjnë për një botë të re, më të bukur.

Le të rrojë përjetësisht kujtimi për heroizmin kosovar!

Le të rrojë Serbia!

Le të rrojë Jugosllavia!

Le të rrojë paqja dhe vëllazëria midis popujve!

Shtojca 2: Fjalimi presidencial i Millosheviqit në Beograd (1999)

“Nuk do ta dorëzojmë Kosovën”¹⁵¹

Të dashur qytetarë, agresioni ka marrë fund.

Paqja ka mbizotëruar mbi dhunën.

Të dashur qytetarë, ju uroj një paqe të lumtur!

Në këtë moment, mendimet tona të para duhet të jenë me heronjtë që dhanë jetët e tyre në mbrojtje të atdheut, në luftën për lirinë dhe dinjitetin e njerëzve. Të gjithë emrat e tyre do të bëhen publik. Sidoqoftë, në këtë moment dëshiroj t’ju njoftoj se që nga 24 marsi e deri më sot, 462 anëtarë të Armatës Jugosllave si dhe 114 pjesëtarë të policisë së Republikës së Serbisë u vranë në luftën 11 javore. Ne kurrë nuk do të jemi në gjendje për t’i shpague ata për këtë. Ne duhet të bëjmë atë që mundemi dhe çka është detyrë e jona e ajo është që të përkujdesemi për familjet e tyre dhe të jemi gjithmonë të gatshëm për të mbrojtur dinjitetin e lirisë dhe pavarësinë e këtij vendi për të cilin ata dhanë jetën.

Të gjithë njerëzit morën pjesë në këtë luftë duke filluar nga foshnjat në repartet e maternitetit si dhe pacientët e sëmurë rëndë në repartet intensive të kujdesit, e deri tek ushtarët nëpër llogore, ata të mbrojtjes kundërajrore si dhe nënjësitë kufitare. Askush nuk do ta harrojë heroizmin e atyre që mbronin qytetarët, ata që mbronin fabrikat, sheshet, qytetet e tyre, shtetin e tyre si dhe popullin e tyre. Hero është populli – dhe ky është ndoshta përfundimi më i shkurtër i mundshëm sa i përket kësaj lufte. Hero është populli dhe kjo është arsyeja pse ata duhet të ndjehen heronj si dhe të veprojnë në mënyrë heroike, do të thotë në një mënyrë dinjitoze, fisnike dhe të përgjegjshme.

Në fillim të këtij viti, tubime të shumta u mbajtën në të gjithë vendin. Mesazhi i tyre i përbashkët ishte se NE NUK DO TA DORËZOJMË KOSOVËN. Dhe ne nuk kemi hequr dorë nga Kosova.

Grupi i tetë vendeve më të zhvilluara të botës dhe Kombet e Bashkuara garantojnë sovranitetin dhe integritetin territorial të vendit tonë. Kjo

¹⁵¹ Ky titull është përzgjedhur për shkak se jepet si ide qendrore në këtë fjalim që u mbajt me 10 qershor 1999, datë kjo përkon me përfundimin e ndërhyrjes ajrore të Aleancës Veriatlantike (NATO) ndaj Serbisë, ushtrisë si dhe aparatit të saj të sigurisë.

garanci gjendet gjithashtu në projekt-rezolutën e bërë. Marrëveshja e Beogradit i ka mbyllur çështjet e hapura të pavarësisë së mundshme të Kosovës në kohën para agresionit. Tërësia territoriale e vendit tonë nuk mund të kërcënohet. Ne kemi ruajtur dhe kemi pasur sukses në mbrojtjen e vendit sepse e sollëm këtë problem në samitin e autoriteteve botërore – në Kombet e Bashkuara, dhe e dorëzuam zgjidhjen e tij për t'u kërkuar nën kujdesin e OKB-së. Forcat ndërkombëtare të vendosura në Kosovë me detyrën për të siguruar në mënyrë të barabartë sigurinë e të gjithë qytetarëve do të jenë nën kujdesin e OKB -së, siç do të jetë i tërë procesi politik, i cili do të bazohet në parimet që rrjedhin nga diskutimet e zhvilluara më parë, por gjithmonë të bazuara në sovranitetin dhe integritetin territorial të vendit tonë. Kjo do të thotë që vetëm autonomia, dhe asgjë tjetër më shumë se aq, mund të përmendet në këtë proces politik.

Duke dalë para Kombeve të Bashkuara, ne jo vetëm që e mbronim vendin tonë, por ne i kthijem Kombet e Bashkuara në skenën politike pasi që ajo nuk ishte duke funksionuar që para fillimit të agresionit, 80 ditë më parë.

Ky është kontributi ynë në përpjekjet e të gjithë botës liridashëse, në tendencat për të krijuar një botë multipolare dhe për të mos pranuar krijimin e një bote, e cila do të qeveriset nga diktatura e një fuqie të vetme nga një qendër. Unë besoj se për historinë, ky kontribut do të jetë edhe më i madh dhe se heroizmi i popullit tonë duke rezistuar ndaj një armiku më të madh dhe më të fortë do të shënojë fundin e shekullit 20. Dhe unë jam i sigurt për këtë.

Ne kemi demonstruar se ushtria jonë është e pathyeshme dhe më e mira në botë. Kur them armata, unë mendoj në një kuptim të përgjithshëm ku përfshihen forcat e armatosura, policia dhe të gjitha forcat e mbrojtjes shtetërore. Ata i kanë treguar të gjithë botës se si njerëzit duhet të mbrohen, si të qëndrojnë të vendosur dhe të bashkuar sepse populli ishte ushtri dhe ushtria ishte popull.

Asnjëherë më parë në të gjithë historinë e mëparshme, populli nuk ka qenë më i bashkuar se sa në këtë luftë. Ne kurrë nuk kemi pasur kaq pak frikakë që ikën nga vendi për të pritur të sigurt deri në fund të luftës. Në këtë moment, ne po përballemi me shumë probleme të reja të cilat do të hapin shumë detyra të reja pas përfundimit të agresionit dhe në fillim të paqes. Këto janë kryesisht probleme që ndërlidhen me sigurimin e atyre që kanë nevojë më të madhe, sigurimin e plotë të familjeve të atyre që u vranë, por edhe atyre që u plagosën dhe u bënë pjesërisht u paafte për të kryer funksionet e tyre, provizion për të gjithë ata punëtorë, bujq dhe qytetarë të të gjitha profesioneve që pësuan dëme në luftë dhe që kanë

nevojë të ndihmohen sipas kritereve e të cilat fillojnë nga ata që kanë më së shumti nevojë. Çdo kush ka nevojë për ndihmë.

Ne përballemi me rindërtimin e vendit. Ne do të fillojmë menjëherë t'i rindërtojmë urat tona, rrugët tona, fabrikat dhe të ringjallim një zhvillim të madh, i cili do të shprehë gatishmërinë dhe vitalitetin e popullit tonë, qytetarëve tanë, shtetit tonë dhe të popullatës në përgjithësi. Kur flas për popullin tonë, unë mendoj për të gjithë qytetarët e Jugosllavisë dhe të gjitha kombet në të. Ne kemi arritur të mbrojmë bashkësinë shumëkombëshe, bashkësia e vetme shumëkombëshe që ka mbetur nga ish-Jugosllavia. Unë këtë e konsideroj si një nga arritjet më të mëdha të mbrojtjes sonë.

Forcat që vijnë në Kosovë do të jenë në shërbim të paqes, pavarësisht se nga cilat vende vijnë ata. Ushtria gjithmonë zbaton urdhra dhe urdhrat këtu janë për të mbrojtur qytetarët dhe për të ruajtur paqen. Puna e madhe me të cilën po përballemi do të kërkojë mobilizim në shkallë të gjerë.

Unitetin e arritur në këtë periudhë të vështirë, unë e shoh si një arritje e madhe, të cilën ne duhet ta ruajmë edhe gjatë periudhës së rindërtimit, sepse kemi nevojë për unitet dhe një mobilizim të madh për të përfunduar me sukses rindërtimin dhe për të filluar me sukses një zhvillim të ri. Për këtë gjë, unë i uroj të gjithë qytetarët e Jugosllavisë shumë fat dhe lumturi.

Shtojca 3: Fjalimi presidencial i Millosheviqit në Beograd (2000)

“Po na e rrezikojnë identitetin”¹⁵²

Qytetarë të nderuar.

Në pritje të rrethit të dytë të zgjedhjeve, do të doja të shfrytëzoja rastin të shpjegoja pikëpamjet e mia mbi gjendjen politike në vendin tonë, veçmas në Serbi. Siç e dini, përpjekjet janë duke u zhvilluar prej një dekade të tërë për të vënë të gjithë Gadishullin Ballkanik nën kontrollin e fuqive të caktuara perëndimore. Një pjesë e madhe e asaj pune u arrit duke krijuar qeveri kukullash në disa vende, duke i transferuar ato në vende me sovranitet të kufizuar ose pa sovranitet fare.

Pasi që rezistua, ne i jemi nënshtruar të gjitha presioneve që mund të zbatohen ndaj njerëzve në botën e sotme. Numri dhe intensiteti i këtyre trysnive u shumëfishua me kalimin e kohës.

E gjithë përvoja që Fuqitë e Mëdha fituan në gjysmën e dytë të shekullit 20 në përmbysjen e qeverive, duke shkaktuar trazira, duke nxitur luftëra civile, duke nënçmuar ose eliminuar luftëtarët e lirisë kombëtare, duke sjellë shtete dhe kombe në prag të varfërisë – dhe që të gjitha këto janë zbatuar edhe ndaj vendit dhe popullit tonë.

Gjërat që po ndodhin gjatë zgjedhjeve tona, janë pjesë e persekutimit të organizuar të vendit dhe popullit tonë sepse ne përbëjmë një barrierë për dominimin e plotë të Gadishullit Ballkanik.

Për një kohë të gjatë ka pasur grupime mes nesh, e të gjitha ishin nën maskën e të qenit prodemokratë, e në fakt ata i kanë përfaqësuar interesat e qeverive që e sulmojnë Jugosllavinë, e në veçanti Serbinë. Gjatë zgjedhjeve, një grup e quajti veten “Opozita Demokratike” e Serbisë. Bossi i tij nuk është kandidati i tyre presidencial. Ai është vetëm presidenti i Partisë Demokratike. Vite me radhë, ai ka bashkëpunuar me aleancën ushtarake, e cila e sulmoi vendin tonë. Dhe ai nuk mund ta fshejë bashkëpunimin e tij.

¹⁵² Ky titull është përzgjedhur për faktin se identiteti mbizotëron pjesën më të madhe të këtij fjalimi të mbajtur më 2 tetor 2000, në një kohë kur Beogradi ishte shndërruar në arenë protestash e përplasjesh midis mbështetësve dhe kundërshtarëve të Millosheviqit.

Në fakt, i gjithë populli e di, se ai i bëri thirrje NATO-s për ta bombarduar Serbinë për aq javë sa ishte e nevojshme për të thyer rezistencën e saj.

Prandaj, ky grup "demokratik" i organizuar për këto zgjedhje i përfaqëson ushtritë dhe qeveritë të cilat, së fundmi, zhvilluan luftë kundër Jugosllavisë.

Me urdhër të këtyre fuqive të huaja, demokratët tanë u thanë njerëzve se ata do ta bënin Jugosllavinë të lirë nga lufta dhe dhuna, se Jugosllavia do të përparonte, standardi i jetesës do të përmirësohej dukshëm dhe shpejt, dhe që Jugosllavia do të ribashkohej me institucionet ndërkombëtare, etj. etj.

Qytetarë të nderuar,

Është detyrë e imja që t'ju paralajmëroj publikisht, për aq sa ende ka kohë, se këto premtime janë të rreme. Gjendja është krejt ndryshme. Është pikërisht politika jonë ajo që lejon paqe, ndërsa ajo e tyre garanton vetëm konflikte dhe dhunë të qëndrueshme, dhe unë tani do t'ju them se pse është kështu.

Me krijimin e një administratë të mbështetur ose të instaluar nga NATO, Jugosllavia do të shpërbëhet shpejt. Por, këto nuk janë qëllimet e vetme të NATO-s.

Këto janë premtimet parazgjedhore të Opozitës Demokratike të Serbisë. Ne kemi dëgjuar nga përfaqësuesit e tyre se regjioni i Serbisë i njohur si Sanxhak do të merrte autonominë, e mbrojtur nga një prej anëtarëve të koalicionit, Sulejman Uglanin, udhëheqës i një organizate separatiste myslimane. Zbatimi i kësaj autonomie, të cilën Sulejman Uglanin e ka mbrojtur qysh dhjetë vjet më parë, në fakt do të nënkuptonte një ndarje të caktuar të Sanxhakit nga Serbia. Premtimet e tyre përfshijnë gjithashtu dhënie të një autonomie krahinës serbe të Vojvodinës, e cila jo vetëm që do ta ndante atë nga Serbia dhe Jugosllavia, por në fakt do ta bënte pjesë përbërëse të Hungarisë fqinje.

Në mënyrë të ngjashme, edhe zonat e tjera do të ndaheshin nga Serbia, veçmas viset kufitare të saj. Aneksimi i këtyre zonave nga shtetet fqinje ka qenë për një kohë të gjatë një çështje e nxehtë në ato shtete që kanë nxitur vazhdimisht pakicat e tyre në Jugosllavi për të ndihmuar integrimin e pjesëve të vendit tonë në shtetet fqinje. Brenda kësaj politike të copëtimit të Jugosllavisë, Kosova do të ishte viktimë e parë. Statusi i saj aktual do të shpallej ligjor dhe përfundimtar. Është pjesa e parë e territorit serb, të cilës Serbia do të duhej t'i jepte lamtumirën, pa shpresë se ne mund të rimarrim këtë pjesë të vendit tonë.

Territori që do t'i lihej ta mbante emrin Serbi, do të pushtohej nga forcat ndërkombëtare, ShBA apo ndonjë shtet tjetër. Ata do ta trajtonin tokën tonë si terren të stërvitjeve të tyre ushtarake, si rezervat i tyre privat, për ta kontrolluar në përputhje me interesat e fuqisë pushtuese.

Ne kemi parë raste të ngjashme të këtij kontrolli dhe të pasojave të saj për dekada të tëra, e veçanërisht në dekadën e fundit në shumë vende të botës, për fat të keq kohët e fundit edhe në Evropë, për shembull në Kosovë, Republikën Srpska dhe në Maqedoni, ashtu si dhe tek fqinjët tanë të afërt. Populli i Serbisë do ta kishte fatin e kurdëve, me një perspektivë për t'u shfarosur më shpejt se kurdët, meqenëse ata në numër janë më pak, dhe meqenëse lëvizjet e tyre do të kufizoheshin në një zonë shumë më të vogël sesa ajo në të cilën kurdët kanë qenë të pranishëm me dekada.

Sa i përket Malit të Zi, fati i tij do të lihej në duart e mafies, rregullat e lojës të së cilës duhet të bëhen të njohura për qytetarët: çdo shkelje e disiplinës, dhe sidomos çdo kundërshtim ndaj interesave të mafies, dënohet me vdekje pa asnjë të drejtë ankese. Unë ju kam paraqitur fatin e Jugosllavisë në rast se do të pranohet opsioni i NATO-s, me qëllim që t'ju paralajmëroj se përveç humbjes së tokës dhe poshtërimit të njerëzve, të gjithë do të jetonin nën një regjim dhune të pandërprerë.

Pronarët e rinj të asaj që ishte territori shtetëror i Jugosllavisë dhe pushtuesit e asaj që do të kishte ngelur nga territori serb, në mënyrë të parashikueshme do të terrorizonin popullatën, dhe atë në territorin të cilin ata do ta pushtonin.

Këto fuqi imperiale nuk duan paqe apo prosperitet në Ballkan. Ato duan që kjo të jetë një zonë e konflikteve dhe luftërave të përhershme që do t'iu siguronin atyre një alibi për mbajtjen e një pranie të qëndrueshme. Prandaj, një administratë kukullash garanton vetëm dhunë e mbase shumë vite luftërash të ndryshme, pra gjithçka përveç paqes. Vetëm vetadministrimi e bën të mundur paqen. Por ka edhe më shumë.

Të gjitha shtetet që e gjejnë veten me sovranitet të kufizuar dhe me qeverisje të kontrolluar nga fuqitë e huaja, do të varfërohen shumë shpejt, në atë mënyrë që do të shkatërrohet çdo shpresë për marrëdhënie të drejta shoqërore dhe njerëzore. Një ndarje e madhe në një shumicë të varfër dhe një pakicë të pasur ka qenë e shfaqur në Evropën lindore vite me radhë, dhe atë të gjithë kemi mundur ta vërejmë.

Edhe ne do të kishim situatë të ngjashme. Nën kontrollin e pronarëve të rinj të vendit tonë, edhe ne do të kishim shpejt një shumicë të jashtëzakonshme të të varfërve, perspektivat e të cilëve për të dalë nga varfëria e vet do të ishin shumë të pasigurta, shumë të largëta. Pakica e

të pasurve do të përbëhej nga elita e tregtarëve të zinj, e cila do të lejohej të qëndronte e pasur vetëm me kushtin që të ishte plotësisht besnike ndaj fuqive kontrolluese nga jashtë.

Pronat publike dhe shoqërore shpejt do të shndërroheshin në prona private, por pronarët e tyre, siç demonstrohet nga përvoja e fqinjëve tanë, do të ishin të huaj.

Ndër përjashtimet e pakta do të ishin ata që do të blinin të drejtën e tyre për pronësi me besnikërinë dhe nënshtrimin e tyre, që do të çonte në eliminimin e dinjitetit elementar kombëtar dhe njerëzor. Në rrethana të tilla, pasuritë më të mëdha kombëtare do të bëheshin pronë e të huajve dhe njerëzit që do t'i menaxhonin ato do të vazhdonin ta bënin këtë punë, por vetëm si punonjës të kompanive të huaja në vendin e tyre. Poshtërimi kombëtar, copëtimi i shtetit dhe mjerimi shoqëror do të çonin domosdoshmërisht në shumë forma të patologjisë shoqërore, nga të cilat krimi do të ishte i pari. Kjo nuk është vetëm një hamendje, kjo është përvoja e të gjitha vendeve që kanë marrë këtë rrugë e që ne po përpiqemi ta shmangim me çdo kusht.

Kryeqytetet e krimit evropian nuk janë më në Perëndim, ato u zhvendosën në Evropën Lindore një dekadë më parë. Njerëzit tanë e kanë të vështirë të mbajnë edhe shkallën e tanishme të krimit, sepse për një kohë të gjatë, që nga Lufta e Dytë Botërore e deri në vitet e nëntëdhjeta, ne kemi jetuar në një shoqëri që nuk njihnte pothuajse asnjë krim. Kjo rritje e jashtëzakonshme e krimit, nuk mund të shmanget në një shoqëri siç do të bëheshim ne me humbjen e sovranitetit tonë dhe një pjesë të madhe të territorit tonë, një krim i tillë më i gjerë do të ishte po aq i rrezikshëm për njerëzit tanë, të paktë në numër dhe të papërdorur në krim, po ashtu sikur lufta që është e rrezikshme për shoqërinë dhe qytetarët e saj. Një nga detyrat thelbësore të një qeverie kukull në çdo vend, duke e përfshirë edhe vendin tonë nëse do të kishim një qeverisje të tillë, është humbja e identitetit.

Shtetet nën komandën e huaj e harrojnë shpejt historinë e tyre, të kaluarën e tyre, traditën e tyre, simbolet e tyre kombëtare, mënyrën e tyre të jetesës, dhe, shpeshherë, edhe gjuhën e tyre letrare.

Identiteti ynë kombëtar do të shqyrtohej në mënyrë të padukshme në fillim, por pastaj në mënyrë shumë më efikase dhe të pamëshirshme, dhe disa aspekte të identitetit kombëtar do të zgjidheshin, duke e kufizuar atë në disa dëshira të kërkuara lokale, disa këngë dhe valle popullore me emrat e heronjve kombëtarë të përdorur si emrat e markave të produkteve ushqimore apo kozmetike.

Një nga pasojat reale të dukshme të pushtimit të shteteve nga fuqitë e

mëdha në shekullin 20 është asgjësimi i identitetit kombëtar të njerëzve.

Përvoja e vendeve të tjera tregon se njerëzit zor që mund të pajtohen me shpejtësinë me të cilën duhet të fillojnë të përdorin një gjuhë të huaj si të tyren, duke u identifikuar me figurat historike të huaja, ndërkohë që harrojnë gjuhën e vet, duke e njohur më mirë letërsinë e pushtuesve të tyre sesa letërsinë e tyre, duke lavdëruar historinë e të tjerëve, por duke u tallur me të tyren, në mënyrë që ata më shumë të ngajjnë me të tjerët sesa me veten e tyre.

Humbja e identitetit kombëtar është disfata më e madhe që mund ta përjetojë një komb, dhe është e pashmangshme nën formën bashkëkohore të kolonizimit.

Për më tepër, nga vetë natyra e saj, kjo formë e re e kolonizimit përjashton çdo mundësi të fjalës së lirë ose vullnetit të lirë, dhe veçanërisht përjashton kreativitetin e çdo lloji.

Shtetet që nuk janë të lira u mohojnë popujve që jetojnë në to të drejtën e fjalës së lirë, pasi që fjala e lirë, në mungesë të lirisë, do të shkaktoje probleme.

Kjo është arsyeja pse tortura mbi mendimet e gabuara është forma më e qëndrueshme dhe thelbësore e torturës në një vend që ka humbur lirinë. Sa i përket ushtrimit të vullnetit të lirë është natyrisht jashtë diskutimit. Lejohet vetëm për avokatet e pronarëve të huaj, vullneti i lirë i të cilëve përdoret nga pushtuesit si një përligjje për krijimin e një "demokracie" në emër të së cilës ata marrin dhe mbajnë një shtet të një populli të pushtuar.

Unë do të doja t'iu drejtohem veçanërisht të rinjve, intelektualëve, shkencëtarëve, etj., se vendet e privuara nga sovraniteti janë, si rregull, të privuara edhe nga e drejta për punë krijuese, por veçanërisht nga puna krijuese në fushën e shkencës. Qendrat e mëdha dhe fuqitë e mëdha financojnë punën shkencore, kontrollojnë arritjet e saj dhe vendosin për zbatimin e rezultateve të saj. Edhe nëse shtetet e varura kanë laboratorë shkencorë dhe institute shkencore, ato nuk janë të pavarura; ato veprojnë si degë të kontrolluara nga një qendër. Arritjet e tyre duhet të mbeten brenda kufijve të caktuar në mënyrë që të mos fusin farën e rebelimit dhe emancipimit në vendet e pushtuara dhe popujt e pushtuar.

Tani jemi në periudhën para balotazhit të zgjedhjeve. Opozita "demokratike" e Serbisë dyshon se mund të arrijë rezultatin që i nevojitet. Prandaj udhëheqësit e kësaj opozite po përpiqen të ndalojnë prodhimin, të gjithë punën, të gjithë aktivitetin. Duke përdorur paratë që dërgohen në vend, ata po iu japin disave ryshfet, duke shantazhuar ose ngacmuar të tjerët, duke organizuar greva, trazira dhe dhunë.

Ideja është që të ndalohet jeta në Serbi duke ofruar karremin se jeta mund të fillojë dhe të përparojë përsëri, vetëm nëse ajo organizohet nga ata që përfaqësojnë, brenda Serbisë – çfarë përfaqësojnë ata? Planet dhe interesat e pushtuesve të mundshëm.

Vendi ynë është një shtet sovran dhe ka ligjet e veta. E ka Kushtetutën dhe institucionet e veta. Serbia e meriton dhe është e detyruar të mbrohet nga ky pushtim, i cili ka filluar me këto përçarje të skenës dhe premtime të rreme për përmirësim të shpejtë.

Por edhe qytetarët duhet ta dinë këtë, se nëse disa marrin pjesë në këtë përmbyse, objektivi i të cilës është dominimi i huaj si dhe pushtimi i vendit të tyre, atëherë ata do të mbajnë përgjegjësinë historike jo vetëm për t'i mohuar vendit të tyre të drejtën për të ekzistuar, por edhe për të humbur kontrollin mbi jetën e tyre. Duke ualënë vendin e tyre të tjerëve dhe një vullneti të huaj, ata gjithashtu do t'i dorëzojnë një vullneti të huaj jetët e tyre dhe të fëmijëve të tyre si dhe jetët e shumë njerëzve të tjerë.

Unë e kam konsideruar si detyrë time për t'i paralajmëruar qytetarët e vendit tonë për pasojat e aktiviteteve të financuara dhe mbështetura nga qeveritë e NATO-s.

Qytetarë, ju duhet të vendosni vetë nëse do të më besoni apo jo.

Dëshira ime e vetme është që ata të mos e kuptojnë se unë po e them të vërtetën kur të jetë shumë vonë, që ata të mos e kuptojnë kur të bëhet shumë më e vështirë për t'i korrigjuar gabimet që disa njerëz i kanë bërë në mënyrë naive, sipërfaqësisht ose gabimisht. Disa nga ato gabime do të ishte vështirë për t'i korrigjuar dhe disa nuk do të korrigjoheshin kurrë. Motivi im gjatë shprehjes së mendimeve të mia, në këtë mënyrë nuk është personal; aspak. Unë u zgjodha dy herë president i Serbisë dhe njëherë president i Jugosllavisë. Duhet të jetë e qartë për të gjithë, pas dhjetë viteve të fundit, se NATO-ja nuk po sulmon Serbinë për shkak të Millosheviqit; por po e sulmon Millosheviqin për shkak të Serbisë. Ndërgjegjja ime në këtë aspekt është e pastër.

Por, ndërgjegjja ime nuk do të ishte e pastër nëse nuk do t'i thosha popullit tim, pas gjithë këtyre viteve si udhëheqës të tyre, atë që unë mendoj që mund të ndodhë nëse ata lejojnë që fati i tyre të imponohet nga një forcë e jashtme armiqësore, edhe nëse duket se ata e kanë zgjedhur atë fat për veten e tyre.

Gjykimi i gabuar që ata do të bënin duke "zgjedhur" atë që është zgjedhur për ta, është gjykimi i gabuar më i rrezikshëm i mundshëm. Kjo është arsyeja pse unë sot po i drejtohem publikisht qytetarëve të Jugosllavisë.

Faleminderit.

10.0. BIBLIOGRAFIA

10.1. Literatura

- Aristoteles. (1983) Retorikk, Platonselskabets skriftserie, Pærkthyer nga Thure Hastrup, Museum Tusculanums Forlag, København.
- Berthold, Carol A. (1976) "Kenneth Burke's cluster – agon method: Its development and an Application." *Central States Speech Journal*, 27 (1976): 302-309.
- Blitzer, Lloyd F: 1968. "The Rhetorical Situation". *Në Philosophy and Rhetoric* 1/1968
- Bitzer, Loyd. F. (1997) "Den retoriske situasjon", *Rhetorica Scandinavica*, Nr. 3 – 1997, Version 2006 -06. København.
- Black, Edwin. (1999) "*Den andre persona*." *Rhetorica Scandinavica*, *Rhetorica Scandinavica*, Tidsskrift for Skandinavisk Retorikforskning, nr. 9. s. 7-16. København.
- Buda, Aleks; Frasheri, Kristo; Pollo, Stefanaq; Alibali, Jusuf; Plasari, Ndreci. (1969) *Historia e Popullit Shqiptar*, Rilindja - Prishtinë.
- Burke, Kenneth. (1937) *Attitude towards history*, New York The New Republic, Volume 2. Copyright, 1937, Editorial Publications, Inc, Printed in the U.S.A.
- Burke, Kenneth. (1939) "Klassikeren: Retorikken i Hitlers 'Min Kamp'." *Rhetorica Scandinavica*, Tidsskrift for Skandinavisk Retorikforskning, nr. 4. 1997, s. 9-20.
- Burke, Kenneth. (1941) *The Philosophy of literary form*, Studies in Symbolic Action, Louisiana State University Press.
- Burke, Kenneth. (1945) *A Grammar of Motives*, Prentice-Hall, Inc, New York.
- Charland, M. (1987) *Constitutive rhetoric: The case of the people quebécois*, *The Quarterly Journal of Speech*, Volume 73, May 1987, Number 2.
- Chery, Roger D. (1998) "Ethos Versus Persona. Self- Representation in wrritten Discourse" i *Written Communication*, vol. 15, nr. 3, SAGE Publication, Inc.

- Cubrilovic, V. (1937) "The expulsion of the Albanians", Memorandum presented on March 7, 1937 in Belgrade.
- Doucette, R. Serge, Ph. D; Thaqi, Hamdi. (2004) Kosovo "Moral Democracy" or Kosovo "Greater Serbia", Preview Edition, Europrinty; Prishtina, Kosovo.
- Foss K., Sonja. (1996) "Metaphoric Criticism", Rhetorical Criticism, Exploration and Practice, Second Edition, Waveland Press, Inc.
- Jacques, Edwin. (1995) E.: The Albanians. An Ethnic History from Prehistoric Times to the Present. Jefferson/NC: McFarland & Co.
- Judah, Tim. (2002) Kosovo. War and revenge, Second Edition, Yale Nota Bene.
- Kjeldsen E. Jens. (2004) Retorikk i vår tid – en innføring i moderne retorisk teori, spartakus forlag. Oslo.
- Kjeldsen E. Jens & Meyer Siri (red). (2004) Krig, rett & retorikk, En bok om kommunikasjons regimer, Rhetor foralg.
- Klujeff, Lund Marie. (2006) "Retorisk publikum" (s. 91 – 112). Retorikens Aktualitet, Grundbog i retoriske analyse, I utgave, I. Opplag. @ Forfatterne og Hans Reitzels Forlag.
- Mathiesen, Thomas. (2002) Makt og Medier, En innføring I mediesosiologi, Pax Forlag A/S, Oslo.
- Malcolm, Noel. (2001) Kosovo, A short history, Koha, Prishtinë – Tirana.
- Malcolm, Noel. (2002) Kosovo, A short history, Pan Books – London.
- McGee, Calvin Michael, *The "ideograph ": A link between rhetoric and ideology*, The Quarterly Journal of Speech, Volume 66, 1980, Number 1.
- McGee, Calvin Michael, *In search of "the people": A rhetorical alternative*, The Quarterly Journal of Speech, Volume 61, October 1975, Number 3.
- Mønnesland, Svein. (1999) Institutt for østeuropeiske og orientalske studier, Morgenbladet 30/5-99.
- Mønnesland, Svein. (1999) Før Jugoslavia og etter. @ 1992 sypress forlag. 4. utgave.
- Mønnesland, Svein. (1994) Kosovo, Syress Forlag, Aktuell Informasjon 1/94.
- Fjalori Norvegjez, Aagot Landfal og Kjell M. Paulsen. (1998) Cappelens Ordbok, Bokmål, Oslo.

- Perelman, Ch. and Tychta-Olbrechts L. 1971 (Së pari u botua në gjuhën franceze në Paris 1958) *The New Rhetoric, A treatise on Argumentation*. University of Notre Dame Press (Përkthyer në gjuhën angleze në 1969)
- Petritsch, Wolfgang. (1999) *Kosovo. Mythen – Daten – Fakten*. 2. Aufl. Klagenfurt: Wieser Verlag.
- Ramosaj, Fetnete. (2005) *Serbian crimes in Kosovo, Without Apology, Facts against defamations, Translated from Albanian by: Ramize Ferati (Reprint)*, Prishtina.
- Sloane, O. Thomas. (2001) "Constitutive rhetoric", (s. 616-619), *Encyclopedia of rhetoric*, Oxford, University Press.
- Vatz, Richard (1973) "The Myth of the Rhetorical Situation", në *Philosophy & Rhetoric*, Vol. 6. No. 3. Përkthyer në gjuhën daneze në *Rhetorica Scandinavica*, 2002, København.
- W. E. Griffith. (1963) *Albania and the Sino-Soviet Rift*, Cambridge, Massachusetts. N. C. Pano. (1968) *The Peoples' Republic of Albania*, Baltimore.
- White, Boyd James. (1984) *When Words lose their meaning. Constitutions and reconstitutions of Language, Character, and Community*. The University of Chicago Press, Ltd., London@ 1984.

10.2. Webfaqe

2000: Milosevic quits, street celebrations continue, http://news.bbc.co.uk/onthisday/hi/dates/stories/october/6/newsid_2516000/2516673.stm

Geschichte der Raumbegriffe zum Östlichen Europa, http://www.lpb-bw.de/oe_eu/allgemeines/allg_reg.php [online 16. dhjetor 2005].

www.nato.int/docu/review/2004/issue2/norwegian/special.html - 32k - [online 11. dhjetor 2005].

Latest press releases and press advisories, <http://www.un.org/icty/latest-e/index.htm> [online 03. nëntor 2005].

President Slobodan Miloseviç's address to the nation, (10 June 1999) Belgrade, Yugoslavia, <http://www.slobodan-milosevic.org/news/milosevic061099.htm> [online 20. maj 2005].

President Slobodan Milosevic's address to the nation (2. tetor, 2000)

Beograd, <http://www.slobodan-milosevic.org/spch-oc2000.htm> [online 20. mai 2005].

Ustav i referendum u miloševićevoј srbiji, (Reč no. 74/20, 2005.) <http://www.fabrikaknjiga.co.yu/rec/74/33.pdf> [online 24. shkurt 2005].

Stor-Serbia, <http://no.wikipedia.org/wiki/Stor-Serbia> [online 27. prill 2004].

Military technical agreement, <http://www.afsouth.nato.int/operations/kfor/mta.htm> [online 17. mai 2005].

Det politiske samarbeid, St. meld. nr. 49 (2000-2001), <http://www.regjeringen.no/nb/dep/ud/dok/regpubl/stmeld/20002001/Stmeld-nr-49-2000-2001-/2.html?id=195155> [online 08. februar 2005].

Foto: Beograd 06. tetor 2000, Demonstratat kundër Millosheviçit, Beograd 06. tetor 2000, http://sr.wikipedia.org/wiki/Slobodan_Milosevic [online 28. mai 2005].

10.3 Artikuj të gazetave

Koha Ditore (15 dhjetor 2006) “Nauman: Millosheviçi më tha se do t'i pushkatonte të gjithë shqiptarët e Kosovës”, faqe 2, Koha Ditore.

<https://www.koha.net/arberi/134983/si-e-deboi-serbia-kosoven/>

Dagsavisen (03 shkurt 07) “Fakta om Kosovo”, faqe 18, NTB.

10.4 Videoincizimi

RTB (1989) Videoincizimi original i Millosheviçit, prodhuar nga televizioni serb, Radio Televizija Beograd, 26. Qershor, 1989.

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

94(496.51)(042.5)

Mekuli, Gëzim

Fjalimet që përgjakën Ballkanin : analizë retorike
e fjalimeve të Millosheviqit / Gëzim

Mekuli. – Prishtinë : Alfabeta J&H, 2022. - 182 f. :
ilustr. ; 24 cm.

Historia -- Kosovë -- Fjalimet

Shkrime, korrespondenca për shtypin

ISBN 978-9951-826-08-2

Aleph [000100726]